

Lufta e Kosovës

DILAVER GOXHAJ
(SHPËTIM GOLEMI)

LUFTA
E
KOSHARES

(Analiza, ballafaqime, krahasime dhe replika)

Radio Kosova e Lirë,
Prishtinë, 2019

Dilaver Goxhaj

Autor: Dilaver Goxhaj

Titulli
Lufta e Koshares

Redaktor:
Ahmet Qeriqi

Recensent:
Prof.dr.Bernard Zotaj

Kopertina
Nevila Nallbani

Arti grafik
Nevila Nallbani

© Copyright i këtij botimi i rezervohet autorit

ISBN

Botuar në «Shkrola» Prishtinë

I D E J A

e hapjes së korridorit në Koshare!



“Të mburren ata që luftuan në Pashtrik, deri diku kanë të drejtë. Por të mburren ata që luftuan në Koshare, nuk kanë të drejtë.

Pse s’kanë të drejtë?

Ata luftuan 65 ditë. Kishin furnizime të bollshme në të gjitha llojet e armëve e shërbimeve. Dhe të luftosh 65 ditë, e të mos hapësh dot korridorin...?! Ata luftuan. Luftuan me heroizëm. Nuk u turpëruan. Por detyrën nuk e kryen.

Dhe mua më ka bërë përshtypje, ngaqë kam dëgjuar shpesh herë në mediat tuaja, në Prishtinë, ku thuhet se: beteja më e madhe, nderi më i madh është “Beteja e Koshares”. Dhe dikush thotë: Ja, shikoni, edhe Serbia i ka vënë një rrugë në Beograd emërtimin “Beteja e Koshares”.

Tashti, kush ka të drejtë të mburret?

Ka të drejtë Serbia, sepse ne nuk e realizuam dot detyrën. Ajo na bllokoi. Kështu që, ne s’kemi pse mburremi me një “betejë” që s’e fituam...

Por, me sa shoh unë, ju në Kosovë jeni infektuar nga Serbia, festoni humbjet?!...

Nëse Kosova do të kishte shtet të rregullt, komanda dhe shtabi i kësaj brigade duhej t’i jepej gjyqit ushtarak, për mos zbatim urdhëri e detyre...”

Dilaver Goxhaj

TV Dukagjini, 10 tetor 2018



S Q A R U E S E

***“Të gabosh është njerëzore,
por të ngulësh këmbë në gabim është djallëzore.”***



Latine

ANALIZAT e ngjarjeve historike kanë për objekt studimi veprimet e njerëzve, sidomos vullnetin e atyre që zenë vendin më të rëndësishëm në atë ngjarje. Edhe cikli i shkrimeve të këtij libri ka për objekt studimi dinamikën e një lufte disa mujore, prill-qershor 1999. Kjo luftë është zhvilluar në një pjesë të brezit kufitar Kosovë-Shqipëri, në drejtimin e përgjithshëm Tropojë – Gjakovë, midis një njësie taktike (brigadë) luftarake e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës (UÇK), kundër një pjese të Ushtrisë Serbe në Kosovë. Kjo ngjarje historike është bërë e njohur me emërtimin “Beteja e Koshares”.

Analiza e kësaj “beteje” përqendrohet kryesisht në veprimtarinë e Komandës dhe të Shtabit të kësaj njësie taktike të UÇK-së, e formuar me vullnetarë të ardhur nga radhët e emigracionit dhe diaspora shqiptare. Njësia taktike e UÇK-së fillimisht ka qenë e emërtuar: Grupi i Tretë Operativ (GO-3), por më pas ka marrë emërtimin zyrtar: Br.138 “Agim Ramadani”.

Lufta dymujore e Koshares dhe pasojat e saja – (rënia e 114 dëshmorëve dhe gjymtimi i mbi 350 luftëtarëve të tjerë), - është një prej ngjarjeve më të veçanta të historisë së luftës çlirimtare në Kosovë, 1997-1999. Kjo veçanti qëndron në faktin se, edhe pse ajo njësi takike e UÇK-së nuk mundi ta realizonte detyrën luftarake të dhënë nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, megjithatë është shpallur nga Presidenti i Kosovës, z.Hashim Thaçi, si formacioni luftarak më i lavdishëm Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës! Kuadri i saj komandues kanë 20 vjet që mburren duke thënë: “Ne kemi fituar betejën më vendimtare të Luftës për Çlirimin e Kosovës”. Dhe kjo u bë e besueshme për masën e gjerë të popullit në Kosovë, pasi dihet që legjendat popullore nuk bazohen në vlerësime të sakta dhe studime shkencore. Madje mediat kanë krijuar një iluzion, sipas të cilit “Beteja e Koshares” paraqitet si një përpjekje heroike që i solli Kosovës fioren vendimtare.

Ngjashëm lëvdohen edhe kuadrot drejtuese të palës kundërshtare, pala serbe, të cilët kanë përgatitur dhe e kanë bërë publik një film dokumentar me metrazh bukur të gjatë.

Janë këto gjykime të marrëzishme që më nxitën të qartësoj jo vetëm se cila është pala fituese e atyre luftimeve, por edhe cili është qëllimi i asaj mburrjeje jo dinjitoze. Në këtë analizë të gjatë, që po i paraqes lexuesit përmes këtij libri, më rezulton se të drejtën për t’u mburrur si fitues, për fatin tonë të keq, e ka pala kundërshtare, të cilën e tregoi rezultati përfundimtar. “Fundi është ai që kurorëzon veprën”, thotë Virgjili.

Të shtrembërosh të vërtetën e asaj “fitoreje”, sikundër veprohet nga ana e shumë kuadrove të GO-3, me të vetmin qëllim për t’ia përshtatur dëshirave të udhëheqjes së kësaj

njësie taktike, duke e trumbetuar madje dhe me të madhe, se “Betejën e Koshares” e fituan forcat tona, kjo është e papranueshme edhe thjesht për faktin, se është jo vetëm një luftim i humbur nga ana e jonë, por edhe me pasoja të mëdha.

Të bëhej fjalë se kishim të bënim me një ndeshje që nuk ka zgjatur shumë gjatë asaj lufte dy-vjeçare në Kosovë, e ku të kishin marrë pjesë një numër i vogël forcash e me humbje të pakta, ne edhe mund ta quanim këtë ngjarje si një përjashtim. Por ajo ngjarje disa mujore u zhvillua para syve tanë, duke u ndjekur me interes të jashtëzakonshëm jo nga dita në ditë, por nga ora në orë, ngaqë ishte në lojë jo vetëm jeta e disa mijëra njerëzve pjesmarrës në të, por edhe fati i asaj ushtrie çlirimtare (UÇK-së) dhe i luftës së saj. Njëkohësisht, përmes kësaj analize të gjatë, duke hulumtuar sa më shumë dëshmitarë të ndryshëm, jam munduar të nxjerr në pah të vërtetat rreth asaj lufte dymujore si dhe ta demantoj edhe qëllimin djallëzor të kësaj propagande me një ogur të zi, qëllimi i së cilës është: të lihet gradualisht në hije, mundësisht të eklipsohet plotësisht ekzistenca e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si dhe gjithë lufta e zhvilluar prej saj.

Të thuash se “Betejën e Koshares” nuk e fituam, nuk është turp, pasi për këdo që lufton, humbja nuk është turp. Jo çdo betejë fitohet. Por edhe sikur të ishte fitore, ngaqë ato forca depërtuan 3-5 km në thellësi të Kosovës, duke u lëvdur së tepërmi, i kaluan kufijtë e saj, kur dihet që ajo nuk u shtri në një vepër jetëgjatë, siç do të ishte hapja e korridorit. Ndaj dhe është një lavdi shterpë. Por më e keqja është se duan ta nxjerrin si fitoren e vetme të luftës së UÇK-së!

Të njëjtin mohim të kontributit të UÇK-së bëjnë edhe profiterët e asaj luftime çlirimtare, por me pak ndryshim, duke thënë se Kosovën e çliroi veç NATO-ja, pa e përmendur fare UÇK-në. Këtë e dëgjuam edhe nga një anëtar i rëndësishëm i ish-Drejtorisë Politike të UÇK-së ai dhe ish-Shefi i Kundërzbulimit të saj, z.Kadri Veseli, me rastin e 20 vjetorit të çlirimit të Kosovës, në prezencë të ish-Presidentit Klinton, në Prishtinë, i cili na befasoi kur tha: “Ju, 20 vjet më parë, shpëtuat një komb të tërë. Shpëtuat fëmijët e pastrehë dhe të frikësuar, prindërit e pashpresë dhe të tmerruar; nënat, gratë, vajzat e pambrojtura. **Shpëtuat një popull të tërë nga gjenocidi.**”¹⁾); kur vetë Presidenti Klinton në 23 maj 1999 pat thënë se është UÇK-ja ajo që me ofensivat e saj i nxjerr forcat serbe nga skutat ku fshihen për t’u goditur nga forcat ajrore të NATO-s²⁾). **Që do të thotë, se pa UÇK-në nuk do të qe shpëtuar ky popull nga gjenocidi.**

Të mos na vijë keq, por këto dy dekada është vërtetuar se imazhi i UÇK-së është dëmtuar më së tepërmi nga vetë shqiptarët! Dhe për këtë nuk kanë reshtur as simpoziumet farsë; as akademitë komparative; as përkujtimi i përvitshëm i asaj “beteje” në vendin e ngjarjes pothuajse 20 vite rresht; as botimi i shumë librave, analizave dhe shkrimeve të një numuri të jashtëzakonshëm gjatë këtyre dy dekadave etj, etj, ku në shumicën e rasteve UÇK -ja ose lihet në plan të dytë, ose nuk përmendet fare, kur dihet se faktori i brendshëm është faktori kryesor. Nuk thuhet më kot, se mediat janë krahu i djathtë i anarkisë. Gjithë këto veprimtari mediatike nga kjo kategori mohuesish dhe përkahësit e tjerë mediatikë

1) RKL, 12 Qershor 2019

2) Bill Klinton “Ne luftën, ju paqen”, Tiranë, 2000, f. 82

e politikë, duke filluar menjëherë pasi mbaroi lufta, kësaj fryme i kanë bërë jehonë. Edhe anulimi i simpoziumit për Luftën Çlirimtare të Kosovës, planifikuar për në 23 Nëntorin 1999 dhe mos organizimi i tij për 20 vite rresht, të ndihmuar edhe nga UNMIK-u e EULEX-si, kanë treguar dhe tregojnë se ka një prapavijë edhe më të dëmshme: kthimin e Ibrahim Rugovës në fronin e presidentit, duke e paraqitur atë si figura e vetme kryesore politike e ushtarake për çlirimin e Kosovës; dhe, së dyti, denoncimin e Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si ushtri terroriste. Qëllimi i parë është realizuar tërësisht në të gjitha aspektet; qëllimi i dytë është në proces. Pas bombardimit propagandistik kundër saj, tash e kanë paditur në Gjykatën Ndërkombëtare, që unë do ta quaja Gjykata që ka për ta damkosur UÇK-në me turp, si ushtri terroriste. Asaj propagande i kanë dhënë një ndihmë të madhe edhe ish-kuadrot drejtuese kryesore të saj, politikë e ushtarakë, me një përjashtim shumë të pakët, të cilët, me degjenerimin e tyre moral e politik, jo vetëm që e privatizuan atë luftë por kanë privatizuar edhe pasuritë kombëtare të Kosovës.

Gjithkush që ka dy pare mend pyet: Mos vallë gjithë kjo propagandë ka për qëllim të rivendosin të drejtat dhe privilegjet e klasës politike të dikurshme, si dhe të largojnë nga Kosova, atdhetarët duke u munduar të gjenden forma që Kosovën t'ia rikthejnë Serbisë? Jeta ka vërtetuar se gjithçka që flitet nuk është pa gjë.

Por na ngushëllon fakti se kjo tendencë antikombëtare ka gjasa të mos realizohet ngaqë bie ndesh me dëshirën mbarë popullore dhe se ekziston vetëm në interesin e disa familjeve të LKJ së dikurshme për Kosovën, por edhe të disa familjeve prej drejtuesve kryesorë të UCK-së.

Ndoshta gabohem, por këto qëllime i vërteton edhe vetë fakti i dekorimit nga Presidenti Hshim Thaçi, ish-Drejtori Politik i UÇK-së, të formacionit që zhvilloi “Betejën e Koshares” me motivacionin: “*Një ndër betejat më të rëndësishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!*”³⁾), i cili deri sot nuk ka dekoruar asnjë formacion tjetër të UÇK-së. Në politikë, ka thënë dikur Presidenti Ruzvelt, asgjë nuk ndodh kurrë rastësishtë.

* * *

Natyrisht që gjithkush don me ditë se kur dhe ku është zhvilluar kjo “Betejë e Koshares”; cilat kanë qenë këto forca që zhvilluan këtë betejë; në një moment të caktuar të luftës a bënte pjesë kjo betejë në strategjinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; cili ka qenë misioni i kësaj beteje; kush e ka planizuar këtë betejë; si është zhvilluar dhe cili ka qenë realizimi i kësaj beteje; çfarë përfitoi Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe lufta çlirimtare në tërësi nga kjo betejë etj, etj.

Të gjitha këtyre pyetjeve jemi munduar t’u japim përgjigje përmes këtij libri, në një kënd vështrimi analitik ushtarak.

Po, me të drejtë dikush mund të pyesë, se pse u dashka ta analizojmë “Betejën e Koshares” pas 20 vjetësh, dhe nuk është reaguuar kur vetë komandanti dhe shtabi i forcave që kanë drejtuar “Betejën e Koshares” kanë organizuar një “simpozium shkencor” menjëherë pas 9 muaj si kishte përfunduar lufta në Kosovë?

Së pari, duhet bërë e qartë se simpoziumi shkencor i mbajtur më 9 prill 2000, në qytetin e Gjakovës, nga udhëheqja e atij formaconi luftarak që pat zhvilluar

3) RKL, 12 qershor 2019

“Betejën e Koshares”, është organizuar duke u kufizuar vetëm te kuadrot që morën pjesë në atë “betejë”, pa bërë thirrje publike ose ftesa për ne ushtarakët dhe politikanët që kemi qenë në kontakt të përditshëm me Luftën në Koshare, as historianë e studjues ushtarakë, me përjashtim të ish-Komandantit të Zonës III Operative “Dukagjini” të UÇK-së, gjeneral Ramush Haradinaj, dhe ish shefin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, gjeneral Agim Çeku, të cilët në ato ditë që të dy ishin komandant dhe shef shtabi të Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Por nga këta të dy vetëm Ramush Haradinaj ka qenë i njohur me organizimin dhe qëllimin e asaj “beteje”, ndërsa gjeneral Agim Çeku ende nuk ishte angazhuar në rradhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kur filluan luftimet në Koshare. Kështu që, ai simpozium është organizuar si një lloj simpoziumi lokal, pothuajse si gjysëm ilegal.

Me sa kuptohet ata kanë pas qëllim që fillimisht të tatohej pulsi i masës së madhe të UÇK-së dhe, në rast se nuk do të kishte reagime, të fillonin nga propaganga glorioze për atë “betejë”, sikundër edhe jemi dëshmitarë gjatë gjithë këtyre 20 viteve të pasluftës. Bazuar në atë çfarë është bërë tashmë publike, ata e kanë trajtuar “Betejën e Koshares” si një rast i veçantë në historinë e gjithë luftrave dhe kryengritjeve në Kosovë dhe jo vetëm të UÇK-së, duke përdorur slloganin: “vetëm profesionistët mund ta drejtojnë luftën sikundër drejtuan me sukses Betejën e Koshares”. Ky është një trillim, për të cilin lexuesi do të marrë informacion të gjerë në këtë libër.

Po cilët janë organizatorët dhe drejtuesit e “Betejës së Koshares”?

“Betejën e Koshares” e kanë përgatitur dhe drejtuar një grup oficerash profesionistë ushtarakë shqiptarë të shkolluar nëpër akademitë e ndryshme ushtarake të ish-Jugosllavisë. Shumica e tyre kanë qenë angazhuar 2-3 muaj në luftën për çlirimin e Kosovës, në periudhën qershor-gusht 1998, në Zonën e Dukagjinit. Pothuajse të gjithë ata janë me vendlindje prej trevës së Dukagjinit, dhe në javën e parë të shtatorit 1998 u larguan nga Kosova, për mos të thënë dezertuan nga lufta, duke ia dozuar armatimin ushtarisë serbe, (gjë që pasqyrohet edhe në këtë libër), dhe shkuan në shtetin amë, Shqipëri, së bashku me një pjesë të efektivit të Br.131 dhe 134 të asaj zone operative.

Dhe ajo çka është edhe më interesante, ata largimin nga Kosova e justifikojnë me një lloj absurditeti që vetëm ata mund ta besojnë. Ata thonë se Kosova nuk mund të çlirohej nga ngritja në luftë e gjithë popullit, duke krijuar ushtrinë e vet çlirimtare, dhe as me luftë guerile. Me këtë propagandë, të veshur me petkun e strategjisë ushtarake, ata indirekt duan t’i vinë në takim strategjisë pacifiste të Ibrahim Rugovës.

Strategjia e këtyre oficerave profesionistë ka qenë dhe është: Kosova nuk mund të çlirohet nga vetë populli i armatosur, por, vetëm duke sulmuar nga jashtë saj, me

ushtri të përgatitur në Shqipëri, dhe me kushtin duke u drejtuar vetëm nga ushtarakë profesionistë.

Na rezulton se kjo lloj strategjie nuk ka qenë thjesht ide e këtij grupi oficerash, por e vetë ish-presidentit Rugova dhe Qeverisë Bukoshi, duke ia ngarkuar këtë detyrë Ministrisë së Mbrojtjes të asaj qeverie. Këtë fakt na e vërteton qartë z.Anton Çuni në intervistën e tij, më 2 maj 2019: *“Kur jam paraqit për herë të parë në një objekt të Ministrisë së Mbrojtjes, në dhomën operative, ka qenë në mur një hartë,- kjo ka ndodh në fillim të korrikut 1998, - e cila ishte mbuluar me një stof. E shpalosa. Aty pashë se dikush kishte parapa një ndërhyrje strategjike që të kishte hapje të kufijve, në Qafë të Prushit, Qafë të Morinës... E kemi paraparë për një ndërhyrje.”⁴⁾*

Këtë lloj strategjie na e pohon vetë Komandanti i GO-3 (Br.138), z.Rustem Berisha në simpoziumin e organizuar po prej tij, më 9 prill 2000, në Gjakovë:

“në situatën e pashpresë, kur popullsia e kësaj ane (brenda në Kosovë, D.G) mund të ishte tashmë jo vetëm pre e luftimeve intensive të ushtrisë serbe, por edhe e terrenit të papërshtatshëm dhe të minuar në rajonin e gjerë të Bjeshkëve të Nëmura, si kalim i vetëm i mundshëm për evakuim. Këto ishin rrethanat që edhe më shumë e lidhën motivin dhe idenë tonë për një luftë nga kufiri e deri në çlirim, tek luftëtarët, konkretisht tek ne si ushtarakë që drejtonim këtë brigadë.”⁵⁾

Në vjeshtën e vitit 1998 këta oficerë, të mbështetur dhe inkurajuar nga Ministria e Mbrojtjes e Qeverisë Bukoshi, u

4) Shih Shtesën Nr.16 të këtij libri.

5) M. Çetta, “Me UCK-në në Kosharë”, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2000, v.2, f.262

riorganizuan dhe krijuan disa qendra stërvitore në veri të Shqipërisë. Por është fakt, se shumica e atyre që u stërvitën nën drejtimin e këtij kontigjenti oficerash, nuk u angazhuan asnjëherë në luftë, sikundër ishte “Brigada Mërgimi”, e dislokuar në Mamuras, dhe ata në Qerret të Kavajës, përveç kontigjentit prej 256 luftëtarë që sulmoi në 9 prill 1999 në Koshare.

Në 21 janar 1999 këto forca u grumbulluan në Qendrën Stërvitore në fshatin Babinë të Tropojës dhe më 2 prill, të gjitha njësitë u zhvendosën në fshatin Papaj, në afërsi të kufirit, ku dhe u bë furnizimi i tyre me armatim e municione për të pritur datën 9 prill 1999, kur filluan sulmin në Koshare⁶⁾.

Kur u angazhua NATO në luftë me aviacionin e saj, gjë që u bind edhe më skeptiku se lufta në Kosovë do të fitohej nga shqiptarët, këta oficerë dhe një pjesë e ushtarëve që luftuan bashkë me ta në 1998, vendosën që të riangazhoheshin në luftë, për të vënë në jetë strategjinë e shprehur më lartë: të çlironin Kosovën duke sulmuar nga territori i Shqipërisë. Kjo kërkesë e tyre, për sulm në Koshare, u miratua edhe nga Ministria e Mbrojtjes e Qeverisë së Përkohëshme e Kosovës si dhe nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës. Gjithashtu u miratua edhe drejtimi që ata kishin zgjedhur për të sulmuar, rajoni i Koshares. Kjo nismë e tyre u mirëprit jashtëzakonisht nga SHP, pasi UÇK-ja kishte shumë nevojë për armë, municione dhe materiale të tjera për luftën si dhe për popullin që i ishte bashkangjitur formacioneve të UÇK-së.

Detyra e dhënë këtyre forcave nga SHP ishte: **Hapja e korridorit të funizimit në drejtimin Padesh-Nivokaz**, si

6) M. Çetta, v.2,f.254

drejtimi më i shkurtër. Detyra e afërt ishte: dalja në bregun jugor të lumit Erenik, (me thëllësi 5-6 km.); detyra e largët: lumi Drini i Bardhë.

Si rrjedhojë, SHP i UÇK-së e fuqizoi këtë forcë luftarake gradualisht, (duke dërguar vijimisht kompani dhe batalione prej ditës së parë të atij sulmi, si dhe armatim e municione), me mbi 2.000 luftëtarë. Këta ishin vullnetarë të ardhur nga diaspora si dhe nga gjithë trojet shqiptare e që stërviteshin në Qendrat Stërvitore në Shqipëri. Përgatitjen dhe organizimin e tyre e bënte Ministria e Mbrojtjes e QPK në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë dhe SHP të Ushtrisë Shqiptare. Këto qendra ishin ngritur në Feken (Mali me Gropa), Helshan (Krumë) dhe në qytetin e Burrelit. Vullnetarët, të cilët vinin përmes portit të Durrësit, fillimisht grumbulloheshin në qendrën “Drenica”, në Durrës.

Forcat nismëtare të “Betejës së Koshares”, që nuk ishin më shumë se 256 vetë, qenë emërtuar nga Ministria e Mbrojtjes së Qeverisë Bukoshi “Grupi i Tretë Operativ” (GO-3). Por, SHP i UÇK, pasi ky formacion u pagëzua me luftën, e emërtoi Brigada 138 e UÇK-së, duke e kaluar në vartësi të Zonës III Operative “Dukagjini”. Pas një muaji u pagëzua edhe me emërin e ish-shefit të saj të shtabit, Agim Ramadani, i cili vritet pas 48 orësh si pat filluar Lufta në Koshare.

Çuditërisht, menjëherë sa vritet shefi i shtabit i këtij formacioni luftarak, komandanti dhe shtabi i “Grupi i Tretë Operativ” (GO-3), sikundër shpjegohet edhe në këtë libër, e ndërpresin mësymjen dhe kalojnë në mbrojtje. Këtë vendim ata e marrin pa marrë miratim prej SHP të UÇK-së. Dhe menjëherë filluan me organizimin e mbrojtjes, duke krijuar

një front mbrojtjeje me gjerësi 15 km, në një thellësi 2-5 km, brenda kufirit politik të Kosovës. Ky formacion luftoi në mbrojtje, në këtë brez kufitar 65 ditë të tjera, derisa u futën forcat e NATO-s (KFOR-i) në Kosovë.

Me të drejtë dikush nga lexuesit edhe mund të indinjohet e mund të pyesë se pse është ndërmarrë me kaq vonesë nga ana e ime kjo analizë për të ashtuquajturën “Betejën e Koshares”?

Edhe kjo ka historinë e vetë.

Ditët e para të muajit tetor 2018 më telefonon Kryetari i Shoqatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për Shqipërinë, z.Sokol Poga, dhe më fton, duke më thënë: “ A pranoni të merrni pjesë në një emision televiziv, TV Dukagjini, i cili ka një rubrikë të veçantë të tij, të emërtuar “Debat Plus”, e ka për qëllim të intervistoi edhe ish-ushtarakë nga Shqipëri, që kanë qenë të angazhuar me luftimet e zhvilluara në Koshare dhe në mal të Pashtrikut”? Pranova. U intervistova edhe unë. Intervista u zhvillua në ambientet e një hoteli turistik në Durrës dhe është transmetuar pas 7-8 ditësh, më 10 tetor 2018. Midis të tjerave, kur u pyeta për Betejën e Koshares, unë thashë:

“Të mburren ata që luftuan në Pashtrik, deri diku kanë të drejtë. Por të mburren ata në Koshare, nuk kanë të drejtë. Pse s’kanë të drejtë? Ata luftuan 63 ditë. Kishin furnizime të bollshme në të gjitha llojet e armëve e shërbimeve. Dhe të luftosh 63 ditë, e të mos hapësh dot korridorin...?! Ata luftuan. Luftuan me heroizëm. Nuk u turpëruan. Por detyrën nuk e kryen. Dhe mua më ka bërë përshtypje, ngaqë kam dëgjuar shpesh herë në mediat tuaja, në Prishtinë, ku thuhet se: beteja më e madhe, nderi më i madh është “Beteja e Koshares”. Dhe dikush thotë: Ja, shikoni, edhe

Serbia i ka vënë një rrugë në Beograd emërtimin “Beteja e Koshares”. Tashti, kush ka të drejtë të mburret? Ka të drejtë Serbia, sepse ne nuk e realizuam dot detyrën; ajo na bllokoi. Kështu që, ne s’kemi pse mburremi me një “betejë” që s’e fituam... Por, me sa shoh unë, ju në Kosovë jeni infektuar nga Serbia, festoni humbjet?!... Nëse Kosova do të kishte shtet të rregullt, komanda dhe shtabi i kësaj brigade duhej t’i jepej gjyqit ushtarak, për mos zbatim urdhëri dhe detyre luftarake...”

Menjëherë pas transmetimit të asaj interviste filluan shkrimet dhe komentet fyese nga shumë pjestarë të “Betejës së Koshares”. “Kritikat” e tyre fyese ishin pa asnjë lloj argumenti që të mund të rrëzonin me fakte këtë deklaratë time. Që lexuesi të ketë mundësinë të njihet me ato “kritika”, ato ia kemi bashkangjitur këtij libri, si pjesë e veçantë e tij. Bazuar në përmbajtjen e atyre “kritikave”, thënë më saktë: fyerje, mund të them pa ndrojtje: nëse nuk janë injorantë në njohjen e artit të luftës, duhet të jenë shejtanë.

Unë, përmes kësaj analize, i dënoj rëndë ata komandues ushtarakë profesionistë të GO-3, për mos realizimin e asaj detyre, për disa arsye:

- 1- Luftimi në Koshare është një luftim që është zhvilluar në një terren të njohur shumë mirë prej të gjithë oficerave të këtij formacioni luftarak;
- 2- Është një terren dhe drejtim i zgjedhur po prej tyre dhe jo i rekomanduar nga dikush tjetër;
- 3- Është një terren i hetuar regullisht 5-6 muaj më herët po prej tyre, dhe intensivisht 40 ditë resht para sulmit;
- 4- Është një terren i studjuar prej tyre me imtësi me syrin e oficerave profesionistë dhe me përvojë lufte dhe jo të turistit;

- 5- Studimi perj tyre i atij drejtimi për 5-6 muaj rresht është bërë me qëllim që të familjarizoheshin me të gjitha përparësitë dhe rreziqet e mundëshme;
- 6- Përmes këtij studimi të hollësishëm patjetër që atyre duhet t'u kenë shkuar ndër mendje të gjitha kundërshtimet dhe mënyrat e mundshme mbrojtëse që mund të shfaqeshin në mendjen e komandantëve serbë. Si rrjedhojë, ata duhej t'i kishin parashikuar kundërveprimet e forcave të tyre në secilin rast të mundshëm të reagimit nga ana e armikut.

Të gjithë këta faktorë na i pohon vetë ish-shëfi i shtabit të GO-3 (Br.138), z. Anton Çuni në intervistën dhenë TV Dukagjinit, më 02 Maj 2019, ku thotë: *“Kemi bërë 23 kalime kufitare për të përcaktuar vendin ku dhe si të kalonim...U zgjodh Kosharja për të krijuar epërsi dominuese për të minimizuar të gjitha avantazhet që kishin forcat serbe.”*⁷⁾

Bazuar në këta faktorë, lufta në Koshare nuk do të ishte një fitore e zakonshme, por tamam një betejë e vërtetë, maksimumi dy ditore e jo më shumë. Por dështuan ngaqë e kanë siguruar veten me bindjen se armiku ishte ndjerë i kërcënuar dhe do tërhiqej sa më shpejt. Dhe një arsye tjetër, pse ata dështuan, është se këta oficerë nuk u konsultuan me SHP të UÇK-së për mënyrën e kryerjes së asaj detyre.

Këta zotërinj oficerë me akademi ushtarake pretendojnë se në Koshare është zhvilluar betejë. Me këtë emërtim edhe mund t'u jepet pak e drejt ngaqë premisat ishin për një betejë, por duhet sqaruar:

- çfarë lloj betejë u zhvillua: betejë mbrojtëse, apo betejë sumuese;
- cila palë zhvilloi betejë mbrojtëse dhe cila palë zhvilloi betejë sulmuese;

7) Shih shtesën nr.16 në pjesën e dytë të këtij libri.

- cila palë e pati në dorë fillimisht inisiativën dhe cila palë ia hoqi nga duart palës tjetër inisiativën;
- cila palë kaloi në mbrojtje të dëshpëruar dhe cila palë fitoi betejën;
- cilës palë i dështoi mësymja;
- cila palë e pat parapërgatitur sulmin me kujdes dhe si e zhvilloi atë sulm;
- cila palë donte të fitonte për çështje prestigji dhe cila palë e mbrojti prestigjin e vet;
- cila palë përparoi në drejtim të pozicioneve të palës tjetër;
- cila palë pati epërsi numerike ndaj palës tjetër;
- cila palë pati epërsi zjarri ndaj palës tjetër;
- cila palë dallohej më shumë në epërsi morale se pala tjetër dhe pse kjo epërsi nuk dha rezultat përparimi drejt pozicioneve të kundërshtarit;
- cila palë pati furnizime në vijueshmëri në forca e mjete;
- cilës palë i pengoheshin furnizimet nga toka dhe ajri;
- cila palë pati konceptin e udhëheqjes së përbashkët dhe të kombinuar me forcat e tjera të ushtrisë së vetë;
- si do të ishte më i drejtë përdorimi forcave nga GO-3 për dhënien e goditjes kryesore dhe ku e si do të duhej të jepej një a më shumë goditje ndihmuese;
- a duhej të qëndrohej në mbrojtje nga ana e forcave tona apo duhej të tërhiqeshin, kur e panë se qëndrimi vetëm në betejë mbrojtëse ishte i padobishën dhe i paleverditshëm për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe luftën në tërësi;
- dhe, së fundi, duhet bërë e qartë se cila palë arriti sukses në fushën strategjike, operative apo taktike.

Të gjitha këtyre çështjeve u jepet përgjigje në këtë libër, prej të cilave delet në përfundimin se: sa e lehtë është të fitosh betejën kur ke epërsi në forca e mjete, nëse di t'i përdorësh ato,

aq edhe e vështirë është ta arrish fitoren kur je inferior në forca e mjete ose kur je i paaftë të dish t’i përdorësh ato.

Megjithatë, duhet të kemi kurajon e të pranojmë me guxim të vërtetën, se **në frontin e Koshares nuk u arrit as sukses i shkallës strategjike, as i shkallës operative dhe as i shkallës taktike.** Dhe këtë na e thotë vetë gjenerali Hysen Berisha në intervistën dhënë gazetës “Bota sot”, datë 4 maj 2019, duke dashur të tregohet teoricion, por që në vend të vetullave ka nxjerrë sytë:

“Po të flasim me gjuhën tekniko-ushtarake lidhur me objektivat e një luftime, atëherë dua të sqaroj se çdo luftë ka tre nivele objektivash e që janë: ai strategjik, operativ dhe taktik. Në nivelin strategjik objektiv yni dhe i çdo luftime të karakterit çlirimtar është dhe ishte çlirimi i Kosovës. Në aspektin operativ ishte zhvillimi i kapaciteteve tona luftarake dhe shtrirja e luftës me kapacitetet tona në përmasa vendore deri në armatën e Kosovës. Kurse në nivelin taktik, ne kishim detyra konkrete që na u dhanë me urdhrin për sulm që nga kapja e objektivave të afërm në fazën e parë të sulmit që u realizuan në ditën e parë, me eliminimin e të gjitha pozicioneve siguroese të Kazermës ushtarake si dhe pozicioneve përgjatë vijës kufitare nga kazerma “7 Korriku” mbi Qafëmorinë deri te Rrasa e Zogut mbi Rrasën Koshare.

Kapja e këtyre objektivave na mundësoi që kazerma të merej ditën e dytë të luftimeve dhe brenda ditës së 11 prillit të arrijmë të riorganizojmë sistemin e zjarrit, plotësimin e kapaciteteve dhe zhvillimin e njërive për kapjen e objektivave të ardhshme dhe përmbushjen e objektivit final të Betejës, përkatësisht luftës.”⁸⁾

8) “Bota sot”, datë 4 maj 2019

Me këtë teorizim të gjeneral Hysen Berishës bindemi, se këta zotërinj nuk kanë pas asnjë lloj strategjie, por veç teori konkurruese dhe asnjërin prej atyre teorive nuk e kanë çuar deri në konkluzione. Të ndodhur midis dëshirës për një fitore *epope teorike* dhe parandjenjës për një disfatë ushtarake, duket se ata kanë qenë para një dileme tragjike: **të sulmojmë apo të bëjmë sikur sulmojmë.**

Nëse nuk janë dakort se kanë qenë në këtë lloj dileme, janë të lutur t'u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme, me të cilat të na qartësojmë konceptet e tyre strategjike, operative dhe taktike:

1. Ju që luftuat në Koshare, a e arritët objektivin strategjik të luftës sonë çlirimtare, çlirimin e Kosovës, sikundër e keni patur objektiv dhe që e keni theksuar edhe në intervistat e fundit?
2. A e arritët objektivin tuaj: *“në aspektin operativ shtrirjen e luftës në të gjithë territorin e Kosovës dhe krijimin e armatës së Kosovës.”*, sikundër shpreheni?
3. Nëpërmjet realizimit të detyrës së nivelit taktik *“duke mbritur deri te Rrasa e Zogut mbi Rrasën Koshare”*, vallë kjo arritje bëri të mundur *“përmbushjen e objektivit final të Betejës, përkatësisht luftës.”*, të nivelit strategjik dhe operativ për çlirimin e Kosovës?

Duke qenë se gjenerali Hysen Berisha ka bindjen se me *“Betejën e Koshares”* janë realizuar të gjitha synimet strategjike, operative dhe taktike të strategjisë së tyre, na del detyrë t'i themi se, duke u ngutur me qëllimin për të na e mbyllur gojën, është futur në një qorrsoak nga i cili vështirë se ka për të dalë ai dhe ata që e nxisin të flasë në këtë mënyrë. Dhe kjo ndodh ngaqë zoti Hysen nuk i ka shumë të qarta konceptet strategjike, operative e taktike.

Pse dal në këtë përfundim?

Dal në këtë përfundim se nuk mund të quhet as sukses strategjik, as sukses operativ dhe as sukses taktik pse u depërtua 2-3 km në thellësi të mbrojtjes kufitare serbe dhe papritmas kaluan në mbrojtje!

Madje, këtë nonsens të tij të shfaqur në këtë intervistë, ai e përforcon kur tregon se me 256 forca kanë sulmuar në tre drejtime operative (DO)!. Dhe konkretisht:

“I tërë operacioni ishte organizuar në tre drejtime operative: DO 333, që mbulonte zonën nga “Gusha e Batushës” deri në “Shkallën e Radanit”, në Qafe Morinë; DO 555, që përfshinte “Gushen e Batushës” deri në “Oplaz” të Junikut, dhe DO 777 që përfshinte “Rrasën e Koshares”, deri në “Rrasen e Zogut”... Tre drejtimet e para operative u komanduan që më Urdhrin për Sulm të Shtabit të GO-3. Ndërsa, DO 999, u komandua me urdhrat plotësues që lëshoi Shtabi i GO-3, përkatësisht Brigada 138 “Agim Ramadani”, gjegjësisht Komandanti i operacionit, Rrustem Berisha.”³⁾

Mirëpo, në intervistën e datës 16 prill 2019 gjeneral Hyseni na thotë të kundërtën: *“Sulmin e kemi kryer me grupe të vogla, ku secili grup kishte rolin e vet duke sulmuar.”*

Cilën nga këto dy përgjigje t'i besojmë z.Hysen Berisha?

Pastaj, si është e mundur që me 256 forca të sulmohesh në 3 drejtime operative (DO)(?!)

Kaq të vështirë e ka ky gjeneral të bëjë llogarinë: 256 forca, duke i ndarë në *“tre drejtime operative”*, i bie që në çdo DO të ketë sulmuar afërsisht një kompani këmbësorie pa rezerva dhe pa përforcime(!!!) Kjo ka qenë një mendjlehtësi e kushtueshme për komandën dhe shtabin

e GO-3 dhe eventualisht prandaj dhe u pagua shtrenjtë. Veprimet e frymëzuara nga teket e momentit dhe që nuk kanë të bëjnë me asnjë strategji të përgjithshme, nuk mund të vazhdojnë pa fund, do ta paguash shtrenjtë.

Kjo do të thotë se zoti gjeneral nuk e ka të qartë se çfarë kuptohet me termin *drejtim operativ*. Me sa duket, ky zotëri nuk e di se *drejtimi operativ* është një brez vendi, ku kryhen veprime luftarake të një njësie operative (kupto: divizion këmbësorie) ose të disa njësive taktike (kupto: dy e më shumë brigada këmbësorie) dhe që në mësymje u siguron njësive të tjera kapjen e objektivave me rëndësi operative, të cilat do të ndikonin në zhvillimin e luftës në tërësi; në rastin tonë në tërësinë e luftës për çlirimin e Kosovës.

Megjithatë, nëse kjo njësi taktike, (GO-3), do të kishte arritur të hapte korridorin e furnizimit, do ta pranonim se do të kishte realizuar një detyrë taktiko-operative, pasi do të kishte mundur kalimin në mësymje të përgjithshme të gjithë UÇK-së.

Por më e keqja është se ky gjeneral nuk e pranon se njësisë së tyre taktike i ishte dhënë për detyrë: hapja e atij korridorit, të cilën ai e redukton në kapjen e Rrasës së Zogut dhe Rrasës së Koshares! Pse nuk na e thotë gjenerali se çfarë u fitua nga UÇK-ja me kapjen e këtyre dy Rrasave prej guri? Pse nuk na thotë se kush do ta bënte hapjen e korridorit të furnizimit për UÇK-në, apo do të bëhej me urdhër të peshkut dhe me dëshirën strategjike të oficerave profesionistë të Koshares.

Duke mos e pasur të qartë së çfarë kuptohet me termin *drejtim operativ*, prandaj ky zotëri drejtimin e sulmit të një kompanie e quan Drejtim Operativ.

Por edhe duke kaluar në mbrojtje, sikundër bënë në datën 11 prill 1999, a mund të na thotë ky gjeneral

se cili është ai objekt me rëndësi operative që mbrojtën këta gjeneralë e që ndikoi në tërë luftën tonë çlirimtare? Meqenëse kështu shprehet.

Na del njëkohësishtë detyrë t'i kujtojmë këtij gjenerali dhe kolegëve të tij, se brigada e këmborsisë, (në rastin tonë GO-3), vepron në një drejtim taktik ose maksimumi taktiko-operativ, që zakonisht është një drejtim lokal, (sikundër thuhet në Doktrinën e NATO-s), ose më saktë një hapësirë e caktuar, kufij të e së cilës goditen nga zjarri i armëve të veta organike për të realizuar qëllimin taktik.

Bazuar në sqarimin që na bën gjeneral Hysen Berisha, rezulton se forcat e GO-3 kanë sulmuar me kompani këmborsie në secilin “*drejtim operativ*”. Mirëpo, kompania e këmborsisë është nënrepart taktik bazë, e cila kryen luftim të afërt me anë të ndeshjes, në luftim të afërt me armikun, në një front me gjerësi 800-1000 m, dhe jo në një *drejtim operativ*, i cili zakonisht ka një gjerësi 10-15 km dhe jo 3 km sa është gjerësia ku sulmuan tre kompanitë tuaja. Si mund të quhet drejtim operativ (DO) një sektor me gjerësi prej 800-1000 m, dhe me thellësi 600-800 m?!

Dhe ajo që të bën të dyshosh edhe më shumë në aftësitë e tyre ushtarake është fakti se të tre këto kompani, (që këta i quajnë njësi taktike, që do të thotë brigada!), janë i vetmi skalion që dispononte GO-3 në 9 dhe 10 prill 1999, duke mos pas skalion të dytë! Dhe më keq akoma. Si mund të kalohej në mësymje ndërkohë që armiku kishte epërsi në forca, (ai 300 forca, ndërsa, ne 256 forca), kur dihet që në këto raste raporti i forcave duhet të jetë 2-3-4:1 në favor të sulmuesit? Këtë raport forcash e di mirë z.Hysen, pasi na e ka thënë vetë në një intervistë të tij. Dhe gjeneral Hyseni na mburret se paskanë sulmuar në tre drejtime operative dhe në

një skalion, në secilin DO, kur dihet që brigada në mësymje e ndërton rendimin e luftimit në dy deri tre skalione! Dhe, po ashtu, a mud të gjenden diku tre drejtime operative në një front me gjerësi deri 3 km, në Koshare?!

* * *

Në intervistën e datës 10 tetor 2018, dhënë gazetarit Ermal Panduri, për luftën në Koshare, midis të tjerave unë pata thënë: *“Ata luftuan. Luftuan me heroizëm. Nuk u turpëruan.”* Dhe kjo është më se e vërtetë. Trimëria e forcave të njësisë taktike GO-3 (Br.138“Agim Ramadani”), në këtë luftë dymujore, është admiruar edhe prej vetë kundërshtarëve. Fakti që forcat tona në Koshare shkaktuan surprizë për forcat serbe, përbën të vetmen meritë shumë të madhe për forcat tona. Dhe me rastin e 20 vjetorit të asaj beteje mbrojtëse këtë gjë e pranon me plot gojën edhe gjenerali i pensionuar serb, Vladimir Lazareviç, i cili ishte komandant i Korpusit të Prishtinës gjatë kohës së luftës në Kosovë, i cili edhe sot kujton se forcat që sulmuan në Koshare nuk ishin vullnetarë të stërvitur vetëm një muaj, por kanë kujtuar se ishin forcat më speciale të NATO-s, prandaj thotë:

“Sulmi ishte i tmerrshëm, dhe armiku ishte shumë i armatosur mirë, me mbështetje të mirë ajrore dhe instruktorët më të mirë të NATO-s ... Ishte një Vietnam në miniaturë. Nuk ishte beteja vetëm e Karakollit të Koshares, ishte një front prej 15 kilometrash....Unë madje kam qarë.”⁹⁾

Nga ana tjetër, edhe presidenti i Serbisë Vuçiç, po me rastin e këtij 20 vjetori, e quajti sulmin e dy ditëve të para të

9)) Gazeta EXPRESS, e Shtune, 11 Nentor 2017

forcave të GO-3: “*Termopilet serbe*”¹⁰⁾). Gjë që pranohet pa hezitim morali, devotshmëria dhe trimëria e luftëtarëve tanë. Por këta zotërinj “profesionitë” nuk kanë ditur ta shfrytëzonin atë trimëri e vetësakrifikim të vullnetarëve shqiptarë ardhur nga të gjitha anët e rruzullit tokësor. Uroj që kjo të ketë qenë vetëm paaftësi e këtij kontigjenti oficerash.

* * *

Në krerë të veçantë të këtij libri do të tregohet me hollësi se raporti i forcave në Koshare ka qenë përherë në favor të forcave tona. Këtë e tregoi vetë fakti që forcat serbe nuk mundën të përparonin asnjë hap në drejtim të pozicioneve të kapura nga forcat tona. Por e tregon edhe fakti tjetër që, kundër 2600 forcave tona vepruan repartet e mëposhtme serbe, të cilat na i jep jo vetëm pala armike, por edhe një oficer prej anëtarëve të shtabit të GO-3:

- 1- batalioni kufitar 53 i Brigadës 125 të Ushtrisë jugosllave, e përkrahur nga policia serbe
- 2- batalioni i II i Brigadës 125 të motorizuar, pjesë i Brigadës së parashutistëve;
- 3- një pjesë e njësiteve special të Brigadës 72 ;
- 4- njësitet e policisë së Korpusit të Pristinës;
- 5- njësitet e policisë së korpusit të 2 beogradase të përforcuara me policë nga ish vendet jugosllave;
- 6- detashmenti i huaj me forca vullnetare e mercinarë;
- 7- detashmenti “Kozak” i ardhur nga Rusia, pjesëmarës nga lufta në Çeçeni; - mbeshtetja nga skuadrilia e aviacionit sulmuese-bombarduese të armatës jugosllave.

Gjithsej: 2332 forca

10) “Politika”, 9 prill 2017

Këtë sasi forcash na e konfirmon edhe pala serbe përmes organit “*The Srpska Times*”, datë 09.04.2019:

*“Around 12,000 NATO troops were on the Albanian side, ehile only about 2,000 Serbian soldiers defended the the Serbian border, mostly members of the 125th and 549th Motor Brigade, parts of the 63rd Parachute Battalion and 72nd Special Brigade, and Russian volunteers. Battle of Košare took many lives on both sides.”*¹¹⁾

Të gjitha këto forca serbe muarën kontakt me forcat tona, pavarësishtë se armiku kishte mundësi të afronte edhe forca të tjera të Korpusit të Prishtinës. Por, mos afrimi i forcave të tjera nga pala serbe tregon, se ajo komandë e pat bindur veten se forcat tona kishin vendosur të bënin vetëm betejë mbrojtëse. Kjo lloj beteje mbrojtëse e forcave tona, nuk ishte në interes të nivelit strategjik e operativ të UÇK-së, por në interes të forcave serbe, pasi kundërshtari u bind se forcat tona që luftonin në Koshare kishin hequr dorë nga hapja e korridorit të furnizimit për UÇK-në. Dhe mos të harrojmë edhe faktin që forcat tona ishin të përforcuara edhe me një sasi repartesh artilerie të Divizionit të Kuksit të Ushtrisë Shqiptare, që llogariten në 4-5 grupe artilerie me larghedhje të madhe.

Në të vetmen gjë, që nuk patën dallime këto dy pale kundërshtare, ishte se asnjëra prej tyre nuk pati asnjë periudhë pushimi gjat gjithë luftës dymujore.

11) “*The Srpska Times*”, datë 09.04.2019: “Rreth 12,000 trupa të NATO-s ishin në anën shqiptare, ndërsa vetëm rreth 2,000 ushtarë serbë e mbrojtën kufirin serb, kryesisht pjesëtarë të Brigadës Motorike të 125-të dhe 549-të, pjesët e Batalionit të 63-të të parashutëve dhe të Brigadës së Posaçme 72 dhe vullnetarëve rusë. Beteja e Košare mori shumë jetë nga të dy anët.”

* * *

Nga ana tjetër, thirtjes së QPK-së dhe SHP të UÇK-së për mobilizim të përgjithshëm iu përgjigjën mijëra vullnetarë nga e gjithë diaspora dhe trevat e banuara me shqiptarë. Deri në datën 8 prill 1999, vetëm në Qendrën Stërvitore në Helshan (Kukës), sikundër tregon komandanti i asaj qendre stërvitore, Agim Haziri, ishin duke u stërvitur 1200 luftëtarë vullnetarë. Merret me mend se, sikur kjo masë kaq e madhe të ishte përqëndruar për zhvillimn e mësymjes në Koshare, ajo betejë kishte për t'u fituar ndoshta pa pasur nevojë fare për t'u përleshur. Pasi, serbët, të kapur në befasi nga ajo dyndje e madhe njerëzish të armatosur e të mbështetur me zjarr të shumtë artilerie, do ta kishin lënë vetë korridorin të lirë qysh në ditën e parë të sulmit. Korpusi i Pirishtinës, çfarëdo mase që të merrte, nuk do të mund ta shmangte dot disfatën brenda asaj dite, për mos të thenë brenda disa orëve.

Kësaj zhurme të madhe propagandistike, të inicuar prej kuadrit komandues të GO-3 dhe iluzioneve të tyre, ka gjasa t'i ulet kjo eufori fallco pasi ta lexojnë me gjakftohtësi këtë analizë të hollësishme ushtarake, me besimin se kanë për t'u bindur përfundimisht se nuk është GO-3 që çliroi Kosovën, por është bashkveprimi luftarak midis UÇK-së dhe aviacionit të NATO-s. Dhe këtë bashkëveprim e mbajti SHP i UÇK-së, për të cilin Komandanti i Përgjithshëm i NATO-s, Uesli Klark, u shpreh: *Bashkveprimi më i mirë luftarak në historinë 50 vjeçare të NATO-s.*

* * *

Konkluzioni i bërë prej meje në intervistën e 10 tetorit 2018, për “Betejën e Koshares”, sikundër u shpreha më lartë, inicoi një reagim tepër të ashpër dhe mospranues

si nga një pjesë e kontigjentit oficer që luftoi në Koshare, por edhe nga luftëtarë të thjeshtë të atij formacioni luftarak, bashkë me disa analistë profanë nga ana ushtarake, nëpër televizorë të ndryshëm ashtu edhe në mediat me shkrim. Kuptohet, se konkluzioni që unë deklarova për atë “betejë” tingëlloi si e papritur për opinionin në Kosovë, dhe kjo ngaqë gjatë 20 viteve, 1999-2019, pothuajse për ditë, populli është bombarduar me të kundërtën e asaj që unë shpreha. Prandaj dhe reagimet e pjesmarrësve në atë formacion ishin dhe vijojnë të jenë fyerje e aspak analitike, të cilat, sikundër thashë, janë pjesë e veçantë e këtij libri.

Dhe gjithë ky agresivitet i tyre e ka burimin te fakti, se këta zotërinj të “Betejës së Koshares” mburren dhe fyejnë ngaqë nuk e njohin mirë artin e luftës. Duke qenë se mjeshtërinë e të luftuarit ata e quajnë shkencë prandaj, kujtojnë se bëjnë mirë që luftën e tyre dy mujore në Koshare e quajnë betejë; ata nuk e dinë se të organizosh një betejë është mundësi dhe jo dije statike; ata nuk e dinë se beteja nuk është diçka e bazuar mbi ligje dhe rregulla fikse që mund të zbatohen në mënyrë skematike, por është një lloj aftësie për t’iu kundërvënë një objekti që jeton dhe kundërvepron, është një gjykim i shpejtë në një moment të caktuar se si ta mposhtësh kundërveprimin e tjetrit, si ta rrethosh e ta asgjësosh atë në atë moment. Me një fjalë, ata e kanë ende të paqartë se lufta është kryesisht art i gjykimit të shëndoshë, sikundër thotë Napoleoni. Por që më saktë e shpreh një proverb spanjoll: “Udhëtar, rrugë nuk ka. Rrugët janë bërë duke ecur”.

Gjithashtu, ata ende nuk e kanë të qartë se ka *betejë mbrojtëse* dhe *betejë sulmuese*. Këtë përcaktim e bën Klauzeviçi. Duke mos e pasur shumë të qartë këtë gjë,

prandaj z.Hysen Berisha në intervistën e dhënë në 16 prill 2019 te TV Dukagini thotë: *“Përgatitja për vendimmarrje të betejës ka ndodhur 5-6 muaj përpara.”!*

Nga ana tjetër, në një moment të caktuar, z.Hysen Berisha, gjatë intervistës së datës 16 prill 2019 në TV Dukagini, na la të kuptojmë se ata quajnë “Betejë e Koshares” momentin e marrjes së karakollit të postës kufitare serbe “7 Korriku”, në Koshare, duke na thënë qartë: *“Një ushtri thyhet nëse i merret kazerma.”* Çfarë kërkon të na thotë ky zotëri më këtë shprehje? Mos vallë kujton se jemi në mesjetë? Vetëm në në luftrat e mesjetës ekzistonte kjo aksiomë: po të merrej kështjella lufta ishte e fituar. Dhe me kaq e quajnë të realizuar detyrën ndaj Atdheut, e quajnë të çliruar Kosovën, e quajnë të realizuar strategjinë e luftës në Kosovë, e quajnë të kryer detyrën e dhënë nga SH.P i UÇK! Madje, pse morën karakollin e postës kufitare, “Betejën e Koshares” e quajnë *“epopeja e madhe e UÇK-së”!*¹²⁾, edhe pse EPOPE thuhet për një ngjarje të madhe historike që ka të bëjë me fatet e një populli a kombi të tërë, sikundër është lufta e Jasharajve, që ngriti në këmbë një komb të tërë. Por këta zotërinj, nuk mund ta pranojnë luftën në Prekaz si betejë, ndryshe do të pranonin për Komandant të Përgjithshëm Adem Jasharin, gjë që do t’i akuzonin për shkarkim nga detyra të Rugovës. Pse, e hanë atë teke ata?

* * *

Këta zotërinj e kanë më se të qartë se gjatë dy muajve luftë, duke luftuar vetëm në mbrojtje, ranë 114 dëshmorë dhe u gjymtuan 350 të tjerë. Kjo do të thotë se çdo ditë delnin jashtë luftimit 7-8 luftëtarë, që përbëjnë gati një batalion,

12) M.Çetta, vepër e cituar, v.2,f.260

duke mosllogaritur ata që shoqëronin të plagosurit në spital e që shumë prej tyre nuk u kthyen, (sikundër mësojmë nga dëshmitari Muhamet Çetta). Thua të mos jetë kjo një prej shkaqeve pse nuk u arrit realizimi i detyrës, e që gjeneralët tanë bëjnë sikur nuk e kuptojnë këtë gjë?!

Nëse do të qe arritur fitorja, hapja e korridorit të furnizimit, dhe do të kishin ardhur furnizimet nga Shqipëria, fitoria do të kishte të atillë çmim sa të mos vihej në llogari sasia e forcave të humbura e të gjymtuara, dhe s'do të kishte pasojë tjetër veç keqardhjes për forcat e sakrifikuara. E kështu magjia e fitores dhe mënxyra e humbjeve do të ndërronin peshën specifike të këtyre elementëve.

Boll që t'u kujtojmë këtyre zotërinjve se SHBA e ndërprejnë luftën në Vietnam kur filluan të pësonin humbjen e 6 ushtarëve në ditë. Dhe të mos harrojmë që ata ishin një shtet me 260 milionë banorë, ndërsa ne as 1,5 milionë! Sa mirë këta gjeneralët tanë mburren kur gjeneralët serbë thonë *"Kosharja për ne ishte një Vietnam amerikan"*, dhe për atë pse amerikanët ndaluan luftën në Vietnam bëjnë sikur nuk e dinë?! Kur këta gjeneralët tanë e shihnin se humbjet i kishin me të tilla shifra, 7-8 luftëtarë në ditë largoheshin nga fronti, dhe hapja e korridorit po bëhej çdo ditë e më e pamundur, sikundër edhe rezultoi, pse nuk u tërhoqën? Gjeneralët tanë profesionistë, nëse do të pranojmë se janë profesionistë të mirëfilltë, duhej të ndërgegjësoheshin për një tërheqje në kohë me formacione të rregullta, e nuk do ta kishim këtë humbje që këta e festojnë si fitore.

Dhe ky lloj veprimi i tyre, duke folur vetëm për fitore, mendoj se ka brenda djallëzinë, që t'ia prishin mendjen popullit e të mos japin llogari për ato humbje. Kjo është arsyeja kryesore pse nuk kanë pushuar së deklaruar se janë

ata që kanë çliruar Kosovën dhe jo UÇK –ja. Ndërsa për Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së nuk rreshtin së thëni: “*Ai ishte shtab jo profesionistësh*”, propagandë e cila ka për qëllim ta nxjerrë gjithë UÇK-në të paaftë dhe veten e tyre strategë të shquar.

* * *

Bazuar në çfarë është shkruar e thënë nëpër intervista, e veçanërisht në kronikat e luftimeve të përshkruara nga z.Muhamet Cetta, bëhet e ditur se prej kur sulmi i Br.138 pushoi duke u transformuar në mbrojtje për më shumë se dy muaj rresht, nuk na rezulton që armiku të ketë sulmuar me forcat kryesore për të rrethuar dhe asgjësuar forcat tona në Koshare. Gjithashtu na është thënë e stërthënë se serbët sulmonin çdo ditë, por jo me forca më të shumta se me kompani.

Ç’farë tregojnë këto fakte?

Këto tregojnë se pala e jonë gjatë gjithë ditëve që luftoi në mbrojtje bënte të njëjtat veprime luftarake: zjarr artilerie dhe sulme me grupe të vegjël e të veçuar. Me këtë lloj taktike apo edhe strategjie kundër të njëjtit armik, oficerat tanë kanë bërë që armiku të kalitej për një mbrojtje të vazhdueshme. Pikërisht këtu qëndron edhe një nga arsytet pse mbrojtja e armikut nuk u thye. Sepse me llojin e luftimit tone, vetëm me zjarr artilerie të njëjtë e të përditshëm, i bënë serbët kundërshtarë të denjë të forcave tona, pasi janë vetë këta tanët që u treguan qëllimin e luftimit të tyre. Prandaj dhe armiku nuk ka bërë përpjekje të sulmonte me forca të shumta, pasi duke i mbajtur forcat tona në mbrojtje, ai e arriti qëllimin: nuk lejoi të hapej korridori furnizimit nga ana e jonë.

Prandaj është e pabesueshme shifra e deklaruar nga komandantët e GO-3 se armikut i janë vrarë 1600 forca¹³⁾. Kjo edhe për faktin tjetër, se po t'i qenë asgjësuar armikut 1600 ushtarë, forcat tona nuk kish pse të prisnin në transhe deri në 19 qershorin e vitit 1999, por brenda 2-3 ore do ta kishin kapërcyer lumin Erenik e do të kishin dalë në brigjet e lumit Drini i Bardhë.

* * *

Por le të ndalemi pak e të shpjegojmë për lexuesin, se çfarë duhet të kuptojmë me **BETEJË**, dhe pse e kanë emërtuar të tillë këta zotërinj luftën në Koshare.

Së pari, duhet theksuar se: qëllimi i betejës ka për objektiv *“të shkatërrojë forca të shumta të kundërshtarit, duke përdorur një pjesë të vogël të forcave të veta”*¹⁴⁾, sikundër thotë Klauzeviçi

Dhe, sikundër thamë më lartë, ka dy lloj betejash, *betejë mbrojtëse* dhe *betejë sulmuese*. Parë nga pikëpamja taktike, beteja është krejtësishtë sulmuese, nëse ti e kërkon kundërshtarin dhe e sulmon atë porsa hyn në teatrin e luftës. Në këtë rast beteja është gjithmonë taktikisht sulmuese, e

13) Sipas Radio *“Europa e Lirë”* (që financohet nga Kongresi amerikan), datë 8 Maj 2018, *jep këto të dhëna* konkrete për sasinë e njerëzve vrarë gjatë lufte në Kosovë: **gjithsej 13.518**. Prej tyre:

A). Shqiptarë: 12.452. (Prej tyre: ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: 2.132; civilë shqiptarë: 8.662, (prej të cilëve fëmijë shqiptarë të moshës 0 – 5 vjeçare: 239); persona të zhdukur (deri në prill 2018): 1.658 (mund të ketë edhe serbë në këtë shumë.)

B). Serbë: 645 (civilë, ushtarë dhe policë).

C). Të etnive tjera: 421 (civilë, police, ushtarë)

Pasqyruar edhe prej gazetës *“EXPRESS”*, e Dielë, 16 tetor 2018

14) Karl Fon Klauzeviç *“Mbi luftën”*, Tiranë, 1996, Libri 6, v.III,f.81.

cila realizohet kur sulmuesi do të ketë vënë në jetë kreu planin e vet dhe do të ketë përdorur pjesën më të madhe të forcave të tij. Palës sonë, edhe pse pat kaluar në mbrojtje duke pritur sulmin e serbëve në pozicionin e saj, pjesa sulmuese e betejës nuk duhej t'i kishte munguar kurrë. Dhe nëse pala jonë mbrojtëse do të ishte fitimtare, atëherë do të kishim të drejtën të thoshim se pala sulmuese serbe ishte shpartalluar, i ishin vrarë 1600 forca, (thënë ndryshe 70% e forcave të tij), që do të thotë, se pala serbe kishte përfunduar në një zhbërje të vërtetë.

Por historia ushtarake rrallë paraqet raste suksesesh të mëdha të arritura nëpërmjet betejës mbrojtëse. Por pala serbe, duke parë që pala jonë ishte e kënaqur me qëndrimin në mbrojtje, ajo e largoi rrezikun dhe ka shpëtuar nderin e armëve të veta. Me një fjalë, pala serbe me sulmet e saj të vazhdueshme me pak forca dhe me forcat kryesore qëndronte në mbrojtje, ka synuar vetëm të sprapste sulmin e palës sonë dhe jo në shkatërrimin e saj, për të mos pasur shumë humbje. Dhe faktikisht ajo pati më pak humbje se ne.

Bazuar në këtë analizë, duke u bazuar te Klauzeviçi, pala jonë (GO-3), duke qenë se e filloi luftën duke kaluar në sulm, atëherë beteja e saj duhej të ishte betejë sulmuese, për vet faktin, sikundër na thotë gjeneral Hysen Berisha, se *“Përgatitja për vendimmarrje të betejës ka ndodhur 5-6 muaj përpara.”*

Në këto kushte, cila duhej të ishte atëherë karakteristika kryesore e betejës sulmuese e Br.138? Përgjigjen për këtë pyetje na i jep përsëri Klauzeviçi, i cili thotë:

“Karakteristika kryesore e betejës sulmuese është krahmarrja ose rrethimi dhe, për rrjedhojë, fakti që është sulmuesi ai që e ofron betejën. Luftimi nëpërmjet vijave

krahmarrëse ka në thelb epërsi të mëdha. Për këtë arsye ai është problem me karakter taktik. Sulmuesi nuk duhet të heq dorë nga të tilla epërsi në mënyrë që mbrojtësi të mos ketë asnjë mjet për të kundërvepruar.”¹⁵⁾

Po t’u referohemi intervistave dhe shkrimeve të bëra nga vetë kuadrot e kësaj brigade, mësojmë se sulmi i saj është bërë ballor në tre drejtime, (DO, sikundër na thotë vetë z.Hysen Berisha), dhe duke qenë se armiku ishte tërhequr prej pozicioneve të para të tij, ai duhet ta ketë ditur që do të sulmohej, ndoshta dhe orën e saktë. Për këtë bindemi, se të gjithë thonë se e dinin orën e sulmit një ditë më herët!

Duke qenë se Br.138 nuk arriti të bashkohej me forcat e tjera të Z III Op. Dukagjini, tregon se ajo pat kaluar në një mbrojtje të shartuar, nga një ndërmarrje sulmuese. Dhe, duke mos mundur më të ruajë epërsinë e sulmit që pati dy ditët e para të luftimit, sulmi u shndërrua në mbrojtje. Përderisa sulmi i kësaj brigade nuk vijoi pas dy ditëve të para, deri në arritjen e hapjes së korridorit të furnizimit, natyrisht që do të përfundonte medoemos me një mbrojtje të shartuar, sikundër edhe përfundoi.

Çdo betejë nuk zhvillohet kurrë ashtu si e kanë parashikuar ata që e drejtojnë. Ky është një kusht kryesor në luftë. Edhe në rastin tonë, luftimet vijuan të zhvilloheshin pa përkuar kurrë me ato që kishin paramenduar ata që e planifikuan atë sulm 5-6 muaj resht. Në vend që të vijonin e fuqizonin sulmin, ata i dhanë atij formë mbrojtëse. Prandaj Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, duke e ndjerë se orvatja për hapjen e korridorit në Koshare dështoi, vendosi që në 12 prill të fillonte planizimin për një operacion sulmues në mal të Pashtrikut.

15) Po aty, libri i 7, f.405

Pa dyshim që kalimi në mbrojtje i forcave në Koshare ishte një fitore për serbët, gjersa fusha e betejës mbeti në duart e serbëve. Na rezulton se forcat tona gjatë atyre dy muajve nuk bënë as edhe një orvatje të vetme për sulm vendimtar, për betejë, sikundër duan të thonë. Ata zgjodhën rrugën e mesme: duel artilerie. Në ato kushte forcave serbe nuk u duhej ndonjë gjenialitet i veçantë. Për këtë ata u mjaftuan të bënin gjënë më të thjeshtë e më të lehtë: të mos i lejonin forcat tona të ngrinin kokën nga transheja, duke i goditur metodikisht me artileri dhe snajperistë; ku vetëm një togë mortajash artilerie serbe ka hedhur gjatë atyre dy muajve luftë në Koshare 45 mijë predha¹⁶⁾. Po gjithë artileria serbe e përqëndruar në Koshare, sa predha artilerie ka hedhur?!

Asgjë nuk ishte më pa mend nga ajo që bëri udheheqja e GO-3: qëndruan në mbrojtje deri në fund të luftës pa zhvilluar betejë, pa u orvatur fare të sulmonin.

Gjithashtu, nuk është aspak e vërtetë se gjoja serbët sollën në Koshare 30% të gjithë forcave që kishin në Kosovë, kur dihet se prej 1 prillit 1999, kur u thye Operacioni “Patkoi” në malet e Berishës, ajo mbarte në vetvete, si të thuash, kushtet kimike të dekompozimit të saj.

Por, edhe forcat tona u përforcuan duke arritur 2600 forca, pse nuk kaluan edhe në atë moment në sulm, nëse do të pranojmë se i kishin asgjësuar armikut 70% të forcave të tij?

16) Marrë prej dokumentarit “*Rrefime lufte nga Kosharja*”, dhënë prej komandantit të një toge mortajash serbe, Dragan Kamenov, B.2 Motorizuar serbe, përcjellë edhe prej klankosova.tv, datë 2 maj 2019: “Mesatarisht në ditë i kam hedhur nga 1 mijë e 200 deri në 1 mijë e 300 ose 1 mijë e 400 predha. Për aq sa më kujtohet, besoj që personalisht i kam hedhur nga 40 mijë deri në 45 mijë predha”.

Po ne nuk kemi asnjë nevojë të fryjmë sasinë e forcave serbe në Koshare për të fshehur turpin tonë. Ne kemi paguar me gjak për të pasur të dretën t'i shikojmë gjerat ashtu siç janë, dhe nuk heqim dorë nga kjo e drejtë. Këtyre kuadrove të GO-3 u duket se, kur kanë ndërmarrë dy-tre raste sulmi (kur kanë depërtuar me grupe shumë të vogla në shpinë të mbrojtjes serbe), i kanë parashikuar të gjitha. Mirëpo ato s'kanë fund.

Plaga që i kishin dhënë armikut, duke i marrë karakollin, tregoi se nuk ishte aspak vdekjeprurëse për të. Këta tanët, duke dëshiruar diçka, janë të aftë të mbledhin gjithë lajmet serbe e shqiptare në mënyrë që këto të duken sikur vërtetojnë gjënë e dëshiruar, fitoren, duke lënë në harresë me dashje gjithçka është në kundërshtim me dëshirën e tyre. Prandaj zotërinjtë e këtij formacioni është mirë t'i gjejnë një emërtim tjetër kësaj luftës së tyre në Koshare, se betejë ajo nuk ka qenë dhe nuk mund të quhet si e tillë.

* * *

Nëpërmjet këtij ballafaqime mediatik jam munduar t'u provoj të dy palëve “avukatë mbrojtës” pjesën e tyre të vërtetë se deri në çfatë mase kanë të drejtë për “fitoren” prej tyre të Luftës në Koshare. Dhe këtë jam munduar të realizoj duke ndërtuar një pamje të tretë të së vërtetës së asaj “fitoreje” prej secilës palë, duke përfshirë në këtë pamje të tretë edhe dy pamjet e së vërtetës të prezantuar nga secila palë mbrojtëse kundërshtare.

Të dy palët mbrojtëse të asaj “fitoreje”, me argumenta që kanë hedhur në këta 20 vjet në trajtën e tyre ekstreme, kemi konstatuar se nuk kanë mundur ta bindin gjithë

opinionin e gjerë. Kjo është arsyeja pse ata po mundohen t'i japin asaj "fitoreje" pamjen e një sintheze, me qëllim që ajo "betejë" të përgjithësohet si fitoria më vendimtare e gjithë luftës në Kosovë nga secila palë.

Duke u nisur nga një pozitë e mesme, mendoj se përmes këtyre analizave dhe krahasimeve kam bindjen se kam arritur t'i tregoj opinionit të gjerë dhe vetë këtyre "avukatëve mbrojtës" rrjedhën e natyrshme të së vërtetës së plotë se si është zhvilluar faktikisht Lufta e Koshares.

Dhe këtë jam munduar ta arrij duke përvetësuar të dy pamjet e asaj "fitoreje" të shprehura prej "avukatëve mbrojtës" të secilës palë, duke realizuar shkallë-shkallë shprehjen më konsekuente të së vërtetës së asaj luftë në Koshare.


Kam bindjen se ky libër ka për të shërbyer si urë midis dy palëve "avukatë mbrojtës", me qëllimin e mirë që, secila palë të bëhet e vetëdijshme për shkallën e realizimit të detyrës së ngarkuar. Këtu mendoj se qëndron kuptimi i gjithë këtij debate mediatik për Luftën në Koshare.

Tiranë, 23. 6 .2019

PJESA E PARË

“Pjesa më e madhe e njerëzve parapëlqejnë më mirë të ndihen të qetë, sesa të njohin të vërtetën. E po mirë, unë jam ai që do ta prish qetësinë tuaj, duke iu thënë të vërtetën.”

Robert R. Kenedi



KREU I PARË

INJORANCA NUK ËSHTË ARGUMENT

Përgjigje z.Milazim Maraj

*“Të gjithë njerëzit kanë frikë në luftë, por frikacak
është ai që e lejon frikën ta tejkaloi sensin e detyrës
që ka marrë, duke e braktisur atë.”*

Gjenerali amerikan George Paton

Kishin kaluar gati dy javë nga dita që ishte shfaqur intervista ime dhënë TV Dukagjii me gazetarin Ermal Panduri kur një dashamir i imi në Kosovë më dërgoi përmes postës elektronike një opinion të shkruar nga një farë opinionisti në gazetën “Bota sot” të Prishtinës, me emërin Milazim Maraj. Ky opinion është botuar në datën 11 tetor 2018. Shkrimi i Milazim Maraj është një reagim akuzues ndaj intervistës sime dhënë TV Dukagjinit dy-tri ditët e para të muajit tetor 2018, dhe emëtuar për publikun më 10 tetor 2018. Në atë intervistë, midis të tjerave, unë, përveç vlerësimit të sakrificave dhe luftës që bënë vullnetarët e ardhur nga gjithë trojet shqiptare dhe që u angazhuan në luftimet prej territorit të Shqipërisë në drejtim të Kosovës, gjatë periudhës prill-qershor 1999, them të vërtetën e përfundimit të asaj përpjekjeje: nuk ia arritën qëllimit të atij angazhimi luftarak, i cili ishte: hapja e korridorit të

furnizimit të UÇK-së prej Shqipërie brenda në Kosovë. Kjo detyrë ishte urgjente për ne, pasi kishim të dhëna se edhe NATO-ja do të hynte me forca tokësore nga drejtimi i Maqedonisë. Gjë që ne na duhej të kalonim sa më shpejt në mësymje të përgjithshme.

Bazuar në datën e botimit të këtij “opinion”, kuptohet se ai shkrim ka shkuar në shtyp në orët që transmetohej intervista në TV Dukagjini. Kjo don të thotë se kemi një koordinim të ngushtë midis gazetarit Ermal Panduri dhe drejtuesve kryesorë të GO-3, me qëllim që transmetimi i asaj interviste të bëhej kur të qe përfunduar “reagimi” i z.Milazim Mara. Nga përmbajtja e shkrimit kuptohet se pas Milazimit qëndrojnë oficerë të Grupit të Tretë Operativ (GO-3). Por unë jam i detyruar t’i përgjigjem Milazimit, ngaqë dihet: kali që zihet, shin lëmën.

Kjo lloj strategjie e “hollë” e tyre ka pas si objektiv kundërshtimin flakë-për-flakë të deklarimin tim: **Lufta në Koshare ishte një dështim**. Dhe këtë lloj manovre e kanë menduar të bindur, se në atë mënyrë e bënin nul atë të vërtetë që unë deklarova publikisht. Gjë që të bind se TV Dukagjini duhet të jetë një televizion i ngritur dhe i financuar edhe nga një grup ish oficera drejtues të Luftës në Koshare, më saktë të GO-3. Ata, duke pasur në dispozicion një medie kaq të fuqishme televizive 24 orëshe, prandaj dhe kanë arritur që të verbojnë një pjesë të konsiderueshme të opinionit në Kosovë, se gjoja Lufta në Koshare na paska qenë beteja vendimtare që nderoi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, dhe se duhet t’ia dimë për nder atij kontigjenti oficerash si sjellës të lirisë për Kosovën. Dhe nënteksti është: kuadrot që kanë drejtuar “Betejën e Koshares” janë heronjtë e gjallë të Kosovës.

Nuk është rastësi që kjo propagandë vijon menjëherë pas shpalljes “Hero i Gjallë i Kosovës” ish-oficerin Tahir Zema, (shoku dhe komandanti i këtyre oficerave të GO-3 gjatë luftës së tyre dy mujore në vitin 1998), nga ish-Presidenti Rugova gjatë fushatës së parë elektorale të pasluftës në Kosovë. Qëllimi i gjithë kësaj propagande dashakeqe është: Injorimi i Betejës së Prekazit dhe të legjendës së vërtetë të Luftës Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari. Këtë e dëshmon edhe mospërmendja nga këta propagandues i veprës legjendë të Jasharajve.

Duke e kuptuar këtë strategji të tyre, m’u desh ta lexoja shkrimin e Milazim Marës me kujdes e me qetësi, për ta kuptuar mirë qëllimin e tij dhe të atyre që qëndrojnë pas tij. Ai arrin deri aty sa akuzon për tradhëti mua dhe shokët e tjerë hartues të “Operacionit Shigjeta”. Kur shihja gjithë ato pyetje-akuzë ndaj nesh, e veçanërisht ndaj meje, duket sikur na ka rrethuar me një batalion të tërë akuzash. Qëllimi? Të na asgjësoi moralisht.

Dy Milazimët

Gjatë leximit dhe rileximit të atij “opinion”, emëri i autorit Milazim, sepse më dukej një emër shumë i familjarizuar, por nuk po arrija të bëja dot lidhjen e ngjarjens me emërin. Dhe më në fund e gjeta; m’u kujtua vargjet e këngës popullore:

*“Milaziim! Largo taborë! / se të skuq të bëj me bojë,
/ porsi deshtë me këmborë / si ata që venë dasmorë / Çerçis
Topulli më thonë!”*

Pra, Milazim quhej komandanti i taborit (batalionit) turk që rrethoi çetën e Çerçis Topullit para 110 vitesh, në

Mashkullorën e Gjirokastrës sime.

Me sa duket, thashë me vete, Milazim Maraj i paska vënë vetes detyrë të na “asgjësoi” ne të treve: mua, Ekrem Rexhën dhe Bislim Zyrapin, “çetën” që hartuam atë plan-operacioni. Por me një ndryshim. Milazimi i Turqisë donte ta asgjësonte fizikisht gjithë çetën e Çerçizit, kurse Milazimi i Kosovës kërkon të na asgjësoi moralisht gjithë “çetën” planizuese të Shtabi të Përgjithshëm të UÇK-së për operacionin “Shigjeta”. Madje, Milazimi i Kosovës na akuzon mua dhe Bislimin edhe si vrasës të shokut tonë të luftës, Ekrem Rexhës, (komandant Drinin), i cili është vrarë në 8 maj 2000, pas shpine, në Prizëren porsa doli nga shtëpia.

Më rezulton gjithashtu se të dy ju Milazimët, turk e shqiptar, keni edhe një përafrim tjetër mes veti: nëse Milazimi i Turqisë u bë trim se kishte në dispozicion një tabor me ushtarë të një Perandorie të tërë, ti Milazimi i Kosovës, duhet të jeshë bërë trim se ke pas vetes një gazetë të tërë me një staf sa një tabor, të një prej partive më të mëdha të Kosovës. Dhe ngaqë je kaq i fuqizuar, ka gjasa të keshë menduar se, ne të mbeturit gjallë nga “çeta” planizuese do të mund të pranojmë çdo shpifje-akuzë tënden. Kuptohet, kjo trimëri të vjen edhe për faktin se duhet të na masësh me kutin tënd.

E di pse ti, Milazimi i Kosovës, m’u duke si Milazimi i taborit turk? Sepse ti nuk e ke vetëm me mua, por e ke me të tre ne që hartuam planin e operacionit “Shigjeta”: me mua, Drinin dhe Shefin e Shtabit të UÇK, të atëhershëm, Bislimin, gjë që në sasi i përafrohemi pak a shumë çetës së Çerçizit. Të kuptohemi, jo se ti Milazimi i Kosovës je si Milazimi i Turqisë, mos e dhëntë Zoti, por je i ngjashëm

në qëllime me Milazimin e Turqisë. Të dy keni qëllim të asgjësoni kundërshtarin. Por përsëri ekziston edhe një dallim në qëllimet tuaja, që në dukje duket si i vogël, por me shumë rëndësi. Në qëllimet e atyre të vitit 1908, Milazimi i Turqisë dhe çeta e Çerçizit përdorën armë zjarri, ndërsa ti Milazimi i Kosovës dhe unë, (përfaqësuesi i “çetës” së SHP të UÇK-së), përdorim mes veti bombardim me fjalë. Por, mos harro që plaga e fjalës ka pasoja më të dhimbshme se plaga e plumbit, Milazim.

Ti Milazim, ngaqë ndoshta ke marrë pjesë ca ditë në luftën e Koshares, (sikundër thua vetë), pretendon se e njeh shumë mirë artin e luftës, sidomos atë të luftës frontale, pasi të tillë ishin luftimet, si në mal të Pashtrikut ashtu edhe në Koshare. Madje, ngaqë unë them të vërtetën, se forcat tona nuk e realizuan detyrën, pasi ushtria armike nuk i la të kontaktonin as me forcat e zonës së tretë operativ dhe as me të dytën, e quan: “Vlerësim i turpshëm”!

Po mirë, mor Milazimi i Kosovës, sipas teje, cili është turp, mosrealizimi i detyrës, apo të thuash të vërtetën, e cila është: detyra për hapjen e korridorit të furnizimit nuk u realizua. Dhe nuk justifikohet mosrealizimi, pasi ishin të gjitha mundësitë! Madje, forcat tona sulmonin nga lartëposhtë, një favor edhe më shumë për ato, sepse armiku e kishte tepër të vështirë për t’u marrë krahët apo për t’i rrethuar forcat tona. Apo, sipas teje, ngaqë u vranë rreth 200 luftëtarë mund të quhet fitore, edhe pse nuk realizohet detyra?

O Milazim i Istogut, më vjen keq që po ta them, por nuk duhet lënë pa ta thënë një shprehje të Ajnshtajnit, që për faktin konkret të përshtatet shumë mirë: *“Dy gjëra janë të pakufishme: gjithësia dhe injoranca, megjithëse për të*

parën kam rezerva”. A e merr vesh Milazim që injoranca nuk ka kufi? Po ashtu, Milazim, që të bësh specialistin e një profesioni që nuk e njeh, sikundër bën ti, është imoraliteti dhe injoranca më e pakufishme. Dhe për të vërtetuar këtë injorancë tënden, po i marr me radhë të gjitha “turpet”-akuza që m’i ke reshtuar në formën e një tabori.

Vështirë të falet një e keqe e paralajmëruar

Ti Milazim na thua se, përmes fjalëve të mia kuptohet që:

“Agim Çeku paska qenë fajtori për dështimin e këtij operacioni, pse u kishte mbyllur gojën këtyre kur u kishte thënë se është i porositur nga Amerikanët që të ndërhyhet nga Gorozhupi”. Dhe më tej vazhdon: *“Kjo deklaratë e tij, (e ke fjalën për mua), nxjerr në pah shumë gjëra: Agim Çeku paska qenë fajtori për dështimin e këtij operacioni.”*

Milazim, pse je lodhur kaq shumë? Çekun atje e ke, shko e pyete, por lodhesh duke i rënë larg e larg. Apo ngaqë është politikan me funksione shtetërore dhe nuk ta mban fërcka. Apo, i tillë trim je ti? Prandaj dhe je çuditur, se si unë mora guximin e thashë një të vërtetë? E thashë atë të vërtetë se ashtu bëjnë të gjithë njerëzit e ndërgjegjshëm. **Njerëzit e ndërgjegjshëm e kanë tepër të vështirë të falin atë të keqe, gjëmën për të cilën kanë lajmëruar se do të ndodhi, dhe që nuk kanë dashur t’i dëgjojnë.**

Sipas teje, Milazim, nuk është mirë të jesh i guximshëm e me karakter, se ndodh ajo që ka thënë dikur filozofi frances Paskal Blez (162ç-1662): *“Duke treguar të vërtetën, mbyt besimin tek ajo”.* Prandaj dhe ti nuk e beson. Thuhet se e vërteta triumfon gjithmonë, po ja që nuk është e vërtetë. U dashka dinakëri për të thënë edhe të vërtetën, por

ja që nuk e zotëroj atë lloj dinakërie.

Ne, tre hartuesit e atij plani, (unë, Drini dhe Bislimi), e paralajmëruam me guxim të keqen që do të ndodhte nëse forcat kryesore i hidhnim në sulm në drejtim të Gorozhupit. Paralajmëruam, duke thënë, se po të jepej godija kryesore në drejtim të Gorozhupit, jo vetëm që do të pësonim humbje, por edhe operacioni nuk do ta realizonte detyrën. Dhe ashtu ndodhi. Madje, mësoje, se të gjithë të vrarët në mal të Pashtrikut janë vrarë në atë drejtim. Lufta ndryshon nga loja e shahut, Milazim, pasi në lojën e shahut ke kohë të mendohesh, për çdo lëvizje që bën, ngaqë je jashtë konditave të kohës, ndërsa në luftë mëndja duhet të jetë orë e çast në alarm. Përsa i përket përfundimit që ke nxjerrë, ndoshta nuk ke gabuar.

Po a e din ti, o Milazim, se ç' do të thotë të sulmohesh në një terren malor shkëmbor, nga poshtë-lart, duke qenë i pambrojtur nga zjarri i përqëndruar i dy grupe artilerie obuzash e top-obuzash, të pozicionuar përballë, në fshatin Zym, kur ti që sulmon nuk disponon të tillë artileri që të mund ta neutralizosh artilerinë e armikut? A e din ti, o Milazimi i Istogut, se për thyerjen e sulmeve të tilla, kjo lloj artilerie prandaj dhe është quajtur "luani i maleve"? Po, kë pyes dhe unë! Lodhja më e madhe mendore është kur mundohesh të bindësh të paditurin.

Intriga është krijimtari

Në një akuzë tjerë, ti z.Milazim thua:

"Anëtari i shtabit Dilaver Goxhaj ka refuzuar urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK për të udhëhequr operacionin. Çka është kjo në Luftë?" Sipas teje, kam bërë

tradhëti, prandaj më poshtë shprehesh: “*Po të ishte çdo gjë në rregull ju zotëri do të duhej të përgjigjeshit para gjyqit ushtarak për kundërshtimin e urdhrit.*”

Nuk thonë më kot se intriga qëndron më lart se talenti, pasi ajo nga hiçi krijon diçka. Dhe kjo aftësi intrigantit i kultivohet ngaqë është fëmijë i së keqes që rritet në gjirin e saj dhe nuk ndahet nga ajo. Këtë aftësi ti Milazimi i Kosovës e paske në mënyrë të përkryer! Nuk duhet me ta ngrënë hakun. Shtiresh sikur nuk më ke kuptuar dhe thua: “*Goxhaj ka kundërshtuar urdhërin në luftë*”. Jo, mor lumë madh, jo. Nuk më urdhëruan, por kur unë u propozova se ai operacion nuk mund t’i besohej një kuadri dosido, ata, duke mos dashur që të shkonte Bislimi, (për këtë pyeti ata se i ke atje), më sugjeruan nëse ishte mirë që të shkoja unë.

Pra, më sugjeruan nëse pranoja unë të kthehesha në Shqipëri e të organizoja e drejtoja atë operacion. Por jo se më urdhëruan. Si thua ti, nuk doja unë të kthehesha në Shqipëri e pranë familjes, por doja të rrija në mes të plumbave të armëve të këmborisë dhe predhave të artillerisë serbe? Apo, sipas teje kam pas “*mision të caktuar, për të cilin ende nuk ka tregime të plota*”. Kjo shprehje të len të kuptosh se duhet të kesh qenë ose të jesh punonjës a bashkëpunor i ndonjë shërbimi të fshehtë, vendas a të huaj. Kam goditur vallë në shenjë, Milazim?

Helbete, një “atdhetar” si puna jote, i kujton të gjithë si veten e vet. Por ti, ngaqë ke ligësinë në shpirt, sidomos ndaj ne, shqiptarët e shtetit amë, prandaj e quan urdhër sugjerimin e atyre. Me sa duket, vecse po të isha me “*mission te caktuar*” mund të vija unë dhe shokët e mi nga Shqipëria e të luftoja në Kosovë, ndërkohë që ti e soi yt u larguat me kuç e me maç? Me sa duket, të gjithë ata shqiptarë që

guxuan dhe u kthyen pushkën barbarëve pushtues serbë, të duken spiunë, ngaqë zotrote, me sa po duket, të qan zemra pse janë përzënë serbët nga Kosova. Kjo duhet të jetë baza urrejtjes së soit tënd ndaj ne të Shqipërisë së brendshme, si pasojë e atij bashkim-vëllazërimit. Por, nuk dua ta besoj këtë, duhet ta kesh nga padija, prandaj dhe nuk dallon dot urdhërin nga sugjerimi.

Sipas teje, Milazim, cila do të ishte më e mirë për Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së: të lija detyrën e bashkëveprimit që mbaja me aviacionin e NATO-s e të kthehesha në Shqipëri dhe të drejtoja atë operacion, (ndërkohë që si unë Shqipëria kishte me qindra oficerë, për mos të thënë me mijëra), apo të shkonte një nga djemtë e Kosovës, sikundër u caktua koloneli Bislim Zyrapit? Si thua ti, ishte shumë mirë të largohesha unë që isha oficeri profesionist i mbajtjes të atij bashkëveprimit të forcave tona me aviacionin e NATO-s, kur oficerë të kësaj kategorie për momentin nuk kishte në UÇK? Për këto arsye më quan me “*mission te caktuar*” e sabotator të atij operacioni?! Ç’mendje të hollë që paske! Lum Istogu që ka një instruktor për arsimin si ti!

Mësoje një herë e mirë, o ti Milazimi i taborit të akuzave dashakeqe: Është e pamundur të çnderosh atë që nuk e ka frikë vdekjen, sado që ta kesh shndërruar intrigën në art. Mua më urdhëroi detyra njerëzore të sugjeroja: “Është më e dinjitetshme që atë operacion ta drejtoi një djalë Kosove”. Kjo ndërhyrje e imia nuk ishte kundërshtim urdhëri, por meritë, o Milazim.

Çështja është se e njeh apo nuk e njeh ti dinjitetin! Kjo është çështja. Unë dhe shokët e mi që lamë familjet, duke u arratisur nga liria dhe erdhëm në luftë, nuk është se

e kishim borxh që t'i bashkangjiteshim UÇK-së. Borxh dhe detyrë e kishit ju, të gjithë qytetarët e Kosovës me në krye “Komandanin tuaj të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Kosovës” (FARK-ut), që e kishte emërin Ibrahim Rugova. Por shumica absolute e trimave të Rugovës ia mbathi nga sytë këmbët, kurse Komandantin e nisët në Beograd t'i bënte thirrje NATO-s që të ndalonte bombardimet, dhe e latë Kosovën në mëshirën e fatit, dhe jo ne. Thonë se ti je kthyer e ke shkuar në Koshare, (nuk di sa është e vërtetë), kur doli thirrja për mobilizim të përgjithshëm. Megjithatë ai kthim, edhe në qoftë i vërtetë, nuk të justifikon, pasi, nëse është e vërtetë që je kthyer, je kthyer kur e pe se lufta do fitohej. Ta shpjegoj më poshtë se për cilët ishte thirrja.

Dhe, çuditërishtë, o ti Milazim trimi, arratisja e ime dhe e shokëve të mi nga liria në luftën për çlirimin e Kosovës rezultoi se ne u duheshim të gjithë atyre që luftonin, sikundër u duheshe edhe ti me shokët e tu. Ajo arratisje e jonë (jo e juaja) tregoi se pushteti i ndërgjegjes shoqërore tek ne ishte shumë i madh, i pakrahasueshëm me ndërgjegjen tënde. Ata që i bashkangjiten vullnetarisht, e jo me mobilizim të përgjithshëm, një luftë çlirimtare, kanë diçka të veçantë, Milazim; tek ata diçka ka kalit besimin në vetvete. Pikërisht për këtë arsye ata edhe vriten në luftë, ndërsa kallëpi yt jeton 1000 vjet.

Pa lene mo, thonë tiranasit, më akuzon edhe për “*mision të caktuar, për të cilin ende nuk ka tregime të plota*”! E di si i thonë kësaj, o Milazim: Thërret hajduti, kapni hajdutin! Nuk thonë më kot: Mos e pvet se flet vet.

Strategjia Milazim-iane “e mbajtjes së territoreve”

Më habit aftësia e juaj Milazim si “strateg” luftime kur thua:

”Ky plan i hartuar pas shumë debatesh nuk ka pasur strategji si të mbahet territori i çliruar pas sulmit. Ky qenka profesionalizmi i këtij eksperti”.

Ç’paska humbur UÇK-ja për një strateg kaq të madh si ti Milazim! Me sa duket, të kanë diktuar këtë mëndje kaq brilante këta të “Bota sot”, prandaj të kanë lutur t’u bësh opinione!

O Milazim’i taborit të akuzave, a mund të na e shpjegosh pak këtë “*strategji të mbahet territori i çliruar pas sulmit*”, se qenka një risi për teorinë ushtarake. Po a mund të na thuash se cili ishte qëllimi i “*strategjisë si të mbahet territori i çliruar pas sulmit*”? Po mire, mo Milazim, a e di ti, se mbajtja e atij territori që ti pretendon, ka pas qëllim pasiv?

Milazim, “*mbajtja e atij territori të çliruar pas sulmit*”, sikundër na thua, e që u muar qysh dy ditët e para të sulmit, sikundër e pranon edhe vetë, në datat 9 dhe 10 prill, kishte për qëllim të grumbullonte mjete të mjaftueshme për të kaluar nga strategjia mbrojtëse në strategjinë mësymëse, në mënyrë që të arrihej qëllimi aktiv i caktuar nga SHP. Akoma nuk e ke mësuar se cili qe ai qëllim aktiv i forcave në Koshare? Dhe mos harro që jeni përforcuar çdo dy-tre ditë me forca të freskëta.

Në çastin që ju ndërpretë përparimin dhe kaluat në “*mbajtjen e atij territori të çliruar pas sulmit*”, përmbysët situatën, Milazim. Në vend që të përfitonit nga forcat morale, që buroi nga marrja e atyre territoreve, që po na i rreshton më poshtë, (*Rrasa e Koshares, Kosharja, Rrasa e Zogut,*

Gomaret e Botushës, Gjocajt, Jasiqi dhe Juniku), dhe të vazhdonit të përparonit, ju u ndalët, duke i dhënë kohë kundërshtarit të afronte forca nga thellësia e të qëndronte i vendosur dhe i patundur. Derisa ju ishit në sulm duhej ta mbanit nismën. Ndalimi i mësymjes nga ana juaj ishte në dobi të palës tjetër.

Po më detyroni ta them qartë dhe me zë të lartë: **Qëndrimi juaj kryesishtë pasiv për dy muaj rresht, pas marrjes të atyre territoreve, ishte mohim i detyrës së dhënë nga SHP. A je dakort?**

Ai pasiviteti i komandantëve tuaj ka ardhur si rrjedhojë e mos llogaritjes së forcës së vullnetit të forcave vullnetare të ardhura nga e gjithë diaspora jonë. Morali (vullneti) nuk është diçka e panjohur: nga gjendja e tij e sotme, thotë Klauzeviçi, mund të parashikohet se si do të jetë e nesërmja. **Ajo, që për dobësi, u la pa u kryer prej komandantëve tuaj, u bë për kundërshtarin një armë objektive, reale, për të pakësuar përpjekjet e tij. Ndërprerja e veprimtarisë luftarake sulmuese nga ana e forcave tona në Koshare ishte në kundërshtim me logjikën e detyrës së dhënë.** Si strateg që pretendon se je, a mund të më thuash të kundërtën ti dhe ata që lëvdon ti?

Por që të jemi sa më të drejtë, duhet thënë: nga pikpamja ushtarake ne dështuam në Koshare, por nga ana psikologjike dhe politike ishte një fitore e madhe për ne. Pse? Sepse serbët kaluan nga sulmi në mbrojtje. Dhe mbrojtja është gjithmonë fillimi i disfatës. Them fillimi i disfatës pa qenë në kundërshtim me veten time: sepse në fakt fitorja përfundimtare do të ishte në favorin tonë, pavarësishtë se humbja e betejës në Koshare nuk ishte humbje e gjithë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Fitorja me

cdo kusht e betejës në Kosharja ishte shumë e rëndësishme edhe për Serbinë, pasi në Koshare vihej në lojë prestigji i saj. Serbët në Koshare bënë të pamundurën për të mbrojtur prestigjin e tyre, prandaj dhe mburen që e ndalën sulmin tonë; prandaj dhe thonë se “lufta në Koshare ishte një Vietnam në miniaturë”.

Milazim, gjithashtu, a mund të ma kujtosh pak, se duhet ta kem harruar, për cilin territor kemi diskutuar ne në Shtabin e Përgjithshëm për ta mbajtur me anë të operacionit “Shigjeta”? Jo për gjë, por ngaqë s’më kujtohet. Mos ta ka thënë vallë ndonjë person i ndonjë shërbimi të fshehtë? Se helbete, në Kosovë, siç ka deklaruar shefi i UDB-së për Serbinë, ata kishin 80 mijë agjentë. Të më kuptosh drejt, nuk e kam fjalën se je dhe ti një nga ata.

Një nga pyetjet-akuzë të tuat, o Milazim, është edhe kjo:

” Pse nuk e tregon se kundërsulmi serb ka arritur të futët në Shqipëri, pastaj me forca të përbashkëta të artillerisë shqiptare dhe forcave të NATO-s janë larguar, por ka pësuar edhe popullata civile shqiptare afër kufirit?”

A mund të na e sqarosh Milazim, se kush të ka thënë ti se forcat serbe kapën territor në brendësi të kufirit shtetëror të Shqipërisë pasi ka filluar operacioni “Shigjeta”? Nëse ka ndodhur në Koshare, ku ti ke qenë, na e thuaj, pasi deri sot nuk na është raportuar një gjë e tillë. E ke të saktë, apo ke parë ëndërr? Kështu i ke të gjitha të vërtetët ti Milazim?

Nuk ka asgjë më të urryer se gënjeshtër, Milazim. Ndëroje atë drej emëri, se më ngjan si turku që desh të vriste Çerçizin me shokët e tij, sikundër ti, me anë të kësaj të “vërtete” kërkon që të vrasësh moralisht Bislim Zyrabin e Fatmir Limën që drejtuan forcat që luftuan në Pashtrik. Pse nuk vret veten, a i zi, por rron e këput të tilla broçkulla!

Më tej ti, z.Milazimi i Kosovës, na akuzon:

“Për këtë operacion rrufe, ku mbetën gjithë ata ushtarë të rënë, dhe terreni përsëri u mbulua me ushtrinë serbe pikërisht nga gabimet e planifikimit sipas kësaj deklarate.”

Ç’është e vërteta, o ti Milazim strategu, kur thua: na *“mbetën gjithë ata ushtarë të rënë”*, këtu ke thënë të vërtetën e asaj që ne paralajmëruam për Gorozhupin dhe për pozicionimin pasivë në Koshare, por ja që ke harruar çfarë ke shkruar më lartë. Por, ama, ushtarët serbë nuk patën asnjë rast që të kenë rimarë territor nga ai që ushtarët tanë kishin kapur me sulmin e tyre. Por kjo tregon se këtë gënjeshtër ti duhet të ta ketë thënë, si duket, ndonjë ushtar a oficer serb, se nuk ma merr mendja të ta ketë thënë ndonjë nga ne të UÇK-së. Ke gjë lidhje me ata Milazim? Po të pyes thjeshtë për kuriozitet, jo për gjë tjetër.

Si thua ti z.analisti kompetent, *“pikërisht nga gabimet e planifikimit mbetën gjithë ata ushtarë të rënë”*?! Si mendon ti Milazim, nëse inxhinieri zbatues për ndërtimin e një pallati nuk vepron sipas projektit, në këtë rast fajin e ka inxhinieri projektues? Ç’profesion ke ti, o Milazim strategu, që je kaq i hollë në artin ushtarak? Lum Kosova që të ka, por nuk di nëse të njohin ata të FSK që të të vënë në krye të Ushtrisë së Kosovës që pritet të legjitimohet këto ditë.

Milazimi zbulon se me kapjen e fshatit Batushë u çlirua Kosova!

Në një prej akuzave të tjera, ti Milazim strategu thua:
“Pse dezinformon ky njëri? Brigada e Koshares nuk e paska thye kufirin. Si nuk ka turp me gënjye kështu haptas?. Më datën 09.04.1999 është çliruar territori i Rrasës së Koshares. Ku i bije Rrasa e Koshares zotëri ekspert, në Shqipëri apo në Kosovë? Më 10.04.1999 është çliruar Karakolli i Koshares po a e dini ju ku ka qenë i ndertuar, në Kosovë apo Shqipëri. Kosharja dhe Rrasa e Zogut, Gomaret e Botushës janë në Kosovë apo Shqipëri. Po Gjocajt, Jasiqi dhe Juniku ku janë?... Pse dezinformon ky njëri? Brigada e Koshares nuk e paska thye kufirin. Si nuk ka turp më gënjye kështu haptas?. Më datën 09.04.1999 është çliruar territori i Rrasës së Koshares.”

Me këtë vërejtje-akuzë ma ke mbyllur rrethimin, o Milazimi i taborit të akuzave. Alla hile, or te, më ke kapur shah-mat. S’kam ç’të them, pasi nuk e kam ditur që 2.552 forcat që sulmuan në Koshare paskanë pas detyrë veç *“të merrnin karakollin dhe të mbanin Batushën dhe Rasën e Koshares etj”*.

O të keqen e mëndjes, o Milazim! Sipas strategjisë tënde, ne u paskishim vënë juve detyrë veç që të merrej Kosharja, karakolli serb, si dhe Batusha dhe me kaq ishte e kryer dytyra e atij operacioni?! Meqenëse u morën ato objekte, ti Milazim na thua se me kaq u kry edhe furnizimi me armatim e municion i formacioneve të UÇK-së që luftonin brenda në Kosovë. Dhe me kaq, sipas jush, ishte çliruar edhe Kosova?!

Sipas kësaj strategjisë suaj të ndritur, kot që këmi luftuar ne të tjerët brenda në Kosovë, se mjaftohej të merrej fshati Koshare dhe Batusha, dhe Kosova e kishte fituar pavarësinë!

Milazim, bëre mirë që na e the një gjë të tillë, për të vetmen arsye se tash po mësojmë nga ti, se komanda juaj në Koshare, ishte e bindur se pas pushtimit të këtyre territoreve, ishte arritur qëllimi politik dhe ushtarak i gjithë luftës sonë, prandaj nuk e ndjenit më nevojën për të vijuar sulmin, prandaj dhe e ndalët atë! Nuk e di nëse kështu do të shprehen edhe ata. Besoj se edhe ata do të shprehen. Po presim.

Por fiksojeni mirë, se nga çasti i ndalimit të mësymjes nga ana e juaj, (e forcave tona në Koshare), inisiativa kaloi në duart e kundërshtarit. Apo jo Milazim? Kjo solli mos zbatimin e kryerjes së detyrës luftarake, që unë e thashë në atë intervistë, e që nuk u pëlqen të gjithëve juve që e festoni atë humbje çdo vit si fitore. Si thua ti Milazim?

Milazim! Të kesh mëndjen tënde, rron njeriu, pa merak fare, 1000 vjet. Milaziiiiim! Ato forca duhej të hapnin korridorin e furnizimit dhe jo të pinin çaj në shtëpitë e fshatit Batushë! Ta dijtë kjo toka e Kosovës se sa Milazimë të tillë ushqen, do që hapur e do që bërë zgavër nga marazi.

Por akuzat e tua ndaj meje nuk kanë të mbaruar, o Milazim. Sidomos, me këtë vërejtjen e fundit më ke vënë me shpatulla për muri, kur thua:

“Deklarimi juaj se në Koshare luftuan vetëm 65 ditë, jo vetëm që është i pa vërtetë, por tregon qëllimin tuaj të keq ose që fare nuk ke informata për këtë luftë”.

Ore, z.Milazim, të pyeta më lartë se çfarë profesioni keni. E di pse? Sepse po shoh që ti nuk zotëron as aritmetikën, mbledhje e zbritje, gjë që do të thotë se matematikës i vjen anës. E kam seriozisht, a keni qenë ndonjëherë nxënës shkollë? Po

do më thuash që je inspektor arsimit, në Burim (Istog). Kjo nuk do të thotë se nuk je analfabet, se sot, në Kosovë e Shqipëri kanë marrë grada shkencore jo pakë analfabetë.

Por megjithatë, nuk të falet të mos dish të bësh mbledhjen e tre numurave, o “strategu” ynë?! Atëherë, më del mua për detyrë që të të mësoj mbledhjen e tyre. Dëgjo Milazim: nga data 9 deri 30 Prill 1999 janë 22 ditë, nga data 1 deri 31 Maj janë 31 ditët, nga data 1 deri 12 Qershor, kur u vendos armëpushimi, janë 12 ditë. E, që të mos ngatërohesh, po t’i vendos, ashtu siç i vendos mësuesia në tabelën e klasës: $22+31+12 = 65$ ditë. Mundou të mos e harrosh tjetër herë. Hë, bravo!

Në këto 65 ditë luftë, luftuan gati 3000 forca në Koshare, të pajisura nga peu e gjëlpëra e deri te topa e murtaja, dhe nuk e hapën dot korridorin e kërkuar, edhe pse u vranë 114 djem nga më të mirët, sikundër na thua edhe ti. Dhe këtë ti e quan heroizëm?! Dhe mos realizimin e detyrës nga ana e juaj e quan faj timin, të Bislimate të Drinit, pse e planizuaam atë operacion dhe urdhëruam të luftonit?! Aferim, o Milazim!

Intriga nuk di të fshihet, ajo të fajëson e të gjykon pa dëshmi

Kulmi i intrigës tënde, Milazimit, arrin kur thua për mua, se *“ky njeri tregon (se ka pas) mision të caktuar, për të cilin ende nuk ka tregime të plota. Pastaj vrasja e komandant Drinit më një herë pas luftës????!!”*

Milaziiiiim! Jo më kot të krahasova me Milazimin e taborit turk që rrethoi Çerçizin, ngaqë keni një ngjashmëri tjetër interesante. Ashtu si Milazimi turk që i vrau Çerçizit trimin Hajredin Tremishti, ashtu edhe ju Milazimët tanë na vratë pas lufte anëtarin e “çetës” sonë planizuese të atij

operacioni, Ekrem Rexhën, (Drinin)! Një me një jeni, si ti dhe turku.

Nuk thonë më kot që Historia përsëritet, Milazim! Por në rastin tënd ajo përsëritet me një ndryshim. Milazimi turk nuk e akuzoi as Çerçiz Topullin dhe as shokët e tjerë të çetës për vrasjen e Hajredinit të tyre, ndërsa ti Milazimi ynë akuzon ne, shokët e tij të “çetës” planizuese, për vrasjen e Drinit! Ndryshimi nuk është i vogël. Kjo dëshmon se Milazimi turk nuk e ka njohur intrigën dhe mashtrimin, ka qenë ku e ku më i ndershëm e më trim se ti Milazimi ynë në Kosovë. Kjo afësia juaj krijuese do të thotë: Hedh gurin dhe fsheh dorën; e vratë ju Drinin dhe akuzoni neve. Të lumtë! Kjo është vlerë.

E shoh, o “trimi” Milazim, që ke për të më dërguar edhe mua në Gjykatën Ndërkombëtare Speciale, me akuzën se qenkam unë ai që kam vrarë komandant Drinin, por për fat të keq timin, nuk e kam pas ditur!

Kjo akuzë krijuese e juaj, tregon se ti Milazimi i Kosovës ke dy difekte: një në zemër e një në tru. Difekti në zemër është se nuk të qarkullon gjak, por ujë, ndaj dhe na urren. Si rrjedhojë, burra të tillë pa hallate dinë të vrasin vetëm pas shpine, se ashtu e vratë edhe komandant Drinin; njësoj sikundër vepruat ndaj viganit Adem Demaci, e “vratë” kur vdiq, duke i hedhur njëmijë fyerje e akuza, sepse sa qe gjallë nuk guxonit t’i delnit përpara, e shanit me zë të sfumuar.

Por kot e ke Milazim, nuk ka për të besuar njeri se mund të jem unë vrasësi i Drinit. E di pse? E para, mua nuk më pengonte për ndonjë gjë Drini, pasi, jo vetëm që nuk më bren kanceri i pushtetit, por askush nuk më ka mësuar të bindem verbërisht; pa harruar të të them se nuk e njoh

as dhunën e as urrejtjen. Përveç që isha qytetar i një shteti tjetër. Me një fjalë, s'na lidhte asgjë tjetër, veçse dashuria e të qenit në një llogore, e cila ishte dashuri e singertë, pasi, përveç se ishim të një profesioni, me kualifikime pothuajse të njëjta, ai ishte dhe një intelektual i emancipuar dhe, si i tillë, nuk e njihte ligësinë shpirtërore. E dyta, përveç miqësisë të farkëtuar në llogore midis nesh, rastësia na kishte miqësuar edhe familjet gjatë luftës; ishte djali im që në prillin e vitit 1999 e kërkoi dhe e gjeti familjen e Drinit në Fush Arëz dhe e sistemoi në Tiranë. Domosdoshmëria, thonë, e kalon rrugën përmes rastësive. E treta, nëse unë do të isha vrasësi i Drinit, sot do të isha, të paktën, në një detyrë të barabartë me tënden, inspektor i arsimit në ndonjë komunë (bashki), në mos dëshmor, ose nuk do të më kishin persekutuar familjen si andej dhe këtej. E katërta, dhe kryesorja, andej nga vij unë, o Milazim, nuk njihet vrasja pas shpine; pas gardhit desha me thënë. E mësove? E mësova, thuaj. Ka gjasa që ti e di kush e vrau Drinin, por nuk ta mban fërcka të tregosh se, kuptohet, duhet të bësh pjesë në atë grupin shoqëror që fshihet pas gardhit, ose që mburret me hallatet e dashit. “Dashi” është gazeta që ke në dispozicion.

O Milazim, a ia ke bërë ndonjëherë pyetje vetes, se kush duhet t'ia ketë pas frikën Drinit pas lufte dhe pse? E kupton pse ta bëj këtë pyetje? Sepse i gjithë tabori juaj e ka ditë shumë mirë që Drini kishte kryer të gjitha llojet e akademive ushtarake, si asnjë koleg tjetër shqiptar i Kosovës në UÇK, madje edhe atë të diplomacisë ushtarake. Drini ishte ndër kuadrot e para ushtarake të Kosovës që iu përgjegj thirrjes së Nënës Kosovë dhe erdhi e formoi një nga formacionet më të mëdha të UÇK-së. Ju të gjithë e dinit që Drini si ushtarak i kompletuar ishte edhe një poliglot.

Po që Drini ishte edhe orator, a e dinit? Po që Drini ishte dhe një enciklopedi që ecte, a e dinit? Si i tillë, pa as më të voglin dyshim që ai do të bënte pjesë në elitën intelektuale të Kosovës. Por të gjitha këto trembnin gjithë dallkaukët e kopukët e etur për pushtet, pasuri dhe lavdi dhe jo mua që, siç e sheh, isha i përkohshëm në Kosovë.

Si rrjedhojë, edhe anëtari tjetër i “çetës”, që mori pjesë në planizimin e atij operacioni që ti na akuzon, Bislim Zyrapi, përjashtohet, si dhe unë, për vrasjen e Drinit. E di pse? Se edhe Bislimi bën pjesë në racën e trimave, ndaj dhe veproi njësoj si Drini. Po të mos ishte trim por intrigant, ai nuk do vinte të luftonte në Kosovë qysh ditët e para të UÇK-së, por do të vinte aty nga fundi i luftës, kur erdhe zotrote, kur hyri NATO-ja, kur dhe serrat që fluturonin në qiellin e Kosovës e morën vesh se lufta do fitohej njëqind për qind; do të vepronte edhe Bislimi sikundër bënë disa ish-ushtarakë të tjerë që trumbetojnë se kanë bërë “betejë” të madhe në Koshare, apo që janë shpallur heronj të gjallë e bërë gjeneralë, deputetë e ku di unë. Gjithashtu, nëse Bislimi do të ishte frikacak e karjerist, edhe ai do të gjente sebepe të largohej gjatë luftës shpesh herë për në Tiranë si ca të tjerë. Ta thashë, trimi nuk të vret. Gjithashtu, nëse do të ishte Bislimi urdhërdhënësi i vrasjes së Drinit, në mos ministër, të paktën, do të ishte deputet i Kuvendit të Kosovës. Ti e di që ai ka qenë Shefi i SHP të UÇK prej Qershorit 1998 deri 28 Prill 1999 kur erdhi në Shqipëri për të drejtuar operacionin “Shigjta”, ndërsa sot është si puna ime. Kështu që vrasësi duhet të jetë i racës që fshihet pas gardhit ose pas politikës, Milazim. Mos u trondit, nuk e kam për ty, se ti bën pjesë në sojin e trimave.

Difekti i dytë që ti Milazim ke në mendimin tënd, është se nuk e di që trimi nuk të vret, prandaj gabove kur

akuzove mua dhe Bislimin. Milazim, a e ke parë filmin shqiptar “Njeriu me top”? Të kujtohet si i thotë Mato Gruda Pinxhos, pasi e çarmatsi: “Ik e mos më dil më përpara!”. Pra nuk i tha: “Hë, në të gjeça anën”, sikundër bëjnë intrigantët, por i ktheu Pinxhos edhe pisqollën, e i tha: Ik, pirdhu, e mos më dil më përpara. Ashtu siç i thoshte Adem Demaci sojt tuaj, prandaj dhe u bëtë trima e nuk i shkua as në varrim. E pse rroni, e i hani bukën kotë familjes dhe Kosovës, o Milazim?! Hiqja më mirë vetes.

Ne, dhe ju trimat pas beteje

E di pse ta them këtë? Se ti je një nga ata trimat që e braktisët Kosovën kur ajo kishte nevojë për ju. Pavarësisht se ndonjë nga ju u kthye pas thirrjes për mobilizim të përgjithshëm. Ajo thirrje ishte për ata banorë të Kosovës që fillimi i luftës i kapi jashtë Kosove, si dhe për ata që nuk kishin lindur në Kosovë apo që nuk qenë ndonjëherë banorë të Kosovës, por jo për ju si ti Milazim, që 27 nëntori i vitit 1997, kur shpërtheu lufta, ua gjeti familjet në Kosovë. Njeriu mund të braktisë shtëpinë por jo atdheun, Milazim, e sidomos kur atdheu është në rrezik dhe ti e ke familjen në atdhe. E gjithë kjo kategori duhej të qe kthyer menjëherë në Kosovë porsa filloi lufta, sikundër u kthyen Bislimi, Drini, Ramushi, Fehmiu, Xheva etj. Ai që e braktis atdheun ose që nuk kthehet menjëherë në të tilla raste, dhe nuk ndihmon në asnjë mënyrë atë luftë, ai nuk ka më atdhe, Milazim. Kjo edhe për dicka tjetër. Nuk u mjaftuat që u bëtë sehirxhinj, por fyenit të gjithë ata që luftonin për çlirimin e Kosovës. Madje nuk kontribuat as dhe me financa për të blerë ne municione e armë.

A e di ti Milazim se çfarë u bëri Tuxhmani të gjithë kroatëve që vepruan si puna jote, atyre që nuk dërguan asnjë pjesëtar të familjes në luftë si dhe atyre në emigracion e në Kroaci që nuk e ndihmuan financiarisht luftën kundër Serbisë? I detyroi t'i blinin shtëpitë e tyre stërgjyshore me çmime shumë të shtrenjta, se vetëm ashtu do të kishin të drejtën ta kishin përsëri Kroacinë për atdhe. Ja që Kosova nuk pati burrë shteti si Tuxhmani. E kishim edhe ne një. Demaçin. Por i bënë tetshin para se të angazhohej NATO në luftë, që ai të jepte dorëheqjen e të mos ishte në krye të shtetit të Kosovës. Prandaj qeveritarët europianë nuk morrën pjesë as në varrimin e Tuxhmanit dhe as të Demaçit kur vdiqën, ngaqë këta të dy donin më shumë atdheun e tyre sesa Evropën. Apo nuk e di?

Ndërsa me Rugovën bëri të kundërtën Evropa. E nderoi Evropa Rugovën tënd, sepse bëri të kundërtën e Tuxhmanit. Evropa kështu na do, pa shtyllë kurrizore dhe pa ndjenjë atdhetare, se vetëm kështu na vjedh lehtësishtë pasuritë kombëtare; se ai që nuk ka atdhe dhe ai që ka vjedhur atdheun dhe paratë i ka në offshore, nuk ka dhëmbshuri për pasuritë kombëtare, i duken gjëra abstrakte. Prandaj dhe Evropa përkrah ata politikanë shqiptarë që për atdhe kanë pasurinë personale dhe paranë. E pe sesa lehtë ia falën Maqdonisë tokën e Kosovës ky lloj kallëpi politikanësh dhe UCK-në e çuan në gjykatën e turpit?

Unë e kam më se të qartë, se duke të ngacmuar ndërgjigjen tënde të sëmure dhe të gjithë atyre që të kanë përgëzuar për këtë tabor akuzash të padrejta dhe fyerje ndaj meje dhe kolegëve të mi, porsa ta kuptosh që të doli boja, do të fillosh të egërsohesh deri në shtazëri, duke u bërë gjithnjë e më agresivë me shkrime thashthemesh e shpifjesh, duke

u pasuar edhe nga të njëjtë të tjerë. Por mos kujto se do të merrem tjetërherë me ti, sido e sado që të shkruash.

Me përgjigjen që po të kthej, i nderuar Milazim, besoj se do ta ndjesh veten fajtor ndaj atdheut, ndoshta edhe para ndërgjegjes tënde, dhe aq më me dëshirë dhe kundër vullnetit do të kërkosh faje tek mua. E di pse do ta bësh këtë? Sepse para meje, para shokëve të mi dhe Kosovës ti e di që je fajtor.

Tung!

30. 11. 2018

KREU I DYTË

“Nuk ka regjimente të paaftë, ka kolonelë të paaftë”
Napoleon Bonoparti

Kanë kaluar 20 vjet nga mbarimi i Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe nuk kemi dëgjuar që të jetë organizuar nga qeveritë e Kosovës por edhe të Shqipërisë ndonjë simpozium apo konferencë shkencore, për të evidentuar përvojën dhe mësimet që mund të nxirren nga ajo luftë, në të cilën mori pjesë i gjithë kombi shqiptar, përfshi edhe gjithë diasporën, si asnjë herë në historinë tonë kombëtare.

Madje do të jetë e pabesueshme për brezat e ardhshëm të kombit tonë kur ata do të mësojnë, se disa vjet pas asaj lufte çlirimtare, të gjitha institucionet shtetërore në Kosovë, të dala nga ajo luftë, bënë të pamundurën për ngritjen e një Gjykate Ndërkombëtare të Posaçme kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kundër asaj ushtrie që çliroi Kosovën prej pushtimit shekullor të Serbisë!

Qëllimi? Për ta cilësuar atë luftë çlirimtare si një luftë e padrejtë, luftë terroristësh dhe kriminelësh, vetëm pse luftoi kundër pushtuesve të saj shekullor!

Dhe ajo që është edhe më e çuditshme, këtë nismë ndërkombëtare antishqiptare po e glorifikojnë të gjitha

mediat në Kosovë, pëjashtur: Radio Kosova e Lirë, Agjensinë Kosovapress dhe disa portale si: pashtriku.org, mekuli.press, opozita.com e ndonjë tjetër!

Sikundër e kam cekur edhe më herët, në fillim të muajit Tetor të vitit 2018 TV Dukagjini transmetoi një emision për luftimet në Koshare dhe në mal të Pashtrikut, ku pata folur edhe unë. Midis të tjerave, në atë intervistë unë kam thënë:

“Të mburren ata që luftuan në Pashtrik, deri diku kanë të drejtë. Por të mburren ata në Koshare, nuk kanë të drejtë. Pse s’kanë të drejtë? Ata luftuan 65 ditë. Kishin furnizime të bollshme në të gjitha llojet e armëve e shërbimeve. Dhe të luftosh 65 ditë, e të mos hapësh dot korridorin...?! Ata luftuan. Luftuan me heroizëm. Nuk u turpëruan. Por detyrën nuk e kryen. Dhe mua më ka bërë përshtypje, ngaqë kam dëgjuar shpesh herë në mediat tuaja, në Prishtinë, ku thuhet se: beteja më e madhe, nderi më i madh është “Beteja e Koshares”. Dhe dikush thotë: Ja, shikoni, edhe Serbia i ka vënë një rrugë në Beograd emërtimin “Beteja e Koshares”. Tashti, kush ka të drejtë të mburret? Ka të drejtë Serbia, sepse ne nuk e realizuam dot detyrën; ajo na bllokoi. Kështu që, ne s’kemi pse mburremi me një “betejë” që s’e fituam... Por, me sa shoh unë, ju në Kosovë jeni infektuar nga Serbia, festoni humbjet?!... Nëse Kosova do të kishte shtet të rregullt, komanda dhe shtabi i kësaj brigad duhej t’i jepej gjyqit ushtarak, për mos zbatim urdhëri e detyre...”

Ajo deklaratë e imja, për moszbatim të detyrës prej forcave që morën pjesë në të ashtuquajturën “Betejën e Koshare”, hodhi dritë mbi të vërtetën dhe dimensionet e asaj ”beteje”, të pathëna deri atëhere; e parë ajo në këndin e një ushtarakut profesionist, pjesmarrës në atë luftë. Ajo

deklaratë ngacmoi jo vetëm sedrën e sëmurë të disa prej kuadrove kryesore të Grupit të Tretë Operativ (B.138), që ishin angazhuar me përgatitjen, organizimin dhe drejtimin e luftimeve të kësaj brigade në Koshare, si dhe ngjalli interesim edhe në shumë qarqe të tjera shoqërore. Por ajo shkaktoi revoltim të madh edhe tek ata që e kishin glorifikuar atë “betejë” si fitore.

Në shumë prej atyre reagimeve kundër deklaratës sime, të bëra me shkrime dhe intervista, janë hedhur ndaj meje shumë dyshime si dhe epitete nga më të ndryshmit: “ideologjik”, “enverist”, “i doktrinuar”, “i dyshimtë”, “i paturpshëm”, “ka arrdh në luftë për qëllimin e tij material”, “ka pas mision të caktuar, për të cilin ende nuk ka tregime të plota”, “duhet shkuar në Shqipëri e duhen parë dosjet e tij”, etj, etj. Por dihet që *“Epitetet, - sikundër thotë Gëte, - nuk janë argumente. Kur këto mungojnë tregojnë dobësi.”* Deri tashti, moszbatimi i detyrës luftarake, për hapjen e korridorit të furnizimit nga ana e forcave tona që luftuan në Koshare, është menduar se kjo më shumë ishte një rastësi sesa një gjë e paramenduar. Fillimisht edhe unë i këtij mendimi kam qenë, rastësi, duke u nisur nga mendimi se jo çdo betejë fitohet.

Mirëpo, në vend që ajo humbie t’u kishte shërbyer drejtuesve të GO-3 për të mësuar diçka, ata dhe mediat e tyre kanë gati një dekadë që po e festojnë si fitore madhështore, madje në mënyrën më glorioze, duke e quajtur atë si beteja më e shquar e gjithë Luftës Çlirimtare të Kosovës! Ky glorifikim gjithnjë e në rritje më ka tërhequr vijimisht vëmendjen, pasi bie ndesh me të vërtetën e përfundimit të asaj lufte gati 70 ditore. Më dukshëm, kjo lloj fushate pat filluar në 10 vjetorin e saj e në vijim, duke kaluar çdo lloj mase.

Bazuar në mënyrën e festimit të asaj “fitoreje” dhe në përmbajtjen e atyre prononcimeve të shprehura nga një kontigjent jo i vogël ushtarakësh, analistë e politikanësh është dalë në përfundimin se pot ë mos ishte luftuar në Koshare, vështirë se do të ishte çliruar Kosova. Qëllimi? Për t’i thënë gjithë popullit shqiptar, veçanërisht gjithë formacioneve të tjera të UÇK-së se, po të mos ishte zhvilluar Lufta në Koshare, vështirë se do të përmendej Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Dhe për ta bërë sa më bindës këtë qëllim të tyre, një ish-komandant batalioni, pjesmarrës në luftën e Koshares, i quajtur Hysen Berisha, mundohet të përshtat një thënie të Uesli Klark se gjoja e ka për luftën e tyre në Koshare, por që ai e ka për të gjithë periudhën 78 ditore të luftës që bashkëveproi aviacioni i NATO-s me UCK-në. I vetmi rast që Uesli Klark, (Komandanti i Përgjithshëm NATO-s), e përmend luftën në Koshare, në libririn e tij *“Të bësh luftë moderne”*, ku saktësisht thotë: *“Dhe, ne, kishim vëzhguar se si kishte hapur UÇK-ja një korridor të vogël, i cili nga verilindja e Shqipërisë çonte për në Kosovë, nëpërmjet fshatit Koshare. Lufta e vazhdueshme aty, shpesh i detyronte forcat serbe të dilnin në terren të hapur; ku kishim mundësi t’i sulmonim ato”*¹⁷⁾.

Fjalja e dytë është për goditjet e aviacionit të NATO-s që kishte më se dy javë që vepronte brenda në Kosovë para se të fillonte lufta në Koshare, pasi dihet që në atë sektor të asaj lufte aviacioni i NATO-s nuk u angazhua më shumë se në dy-tre raste. Por ja që kështu u pëlqen zotërinjve oficerë të GO-3. Dhe Klarku nuk e përmend më Kosharen në të gjitha 511 faqet e tjera të atij libri. Por, me sa duket, qenkan aq të aftë në këtë drejtim këta zotërinjtë e Koshares, sa dhe

17) Uesli Klark *“Të bësh luftë moderne”*, “Zeri”, Prishtinë, 2003, f.372

Klarkun e paskanë mashtruar, duke e bindur se e patët hapur korridorin e furnizimit në Koshare! Mirëpo, çudia është se, po ky Hysen Berisha, në datën 16 prill 2019, në intervistën e tij në TV Dukagjini, na tha se “*Objektivi i Koshares nuk ishte hapja e korridorit të furnizimit.*”¹⁸⁾, edhe pse na mburret se ata i ka vlerësuar për këtë gjë vetë Klarku!, për “*hapjen e korridorit të vogël, i cili nga verilindja e Shqipërisë çonte për në Kosovë, nëpërmjet fshatit Koshare.*”(!!!)

Atëherë, cilën deklaratë duhet t’ia marrim për të vërtetë gjeneral Hysen Berishës?

Është më se e vërtetë që unë, në intervistën dhënë atij televizioni, midis të tjerave, për luftën e zhvilluar nga GO-3 (Br.138), pata thënë: “*Ata luftuan. Luftuan me heroizëm. Nuk u turpëruan.*” Por kjo nuk do të thotë se Br.138 e realizoi detyrën kryesore: hapjen e korridorit për të furnizuar formacionet e UÇK-së me armë e municione, si dhe me ushqime ato si dhe 800.000 qytetarë që kishin ardhur në zonat e mbrojtura nga UÇK-ja, për të cilën kam për të shkruar në shkrimet e ardhshme.

Por fiksojeni mirë, se moszbatimi i asaj detyre luftarake nuk është për faj të luftëtarëve, por për faj të personelit komandues të atij formacioni luftarak.

Për ta përgënjeshtuar me çdo kusht atë deklaratë që unë kam bërë për dështimin e forcave që luftuan në Koshare, për mos hapjen e korridorit të furnizimit, tash, në kuadër të 20 vjetorit të “Betejës së Koshares”, TV Dukagjini prej javës së parë të muajit prill ‘99 pat filluar të organizoi një seri intervistash me kuadro të asaj brigade dhe analistë të ndryshëm. Duke qenë se pjestarë të komandës dhe shtabit të Br.138 të UÇK po bëjnë të pamundurën që atë mosrealizim

18) Shih Shtesën Nr.6 të këtij libri

detyre ta quajnë sukses, duke përdorur edhe fyerje, natyrisht që edhe unë nuk do të rri duar kryq; po më detyroni që ta shoh me sy ushtarak edhe më kritik, duke shfrytëzuar gjithçka që kam lexuar e dëgjoj në këto intervista, ku mësoj shumë elementë të ndryshëm që nuk i kam ditur më herët. Për këtë ndihmesë i jam shumë mirënjohës TV Dukagjini-t. Në qendër të kësaj analize ushtarake kuptohet që do të kem komandën dhe shtabin e GO-3(Br.138), të cilët janë autorët e vendimeve plotësisht të pavarur dhe që me shembullin e tyre kanë drejtuar vartësit në gati 70 ditë lufte, 9 prill deri 19 qershor, sikundër na e qartësoi një nga ish-kuadrot drejtuese të atij shtabi, oficeri i përgatitur në shkollat ushtarake të ish-Jugosllavisë, gjenerali Hysen Berisha¹⁹⁾ si dhe komandanti i b4 Br.138, z. Pren Marashi².

Për këtë saktësim u jam edhe më shumë mirënjohës. Hysen Berisha duhet ta dijë se, sa më lart të jesh në hierarkinë ushtarake aq më shumë përgjegjësi ke. Dhe mbi këtë bazë do të përpiqem të gjykoj veprimtarinë e komandës dhe shtabit të asaj brigade. Sikundër e ceka më lartë, duke dashur të përgënjeshtrojnë deklaratën që unë kam bërë për mos realizimin e detyrës nga forcat që luftuan në Koshare, glorifikuesit e asaj humbjeje si me qenë fitore, kanë përdorur lloj-lloj epitimesh. Por duhet bërë e qartë se, fraza të tilla emocionale tregojnë shumë pak nga botkuptimi i kësaj kategorie ushtarakësh dhe intelektualësh në Kosovë, e cila mund të shpjegohet se duhet të kenë qenë të përkëdhelur nga regjimi titist dhe Serbia ngaqë i kanë humbur ato privilegje.

Këto epitete fyese ndaj meje dëshmojnë edhe për një bindje ekstreme anti-Shqipëri, midis një pjese jo të vogël

19) Shih Shtesën Nr.6

2.Shih Shtesa Nr.23

të atyre ish-oficera karjere në ushtrinë jugosllave, por edhe mes të një pjese intelektualësh shqiptarë në Kosovë, të shkolluar dhe edukuar në shkolla të larta civile e ushtarake në ish republikat jugosllave, jashtë Kosove. E megjithatë, këto emërtime brezash nuk mund të themi se thonë gjithçka për personalitetin e tyre dhe aftësitë profesionale të tyre drejtuese dhe as për karakteristikat e shkollave dhe universiteteve civile e ushtarakë të ish-Jugosllavisë ku ata kanë studjuar.

Por, që të jemi sa më konkretë, shkrimet dhe intervistat e tyre me përmbajtjen e një botkuptimi të tillë, e kanë venitur disi te populli i Republikës së Shqipërisë simpatinë e dikurshme të jashtëzakonshme ndaj kësaj inteligjence civile e ushtarake në Kosovë.

Si rrjedhojë, me dashje apo pa dashje, jam i detyruar të shprehem mbi të vërtetën se si dhe sa e kreu detyrën Komanda e GO-3 (Br.138), detyrë e vënë nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Për këtë i falënderohem së tepërmi TV Dukagini, i cili, përmes një seri intervistash të njëpasnjëshme, kasten për të ashtuquajturën “Beteja e Koshares”, më ngacmoi për të nxjerrë mundësishtë sa më mirë në pah, rëndësinë e detyrës luftarake që iu dha GO-3(Br.138), veçanërisht përgjegjësitë e komandës dhe shtabit të asaj njësjije taktike, pa lënë mënjanë edhe dobësitë e atij formacioni luftarak, por pa mohuar aspak vlerat e luftëtarëve gjatë atyre 70 ditëve.

Njëkohësishtë, përmes këtyre intervistave të kohës së fundit, duke filluar prej 2 prill 2019 e në vijim, ky TV po më nxit të evidentoj edhe qëllimin e vërtetë të fshehjes së atij mosrealizimi. Të gjitha këto mendoj se ndoshta qëllimisht janë lënë pas dore nga analistët ushtarakë në Kosovë, që

dikush edhe mund ta quaj filozofia e luftës së një kategorie të ngushtë ish-oficerash shqiptarë të ish Armatës Jugosllave.

Në shkrimet e mëpastajme mendoj të ndalem më hollësishtë në zhvillimin e asaj “beteje”, duke i trajtuar ato çështje me të vetmin qëllim: për të nxjerrë mësim nga gabimet dhe mosrealizimet e shfaqura në luftimet gati 70 ditore në Koshare.

Njëkohësishtë, përmes këtyre shkrimeve do të përpiqem që te kjo pjesë e ish-ushtarakëve në Kosovë dhe të asaj inteligjence të saj që e anatemojnë UÇK-në të thelloj të kuptuarit më mirë prej tyre idetë e asaj “beteje”, e në veçanti të asaj lufte çlirimtare në përgjithësi, idealet e profesionizmit ushtarak të kuadrove që u angazhuan në formacionet e UÇK-së brenda në Kosovë, por edhe kontributin e dhënë nga ne “*enveristët*” prej Shqipërie, “*me dosje të dyshimta*”, sikundër është shprehur ish-oficeri i shkollave ushtarake jugosllave, Hysen Berisha, Musa Gjakova, Milazim Mara etj., si në Prishtinë edhe në Tiranë, e që, për fat të keq tonin, nuk janë të paktë.

Por për të vërtetuar “*të qenët ideologjik të Dilaver Goxhaj*” dhe që të mos lodhen Hysenët e Milazimët e Kosovës “*për të parë dosjet e tij*”²⁰⁾ duke ardhur deri në Tiranë, po u tregoj shkurtimisht atyre “*ideologjizmin*” tim, të cilin do ta kishte zili çdo shqiptar i vërtetë.

Akademia Ushtarake e Shtabit të Përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë, e cila përgatiste oficera madhorë për komandim brigade e më lart, unë kam qenë dëgjues pas 13 vite diplomimi oficer, 1982-1984, e më pas, për një dekadë rresht, pedagog e shef katedre (departamenti) i një prej më të rëndësishmëve të saj, departamenti i Mbrojtjes

20) Shih Shtesa Nr.6

Kundërajrore dhe Aviacionit, deri në mbylljen e saj, njëkohësishtë edhe anëtar i Këshillit Shkencor të Ushtrisë për taktikën dhe strategjinë e mbrojtjes. Përveç detyrimeve shkencore si shef departamenti kisha për obligim edhe 400 orë dhënie mësimesh e zgjidhje detyrash në vit si pedagog. Ajo Akademi Ushtarake, prej themelimit të saj, më 10 Maj 1958 dhe derisa u mbyll në vitin 1993, ka bërë kujdes që dëgjuesit e saj të njihnin në detaje ushtrinë e ish-Jugosllavisë, llojet e forcave, përbërjen dhe armatimet e tyre, taktikat dhe strategjitë e saj, të cilën e konsideronim si një nga shtetet më armike të kombit shqiptar, veçanërisht Serbinë ku ti Hysen Berisha je shkolluar; por, njëkohësishtë, është punuar edhe për njohjen e historisë ushtarake të popullit shqiptar në ish-Jugosllavi, mentalitetin e kësaj popullsie dhe ndjenjat e saj ndaj shtetit amë, të cilat na ushqyen mua, dhe gjithë brezat që e kanë kryer atë akademi, me dashurinë e zjarrtë për kombin shqiptar. Dhe që të mos u mbetet merak, po u tregoj shkurt se në shtatorin e vitit 1992 na erdhi në atë Akademi të SHP një grup pedagogësh ushtarakë të një akademie simotër amerikane. Dhe pasi dëgjuan stafin pedagogjik tonin si dhe vizituan kabinetet mësimore, e përfunduan vizitën, duke na thënë: “Me këtë nivel përgatitjeje të kuadrit tuaj oficer, më këtë lloj fortifikimi që na e demonstruat përmes kabineteve dhe me këtë organizim luftarak të gjithë vendit, keni pas të drejtë që e ndjenit veten të papushtuar”.

Me këtë prezantim të shkurtër për programin e Akademisë së SHP në Shqipëri desha t’i tregoj gjithë kategorisë së Hysen Berishës se, duke e njohur sa më mirë historinë e luftimeve të kombit shqiptar, kuptohet që për Hysenët e Milazimët aq më shumë premisa kishim për t’u bërë të dyshimtë për kombin shqiptar. Ndërsa Hysenët

dhe Milazimët që kanë mësuar vetëm historinë ushtarake të kombit serb, kuptohet që nuk ka se si të jenë enveristë. Kështu që u jap të drejtë të dyshojnë për ne “*enveristët*” si antishqiptarë.

Biles edhe kontigjentin për të dalë oficera, Enver Hoxha e përzgjidhte nga familjet që kishin luftuar denbabaden kundër pushtuesve serbë, grekë, italianë, gjermanë etj., gjë që edhe ju Hysenëve dhe Milazimëve të Kosovës mbi bazën e këtyre kritereve u ka përzgjedhur republika jugosllave ku bënte pjesë Kosova, Serbia. Vetëm se ne, duke qenë “*enveristë*” ka shumë gjasa që të jemi të dyshimtë për kombin shqiptar, apo jo Milazim Mara e Hysen Berisha dhe ju kategoria e tyre?

Për ne “*enveristët*” që u angazhuam vullnetarisht në mesin e asaj lufte duke hyrë brenda në Kosovë, kanë më se të drejtë Hysenët e Milazimët e Kosovës të dyshojnë, pasi ndryshojmë nga ata që sollli në Kosovë Azem Syla e Kadri Veseli pas lufte, ngaqë ata janë shumë më kombëtarë se ne, duke hyrë në Kosovë pas lufte, njësoj si Hysenët e Milazimët e Kosovës, prandaj dhe i ka pranuar Agim Çeku dhe Gjykata e Prishtinës në komisionin për veteranët, si dhe ndonjë prej tyre prisni kur ta dëgjoni që të jetë përzgjedhur nga këta zotërinj edhe si dëshmitar i mbrojtur për në atë gjykatën e turpit në Hagë. Se mos guxoni të hiqni dorë prej tyre, o Hysen Berisha dhe kategoria juaj, se nuk përjashtohet mundësia që ndonjëri prej tyre të ketë edhe origjinë të largët të ish-kolegëve tuaj sllavë.

Dhe, që ta mësoni mirë ju Hysenët e Milazimët glorifikues të “*betejës*” së Koshares, Akademia e SHP e Ushtrisë Shqiptare, për të na armatosur me ideologjinë kombëtare, ka organizuar dhe zhvilluar përherë stërvitje të të gjithë niveleve

dhe llojeve të tyre: stërvitje shtabi, stërvitje komando-shtabi një e shumëshkallëshe, stërvitje me trupa nga të gjitha repartet dhe njësitë e të gjithë llojeve të armëve dhe shëbimeve, deri në grup divizionesh, ku, në idetë e dyanshme të të cilave armik kryesor ishte edhe ushtria jugosllave. Mos vallë për këtë gjë jemi të dyshimtë ne të shtetit amë? Vlen të theksohet se këto lloj stërvitjesh janë intensifikuar prej kur Shqipëria u shkëput nga kampi socialist, 1961, e deri në vitin 1992, kur pushteti në Shqipëri kaloi në duart e opozitës së djathtë shqiptare, motërza e LDK-së tuaj, me në krye “kushëririn” e Hysen Berishës, Sali Berisha. Dhe ajo parti e ajo qeveri i vuri vetes si detyrë të parë, shkatërrimin e Ushtrisë Shqiptare, dhe e bëri realitet.

Ky mision, o Hysen Berisha, filloi me mbylljen qysh atë vit të shkollës së vetme të mesme ushtarake “Skenderbej”, dhe pas një viti mbyllën Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerave bashkë me Akademinë e SHP, komandant të së cilës emëruan një akademist të porsa diplomuar e që vinte nga komandant batalioni, duke i dhënë edhe gradën e gjeneralit. Dhe ai gjeneral punën e filloi me djegien e gjithë literaturës ushtarake të përpunuar gjatë 35 viteve të asaj akademie nga stafi pedagogjik i saj, me qëllimin e “mirë”: brezat që do të vinë të habiten që në Shqipërinë socialiste shteti shqiptar nuk ka pas akademi ushtarake dhe, si rrjedhojë, nuk ka pas as ushtri për të mbrojtur atdheun dhe popullin! Kjo ishte faza e parë e shkatërrimit të ushtrisë bashkë me shkurtime drastike të saj dhe çmobilizimin e gjithë kuadrit të aftë, duke u vënë etiketimin “*enveristë*”. Një nga ata “*enveristët*” isha dhe unë i ideologjizuari juaj.

Mësojeni dhe nguliteni mirë, se ajo Akademi Ushtarake ka qenë shembull e profesionalizmit ushtarak dhe e zotësisë, në krahasim me gjithë historinë e ekzistencës

deri sot të shtetit shqiptar, por edhe të atyre profesionistëve që patën mbaruar shkollat ushtarake në vendet e tjera.

Faza e dytë e shkatërrimit të Ushtrisë së Shqipërisë ndodhi në anatgonzmin kataklizmik të vitit 1997, e kryer nga simotra e LDK-së suaj, gjurmët e së cilës kanë mbetur deri në ditët e sotme e do të duken edhe në të ardhmen.

Ndërsa faze e tretë e eliminimit të saj filloi në vitin 1998 ku gjithçka që mbeti nga kataklizma e vitit 1997 u shit dhe u shkatërrua nga qeveritë e Tiranës dhe po vijon ende.

Përsa u përket marrëdhënieve direkte të kuadrit ushtarak të shtetit amë me ushtarakët shqiptarë të shkollave jugosllave, ato filluan nga ne të “*ideologjizuarit enveristë*” pas vitit 1992. Por veçanërisht në periudhën e shpërthimit dhe zhvillimit të luftës për çlirimin e Kosovës, 1997-1999.

Me këtë dua t’u them se këto marrëdhënie kanë një veçori të pashoqe, ngaqë nuk filluan me arsimimin reciprok të studentëve ushtarakë, sikundër ndodh e ka ndodhur historikisht me çdo ushtri të botës, por direkt në fushën e betejës, duke i ideologjizuar bashkëvendasit tuaj me ideologji kombëtare, që ju e quani ideologji enveriste. Një nga ata isha edhe unë që e pata atë fat. Aty u shkëmbyen përvojat taktike e strategjike ushtarake, shqiptar i Kosovës me shqiptar i Shqipërisë, direkt në fushën e betejës, një ëndërr shekullore. Dhe për këtë jam krenar që ia arrita asaj dite, prandaj kam vazhduar të flas e të shkruaj gjithnjë e më shumë për atë luftë heroike shqiptare e ata kolegë të lavdishëm që gjeta në Kosovë, pavarësisht se ti Hysen Berishë i shkolluar në shkollat e Serbisë nuk të pëlqejnë.

Por për fatin e keq tonin, ky shkëmbim përvojash e bashkëveprim shqiptar-shqiptar, zhvilluar në fushën e luftës, është ende i panjohur për shkollat tona ushtarake

në Shqipëri e Kosovë. Dhe kuptohet, se fajin kryesor e ka shteti i Shqipërisë, i cili gjatë asaj lufte bëri të pamundurën të pengonte edhe ne vullnetarët “enveristë” e të “ideologjizuar”, si puna ime, me ideologjinë kombëtare, që të mos ingranoheshim në radhët e UÇK brenda në Kosovë! Arsyen mund ta marrim me mend, pavarësisht se ende është e panjohur për mua; ndërkohë që të gjithë shtetet e tjera anëtare të NATO-s, por edhe jo anëtarë të saj, prej kur filloi lufta në Kosovë ngritën pranë akademive të tyre ushtarake ekipe profesionistësh ushtarakë për ta ndjekur nga afër atë luftë dhe për të nxjerrë mësimë të reja për artin e luftës.

26 prill 2019

KREU I TRETË

GJENERAL, KA DAVA KOSHARJA, GJENERAL!

Në të gjitha intervistat, analizat, shkrimet e ndryshme dhe debatet që janë zhvilluar dhe po zhvillohen sot e dhjetë vite resht rreth veprimtarisë luftarake 70 ditore prej GO-3(Br.138) të UÇK-së, në Koshare, (09 prill deri 19 qershor 1999), vijojnë ta glorifikojnë, duke i thënë: Beteja e Koshares. Edhe unë, në shkrimin e parë reagues, në përgjigje të intervistave të kryera prej TV Dukagjini gjatë këtij muaji prill, e kam titulluar po me këtë emërtim. Por me një ndryshim të vogël: e kam vendosur në thonjëza. Me këtë dua të them se nuk jam dakort që ato veprime luftarake të kësaj brigade të mund të quhen BETEJË.

Veprimtaria luftarake e një brigade këmbësorie, qoftë ajo edhe brigadë e një ushtrie klasike, nuk mund të quhet betejë; aq më shumë kur ajo këto luftime i kryen e shkëputur nga formacionet e tjera të ushtrisë ku ajo bën pjesë, sikundër veproi GO-3(Br.138) e UÇK-së.

Para së gjithash, gjeneralët dhe oficerat e tipit Hysen Berisha dhe kolegët e tij, që i qëndrojnë besnik këtij glorifikimi, duhet të jenë në gjendje të bëjnë dallimin se në cilat raste kemi të bëjmë me betejë, dhe në cilat raste kemi të bëjmë me luftim.

Nëse i referohemi Artit Ushtarak Shqiptar konstatojmë se:

“Beteja është tërësia e luftimeve taktike që kryhen për asgjësimin pjesë-pjesë të armikut nga njësi operative gjitharmëshe ose nga disa njësi taktike (gjitharmëshe e tankiste) në bashkëveprim me forcat vullnetare e sulmuese, për plotësimin, zakonisht, të një ose disa detyrave të caktuara të operacionit. Beteja që zgjidh detyrën më të rëndësishme të operacionit, asgjësimin e grupimit kryesor të armikut, është betja vendimtare.”²¹⁾

Po, çfarë duhet të kuptojmë me njësi taktike gjitharmëshe?

Me njësi taktike gjitharmëshe (këmbësorie) duhet të kuptojmë Brigadën. Ndërsa me njësi operative duhet të kuptojmë Divizionin, i cili përbëhet nga disa brigada, sasia e të cilave varet nga detyra që ka marrë ai divizion. Gjithashtu është më se e nevojshme të qartësojmë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës, përfshi edhe gjithë forcat e saj që sulmuan nga territori i Republikës së Shqipërisë, të gjitha së bashku nuk arritën atë madhësi që ajo të përbënte një divizion. Por, edhe nëse do të pranojmë se UÇK-ja e kishte sasinë njerëzore për të plotësuar numrin e forcave që ka një divizion, asaj i mungonin të gjitha llojet e armëve dhe shërbimeve që duhet të ketë një divizion për të zhvilluar një betejë; aq më shumë një betejë vendimtare, sikundër duan të na e mbushin mendjen apologjetët e GO-3, se gjoja “Betja e Koshares” ishte beteja vendimtare për çlirimin e Kosovës. Përveç që UÇK-ja nuk ishte vetë një njësi operative kompakte sikundër janë ushtritë klasike.

21) Arti Ushtarak i Luftës Popullore, Tiranë, 1983, f.64

Këta “teoricienët” apologjetë ushtarakë e civilë në Kosovë, që duan ta përlligjin si BETEJË veprimtarinë luftarake të GO3 gjatë luftës në Koshare, e kanë edhe ngaqë nuk e dinë se beteja nëqdo rast arrihet nëpërmjet veprimeve sulmuese. Kjo theksohet edhe në Doktrinën Taktike të NATO-s, (ATP-35(B): 0301,0302).

Tashmë, sikundër na e bënë të qartë me gojën e tyre Hysen Berisha me të intervistuarit e tjerë, shtabi i GO-3 në fund të ditës së dytë të sulmit, në 10 prill 1999, urdhëroi ndalimin e mësymjes (sulmit) dhe e kaluan atë njësi taktike në mbrojtje.

Lind pyetja: A mund të rrethohet e asgjësohet armiku kur qëndron në mbrojtje pasive, në një mbrojtje pa kundërsulme?

Por le të mundohemi të jemi sa më konkretë. Të gjithë e dinim që forcat serbe kishin disa muaj që me batalionet e tyre kufitare kishin organizuar mbrojtjen e kufirit me Shqipërinë, me qëllim që të mos vinte asnjë lloj furnizimi nga Shqipëria për UÇK-në.

Mirëpo, duke kaluar edhe GO-3 në mbrojtje pas sulmit të saj dy ditë, do të thotë, se edhe ky formacion luftarak i yni zuri pozicione mbrojtjeje, njësoj si pala kundërshtarë! Si rrjedhojë, nuk kemi asnjë veprim luftarak prej GO-3(Br.138), as veprime sulmuese dhe as veprime mbrojtëse. Pra, kjo do të thotë se GO-3(Br.138), nuk ka bërë as sulm e as mbrojtje aktive, e lenë më të thuhet se ka zhvilluar beteja.

Natyrshëm që na lind pyetja: Çfarë e detyroi GO-3(Br.138), të kalonte në pozita mbrojtëse derisa armiku nuk sulmonte, por mbrohej?!

Kësaj pyetjeje është mirë t'i kthejnë përgjigje gjenerali Hysen Berisha dhe ata që qëndrojnë pas tij.

Nuk e mohojmë që GO-3(Br.138), mund të ketë dërguar apo nxjerrë luftëtarë apo grupe luftëtarësh në krahë e në shpinë të armikut, sikundër dëgjuam nga Hyseni dhe dikush tjetër, por kjo nuk do të thotë se armiku është sulmuar.

Bazuar në ekspozenë që na bëri gjenerali Hysen Berisha në intervistën e dhënë në datën 16 prill 2019, (kuptohet që ai është autorizuar edhe nga ish-komandanti i Br.138, gjenerali Rustem Berisha, ndryshe z.Rustem do ta kishte përgënjeshtuar), mësuam se ajo njësi taktike i ka qëndruar strikt luftës frontale mbrojtëse pasive menjëherë pas ditës së dytë të luftimeve. Mirëpo, sikundër thuhet edhe në Doktrinën Taktike të NATO-s, mbrojtja pozicionale pasive ka për synim dështimin e sulmeve të armikut, nëpërmjet thyerjs së tij²²⁾ dhe jo asgjësim të armikut.

Atëhere, zoti komandant i GO-3(Br.138), dhe ju oficerët anëtarë të shtabit të saj, lutemi na ndihmoni se çfarë emërtimi dhe çfarë note t'i vemë kësaj veprimtarie luftarake të brigadës që ju komanduat dhe drejtuat.

Pra, emërtimi “betejë” i luftimeve në Koshare nga ana e kuadrit komandues të forcave të GO-3(Br.138), tregon megallomaninë e tyre mburravece si dhe nivelin e ulët teorik ushtarak të tyre.

Është mirë ta mësoi gjenerali Hysen Berisha dhe kolegët e tij shtabovikë, se brigada nuk zhvillon betejë, por luftim, si në rastin kur ajo kalon në mësymje, edhe në rastin kur ajo organizon mbrojtje. Si i tillë, luftimi është një konflikt taktik zakonisht mes forcave të nivelit brigadë e poshtë. Dhe aq më shumë që në rastin tonë, GO-3(Br.138)

22) Doktrinën Taktike e F.T. NATO, ATP-35(B), Tiranë,1999, 0416,f.137

kryente veprime luftarake pa pasur në krahë njësi apo reparte të tjera të UÇK-së; gjë që as mund të mendohet se ajo mund të zhvillonte një betejë duke qëndruar në mbrojtje pasive.

Çdo oficer që ka kryer akademi ushtarake, sikundër pretendon gjenerali Hysen Berisha, e ka më se të qartë se çdo lloj brigade e një ushtrie klasike, edhe sikur të dojë të zhvillojë betejë, ajo nuk ka as sasinë njerëzore dhe as kapacitetet e tjera të armëve e shërbimeve për të realizuar një betejë po nuk pat luftuar në kuadër të një njësie operative. Aq më shumë që GO-3(Br.138) kishte një ndryshim total në raport me palën kundërshtare, si në aspektin inferior, përsa i përket organizimit, pajisjeve e doktrinës ashtu edhe të mundësive dhe aftësive luftarake. Prandaj mund të themi pa hezitim, se veprimet luftarake të GO-3(Br.138) në Koshare s'ishin gjë tjetër veçse një luftë asimetrike.

Beteja, sikundër thamë, është një seri luftimesh taktike të lidhura mes tyre, që zgjat një ditë, në raste të veçanta edhe më shumë se një ditë, dhe implikon forca më të mëdha sesa në një luftim, e që ka për synim jo vetëm t'i dëmtoi forcat e armikut, por t'i shpartalloi e mundësishtë t'i asgjësoi ato.²³⁾ Dhe këto luftime taktike sulmuese në kuadrin e një beteje duhet të jenë të njëkohëshme, të cilat zhvillohen në një rajon dhe kohë të caktuar, për të arritur objektivat pjesore të një operacioni.²⁴⁾

Mund të bëjmë një lajthitje të përkohëshme dhe të pranojmë se vetëm në periudhën 26 maj deri 10 qershor 1999, kur janë zhvilluar luftime edhe në mal të Pashtrikut, të mund t'i quajmë të dy këta luftime, një betejë. Por edhe

23) Doktrina F.T. NATO-s, 0430, f.149

24) Po aty, 0304, f.115

kjo është tepër e vështirë të pranohet, pasi forcat që luftonin në Koshare nuk kishin as lidhje taktike dhe as lidhje zjarri me ato që sulmuan në malin Pashtrik, pasi largësia midis tyre ishte gati 20 km. Ato lidheshin vetëm në aspektin strategjik të UÇK-së.

Është e vërtetë që SHP i UÇK-së veprimtarinë luftarake të forcave që qenë grumbulluar në Shqipërinë londineze e emërtoi “Operacioni Shigjeta”. Por atë emërtim ia vendosëm kur fillimisht planifikuam që në mënyrë të njëkohëshme, me dy brigada të tjera të sulmonim edhe nga drejtimi Dragash-Prizren, ndërsa me dy deri tre brigade të tjera të sulmonim në brezin Morinë e Tropojës-fshati Dobrunë. Në këtë kuptim do të kishim të bënim me një zonë gjeografike të një terreni të përbashkët veprimesh luftarake. Si rrjedhojë, vetëm nëse do të zhvilloheshin luftime të njëkohëshme në të gjithë këtë zonë gjeografike, (Koshare deri në Dragash), atëhere do të pranohej emërtimi: Operacion.

Pse e emërtuam “Operacioni Shigjeta”?

Sepse mendonim se do të vepronin njëkohësisht disa njësi taktike (4-5-6 brigada). Atëhere me të vërtetë që do të kishim një operacion të përbashkët, i vetëm dhe i integruar që do të drejtohej nga një komandë e vetme, komanda e forcave të bashkuara për arritjen e një objekti strategjik, sipas urdhërave që do të merrte nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Ky plan u mbështet në njoftimet, se në Shqipëri, veç ish-pjestarëve të UÇK që qenë larguar gjatë verës së vitit 1998 dhe disa forcave që pretendonin se i përkisnin Qeverisë Bukoshi, kishin ardhur edhe mbi 10.000 vullnetarë

nga diaspora. Për këtë të fundit shihni: Arkivi i Agjensisë “Kosovapress”, vëll.2, f.535²⁵⁾) dhe Arkivi Radio Kosova e Lirë, vëll.2, f.296²⁶⁾).

Por ky plan fillestar ndryshoi, kur u informuam saktësishtë se në Shqipëri nuk kishin mbritur mbi 10.000 vullnetarë, sikundër u propagandua në lajmet e datave 2 deri 12 prill 1999, por as sa gjysma e tyre. Njëkohësishtë, grupi i luftëtarëve që ne dërguam posaçërisht për të verifikuar mundësinë e sulmit në drejtimin Dragash-Prizren, në kushtet e atij dimëri të ftohtë e me dëborë, na raportoi se në atë drejtim nuk mund të mësyhej, për shkak të borës me trashësi mbi një metër, përveç terrenit tepër të thyer dhe se ata që do të sulmonin kishin një përgatitje disa ditore.

Atëhere, në datën 18 prill, ndërkohë që e kishim përfunduar atë plan operacioni, e anuluar, dhe hartuar planin e dytë, i cili përfundoi në mesnatën e datave 25-26 prill 1999.

Kështu që veprimtaria luftarake e forcave që luftuan në Koshare ishte e një shkalle më të vogël, ishte një luftim që përfshinte përdorimin e disa batalioneve që vepronin në një drejtim të vetëm taktik, për të realizuar një detyrë të veçantë, por jo të njëkohëshme me të gjitha forcat e atij operacioni që qe menduar më herët. Pra, GO-3(Br.138) zhvilloi luftime në një rajon të kufizuar, gati në një brez sulmi batalioni, duke kaluar pastaj në një brez mbrojtje pasive brigade, prandaj dhe s’mund të quhet betejë.

Bazuar në sasinë e forcave që përbënin GO-3(Br.138) dhe në furnizimet logjistike që ajo kishte në mënyrë të pandërprerë, ne, SHP, shpresonim që kontaktin me forcat

25) Arkivi i Agjensisë “Kosovapress”, Prishtinë, 2016, v.2, f.535

26) Arkivi Radio Kosova e Lirë, Prishtinë, 2009, v.2, f.296

e Z III Operative kjo njësi taktike ta realizonte brenda 2-3 ditëve. Nëse ajo detyrë do të mund të qe realizuar brenda atij afati, më tej, në ditët e pastajme, me të vërtetë që luftimet do të merrnin karakterin e një beteje, pasi bashkë me forcat e Z III Operative do të luftohej për zgjerimin e atij korridori, duke u angazhuar edhe forcat e tjera që luftuan më pas në Pashtrik, gjë që do të kërkonte një seri luftimesh. Ky ishte edhe një nga qëllimet që SHP u dërgoi urdhër gjithë zonave operative të dërgonin me urgjencë në përforsim të Z III Operative jo më pak se nga një kompani, me qëllim që inisiativa të mbahej vijimisht në duart tona.

Kuptohet që ju, kuadrot drejtuese të GO-3(Br.138), e keni shfrytëzuar bukur shumë emërtimin nga ana e SHP: “Operacioni Shigjeta”, prandaj dhe i emërtuat luftimet në Koshare “Beteja e Koshares”. Dhe këtë e keni bërë për t’i ngritur lavdi vetes suaj si dhe për të maskuar dështimin tuaj në plotësimin e detyrës luftarake të dhënë.

Fronti i Koshares

Pak më lartë thashë se të dy palët kundërshtare, si GO-3(Br.138) edhe forcat serbe që mbronin kufirin në sektorin e Koshares, luftonin secila duke qëndruar në mbrojtje. Pra patëm dy palë kundërshtare të pozicionuara nëpër transhe, duke luftuar kryesisht me shkëmbime zjarri artilerie. Prandaj me të drejtë “Betejës së Koshares” i është dhënë edhe emërtimi tjetër: “Fronti i Kosharës”. Kjo lloj lufte vetëm nga llogoret (transhetë), vetëm me shkëmbim zjarresh artilerie e snajperistësh, do të thotë se të gjithë ata që janë vrarë nga të dy palët, janë vrarë si rezultat i sulmeve me zjarr të artilerisë dhe të snajperistëve. Por, fiksojeni mire:

sulmi me zjarr nuk siguron kurrë fitore. Dhe ky duhet të jetë shkak kryesor pse GO-3(Br.138) nuk e kreu detyrën e ngarkuar nga SHP.

Si rrjedhojë, kjo lloj lufte që na paraqitet në Koshare na rezulton tipike si Fronti Perëndimor në Francë dhe Belgjikë në Luftën e Parë Botërore, të cilin aq bukur na e pasqyron shkrimtari Erio Remark te romani i tij *“Asgjë të re nga fronti perëndimit”*, vepra më e shquar e letërsisë gjermane. Fronti Perëndimor del se ishte tipik si ky fronti ynë në Koshare, një ndeshje e armatosur e kufizuar midis dy forcave kundërshtare përballë njera-tjetrës. Të dyja palët e Frontit Perëndimor, duke qenë të lodhura, vazhduan për një periudhe 51 mujore të luftonin nga llogoret, në një vijë të zgjatur llogoresh dhe punime të tjera mbrojtëse. Kjo solli si rrjedhojë një numur të madh viktimash nga të dy palët, franceze dhe gjermane. Deri në fund të nëntorit 1914 ushtria franceze kishte humbur pothuajse një milion njerëz, po ashtu edhe gjermanët patën humbje aq të larta sa që ofensiva e tyre u konsiderua një dështim i madh strategjik.

Kështu na ndodhi edhe ne me strategjinë që përzgjedhi komanda dhe shtabi i GO-3(Br.138), të cilët e mohuan detyrën e vënë nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, pasi nga mësymje kaluan në mbrojtje pozicionale pasive. Dhe pse bënë këtë ndryshim strategjie, prandaj gjenerali Hysen Berisha e mohoi me këmbëngulje këtë detyrë, duke na thënë se: *“Br.138 nuk kishte për detyrë të çelte korridorin e furnizimit nga Shqipëria.”*(!!!)

Lufta në Frontin e Koshares ndodhi ngjashëm si ajo në Frontin Perëndimor edhe në aspektin e humbjeve, pavarësisht se në përmasa shumë herë më të vogla, pasi edhe përbërja e forcave ndërluftuese ishte po kaq e vogël.

Fronti ynë i Koshares pësoi 114 të vrarë dhe 350 të gjymtuar, pothuajse po aq edhe Fronti i palës Serbe: 108 të vrarë dhe disa qindra të gjymtuar.

Duke e parë me këtë sy, mendoj se nuk gabojmë nëse themi: sikur ta dinim se do të ndiqej kjo strategji nga komandanti dhe shtabi i GO-3(Br.138), do të ishte më mirë që të mos qe çelur fare lufta në Koshare, pasi nuk do të na ishin vrarë 114 djemë nënash dhe nuk do të na ishin gjymtuar 350 të tjerë.

Por, më fal se harrova, zoti gjeneral Berisha. Për të rrëzuar këto argumentat e mia u këshilloj të ndërseni një farë Spiro në Tiranë, teoricien si puna juaj, i cili mund t'ua ndihmoi, se edhe ai, si dhe ju, çdo lloj luftimi, edhe atë të skuadrës, e quan betejë. Por, nuk është rastësi, se edhe atë e pat përzgjedhur ai që u ka dhënë juve, Hysen, spaletat e gjeneralit.

Gjeneral, ka dava Kosharja, gjeneral; debati nuk përfundon me kaq.

28 prill 2019

KREU I KATËRT

KUR HISTORIA NUK ËSHTË E SAKTË, POPULLI E KA TË VËSHTIRË TË GJYKOI EDHE TË TASHMEN

Në çdo luftim, betejë apo operacion suksesi do të jetë përherë pasojë e llogaritjeve të përafërta sa më pranë të vërtetës. Ky relativitet është gjithmonë i pandarë nga lufta, sepse cilado qoftë thellësija e dijeve tona në shkencën e luftës, mjeshhtëria qëndron, në fund të fundit, tek arti me të cilin do të zbatohet ky luftim, kjo betejë apo ky operacion. Dhe përgjegjësia kryesore për të bërë këto llogaritje u bie njësoj si komandantit ashtu edhe shtabit të atij formacioni luftarak.

Qysh në shkrimin e parë të analizës për “Betejën e Koshares” pata thënë: “Në qendër të kësaj analize ushtarake kuptohet që do të kem komandantin dhe shtabin e GO-3(Br.138), të cilët janë autorët e vendimeve plotësisht të pavarur dhe që me shembullin e tyre kanë drejtuar vartësit në ato 70 ditë lufte”.

Gjithkush mund të pyesë se pse unë ngarkoj me përgjegjësi edhe Shtabin e GO-3(Br.138), për mos realizimin e detyrës nga ai formacion luftarak i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

E them këtë, duke u nisur edhe nga përgjigjia që botoi sot me shkrim gjenerali Hysen Berisha, i cili nuk u jep përgjigje çështjeve që unë trajtoj, edhe pse shprehet se nuk është dakort me dy shkrimet e mia të mëparshme. Pra, faktikisht, z.Hysen nuk kundërshton asnjë prej shkaqeve që unë tregoj për mos realizimin e detyrës nga Br.138. Dhe në vend që të diskutojmë si specialistë ushtarakë, për të evidentuar shkaqet e mosrealizimit të asaj detyre, Ai merret duke folur për lavdinë e kuadrove të asaj brigade, si dhe me këngën që ushtarët e saj kanë kënduar(!).

Së dyti, unë do të qëndroj në përgjegjësinë që ka Shtabi i GO-3(Br.138), pasi Shtabi i asaj njësie taktike, si çdo shtab tjetër i çdo formacioni dhe i çdo ushtrie, ka përgjegjësi të dyfishtë: ta ndihmoi komandantin nga ngarkesa e punëve të shumta administrative të organizimit të përditshëm dhe nga hollësitë teknike të punës së shtabit, si dhe ta këshilloi komandantin për të gjitha çështjet duke pasur të drejtën e përkujdesjes ndaj tij. Kjo e fundit i bën oficerat e shtabit të Br.138 që të kenë pasur një pozitë që i dallon nga pjesa tjetër e oficerave të saj. Pra, të gjithë oficerat e tjerë të brigadës u japin mendime oficerave të tyre vartës; ndërsa oficerat e Shtabit të GO-3(Br.138), kanë pas detyrë t'i jepnin këshilla komandantit të brigadës për të gjitha çështjet që lidheshin me detyrën e asaj njësie.

Me këtë duam të tregojmë se të gjithë shefat e armëve e shëbimeve anëtarë të Shtabit të kësaj njësie taktike kanë pas të drejtë t'i bënin sugjerime komandantit Rrustem Berisha në marrjen e vendimit. Prandaj dhe komandant Rrustemi, sikundër ka thënë në intervistën e para 5 viteve, i ka dëgjuar ata, sepse ata e kanë pas për detyrë ta

siguronin komandantin me informacion për ta ndihmuar në përgatitjen e vendimit, në kalimin e tij në urdhëra dhe më pas në masa për sigurimin e zbatimit të tyre. Gjithmonë duke pas parasysh që mendimet dhe veprimet e tyre janë udhëhequr nga detyra që i ishte vënë brigadës prej Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.

Me këtë duam të themi se Shtabi i GO-3(Br.138) ka qenë “mendja tjetër” e komandantit të asaj brigade; prandaj edhe Shtabi i kësaj njësie taktike mban përgjegjësi të plotë e duhet të japë llogari për mendimet e dhëna.

Si rrjedhojë, oficerat e Shtabit të GO-3(Br.138) kanë pas një detyrë relativisht të lartë. Për këtë arsye kam theksuar duke i bërë bashkëpërgjegjës, sepse anëtarët e shtabit të GO-3(Br.138), ngaqë e kanë pas detyrë të merrnin pjesë aktivisht në të gjitha fazat e komandimit dhe të drejtimit të forcave gjatë atyre 70 ditëve, (09 prill - 19 qershor 1999); së bashku me komandantin, ata kanë bërë përnjohjen e terrenit, kanë analizuar detyrat, kanë vlerësuar situatën dhe kanë përpunuar vendimin. Pas këtij procesi nuk është më nevoja se kush e dha kontributin, pavarësisht se vetëm komandant Rustemi ka pas të drejtë të marrë vendimin. Me t’u marrë vendimi, oficerat e Shtabit të GO-3(Br.138) kanë zbatuar urdhërat e tij.

Po pse po zgjatemi për këtë lloj “beteje”?

Sepse deri tash në vend që të na kthejnë përgjigje anëtarët e Shtabi të GO-3(Br.138) dhe komandanti i tyre pse e quajnë herë operacion e herë betejë, dhe pse nuk u arrit të kryhej detyra e vënë atij formacioni luftarak, merren

me çështje abstrakte: kush jemi ne, e kush jeni ju.

Prandaj, në pritje të këtyre përgjigjeve, për të na sqaruar se cili ishte vendimi që morën dhe cilat ishin detyrat e dhëna, po trajtojmë pasojat e kësaj lloj propagande glorifikuese të tyre.

Lufta në Kosovë ka 20 vjet që ka mbaruar dhe ne e kemi fituar atë luftë në bashkëveprim me aviacionin e NATO-s. Por, me qenë se komandanti dhe anëtarët e Shtabit të GO-3(Br.138) kanë më se 5 vjet që po shpërthejnë ekranet e televizioneve në Kosovë, duke arritur deri atje sa të krijojnë opinionin në popull, derisa edhe ish-Drejtori Politik i UÇK-së, sot President i Republikës së Kosovës, t'i dekoroi duke thënë më 9 prill 2016: *“Beteja e Koshares, e zhvilluar 17 vjet më parë është ndër betejat më të rëndësishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.”*, edhe pse e ka ditur që ajo njësi e UÇK-së nuk arriti ta kryente të vetmen detyrë të ngarkuar: hapjen e korridorit për të furnizuar formacionet e UÇK-së brenda Kosovës dhe popullsinë që ishte grumbulluar në zonat e mbrojtura nga formacionet e UÇK-së. Me atë dekorim të pashoq deri sot, Presidenti Thaçi nuk ka bërë gjë tjetër, veçse ka nënvleftësuar gjithë pjesën tjetër të luftës së UÇK-së.

Mirëpo, kjo lloj propagande është një fyerje e madhe që po i bëhet gjithë Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe jo vetëm UÇK-së, gjithë legjionit të dëshmorëve të asaj luftime. Në këto kushte na del për detyrë që të themi të vërtetën, pa e mohuar aspak luftën, gjakun që derdhën 114 dëshmorët dhesakrificat e 2500 luftëtarëve të tjerë, të cilët luftuan të gatshëm për të dhënë gjithçka për lirinë e Kosovës, por jo që të kalojë në harresë lufta dy vjeçare e gjashtë zonave operative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe e gjithë popullit të saj.

Ky është edhe qëllimi i këtyre shkrimeve, për t'ia bërë të qartë opinionit të gjerë në Kosovë se deri ku arrin kontributi i GO-3(Br.138) në atë luftë çlirimtare, pa ia mohuar aspak kontributin që dhanë luftëtarët e saj. E bëjmë këtë, duke u nisur nga postulati: kur historia nuk është e saktë, populli e ka të vështirë të gjykojë edhe të tashmen.

E themi me plot gojën, se e vetmia vlerë pozitive e luftimeve të kryera nga GO-3(Br.138), që duhet theksuar medoemos, është tërheqja në ato luftime e rreth 2000 forcave nga më specialet të Ushtrisë Serbe, duke ua lehtësuar disi detyrat formacioneve luftarake të Zonës III Operative të Dukagjinit dhe asaj të II të Pashtrikut.

Por, duke e cilësuar veprimtarinë luftarake të kësaj njësie taktike si “Beteja vendimtare për çlirimnin e Kosovës”, ne e shtrembërojmë historinë e asaj lufte. Nëse historia nuk jepet e saktë dhe e plotë, populli do të ngatërrohet dhe do t'ia vështiresojmë njohjen e rrugës në të cilën do të ecë në të ardhmen, duke e penguar të dijë nga ka ardhur e si ka ardhur liria e tij.

Dhe unë këtu e shoh humbjen graduale të shpresës së popullit tonë në këto dy dekadat e para të shekullit të XXI, i cili po ikën nga atdheu çdo vit e më shumë, edhe pse jemi fitues të asaj lufte për liri.

Kjo lloj propagande bëhet identike edhe në atdheun amë, në Shqipëri, ku jo vetëm që veteranëve të LANÇ-it të viteve 1939-1944 u thuhet nga të tre forcat kryesore politike me gojën e Kryeministrit Rama: “*uleni kokën para ish-kolaboracionistëve!*”. E njëjta gjë po bëhet edhe për periudhën 45 vjeçare për ndërtimin e socializmit, periudhë që e nxorri Shqipërinë nga mesjeta dhe e reshtoi krahas me

vendet e tjera të Evropës, përfshi në të gjitha fushat e jetës; edhe pse ishte periudha që e gjeti shqipërinë me 800 mijë banorë dhe e çoi në 4 milionë banorë, dhe sot mundohen ta cilësojnë si periudha më e errët e historisë së saj, duke na thënë se në këtë të ashtuquajturën “demokraci”: Jetën e jeton kush është më i zoti; ligjin e bën kush është më i forti! Është kjo aksiomë “demokratike”, e cila ka bërë që sot popullsia e Shqipërisë të zbresë në nivelet e vitit 1945.

Duke u ndjekur e njëjta propagandë e njëkohëshme si në Shqipëri edhe në Kosovë kemi të drejtën të shprehim dyshimin, se kjo gjë nuk është rastësi, por një kombinacion agjenturash antishqiptare.

Me këtë reagim, i detyruar nga fyerjet dhe akuzat e bëra prej oficerave të Shtabit të GO-3(Br.138), lidhur me një të vërtetë që shpreha më 10 tetor 2018 në TV Dukagjini, për mosrealizimin e detyrës nga ajo brigadë, do të mundohem të nxjerr në pah veçoritë e asaj që ata e quajnë “Beteja e Koshares”, si beteja vendimtare për çlirimin e Kosovës.

Ata gabohen qysh kur shprehen se lufta e tyre ishte: *“beteja vendimtare, nderi më i madh i luftës në Kosovë”*. Betejë vendimtare quhet ajo betejë që rrethon dhe asgjëson forcat e mjetet kryesore të armikut përballë. Mirëpo Serbia në Koshare nuk grumbulloi më shumë se 2000 forca dhe i janë asgjësuar vetëm 108 forca prej tyre, vetëm 5%. Atëhere si mund të pranojmë se kjo brigadë asgjësoi pjesën kryesore të atyre forcave? Ja pra se deri ku arrin megalomania e asaj propaganda dashakeqe, në kurthin e të cilës bie edhe Presidenti i Kosovës.

Dhe që të binden këta glorifikues, të cilët nuk e kuptojnë se çfarë dëmi të madh po i bëjnë historisë së Kosovës, do të mundohemi të bëjmë të qartë dëmin që sjell

propaganda glorifikuese dashakeqe e tyre.

Gjatë periudhës midis dy shkrimeve të mëparshme lidhur me të ashtuquajturën “Beteja e Koshares” pati shumë reagime nga më agresivet nga shumë kuadro të asaj brigade dhe simpatizantët e tyre, madje dhe fyerje nga më të ndryshme që ka fjalori i gjuhës shqipe, sulme të pamëshetur aspak në ato çfarë unë kam reshtuar si shkaqe për mos cilësimin e veprimtarisë luftarake të asaj njësie taktike si “*shpëtimtaria e Kosovës*”; duke mos i dhënë asnjë përgjigje atyre shkaqeve që unë reshtoj. Vështirë se mund të gjesh një analizë luftimesh për Luftën Çlirimtare të Kosovës që të jetë ndeshur me kaq shumë debate fyese. Gjë që do të thotë se i jemi afruar shumë të vërtetës, pasi dihet se e vërteta është e hidhur, ndaj dhe prodhon urrejtje.

E di i madh e i vogël në të gjitha trojet shqiptare se, me të dalë në skenë Ushtria Çlirimtare e Kosovës e në vijim, ajo është bërë objekt akuzash monstruoze jo vetëm nga armiqtë shekullorë të popullit e të kombit tonë, por edhe nga shumica e mediave në Kosovë, me disa simotra edhe në Tiranë, duke e cilësuar këtë ushtri çlirimtare si një organizëm terrorist profesional.

Edhe kjo propagandë glorifikuese e “Betejës së Koshares” në atë mulli çon ujë.

Pse e themi këtë?

E themi sepse kjo lloj propagande po bën të pamundurën për ta trajtuar GO-3 si një lloj ushtrie krejt e pavarur; si një ushtri që nuk varej as nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, as nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës, as nga Qeveria Bukoshi si dhe as nga Komandanti

i Zonës III Operative të Dukagjinit, ku bënte pjesë. Kushdo që është kurioz për këtë cilësim që i bëhet GO-3, e lusim të lexoi fjalën e z.Rrustem Berisha në simpoziumin e datës 9 prill 2000, të dëgjoji intervistën e tij dhënë më 08 prill 2014, si dhe atë të gjeneral Hysen Berisha dhënë më 16 prill 2019. Në disa media të tjera shkohet deri atje sa të shprehen haptas e pa droje, se “*oficerat e GO-3 nuk mund të pranonin të komandoheshin nga një çoban*”, me të cilën duan të fyejnë Komandantin e Zonës III Operative të Dukagjinit, i vetmi komandant që nuk u largua nga territori i Kosovës dhe lufta, sikundër u larguan në verën e vitit 1998 këta oficerat e Luftës në Koshare me akademira ushtarake.

Qëllimi tjetër i gjithë kësaj propagande është që Ushtria Çlirimtare e Kosovës të ngelet një çështje e hapur

Dhe gjithë kjo “çështje e hapur” filloi kur nisi propaganda e të qenit të GO-3, “ushtri e pavarur”. Dhe më në fund ajo ia arriti qëllimit. U arrit që të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, të dalë nga radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, (me disa përjashtime që numurohen me gishtat e një dore), përfshi të gjithë udhëheqjen e lartë politike e ushtarake të UÇK-së, bënë të pamundurën për themelimin e një Gjykate Ndërkombëtare kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për ta dënuar të gjithë këtë ushtri 20 mijëshe, si ushtri terroristësh. Kuptohet, me përjashtim të GO-3(Br.138)!

Ky vendim i Kuvndit të Kosovës të kujton një nga thëniet e Uinston Çurçillit në kujtimet e tij të pas Luftës së Dytë Botërore: “*Në qoftë se ne arrijmë dhe pushkatojmë çdo oficer të Shtabit gjerman, ne do të kemi paqe për 50*

vjetët e ardhshëm”.

Identike është edhe qëllimi i ngritjes së kësaj Gjykate Ndërkombëtare, për të gjithë kuadrin komandues të të gjithë formacioneve të Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, përjashtuar ata të GO-3, duke perifrastuar Çurçillin: *Në qoftë se ne arrijnë dhe e shpallin terrorist çdo oficer të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, nuk ka për t’iu përmendur më kurrë emëri UÇK-së në të ardhmen.*

Qëllimi tjetër i kësaj propagande është që të delet edhe në përfundimin: Nëse arrihet të shpallet UÇK-ja ushtri terroriste, automatikisht që do të kërkohet ndoshta edhe nga shtete të Evropës që Lufta Çlirimtare e Kosovës të shpallet luftë e padrejtë, dhe, si përfundim të kërkohet që Kosova t’i kthehet Serbisë.

Mos vallë edhe inicimi nga Presidenti Thaçi për diskutimin e kufijve të Kosovës, duke u mbështetur nga i gjithë Kuvendi dhe partitë politike të Kosovës, përjashtuar LVV, ka pas këtë qëllim?

Ndalim në këto dyshime, duke pas parasysh edhe Marrëveshjen e Konferencës së Rambujesë dhe Rezolutën 1244, të cilat UÇK-në nuk kanë denjuar t’i përmendin as emërin, me paramendim për ta akuzuar më pas si organizatë kriminale. Kjo mendojmë se duhet të jetë arsyeja pse nuk u pranua që UÇK-ja të ishte vijim i ushtrisë së Kosovës. E më katastrofikja ishte se në atë kurth të Rambujesë ranë edhe përfaqësuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me apo pa vetëdije. Këtë nuk e dimë ende.

Prandaj dhe thash më lartë se në këtë mulli çon ujë edhe shpallja e GO-3 si “ushtri e pavarur”, si ushtri që nuk ka lidhje me UÇK-në, duke arritur deri atje sa të akuzojnë, si me gjysëm zëri, edhe NATO-n si armike të saj.

Që nga shpallja e pavarësisë së Shqipërisë nuk dimë të ketë pas ndonjë institucion shtetëror që të ketë luajtur një rol kaq shkatërrues sesa kjo propagandë e dy-tre dekadave të fundit kundër dy luftrove çlirimtare shqiptare: si ndaj LANÇ-it të Shqipërisë, (1939-1944), ashtu edhe ndaj asaj të Kosovës, 1997-1999.

4 maj 2019

KREU I PESTË

ÇDO GJË QË KEMI DËGJUAR GJER MË SOT PËR “EPOPENË” E KOSHARES DHE PËR BR.128 THËNË PREJ NJË “GJENERALI” TË VETGRADUAR - JANË OPINIONE DHE JO FAKTE!

Në vijim të analizës ushtarake që po i bëjmë të ashtuquajturës “Beteja e Koshares”, jemi duke shfletuar edhe librat e gazetarit reporter Muhamet Çetta: “Me UÇK-në në Koshare”, në tre vëllime, në të cilat gjendet një informacion i gjithanshëm, pasi ai është një nga dëshmitarët okularë më objektivë të atij luftimi 67 ditor.

Ndër të tjera mësojmë se 9 muaj pas përfundimit të luftës për çlirimin e Kosovës, në Gjakovë, më 9 prill 2000 është zhvilluar një simpozium për të ashtuquajturën “Beteja e Koshares”, e organizuar nga komandanti dhe shtabi i Grupit të Tretë Operativ, ndryshe Br.138.

Në atë simpozium, si dhe në të gjitha intervistat e dhëna nga komandanti i atij Grupi Operativ (Br.138), z.Rrustem Berisha dhe anëtarët e tjerë të shtabit të saj, si dhe në të gjitha shkrimet e botuara prej tyre, flitet për gjithçka, përvëç katër çështjeve më të rëndësishme:

- Cila ishte detyra e dhënë nga SHP – GO-3-it?
- Cili ishte vendimi i asaj komande, për zbatimin e asaj detyre të dhënë?

- Cilat ishin detyrat luftarake që u janë dhënë reparteve dhe nënreparteve të asaj njësie taktike?, si dhe - Si u zhvillua ai luftim?

Këtyre problemeve kyçe stafi i atij Grupi Operativ (Br.138) i është larguar dhe po i largohet si djalli nga thimjani. Në këtë simpozium kanë qenë prezent edhe ish-Shefi i SHP i UÇK-së, z.Agim Çeku, dhe ish-Komandanti i Zonës së Tretë Operative, z.Ramush Harainaj. Mirëpo, të befason fakti tjetër se, prej këtyre dy kuadrove me përgjegjësi shumë të lartë gjatë luftës, nuk është reaguuar fare, kur Komandanti i GO-3 e mohoi detyrën që kishte marrë kjo njësi taktike nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, duke deklaruar se GO-3 kishte për detyrë: *“Heqjen me luftë të kufirit në mes Kosovës dhe Shqipërisë. Lufta e Koshares ishte epopeja më e madhe e UÇK-së, kjo luftë i mblodhi shqiptarët nga e gjithë bota.”*²⁷⁾

Kjo falia e dytë u ritheksua pa u thelluar edhe nga ish-Komandanti i DK Kukës, gjeneral Kuduski Lama, në intervistën e dhënë prej tij²⁸⁾, ndërkohë që dihet se kur filloi luftimi në Koshare kishte 17 ditë që në mbështetje të UÇK-së kishte ardhur me avjonët e saj gjujtës-bombardues e gjithë bota demokratike. Mos vallë nuk e kuptojnë këta zotërinj se, dashje pa dashje, me këtë deklaratë i heqin çdo lloj merite dhe kontribut Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe gjithçka i njihet kësaj *“ushtrisë së pavarur”* në Koshare, e prezantuar me emërtimin: *Grupi i Tretë Operativ?*

Gjithashtu, në kumtesën e tij Komandant Rrustem Berisha ngriti edhe dy çështje të tjera, që edhe për ato çështje këta dy kuadro nga më të lartët në UÇK, Çeku dhe Haradinaj, çuditërisht heshtën:

27) M. Cetta “Me UCK-në në Koshare”, Prishtinë, 2002, v.2, f.262-263

28) Intervistë e dhënë në TV Dukagjini, më 10 maj 2019

*“Shtabi i Grupit të Tretë Operativ, nën udhëheqjen e shefit të shtabit Agim Ramadani, përpiloi planin operativ”, (duke i quajtur batalionet njësi operative, ndërsa brigadën njësi taktike!), si dhe “Ne si ushtarë dhe eprorë të Brigadës 131, dhe eprorë e luftëtarë të brigadës 134 u treguam të gatshëm që të rreshtohemi në Grupin Operativ 3, njësi taktiko-luftarake”.*²⁹⁾

Po ashtu në atë simpozium nga z.Rrustem u tha se: nga kjo *“njësi taktiko-luftarake u bë organizimi i mbrojtjes civile nga pjesa e popullsisë jo e aftë që të sistemohet në njësi operative”*³⁰⁾, duke mos na e bërë të qartë se cilën popullsi civile mbrojti kjo njësi taktike, që ta dimë dhe ne të paktën.

Këto deklarime z.Rrustem Berisha pothuajse i ka përsëritur ngjashëm edhe në intervistën e dhënë në 8 prill 2014.

Si është e mundur që këta dy zotërinj, Çeku dhe Haradinaj, i kanë pranuar të gjitha këto deklarime, si në atë simpozium por edhe më vonë, të cilat nuk përkojnë me realitetin historik?!

Si kanë pranuar këta dy zotërinj ekzistencën paralele në Dukagjin të dy zonave, apo grupeve operative, (një Zonë të Tretë Operative, edhe një Grup të Tretë Operativ), si dhe dy brigada: 131 e 134, si në Zonën e Tretë Operativë ashtu edhe në Grupin e Tretë Operativa?! Kush ka të drejtë, z.Rrustem Berisha, apo faktet e tjera historike?

Dhe këto 4-5 deklarime pompoze të bëra publikisht nga komandanti i GO-3 dhe stafi drejtues i saj, nuk kanë marrë ende përgjigje nga këta dy ish-kuadro me përgjegjësi ushtarake shumë të lartë gjatë luftës në Kosovë!

29) M. Cetta “Me UCK-në në Koshare”, Prishtinë, 2002, v.2, f.262-263

30) M. Çetta, vepër e cituar, v.2, f.260-264

Të jetë kjo thjeshtë një nënvleftësim naiv prej tyre i historisë së asaj lufte; të jetë një oportunitizëm, apo një marrëveshje e heshtur ku mund të fshihen të tjera qëllime?

Kemi të drejtë të shtrojmë të tilla pyetje, kur kujtojmë se edhe ardhja e z. Agim Çeku në luftë në Kosovë përkon disa ditë pasi kishte filluar lufta në Koshare! Të jetë vallë rastësi ky mosreagim prej tij si dhe prej z. Ramush Haradinaj?

Gjithashtu të bën pështypje edhe fakti i urgjencës për zhvillimin e një simpoziumi të tillë “shkencor” për një prej luftimeve të zhvilluara nga një brigadë e UÇK-së, veçan prej gati 30 formacioneve të tjera të ngjashme të saj, pa u zhvilluar qoftë edhe një analizë e vetme, të paktën me ish-drejtuesit e atyre formacioneve ushtarake dhe të institucioneve të Luftës për çlirimin e Kosovës, ku të dilte e veçanta e kësaj njësie taktike-luftarake, të cilës iu ngarkua një detyrë taktiko-operative në Koshare, e shkëputur prej formacioneve të tjera të UÇK-së.

Ky fakt të bën të dyshosh se: Pse kjo urgjencë nga ana e kuadrove drejtuese të GO-3, pa e ditur edhe vetë ata se çfarë vendi zë veprimtaria e GO-3(Br.138) në raport me gjithë luftën çlirimtare në Kosovë?! Dhe aq më shumë duke e cilësuar Luftën në Koshare si “*Epopeja më e madhe e UÇK-së*” dhe si “*Një ndër betejat më të rëndësishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*”, sikundër shprehet me motivacionin e tij të dekorimit Presidenti Thaçi.

Mos vallë gjithë kjo zhurmë bëhet për të mbuluar paaftësinë e gjithë këtyre “*profesionistëve institucionistë të luftës*” të cilët nuk realizuan detyrën e dhënë: Hapjen e korridorit për furnizimin e popullit të tërhequr në zonat e kontrolluara nga UÇK-ja dhe vetë formacionet e UÇK-së, detyrë të cilën e kishte të qartë çdo pjesëmarrës i luftës në Koshare?

Mos vallë kjo urgjencë prej tyre dhe kjo propagandë glorioze e shumëfishuar në këta 5 vitet e fundit nga TV Dukagjini për të mos dhënë llogari para familjeve të dëshmorëve dhe gjithë luftëtarëve idealistë, të ardhur nga të gjitha kontinentet, e shprehur kjo shkurt, thjeshtë dhe qartë nga një prej komandantëve të intervistuar nga z. Muhamet Çetta, Demush Gacaferi:

“..të nesërmen mbritëm në Bajram Curri, ku i takuam shumë fshatarë, anëtarë të familjeve. Bisduam me ta, e prisja me padurim të më njoftonin për situatën në Kosovë.... U pajisëm të gjithë me municion, blemë edhe dy kuaj, i ngarkuam përplot me municion dhe ca armë të tjera, më të rënda se pushkët automatike dhe u nisëm për në Kosovë, që e prisja me padurim. Në Kosovë u nisa me mendimin që të vras sa më shumë armiq, dhe isha i bindur se s’ka serb që të qëndrojë përballë nesh. Kisha një moral të lartë, që s’kam fjalë ta përshkruaj. Pas pesë vjetësh këmba ime shkeli përsëri në Kosovë. Jam ulur në gjunjë dhe i kam mbushur duart me dhéun e tokës sime, duke e puthur me një përmallim të madh. Lotët më pikonin, më treteshin në dhéun ndër duar, ndërsa nuk po ngopesha dot as me ajrin që po mbështillte Kosovën time.”³¹⁾

Këtë karakter kishin të gjithë ata vullnetarë që luftuan në Koshare. Me këta djem e burra ka të drejtë të krenohet jo vetëm Kosova, por i gjithë kombi ynë. Dhe për të mos u dhënë llogari këtyre burrave luftëtarë, manipulohet me simpoziume fasadë e intervista bombastike të organizuara nga gazetari Ermal Panduri përmes TV Dukagjini.

Duke dëgjuar reporterin e atij Fronti, z.Milaim Zeka, në intervistën e muajit prill të këtij viti në TV Dukagjini:

31) M. Çetta, *vepër e cituar*, v.2, f.204.

“Korridori nuk u hap se këta komandantë që lëvdohen sot për “Betejën e Koshares” nuk i lejonin të sulmonin këta dje³²⁾, (deklaratë e cila e nxorri nga takti gazetarin z.Ermal Panduri), bindesh plotësisht se cili ka qenë dhe është qëllimi i atij simpoziumi dhe i dhjetra emisioneve televizive të organizuara vijimisht këta vitet e fundit nga TV Dukagjini.

Pse nuk i thuhet popullit nga TV Dukagjini se cilat janë betejat e tjera të barabarta me “Betejën e Koshares”? Ku flen lepuri, që edhe z.Thaçi bie në këtë grackë dhe heshtin zotërinjtë Çeku, Veseli, Haradinaj dhe institucionet shkencore të Kosovës, duke bërë të pamundurën të organizojnë këta 20 vite një simpozium shkencor sado të shkrurtë për Luftën Çlirimtare në Kosovë?!

Dhe nga kjo mbështetje bërë “*Epopesë së Koshares*” prej Presidentit të Kosovës dhe mbështetja me heshtje e saj prej zotërinjve të përmendur më lartë, është frymëzuar një tjetër “gjeneral”, me emërin Ruzhdi Saramati, ku edhe ai na ka shpikur një lloj Br.128, duke i dhënë edhe asaj një front prej 15 km, sa dhe GO-(Br.138). Madje ky “gjeneral” i vetëgraduuar, Saramati, na e bashkon frontin e këtyre dy brigadave në Qafë të Prushit, [edhe pse këtë të fundit nuk e pranojnë këta të GO-3(Br.138)].

Por ajo që të befason është fakti se që të dy këta formacione na kishin të njëjtën strategji!: Heqjen me luftë të kufirit shqiptaro-shqiptar, duke e çliruar Kosovën me vullnetarë jashtë Kosove dhe jo nga vetë populli shqiptar në Kosovë! Këtë strategji e gjejmë jo vetëm në materialet e atij simpoziumit në Gjakovë, por edhe në intervistat e zotërinjve Rrustem e Hysen Berisha dhe të Ruzhdi Saramatit. Me

32) Intervistë në TV Dukagjini, 18 prill 2019, Shih Shtesa nr.15

këtë lloj “strategjiqe”, vallë këta zotërinj duan të na thonë se në gjithë hapësirën brenda në Kosovë nuk ka pas fare forca të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?!

Ja se deri ku të çon etja shterpë për lavdi ushtarake, të cilën vjen një ditë dhe e paguan shtrenjtë, pasi është një mall që të shket nga duart e s’e mban dot, sikundër shprehet Balzaku! Për këtë lloj etje shterpë, populli ynë ka proverbin: “Ku u çon mushka?!”

10 maj 2019

KREU I GJASHTË

KALIMI NË MBROJTJE – IMPONIM APO I VULLNETSHËM

Në këtë shkrim të rradhës për “Betejën e Koshares” do të ndalemi kryesisht për të sqaruar se kush e planizoi mësymjen në Koshare nga territori i Shqipërisë për në Kosovë; cili ishte armiku përballë tyre dhe shkaqet e ndalimit të mësymjes.

Edhe këtë analizë po e bazojmë në intervistat që kanë dhënë shumë eprorë të të gjithë niveleve drejtuese të forcave të GO-3(Br.138) që sulmuan në Koshare; por jo duke i kontestuar ato thënie të tyre, por duke u marrë me analizën e veprimeve dhe thënieve të tyre. Në të gjithë analizën e deritashme, për të cilën jam i bindur që shumicës së atyre eprorëve nuk u pëlqen, nuk kam thënë asgjë më shumë se ajo çfarë ata kanë ditur dhe as më shumë se çfarë ata kanë thënë deri më sot. Por me sa kam kuptuar nga reagimet e tyre ndaj shkrimeve të mia, duke iu referuar atyre çfatë ata kanë thënë e shkruar, dhe kjo urrejtje u buron atyre ngaqë nuk e dinë se nuk ka gjë më të rrezikshme sesa kujtesa e shkruar.

Qëllimi i shkrimeve të mia rreth “Betejës së Koshares”, për t’iu afruar sa më shumë të vërtetës së asaj që ka ndodhur në Koshare, është një arsye më shumë pse atyre kuadrove nuk u pëlqejnë këto analiza.

Tashmë dihet se këto forca njihen herë me emërtimin

“Grupimi Tretë Operativ” dhe hera-herës, si pa qejf, “Brigada 138 e UÇK-së”.

“Luftës në Koshare i ka pas paraprirë një kohë përgatitore shumë e gjatë”, na tregoi gjeneral Hysen Berisha në intervistën e dhënë në TV Dukagjini, më 16 prill 2019; e cila, “fillon me dislokimin e repartit ushtarak në Papaj, në 14 gusht '98”¹⁾, plotëson gjeneral Rustem Berisha, i cili më tej vijon: “Realisht, ato reparte më vonë formojnë Br.138, e cila ka zanafillën e vet, në përbërje të së cilës ishin tri njësi: Br.131, Br.134 dhe njësia “Delta”. Të tri këto njësi ishin miratuar nga Ahmet Krasniqi.”²⁾ “Kur jemi larguar nga Kosova, ka qenë data 8-9 shtator 1998”³⁾, saktëson eprori Gani Gjukaj, dhe “në 16 Tetor 1998 mbrijmë në Papaj, ku vazhdimisht është biseduar për thyerjen e Kufirit, d.m.th. së pari, për futjen në Kosovë, por edhe për Kosharen, për luftimet aty. Në këtë kohë, Shtabi Përgjithshëm ende nuk ka dhënë urdhër për fillimin e luftës.”⁴⁾


“Përgatitja për vendimmarrje të betejës në Koshare ka ndodhur 5-6 muaj përpara”, - tregon po në atë intervistë z.Hysen Berisha, dhe vijon- “Vendimmarrjes i ka parapri një proces i gjatë i përgatitjes së kësaj lufte, duke filluar me rekrutime e trajnime.... Në fund u bë ristrukturimi i brigadës 131, si brigadë kryesore, të cilës ju bashkangjiti disa muaj përpara një bërthamë e brigadës 134 dhe njësia pranë-shtabore e Ministrisë së Mbrojtjes për vëzhgime, që e udhëhiqte Anton Çuni, i cili më vonë shkrihet në GO-3, batalioni “Delta”, njësi kjo për operacione speciale. Janë këto tre formacione që faktikisht janë formuar më herët, diku në maj '98, nga Ministri i Mbrojtjes Ahmet Krasniqi; me vendimin e tij. Në qershor '98 janë hy në Kosovë, ku kanë zhvilluar luftime në Zonën e Dukagjinit.”

“Këto forca u emërtuan Grupi i Tretë Operativ, -plotëson kolonel Halil Bicaç,- i cili është formuar nga ne, me një detyrë të posacme, që nga këtu, nën drejtim të Ministrisë sonë të Mbrojtjes të bashkohet me forcat e tjera të UÇK-s në terren.”⁵⁾

Këtë deklaratë të ish-Ministrit të Mbrojtjes, z.Halil Bicaç, dhe atë se: *“Kanë qenë dy grupime UÇK”⁶⁾*, deklaruar nga z.Anton Çuni, na i konfirmon edhe z. Jakup Krasniqi: *“Fillimisht jam përpjekur të bëj bashkimin e trupave që gjëndeshin në pjesën veriore të Shqipërisë, ato të Rrethit të Hasit e të Qytetit Bajram Curr. Forcat e Hasit ishin nën komandën e Xheladin Gashit, ndërsa ato të Popajt ishin nën udhëheqjen e Rrustem Berishës dhe Nasim Haradinajt. Ky grupacion përbëhej kryesisht nga ushtarë e ushtarakë të Rrafshit të Dukagjinit, që pas ofansivës së verës 1998 kishin bërë tërheqje taktike në Shqipëri. Po të shikohet ajo që ka ndodhur me ta në verën e vitit 1998, dërgimi i njerëzve për t’u armatosur pa ndonjë kontroll, e sidomos dorëzimi i armëve, (falë zotit që kjo dukuri na ka ndodhur vetëm në Zonën e Dukagjinit dhe në një brigadë të Sufrekës), gjatë ofensivës serbe, vërtet është mirë që e tillë nuk ishte e tërë UÇK-ja, sepse ajo do të zhbëhej si ushtri. Dezertimi, ikja nga fronti i luftës, fshehja, dorëzimi i armëve etj., tregon për dëmet që i janë bërë luftës nga brenda. Kjo na detyronte ta armatosnim përsëri këtë zonë.... Kisha njohuri të mjaftueshme se ky grup, (GO-3, D.G), përbëhej prej 200-250 ushtarëve.”⁷⁾*

Meqenëse z.Jakup Krasniqi na kujton edhe dorëzimin e armëve nga ana e dy brigadave të komanduara nga zotërinjtë oficerë të Koshares, (Br.131 dhe 134 si dhe njësitet

“Cobra” dhe “Delta”), me këtë rast na lejon t’u prezantojmë dokumentin me të cilin mësojmë se çfarë armatimi kanë dorëzuar këta oficerët profesionistë. Këtë dokument e ka publikuar gazeta “Epoka e Re” dhe ajo “Expres”, datë 31 Mars 2014:



(Marrë prej Gazeta Express, e hënë, 31 Mars 2014 18:10)

Në këtë dokument prezantohet sasia e armëve dhe numrin serik i tyre të dorëzuara nga këta zotërinj oficerë, që edhe sot nëpër intervista me të drejtë lëvdohen që i përkin

FARK-ut dhe vareshit nga Miniatria e Mbrojtes e qeverisë Bukoshi, ndërsa përkatësinë në UÇK e theksojnë si me gjysëm zëri.

Sipas kësaj dosje, janë dorëzuar armatimi dhe municionet e mëposhtme:

“Pushkë automatike të prodhimit kinez, kalibri 7.62 mm, me numrin vijues, gjithsejtë 735 (mbyllet me numrin rendor 735) (armët nga faqja 2, 3, 4, 5); 222 copë pushkë automatike kineze me karikatorë, kalibri (i palexueshëm qartë); 419 pushkë gjysmautomatike të prodhimit kinez të kalibrit 7.62 mm; 23 copë pushkë të ndryshme (“M-48”, “Leninka”, “Taljanka”, “Karabina”) të kalibrit 7.9 mm dhe të tjera; 7 automatikë rusë “Ahpagini”; 82 pushkomitraloza të kalibrit 7.62X39; 70 pushkomitraloza të kalibrit 7.62X 54; 35 copë pushkomitraloza “Broving”; 53 mortaja dore të prodhimit kinez; 6 topa pa dridhje; një minahedhës i kalibrit 82 mm; 7 copë minahedhës të kalibrit 60 mm; granata për topin pa dridhje 62 copë; jo i lexueshëm lloji i armatimit 1.050 copë; 7 granata për minahedhës 60 mm dhe 82 mm; 196 granata për mortaja dore; 5 mina kundërtanke; eksploziv tritol 4 kg; 225.054 copë fishekë të kalibrit 7.62x39 dhe 7.32x54; dhe 392 karikatorë pushkësh automatike. Kjo është vetëm një pjesë e të bëmave të oficerëve të paguar nga Qeveria Bukoshi, që e dëmtuan seriozisht luftën çlirimtare në Kosovë.”⁸⁾

Nëse do ta marrim batalionin kufitar, (me të cilët këta zotërinj oficerë luftuan në Koshare), të barabartë me batalionin e këmborisë, i cili ka gjithsej 688 ushtarë dhe oficera, dhe po të shohim se sa armë krahu këta u kanë dhuruar serbëve, gjithmonë bazuar në këtë dokument, mësojmë se janë dorëzuar $735+1050 = 1785$ armë krahu.

Kjo sasi armësh është e barbartë me armatos gati tre batalione këmbësorie serbe, për mos të thënë gjithë efektivin këmbësor të një Brigade Këmbësorie (BrK); kanë dorëzuar mitralozë të ndryshëm aq sa kanë në armatim dy batalione këmbësorie serbe; kanë dorëzuar mortaja dore (60 mm) sa ka në organikë një BrK serbe; kanë dorëzuar topa pa dridhje sa ka në organikë një Regjiment Këmbësorie serbe; kanë dorëzuar fishekë automatiku për 750 automatikë, ose për 1500 pushkë gjysëmatomike, që do të thotë një komplet luftarak batalioni plus edhe një kompani këmbësorie, për të luftuar disa ditë, etj.

Bazuar në sa më sipër, të nderuar zotërinj oficerë të Shtabit të GO-3 (Br.138), kush na garanton ne se ju nuk jeni ndeshur në Koshare me forcat serbe që i keni armatosur vetë, e që i keni përforcuar gati me sasinë e artilerisë së një brigade? Mos ka vallë këtu ndonjë farë njohje me oficerat serbë gjatë shkollimit tuaj? A mund të na gjeni një rast të tillë nga historia e luftimeve botërore, që një palë ndërluftuese, pasi e kompletton kundërshtarin armik shekullor me armë e municione, të kthehet e t'i thotë pas disa muajsh: Eja të bëjmë luftë? Ky është një rast unikat në historinë e luftimeve botërore, zotërinj oficerë “institucionalistë” e “profesionistë”. Dimë se vetëm në duela individësh kanë ndodhur raste të tilla, dhe ato në mesjetën e vonë, por jo nga ushtritë.

Prandaj nuk jam fare dakort me shprehjen e z.Jakup Krasniqi kur thotë: *“ushtarakë të Rrafshit të Dukagjinit, që pas ofansivës së verës 1998 kishin bërë tërheqje taktike në Shqipëri”*. Quhet tërheqje taktike vetëm në rastet për t'u ripozicionuar për mposhtjen e pengesës. Si mund të mposhtej ushria serbe, duke i dorëzuar asaj edhe armët

tona?! Kemi të bëjmë me taktikë apo largim me turp nga lufta? Kjo që kanë bërë këta oficerë “profesionistë” nuk e ka emërin “tërheqje taktike”, por kapitullimi ushtarak, më saktë: dezertim. Këta lloj “profesionistësh”, nëse kishin ardhur për të çliruar Kosovën, duhej ta kishin marrë parasysh edhe vdekjen, sikundër bëri pjesa tjetër e Rrafshit të Dukagjinit me në krye atë “çobanin” që nuk u ka pëlqyer juve.

Dhe ja se cila ishte gjendja në Kosovë kur është bërë ajo “tërheqje taktike”, të cilën na e shpjegon qartë oficeri i Zonës së Dukagjinit, z.Gani Gjukaj, i angazhuar në luftë prej dt.25 maj 1998, e më pas komandant i Logjistikës së GO-3:

“Për mendimin tim, udhëheqja e Kosovës në atë kohë nuk ka pasur vizion të qartë për atë që ndodhte në Kosovë. E kam fjalën për LDK-në, e cila nuk kishte vizione për situatën se çka po ndodhte... Kur lufta në Dukagjin ishte e paevitueshme, kur popullata me të madhe armatosej, vijnë udhëheqës të LDK-së dhe thonë se kjo nuk është vijë jona, nuk qëndrojmë pas saj, e në të njëjtën kohë Bujar Bukoshi e formon njësinë e mbrojtjes, pra, në mars-prill 1998... Rugova ka qenë personi, i cili nuk ka mundur ta udhëheqë luftën, dhe së fundi është deklaruar që nuk është një njeri që i fryn luftës dhe që futet në luftë... Në fund të qershorit të vitit 1998, në këtë pjesë të Kosovës arriti nga Shqipëria edhe grupi më i madh i eprorëve, të organizuar nga Ministria e Mbrojtjes, në krye me Esat Krasniqin, Tahir Zemën (komandant i tyre), i cili ka ardhur nga Br.134. Sa e di unë, nga Shqipëria kanë mbritur 27 eprorë, dhe ky ka qenë grupi më i madh i eprorëve që janë futur në Dukagjin apo në Kosovë, nga fillimi e deri në mbarim të luftës...

Me futjen e këtyre ushtarakëve, në Dukagjin nisën edhe përçarjet, ... por faj të madh kanë edhe këta që u futën në këtë kohë në Dukagjin. Pra, me futjen e tyre nisën edhe acarimet ndërmjet njërit grup dhe grupit tjetër....Tahir Zema kur ka ardhur në Prapaçan, ka ardhur, siç thashë, si komandant i Br.134, dhe ka thënë se atë e ka mobilizuar dhe e ka futur në luftë Ahmet Krasniqi, d.m.th. i Ministrisë së Mbrojtjes, derisa Shtabi i atëhershëm i Rrafshit të Dukagjinit nuk e ka njohur Ministrinë e Mbrojtjes.”⁹⁾

Nisur nga këto fakte, si dhe po të kemi parasysh deklaratën e dhënë nga z.Milaim Zeka në TV Dukagjini, në datë 18 prill 2019: *“Duhet me dit se ushtarët qajshin pse nuk i lejoishin të përparonin këta komandantët që sot e glorifikojnë Betejën e Koshares.”*, na jepet e drejta të dyshojmë. Se helbete, zotërinj Hysen Berisha e Musa Gjakova, si oficer ideologjik i Enverit që më keni përcaktuar, ai “drej” Enveri na këshillonte: “Dyshoni për gjithçka”, si dhe “Beso e kontrollo”. Prandaj dhe unë, duke parë evidencat e prezantuara nga gazetari Muhamet Çetta, në kapitullin e 29, të vëllimit të dytë, të librit të tij *“Me UÇK-në në Koshare”*, ku 33% e dëshmorëve janë vrarë nga snajperistët serbë¹⁰⁾, më lind pyetja “enveriste”: Si është e mundur që dy autorët e planizimit luftarak për vendimin e mësymjes nga GO-3 (Br.138), (dëshmorët Agim Ramadani dhe Sali Çeku), vriten qysh ditën e tretë dhe të nëntë të sulmit?! Të jenë, vallë, rastësi të të vriten dy planovikët e asaj mësymjeje dhe të dy nga snajperistët serbë? Mirë njëri, po të dy?!

E shtrojmë këtë pyetje pasi na e ngacmon mendimin eprori Agim Haziri, kur thotë:

“Kosharen e kishte zgjedh vetë Agim Ramadani, sepse

e kishte vëzhguar terrenin së bashku me Rrustem Berishën dhe Sali Çekun.”¹¹⁾

Po ashtu, janë vrarë nga snajperistët serbë edhe eprorët e tjerë komandues të GO-3: Abaz Thaçi, Bashkim Ramadan Jasiqi, Milazim Mavraj, Xhemajl Metë Fetahaj etj. Të jetë rastësi që të gjithë komanduesit, të cilët kishin parim kryesor sulmin duke dhënë shembullin personal, të vriten nga snajperistët, ndërkohë që ti Hysen Berisha ishte i vetmi me shenjë dalluese, mbaje “*beretën blu*”¹⁴⁾, dhe që dihet se snajperistët vrasin vetëm kuadrot drejtuese?!

Kjo na shtyn të shtrojmë edhe pyetjen tjetër: Vallë, duke u vrarë ideatorët dhe inspiruesit e mësymjes, ju të tjerët nuk kishit zotësinë e tyre të vijonit mësymjen? Kjo të jetë vallë arsyeja kryesore që kaluat në mbrojtje, apo kemi të bëjmë me diçka tjetër të dyshimtë?

Dyshimin e këtyre rastësive e ka shprehur nëpër intervista edhe autori i librit “*Me UÇK-në në Koshare*”, i cili ua ka shtruar me dhjetra herë këtë pyetje eprorëve që ka intervistuar, ngaqë shumica e tyre dhe e ushtarëve të GO-3 (Br.131) i kanë tregua për A. Ramadanin se: “*Ai bile na thoshte: Për 10 ditë do të futemi në Malishevë.*”¹²⁾ *si dhe “Më jepni 50 ushtarë dhe do marr karaulën e Kosharës.”*¹³⁾

Mirëpo, ju e dini që, dyshimet e përsëritura sjellin dyshime të freskëta, zotërinj të nderuar, prandaj mos m’u mërzisni pse unë i shtroj këto dyshime.

Por ajo që na sjell një dyshim edhe më të freskët: Ju, gjeneral Hyseni, ndryshe i njohur edhe me nofkën “*bereta blu*”¹⁴⁾, edhe pse i vetmi midis gjithë atyre 2600 luftëtarëve në Koshare me këtë shenjë dalluese, si dhe përherë në vijë të parë, si nuk kanë mundur t’u identifikonin e t’u shënjestronin snajperistët serbë?!

* * *

Lidhur me pyetjen e fundit po jap një intermexo, e cila tregon se kë kanë objektiv snaiperistët.

“Gjatë luftës së Vietnamit një nga snaiperistët më të mirë të Korpusit të Marinës Amerikane, Karlos Haçkuk, i cili konsiderohet si një nga snaipëristët më të mirë të forcave amerikane deri më sot, mbante, për fat, një pendë të bardhë në kapelen e tij. Më në fund, forcat e Vietnamit të Veriut kishin arritur ta identifikonin se snaiperisti i tmerrshëm ishte amerikani që mbante një shenjë të tillë në kapele. Dhe vendosën ta asgjësonin me çdo kusht. Kur forcat amerikane e zbuluan këtë vendim të vietnamezëve, atëherë Koloneli Herman Pogemyer u jep urdhër gjithë forcave të tij në atë rajon, që “derisa të vendosim se çfarë të bëjmë për ta mbrojtur këtë snaiperist, në momentin që do kthehet nga vija e frontit të mbahet në izolim dhe të mos lejohet dalja e tij në ambientet e jashtme të bazës.” Pas disa ditësh izolimi komanda amerikane vendosi që të gjitha forcat amerikane në të gjitha pikat amerikane ku do të shkonte ky snaiperist në ndihmë të sulmit të forcave amerikane në atë rajon, për aq kohë sa ky snaiperist do të qëndronte atje, u urdhërua që të gjitha forcat e atjeshme të vendosnin në kapelen e tyre një pendë të bardhë zogu të ngjashme me atë që mbante snaiperisti, në mënyrë që forcat verivietnameze të mos arrinin ta identifikonin e ta eliminonin snaiperistin.”¹⁵⁾

* * *

Shkaku tjetër pse na detyron ta përsërisim të njëjtën pyetje është enigma e derisotme, se cila ka qenë ajo arsye aq e fortë që, menjëherë pas vrasjes së autorit kryesor të atij vendimi dhe nismëtari i idesë së atij sulmi prej forcave

të GO-3(Br.138), Agim Ramadanit, ndalohet mësymja dhe kalohet në mbrojtje?! A mund t'i jepet përgjigje kësaj ndalese të mësymjes pas 48 orësh pasi ajo kishte filluar?

Ky ndryshim strategjie bëhet edhe më vështirë për t'u kuptuar, për vet faktin se, është vet gjeneral Hysen Berisha, i cili në “*debatin plus*”, më 16 prill 2019, deklaroi se e kishin shumë të lehtë luftën me forcat serbë që mbroheshin në Koshare:

“Gjatë vëzhgimit kemi parë se ushtria serbe nuk ka qenë e aftë dhe jemi bindur se mund të luftohet me ta... Serbët kanë kujtuar se do të ishim si në vitin 1998. Kanë kujtuar se do të kishim armë si të rezervistëve të Shqipërisë... Morali i ushtarëve tanë ishte shumë i lartë, ndërsa i serbëve shumë i ulët, se ishin në vend të huaj. Kur shikoj një ushtar që i duket qyta e pushkës kuptohet se ose ishte rekrut ose rezervist dhe kjo na ka bind se luftën e kishim të lehtë. Dhe këtë bindje e krijuam pas një gamë të tërë vlerësimesh, gjatë vëzhgimeve 40 ditore.”¹⁶

Edhe ju, i nderuar **Musa Gjakova**, në letrën tuaj përgjigje që keni botuar për mua, krahas hartimit fyes, keni thënë një të vërtetë absolute, (përrjashtuar 7 fjalët e fundit, pasi nuk është e vërtetë):

“Të dhënat mbi forcat e armikut të angazhuara në Koshare që vetë i paraqesin ata janë: batalioni kufitar 53 i Brigadës 125 të Ushtrisë jugosllave, e përkrahur nga policia serbe; batalioni i II i Brigadës 125 të motorizuar, pjesë i Brigadës së parashutistëve; pjesë e Brigadës 72 të njësiteve special; njësitet e policisë së Korpusit të Pristinës; njësitët e policisë së korpusit të 2 beogradase të përforcuara me policë nga ish vendet jugosllave; detashment të huaj me forca vullnetare e mercinarë; detashmenti “Kozak” i ardhur

nga Rusia, pjesëmarës nga lufta në Çeçeni; mbeshtetja nga skuadrilia e aviacionit sulmuese-bombarduese të armatës jugosllave."¹⁷

E falënderojmë z.Musa Gjakova për këto të dhëna!
Nuk thonë më kot në Kosovë: Mos e pvet se flet vet.

Bazuar në informuesin për ushtrinë jugosllave, mësojmë se një batalion këmbësorie I ushtrisë serbe ka gjithsej një efektiv prej 688 ushtarë e oficerë; 422 pushkë vetmbushëse, 242 automatikë, 56 mitralozë të lehtë, 3 mitr. KA 12,7 mm; 6 flakdhës; 45 granathdhës KT; 12 mortaja 60mm; 9 mortaja 81mm, 2 topa KT pa zbrapse 57 mm dhe 9 topa KT pa zbrapse 82 mm.

Po nga ai informues dimë gjithashtu se një batalion kufitar serb ka dy herë më pak efektiv dhe armatim se një batalion i tyre këmbësorie. Por, megjithatë, për t'u ardhur edhe juve sa më shumë në atë që dëshironi, po i marim të dy batalionet kufitarë që ju na paraqesni, të barabartë me bk; po ashtu, edhe kompanitë e policisë i marrim të barabarta me kompaninë e këmbësorisë, me nga 139 vetë. Atëherë na rezulton: $688 \times 2 \text{ bk} = 1376 \text{ vetë} + 2 \text{ kom.policie} \times 139 = 278 \text{ vetë} + 2 \text{ kompani (pjesë të Br72 e asaj parashutiste} \times 2 = 278 \text{ vetë} + 2 \text{ detashmente rusësh} \times 150 \text{ vetë} = 300 \text{ vetë} + \text{ edhe } 100 \text{ policë përforcime: gjithsej} = 2332 \text{ vetë}$, me të cilët luftuan 2600 forcat e GO-3, të komanduar nga ju "profesionistët" e "ushtrisë "institucionale" të Ministrisë së Mbrojtjes së Qeverisë Bukoshi. Raporti forcave, gati 1:1.

Megjithatë, unë dyshoj që armku të ketë pas kaq shumë forca, duke pasur parasysh intervstën në fjalë të gjeneral Hysen Berishës, i cili deklaroi se sulmuesi duhet të jetë tre herë më i madh ne forca se mbrojtësi. Pra, ai desh të na thoshte se raporti i forcave ishte 3:1 në favorin e

GO-3. Dhe sips z.Hysen i bie që: $2600 : 3 =$ gati 900 forca serbe duhet të kenë qenë gjithsej gjatë gjithë kohës së luftës në Koshare, dhe jo 2332 forca. Megjithatë, po e marrim armikun të barabartë me 2332 forca.

Megjithatë, edhe pse po e marrim të mirëqenë se armiku kishte 2332 ushtarë e oficerë që luftuan në Koshare, përsëri kjo shifër nuk përbën 30% të të gjitha forcave serbe në Kosovë, sikundër na tha edhe gjeneral Kudusiu, në intervistën e tij në TV Dukagjin ditët e fundit. Nëse do ta prananim, se 2332 forcat serbe në Koshare përbëjnë 30% të të gjithë forcave serbe në Kosovë, sikundër deklaroi edhe gjeneral Hysen Berisha, del se Serbia duhet të ketë pasur jo më shumë se 10 mijë forca në Kosovë. Gjë që nuk është e vërtetë.

Faktikisht, bazuar në të dhënat që na jep “Human Rights Watch” me librin “*Nën Pushtetin e Urdhrave*”, Serbia pati 141 mijë forca gjithsej në Kosovë³³; dhe me 139-140 mijë forcat e tjera serbe luftuam në “*jo profesionistët*”, sikundër na quani ju zotërinj oficerë të GO-3.

Besoj se këto të dhëna, z.Musa Gjakova, nuk janë “*një plasim gazetaresk nga një i dehur*”, apo jo?

Por, nëse do ta marrim për të vërtetë deklaratën e gjeneral Hysen Berisha se ju në Koshare keni vrarë 1200 ushtarë serbë, thënë në intervistën e tij, më 16 prill 2019, (*ndërsa në f.93 të librit “Me UCK-në në Koshare” thuhet 1600 serbë të vrarë*), rezulton se ju keni pasur përballë vetëm 1100 ushtarë serbë. Dhe ju, me 2300 forca, (s’po i marrim 2600), në ditën e fundit të luftimeve¹⁶), nuk keni mundur të hapnit korridorin e furnizimit?!

33) “*Nën Pushtetin e Urdhrave*”, Tiranë, “*Korbi*”, 2002

Të jetë kjo paaftësi apo... e qëllimshme? Besoj se do të na përgjigjesh, apo jo, zoti oficeri profesionist Musa Gjakova.

Dhe mos harroni tjetrën zotërinj Hysen Berisha e Musa Gjakova dhe kolegët tuaj, që ju keni shkruar e folur se furnizimet nga logjistika kanë qenë me bollëk, madje edhe ushqimi u vinte i ngrohtë tre herë në ditë direkt në transhe; ndërkohë që ne, ushtria “joprofesioniste” prej 20 mijë vetë, hanim një herë në ditë, bashkë me popullsinë që na kishte besuar neve. Gjithashtu, fishekët e predhat ne, duke mos qenë “profesionistë”, i përdornim me shumë kursim dhe i ruanim si djalë hazreti, ndërsa ju i kishit pa hesap. Dhe këtë fakt e dëshmojnë me dhjetra oficera që luftuan në Koshare, por unë po mjaftohem vetëm më një prej tyre:

“Vetëm në pozicionin tim, (me tre mortaja 160mm), -tregon inxhinieri topologaritës i asaj toge mortajash, z.Isa Dukaj,- ditën e fundit të luftës kemi pas mbi 15 (pesëmbëdhjetë) ton municion dhe është dashur që ai të bartet.”¹⁸⁾

A e konceptoni dot një sasi kaq astronomike vetëm për tre mortaja e që ngelën pa harxhuar?!

Mirëpo, kjo shifër flet shumë. Kjo shifër na thotë se gjatë atyre 67 ditëve jeni furnizuar, sikundër shihet, ndoshta edhe me dhjetfishin e nevojave. Dhe këtë na e vërtetojnë vetë serbët në filmin e tyre, ku e quajnë Kosharen “*Vietnam në miniaturë*”, ndërsa presidenti serb e quan “*Termopilet serbe*”. Duke pas direkt në transhe një furnizim kaq të jashtëzakonshëm, të cilin na e pohoi edhe gjeneral Kudusi Lama, kjo tregon se ju e keni planizuar qysh më herët që nuk kishit qëllim të vijonit mësymjen, prandaj, pas rënies së ideuesit të asaj mësymjeje, ju kaluat në mbrojtje. A është kështu?

Bindem për këtë, për vet faktin se në atë terren dhe pa mjete transporti nuk mundej kurrë të transportohej gjithë ai material luftarak me krahë, i çuar në transhe, nëse do të kishit ndër mend të vijonit sulmin. Për mos të thënë se po të kishit ndërmend të sulmonit, ajo sasi municionesh nuk do të ishte çuar kurrë në transhe, por do ta mbanit vijimisht mbi rrota ose mbi mushka, diku pas skalionit të parë a të dytë.

Dhe më duhet t'iu kujtoj edhe diçka tjetër, zotërinj oficerë të shkolluar nëpër akademitë e ushtrisë më të fuqishme në Ballkan, se ju, GO-3 (Br.138), kishit jo vetëm epërsi fuqie zjarri ndaj armikut, të cilën e keni theksuar në të gjitha intervistat tuaja me zë e me shkrim, por kishit edhe epërsi numerike, 2600 : 2332, 1:1 në favorin tuaj, që, po të kemi parasysh “moralin e ulët të serbëve”, sikundër na tha z.Hysen Berisha, raporti i bie të ketë qenë 3:1.

Mos harroni edhe favorin tjetër tuajin: Ju sulmonit nga lart-poshtë. Ua shtroj këto pyetje dhe shifra, ngaqë të më ndihmoi sadopak z.Musa Gjakova, i cili më ka premtuar të më japi ndihmë profesionale, pasi e ka “*habit analiza për betejën e Koshares e z.Dilaver Goxhaj, më shumë më ngjason si një elaborim i nivelit të një kadeti të akademisë ushtarake.*”¹⁹⁾ I bëj këto krahasime dhe analiza, edhe për faktin tjetër se, të gjithë oficerat që u angazhuan në luftimet 67 ditore në Koshare kanë qenë ish-oficera të ushtrisë serbe, kundër së cilës luftuan në Koshare, që do të thotë se ju e njihnit më mirë armikun se sa ai u njihje juve, njihnit taktikën e tij dhe moralin e tij. Kjo njohje ka qenë një avantazh shumë e më shumë në favor tuaj, të cilën na e sqaron edhe z.Naser Vllasi në intervistën e tij tek TV Dukagjin:

“FARK-u i parë formohet në vitin 1998... FARK-u ka ekzistuar në Tiranë, edhe Ministria e Mbrojtjes së Republikës Kosovës ka ekzistuar në Tiranë. Në Kosovë ka qenë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së... Në Koshare luftuam si UÇK, e cila është dashtë të jetë pjesë e FARK-ut, edhe pse ka disa që tani nuk po i pranojnë marrëveshjet.”¹⁸ Por që e kundërshton z.Nasim Haradinaj, kur thotë: “Brigada e Kosharës janë rreshtuar para Azem Sylës, Jakup Krasniqit, Plakut dhe meje (...) edhe Anton Çuni, edhe Rrustem Berisha. (...) Kosharja ashtë vendos pse kemi mbri në marrveshje unë, Rrustemi, Agimi dhe Xhafer Gashi dhe e ka aprovua Sali Çeki. Për këtë unë jam sulmuar pastaj, nga Zona e Dukagjinit, si FARKist, ndërsa Rrustemi, Agimi, Sali Çeku janë sulmuar nga të tjerët si Lëvizje, pse u bam bashkë. Unë kam garantuar në Shtab të Përgjithshë, konkretisht para Xhavit Halitit dhe Jashar Salihit, se këta djem, Rustem Berisha, Agim Ramadani, Xhafer Gashi, Sali Çeku, nuk na mashtrojnë. Me Anton Çunin nuk kam ba marrëveshje...Marrëveshjen e kam bërë me njerëz të revoltuar të FARK-ut...”²¹⁾

Në intervistën time dhënë TV Dukagjinit më 10 tetor 2018, midis të tjerava pata thënë, se komanda e forcave që luftuan në Koshare duhet t’i jepet gjyqit ushtarak. I qëndroj asaj fjale, pasi ju gjatë atyre 67 ditëve keni luajtur një tragjedi me Kosovën, me qëllim a pa qëllim, këtë ende nuk e kemi të qartë përfundimisht. Por e kemi më se të qartë që sot po luani komedi me Kosovën. Dhe, çuditërisht, në këtë komedi merr pjesë edhe Presidenti Thaçi, duke u dekoruar! Mos vallë ka të drejtë z. Fatmir Brajshori-Tushi, kur shprehet:

“Qëllimi i FARK-ut ishte të hynte si Kolonë e Pestë, të mënjanonte UÇK-në nga terreni, pastaj ata farkistët

të arrinin një lloj paqeje me ushtrinë serbe dhe bashkëkordinim... Diçka si ajo që ngjau në Isniq, kur u dorëzuan armët të ushtrisë serbe dhe krijimi i policisë së përbashkët! Por pas tradhtisë së Tahir Zemajt, kolona e pestë u bë ZERO, dhe u pengua lufta vllavrasëse e përgaditur si në Klladush të Bosnjes...”

27 maj 2019

REFERENCAT:

¹⁾ Muhamet Çetta: “Me UÇK-në në Koshare”, v.2,f.251; ²⁾ Rr.Berisha, intervistë e dt.8.4.2014 më TV Dukagjini; ³⁾ Gani Gjukaj tek libri M. Çetta, v.2, f.68-69; ⁴⁾ Gani Gjukaj tek libri M.Çetta,v.2,f.75-78; ⁵⁾ M. Çetta, v.1,f.121-122, marrë nga “Bota sot”, 22 maj 1999; ⁶⁾ Anton Çuni, Intervistë dhënë TV Dukagjini, më 2 maj 2019; ⁷⁾ Jakup Krasniqi “Kthesa e madhe”, 2006, f.203-204; ⁸⁾ Gazeta Express, e hënë, 31 Mars 2014, 18:10; ⁹⁾ M. Çetta, v.2, f. 56-57 dhe 60-61; ¹⁰⁾ M. Çetta, v.2, f.271-289; ¹¹⁾ M. Çetta, v.1, f.90; ¹²⁾ Rahman Samiu-Zogu, M. Çetta, v.3, f.126; ¹³⁾ Tregon Kamer Elezaj; ¹⁴⁾ M. Çetta, v.2,f.150; ¹⁵⁾ Marrë prej librit “Silent Ēarrior”, me autor Charles Henderson “Berkley”, 2000, kreu 8, f.146-150; ¹⁶⁾ Intervistë e dt.16 prill në TV Dukagjini; ¹⁷⁾ *Shih Shtesën nr.17*; ¹⁸⁾ M. Çetta, v.1,f.172. Ndërsa Hysen dhe Rrustem Berisha na japin shifrën 2200 forca; Anton Çuni 2600 forca, Pren Marrashi 2600 forca; Fisnik Ismaili 1500 forca; Rifat Muriqi 4000 forca etj; ¹⁹⁾ M. Çetta, v.3, f.158; ²⁰⁾ Naser Vllasi. Në emisionin “debat plus”, më 23.04.2019; ²¹⁾ Nasim Haradinaj, intervistë “debat plus”, më 18 prill 2019.

KREU I SHTATË

MBETET ENIGMË PSE NDËRPRITET SULMI DHE PSE KALOHET NË MBROJTJE?!

E kemi parë e dëgjuar me kujdes filmin e RTS (PTC) për Kosharen, por edhe transmetimin e tij nga RTK3, të shoqëruar me komente nga disa protagonistë të Luftës në Koshare. Kushdo që e sheh të plotë atë film bindet se edhe vetë serbët nuk e kuptonin, pse forcat e UÇK-së nuk e shfrytëzuan momentin e favorshëm të dy ditëve të para, por kaluan në mbrojtje! Kur forcat tona e ndërprejnë sulmin, me sa merret me mend, atëherë serbët e kanë kuptuar pse-në e ndërprerjes së sulmit të GO-3, ata e kanë kuptuar se vetëm kapja e kazermës së Koshares për forcat tona kishte qënë qëllimi i sulmit dhe me kaq mësymja për tanët ia kishte arritur qëllimit! Dhe kjo është quajtur dhe quhet prej tanëve “Beteja e Koshares”.¹⁾

Këtë fakt na lanë ta kuptojmë edhe komentuesit tanë të atij filmi. Dhe ja se çfarë na tregon ish-shefi i Shtabit të GO-3, z.Anton Çuni, kur flet në komentin që i bëhet filmit të RTS gjatë transmetimit nga RTK3: *“Sulmi u ndërmuar vetëm me 84 forca kundër një batalioni kufitar serb”, (300 forca, një batalion kufitar, D.G.). Forcat serbe u tërhoqën në panik dhe u përgjysmuan.”*

Dhe me kaq, z.Anton Çuni e quan të kryer detyrën luftarake të GO-3. Dhe këtë e bën për t'i ardhur në takim

Komandantit të GO-3, gjeneral Rrustem Berishës, i cili, në simpoziumin e organizuar prej tij më 9.4.2000 deklaroi:

“Heqja me luftë e kufirit mes Kosovës dhe Shqipërisë, që ishte ideali i shumë brezave tanë dhe brezit tonë që luftuan e dhanë jetën e tyre për këtë qëllim”²⁾.

Atëhere lind pyetja: Kur e realizuan atë detyrë “për heqjen me luftë të kufirit” dhe serbët ishin tërhequr më në thellësi, pse nuk depërtuan në forma të tjera për në thellësi të Kosovës duke përforcuar Z III Op. Dukagjini? Gjithashtu: Pse gënjejnë veten se gjoja është hequr kufiri “mes Kosovës dhe Shqipërisë, që ishte ideali i shumë brezave”? A ekzistoi më pas ai kufi edhe kur këta zotërinj bënë simpoziumin ku e shpallën atë luftë *Epopeja e Kosovës*? Ai kufi a është ende atje ku ka qenë?

Nëse këta zotërinj do të kishin hapur korridorin e furnizimit dhe do të kishin filluar të vinin vijimisht furnizimet prej Shqipërie në Kosovë, atëherë do të kishin më se të drejtë të shpreheshin tërë krenari: *“hoqëm kufirin mes Kosovës dhe Shqipërisë”*; dhe sot ne do t’u uleshim në gjunjë, pasi me të vërtetë që nuk do të kishte kufi, do kalohej lirshëm, të paktën gjatë kohës sa do të vijonte lufta. Madje krejt ndryshe do kishte luftuar e gjithë UÇK-ja.

Ç’është ky vetëmashtrim, apo duan të mbulojnë thyerjen e urdhërit luftarak? Mos zbatimi i urdhërit luftarak në kohë lufte ka vetëm një dënim: bëhesh i padëmshëm. Ata kishin marrë urdhër: *Të hapet korridori i furnizimit!* Nuk ka qenë në asnjë rast çështje për diskutim gjatë luftës heqja apo jo e piramidave kufitare, pasi lufta nuk njeh kufij shtetërorë.

Në të gjitha intervistat e dhëna pas lufte, kjo deklaratë absurd është përsëritur e përsëritet nga të gjithë komanduesit

e intervistuar të asaj “beteje”: *thyerja e kufirit!* Ato piramida kufitare nuk i kishin penguar dot idealistët gjatë viteve 1997-1999, të cilat i kishin kaluar (thyer) qindra herë. Vetëm për heqjen e atyre piramidave kufitare në kohë luftime duhej të vriteshin 114 burra e djem dhe të gjymtoheshin 350 e ca të tjerë?! A e mendoni se çfarë thoni zotërinj oficerë?

Duke lexuar me kujdes këto dy deklarata habitemi dhe pyesim veten: gjithë këto forca kanë qenë stërvitur prej shtatorit 1998 deri në prillin e vitit 1999 vetëm për të shkukur ca piramida, “*për heqjen me luftë të kufirit*”, madje, dhe vetëm kur do të angazhohej NATO-ja në luftë?! Dhe, vallë, me kaq e quajnë të kryer detyrën ndaj atdheut? Pse nuk i hoqën këto piramida pa u angazhuar NATO-ja në luftë, kur e dinin se “*ishte ideali i shumë brezave*”, pasi atje ishin nëndë muaj rresht?!

Si mund të pranohet justifikimi i bërë prej komandant Rrustem Berishës se detyra luftarake e GO-3 ka qenë veç “*heqjen me luftë të kufirit*”, kur edhe vullnetarët ndërkombëtarë që iu bashkangjitën këtij formacioni luftarak e kishin të qartë atë detyrë para se të merrnin rrugën për në Shqipëri, se detyra e GO-3 ishte “*futja brenda thellë në Kosovë, për ta përndjekur okupatorin serb*”, të cilën ia kanë bërë të qartë edhe gazetës “Bota sot”, datë 6 maj 1999:

“Kështu, sot derisa po shpërndareshin disa forca të njëjësive tona për në pozicionet e tyre, takuam edhe dy suedezë që kishin ardhë nga Norvegjia dhe që na deklaruan se ne kemi ardhur të futemi atje brenda thellë në Kosovë, për ta përndjekur okupatorin serb dhe për krijimin e kushteve që të kthehen të dëbuarit shqiptarë në trojet e tyre.”³⁾

Dhe çudia tjetër është se kjo detyrë luftarake e *thyerjes së kufirit*, si mund ta quajmë, është realizuar vetëm me 84

forca! Atëhere, kushdo mund të pyesë i habitur: Kur këta komandantë e realizun detyrën e *thyerjes së kufirit*, (pasi vetëm këtë detyrë pranon komandanti i GO-3), vetëm me 84 forca, pse lejuan dhe pranuan të vinin edhe 2500 forca të tjera në Koshare përderisa detyrën e kishin realizuar? Sipas këtij deklarami, a na lind e drejta të pyesim se këtu kemi të bëjmë me një sabotim të qëllimshëm të luftës çlirimtare, duke mbajtur të paangazhuar në atë luftë 2500 luftëtarë vullnetarë që ishin gati të sakrifkoheshin për lirinë e Kosovës, që do të thotë se i kanë hequr asaj lufte deri gati dy brigada luftarake të madhësisë së brigadave të tjera të UÇK-së?

Por le të kthehemi pak e të shohim se si e kanë realizuar thyerjen e kufirit këta zotërinjtë profesionistë, të cilët na japin shifra të ndryshme luftëtarësh të angazhuar; pavarësisht se një herë na thonë 84 vetë, një tjetër 115 vetë, dikush 170-180 vetë, një tjetër 256 vetë, një tjetër jep 350 vetë e disa shifra të tjera. Kjo anomali shifrash tregon se as kanë ditur se sa forca kanë pas edhe sot e gjithë ditën, ose nuk duan të na e thonë të vërtetën, e cila ndoshta duhet të jetë më e rëndë për ta.

Por në ç'mënyrë u krye ky sulm, në sa vija sulmi, (meqenëse kemi të bëjmë me terren malor e të pyllëzuar); në sa drejtime sulmuan këto forca kaq të shumta(!); cilët ishin këta drejtime; cilat ishin detyrat e forcave të secilit drejtim; kush i drejtonte forcat e secilit drejtim etj, etj. Asgjë. Këto nuk na sqarohen hollësisht, (se kështu shkruhet historia), jo vetëm nga z.Anton por as në simpziumin e 9 prillit 2000 dhe as nga të gjithë të intervistuarit që kanë marrë gazetari Muhamet Çetta dhe Ermal Panduri. Gjithçka që kemi mësuar deri tash, janë ato çka ua ka nxjerrë si me grep,

kryesisht gazetari Muhamet Çetta. Duhej të kalonin 20 vjet që të na e thoshte gjeneral Hysen Berisha në intervistën e datës 04 maj 2019, dhënë gazetës “Bota sot” se këto forca (shifra e saktë nuk na thuhet) kanë sulmuar në tre drejtime operativ (DO). Kaq dhe asgjë më shumë.

Kemi disi të qartë vetëm veprimin e një pjese të skalionit të dytë i cili hyn në luftim në mëngjezin e ditës së dytë, të cilin na e sqaron eprori Agim Haziri, pavarësisht se nuk bëhet e qartë gjithçka. Por një gjë na bëhet shumë e qartë, që forcat e skalionit të dytë kanë mbrit në Papaj pasi kishte hyrë në luftime skalioni i parë.⁴⁾

Kjo të len të kuptosh se komandantët që kanë drejtuar forcat e skalionit të dytë nuk janë njohur në detaj me idenë e sulmit nga anëtarët e Shtabit të Gupit të Tretë Operativ para se të hynin në luftim. Gjë që tregon se ata janë futur në luftim si në rastin e mësymjes në ecie e sipër, për mos të thënë sikur shkonin për gjueti.

Gjithashtu na bëhet e qartë se asnjë prej përpiluesve të atij plani për sulm nuk ndodhej në Papaj kur mbritën nga Helshani forcat që do të përbënin skalionin e dytë të sulmit. Hartuesit e atij plani ndodheshin duke luftuar në vijën e parë të sulmit. Sikundër do ta shohim, të porsa mbriturve nga Helshani, komandant Rustemi u ka dhënë vetëm drejtimin e veprimit. Dhe ja se si ka ndodhur konkretisht, të cilën na e tregon eprori **Agim Haziri**:

“Më 8 prill, në mëngjes, në Elshan, ku isha komandant i Qendrës Stërvitore me rreth 1200 ushtarë, erdhi një bashkëluftëtar i Vlanës me pseudonimin “Rrugova”, për të më sjellë urdhërin t’i bashkohemi Rustem Berishës në Papaj. Urdhëri më erdhi nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, përmes “Plakut”... Në Papaj shkova me 240 vetë, duke

*i llogaritur edhe eprorët e tjerë si Fadil Demirin, Ramadan Gashin, Esat Krasniqin, Sami Ukshinin. Aty takuam komandantin Rrustem Berisha, i cili mua personalisht ma dha drejtimin e veprimit. Me ushtarët e mi dhe me eprorin Sami Ukshini menjëherë u nisëm për në drejtim të Kazermës së Koshares. Ramadan Gashit, Fadil Demirit dhe Esat Krasniqit iu jepen drejtime të tjera të veprimit luftarak. Jemi në mes të datave 9 dhe 10 prill 1999, kur të gjithë eprorët me ushtarët tanë kishim mësyer për ta dëbuar okupatorin nga pozicionet e tij. Sali Cekaj së bashku me Naser Vllasin gjendeshin në Rasë të Koshares me njësitë e tyre. Unë isha në drejtimin ku vepronin Agim Ramadanit, Anton Çuni, Skënder Hasanxhekaj, kurse në anën e djathtë nga Kazerma e Koshares vepruan Skënder Rexhahmetaj, Hysen Berisha (327-ta, siç e thirrnin). Me mua ishte edhe Esat Krasniqi dhe Sami Ukshini. Xhafer Gashi ishte me njësinë e vet po ashtu i angazhuar në pozicionet e veta... Në Kazermën e Koshares, para se të futeshim ne, kishte një kompani ushtarësh serbë. Unë e kam gjetur apo më mirë të them jam bashkuar me njësinë e Agim Ramadanit në Kazermën e Koshares. Unë kisha 47 ushtarë me të cilët synonim të pastronim terrenin dhe të futeshim në Kazermën e Koshares nga ana e djathtë e saj. Pikëtakimi ishte në kazermë. Njësia e Agim Ramadanit ishte futur në kazermën e Koshares... **Ishte ora rreth 9 e mëngjesit, më 10 prill 1999**, ku u takova me Agim Ramadanin.... Kazerma ishte e ruajtur mirë nga ushtarët tanë. Menjëherë dhash urdhër që edhe ushtarët e mi të inkuadroheshin në sigurimin e kazermës... Agimi më foli diç për strategjinë e luftimeve dhe për njohuritë në terren. Më tha se Rrasa e Koshares është në rrezik dhe se ajo është në pikësynim të forcave serbe.”⁵⁾*

Sikundër shihet, këto forca vinin nga thellësia dhe do mësynin në terren të panjohur prej tyre. Puna e parë që duhej të qe bërë me këto forca nga komandanti ose shefat e tjerë të GO-3, njohja e komandantëve të tyre me gjendjen e armikut, gjendjen e forcave tona, në cilën vijë po kryheshin luftime nga forcat e skalionit të parë, veçanërisht për njohjen e terrenit, gjë që asnjë prej këtyre informimeve të domosdoshme nuk rezulton të jetë bërë.

Këtë gjë na e pohon edhe eprori tjetër Ramadan Gashi:

“Ardhja jonë e vonuar nga Vlani dhe Cahani në Koshare për të marrë pjesë në thyerrjen e kufirit ishte bërë sepse nuk kishim urdhërin nga ish-ministri i Mbrojtjes së Qeverisë së Përkohëshme të Kosovës, z.Azem Syla”⁶⁾.

Mbetet enigmë, pse GO-3 ndërpreu mësymjen?

Asnjë shpjegim thjesht ushtarak nuk mund ta justifikoi këtë fakt: pse u hoq dorë nga sulmi, prej forcave të GO-3-it në momentin që u vinë në përforcim edhe 240 forca nga Helshani! Sado e fuqishme që të ketë qenë mbrojtja e batalionit kufitar serb, përsëri ekziston çudia: pse u kalua në mbrojtje dhe nuk pati më tentative për të vijuar mësymjen edhe kur janëpërforcuar e shumuar në vijimësi me forca të reja. Madje këtë enigmë e bën edhe më të mjegullt edhe fakti tjetër se pse vijuan të qëndronin në pozicione mbrojtëse edhe 9 ditë të tjera, pas ndalimit të luftës Kosovë-Serbi, deri më dt.19 qershor 1999, datë të cilën na e ka konfirmuar gjeneral Hysen Berisha në intervistën e datës 16 prill 2019. Kam bindjen se sekret i ndërprerjes së papritur të mësymjes dhe kalimi në mbrojtje pozicionale për 70 ditë rresht (11 prill - 19 qershor 1999) ka për të mbetur i errët dhe i pakuptueshëm.

Enigmën e kalimit në mbrojtje e përforcon edhe fakti se kur atdheu është i pushtuar, është absurditet të thuash se ai mund të çlirohet duke luftuar në mbrojtje, apo ai duhet çliuar duke e nxjerrë popullin jashtë kufijve dhe pastaj ai të sulmoi nga jashtë-brenda! As hapja e një korridorit nuk mund të bëhet duke luftuar vetëm nga llogoria. Prandaj nuk ka se si mund ta quajmë “Betejën e Koshares” betejë fituese derisa nuk e çeli dot korridorin e furnizimit. Pikë!

Gjithashtu, nuk mund të themi se patëm fitore vetëm se u kap dhe u mbajt një brez malor kufitar pa popullsi, me gjatësi 15 km dhe gjerësi 2-4-5 km. E kemi shprehur edhe më herët, se e vetmia gjë pozitive e atyre luftimeve ishte se forcat e GO-3 tërhoqën dhe mbajtën nën presion një sasi prej gati 2000 forca serbe, dhe asgjë tjetër.

Eprorët ushtarakë të GO-3 përpiqen të na e mbushin mendjen me disa të dhëna fallco, duke thënë se gjoja kjo “epope” tërhoqi në Koshare 30% të forcave serbe që ishin në Kosovë, nga të cilat vranë 1600 serbë! Dhe me këtë “*na e kishin paralizuan inisiativën e krejt forcave të tjera serbe*”! Që indirekt duan të thotë, se 20 mijë luftëtarët e tjerë të UÇK-së në Kosovë, s’kanë bërë gjë tjetër, veçse kanë hedhur valle!

* * *

Këta zotërinjtë tanë e quajnë luftën e tyre në Koshare si “*ditët më të shënuara të luftës sonë dhe si ngjarja më e lavdishme e saj*”⁷⁾, si betejën më të madhe dhe më fitimtare të të gjithë Luftës Çlirimtare të Kosovës, duke e emërtuar edhe “Beteja e Koshares”.

Çuditërishtë, edhe pala serbe bën të njëjtin përcaktim; edhe ata luftën e tyre mbrojtëse në Koshare e quajnë fitore

dhe betejën më të madhe të tyre në Kosovë. Dhe këtë e mbështesin në pranimin e faktit se zjarri i forcave tona ua pat bërë ato dy muaj jetën skëterrë, prandaj dhe e quajnë “*Ishte një Vietnam në miniaturë*” si dhe “*Termopilet serbe*”. Dhe nisur nga këto me çfarë e justifikojnë serbët mbrojtjen e tyre “termopile, edhe tanët duke u nisur nga këto krahasime serbe, e quajnë edhe këta fitore atë luftim mbrojtës të tyre! Si është e mundur, të ndeshen dy forca dhe të dyja të deklarohen fituese?! A ka logjikë këtu? Kjo është një nonsens. Edhe në sport nuk ndodh një gjë e tillë, e jo më në luftë.

Zotërinj drejtues kryesorë të GO-3, të rimë një moment shtrembër e të flasim drejtë: Armikun urreje, por jepi hakun. Pala serbe ka të drejtë që luftën në Koshare ta quajë fitore. Dhe ja cilat janë arsyet:

1. Penguan palën tonë të kryente detyrën: çeljen e korridorit për furnizim nga Shqipëria në Kosovë.

2. Na vranë planizuesin kryesor të atij luftimi, Agim Ramadanin, i cili “përpiloi planin operativ, të cilin e miratoi Rr.Berisha”⁸⁾ “katalizatorin e Epopesë së Koshares”⁹⁾ Apo mos vallë, ngaqë Agimi nuk ishte gjakovar dhe për ju të GO-3 nuk quhet fitore për armikun? Lëvdimi i juaj se ju e fituat Luftën në Koshare dhe jo serbët më detyron t’ua shtroj këtë lloj pyetje.

3. Ata shkaktuan më shumë humbje njerëzore, duke na vrarë 8 luftëtarë më shumë se sa u vramë ne atyre si dhe na plagosën rëndë 350 e ca të tjerë.

4. Ata fituan moralisht më shumë se ne, pasi e realizuan fitoren duke luftuar në tokë të huaj, sikundër e theksoi me të drejtë edhe gjeneral Hysen Berisha në intervistën e tij.

5. Dhe kryesoria e kryesoreve, për forcat serbe në

Kosovë, lufta në Koshare është e vetmia fitore që ato kanë pasur gjat gjithë përuidhës që vazhdoi Operacionit i tyre “Patkoi”, prej 20 marsit 1999 e deri në fund të luftës; dhe për të mbuluar me gjethe fiku humbjen e madhe që pësuan në Kosovë, trumbetojnë Kosharen, të vetmen fitore të tyre.

Por këta zotërinjtë tanë “profesionistë” vallë nuk i dinë këta 5 fakte shumë të rëndësishëm? I dinë si derri, por nuk duan t’i pranojnë ngaqë kanë bindur veten se për çlirimin e Kosovës nuk luftonte tjetërkush, përveç atyre. Për këtë do të flasim në shkrimet e ardhshëm.

Por edhe nuk duhet t’i ngarkojmë me shumë faj për këtë bindje që kanë këta zotërinj, se prej sa u larguan në fundin e gushtit 1998 nga Gjakova e deri sa mbaroi lufta, këta eprorët e Koshares nuk kanë qenë e nuk dinë se çfarë lufte është bërë brenda në Kosovë prej formacioneve të tjera të UÇK-së. Duke e pasur më se të qartë fajin që kanë bërë, duke ndaluar mësymjen për hapjen e korridorit të furnizimit, prandaj bëjnë këtë zhurmë të madhe, për të mbuluar humbjen. Dhe kujtojnë se mbuluar diellin me shoshë.

Ngaqë i vret ndërgjegjia, kalimin në mbrojtje të GO-3 këta zotërinj duan ta justifikojnë duke na thënë: “*vazhdimi i sulmit kundër 30% të forcave serbe të grumbulluar në Koshare do të ishte një rrezik dhe një aventurë*”. Mirëpo, edhe sikur të jetë e vërtetë se para tyre u grumbulluan 30% e forcave serbe në Kosovë, ato forca nuk ishin atje qysh ditët e para të sulmit të tyre. Në ditët që tanët kaluan në sulm të befasishëm ishin më të fuqishëm se forcat serbe që ndodheshin në Koshare, në “*çdo skuadër kishte mitralozë të rëndë, snajperë 12.7 mm, minahedhës 75 mm*”¹⁰), sikundër tregon luftëtari me universitet Vllaznim Reshani. Kështu që

edhe ky justifikim nuk qëndron. Por këta zotërinj oficerë e mbrojnë me këmbëngulje teorinë e preferimit të mbrojtjes ngaqë këtë teori doktrinare ata e kanë kthyer në një lloj dogme, ndaj dhe e propagandojnë me forcë të madhe.

Por, faktikisht, nuk qëndron këtu shkak kryesor pse u hoq dorë nga vijimi i sulmi. Ky justifikimi i gjoja grumbullimit në Koshare i 30% të forcave serbe bie po të kemi parasysh atë çka na tha ish-shefi i Shtabit të GO-3, z. Anton Çuni, kur flet në komentin që i bëhet filmit serb të transmetuar nga RTK3: *”Forcat serbe u tërhoqën në panik dhe u përgjysmuan.”* Pse atëhere forcat tona nuk e shfrytëzuan këtë sukses e të vijonin sulmin, por kaluan në mbrojtje! Apo prisnin ardhjen e 30% të forcave serbe në Kosovë, të cilat na e theksoi z.Musa Gjakova?! Ja që s’ka asnjë dyshim se shpjegimet ushtarake të njëanshme të eprorëve të GO-3, duhet të shqyrtohen në mënyrë vendimtare.

Sikundër e cituam më herët, shefi i Shtabit të GO-3, z.Anton Çuni, në komentin që ai i bëri filmit të RTS na tha se: *“Sulmi u ndërmuar vetëm me 84 forca kundër një batalioni kufitar serb”, (300 forca, një batalion kufitar).* Bo t’i besojmë kësaj të dhëne rezulton se forcat tona sulmuese kanë qenë 4 herë më të pakta se forcat e armikut, i cili ishte në mbrojtje pozicionale të përgatitur me kohë. Dhe për këtë nuk kemi as dyshimin më të vogël, pasi na e thotë vetë shefi i Shtabit të GO-3. Madje kuptohet se drejtimi ku kanë sulmuar këto 84 forca duhet të ketë **qenë drejtimi i goditjes kryesore** i GO-3, ku raporti i forcave duhej të ishte minimalisht 3-4:1 në favorin tonë, pasi vetëm në këtë mënyrë mësymja do të përfshinte si ortek çdo qëndresë të armikut.

Duke i besuar z.Anton Çuni del se raporti i forcave ka qenë 4:1, por jo në favorin tonë por në favor të armikut! Të jetë vallë e vërtetë që këta zotërinj e kanë dhënë goditjen kryesore në drejtimin ku armiku ishte karët herë më i madh në forca e mjete?! Nuk dua ta besoj që gjithë këta profesionistë të kenë rënë në një gafë të tillë.

Mirëpo, me sa thonë nëpër intervista eprorë të ndryshëm me gazetarin Muhamet Çetta, forcat kryesore armiku i kishte përqëndruar në drejtim të Rrasës së Koshares dhe Shkozë. Kurse forcat tona drejtimin e goditjes kryesore e kanë përqëndruar në drejtim të karakollit të Koshares dhe nuk kemi vijuar më tej, për t'i marrë krahët armikut. Kjo ndoshta duhet të jetë një nga arsyt kryesore të ndaljes së mësymjes nga ana e GO-3, pasi është ulur ritmi i mësymjes; gjë që e ka bërë të pamundur daljen e GO-3 në kohë në objektin e caktuar për detyrën e afërt të saj, bazuar në idenë e luftimit. Dhe kjo ka sjellë edhe gabimin tjetër: skalioni i dytë, edhe pse ka ardhë në mëngjesin e datës 10 prill, në vënd që të rriste fuqinë goditëse për të arritur në vijën e detyrës së afërt, që ishte kapjen e Rrasës së Koshares, i është vënë detyrë të merrej me sigurimin e kazermës!¹¹⁾

Prandaj, duhet kërkuar sqarimi, se me sa mend u ndërmuar sulmi me këtë raport kaq shumë të disfavourshëm forcash për ne, 1:4, në favor të armikut, ndërkohë që këta tanët, sikundër na thonë, e njihnin në detaje gjendjen e armikut!

Do ta pranoni argumentimin nëse këta zotërinjtë tanë mund të na thonë: “Sulmuam me këtë raport forcash dhe patëm sukses, se shfrytëzuam befasinë.” Bukur fort! Dihet se kur e kap armikun në befasi të plotë e kap atë të papërgatitur e të çoroditur, i paralizon vullnetin për qëndresë

dhe i heq mundësinë për të kundërvepruar në një kohë sa më të shkurtër. Deri këtu e pranojmë plotësisht që forcat tona kanë vepruar në mënyrë tepër profesionale. Duke shfrytëzuar natën, motin e keq, befasinë dhe fshehtësinë e sulmit prandaj dhe humbjet në forcat tona kanë qenë të pallogaritshme në datat 9 dhe 10 prill. Dhe këtë na e vërteton edhe fakti që armiku ka kundërvepruar me shumë vonesë, në mesditën e datës 11 prill.

Reagimi i armikut pas 60 e ca orësh tregon se ai nuk është mbajtur nën një goditje të pandërprerë. Moskundërveprimi i armikut për mbi 60 orë do të thotë se ai nuk i ka qëndruar dot sulmit të forcave tona; dhe si i tillë, ai është munduar të afronte sa më shpejt forca të tjera, dhe pasi është riorganizuar ka kundërsulmuar. Kjo flet edhe për atë që armiku nuk ka pas më shumë se 300 forca ditën që ne kemi kaluar në sulm.

Mirëpo, forcat tona, në vend që të mos e ndërprisnin mësymjen, kanë bërë të kundërtën, e kanë ndaluar atë dhe janë marrë me pastrimin e kazermës së Koshares. Duhje të qe mënjanojë kjo ndalesë pasi nuk ishte mbritur në vijën e detyrës së afërt. Kjo ndalesë I ka dhënë armikut mundësi dhe kohë të zerë pozicionet e zjarrit dhe të thyejë pjesë-pjesë sulmin e forcave tona, gjë që ka çuar në dështimin e sulmit tonë. Këtu nis zbërthimi i enigmës pse është kaluar në mbrojtje. Nëse nuk është kjo arsyeja kryesore pse është kaluar në mbrojtje, atëhere enigma zbërthehet vetëm nëse zotërinjtë na shpjegojnë cilat janë arsyet e tjera pse u kalua në mbrojtje pa arritur të realizohej as detyra e afërt, që ishte marrja e Shkozës dhe e Rrasës së Koshares, të cilat janë marrë vetëm më 15 prill 1999¹²). Madje, bëhet e ditur se është kaluar në mbrojtje edhe pa organizuar sigurim

luftarak! Ky është gabimi i parë profesional, i cili tregon pse nuk është arritur të plotësohet detyra e afërt, e cila ka sjellë edhe vrasjen e Agim Ramadanit.

Në momentin kur është dalë në vijën e detyrës së afërt, (Rrasa e Koshares), edhe pse me shumë vonesë, pas një jave, në ato momente duhej të qe marrë vendimi për futjen në luftim të përforcimeve të tjera që kanë ardhur pas datës 10 prill nga Helashani, për vijimin e mëtejshëm të mësymjes. Dhe faktikisht futjen në luftim për plotësimin e detyrës së largët të GO-3 Agim Ramadani e kishte parashikuar menjëherë pasi të kapej Rrasa e Koshares dhe jo kazerma. Këtë na e tregon oficeri Agim Haziri, i cili na thotë: *“Kishim angazhuar nja 60 kuaj për bartjen e armatimit dhe të municionit.”*¹³⁾ Gjashtëdhjetë kuaj, nga një kuntal secili, i thonë 6 ton municione. Kjo don të thotë se kishin ardhur përforcimet për vijimin e mëtejshëm të mësymjes; si dhe na bind që Agim Ramadani e kishte parashikuar sulmin në detaje, prandaj dhe këta zotërinj na e fshehin dhe nuk na e paraqesin të plotë atë plan.

* * *

E paqartë është për ne edhe mënyra e drejtimit të luftimit të mësymjës së GO-3 nga komanda dhe shtabi. Për të realizuar kërkesat e drejtimit të luftimit dhe për ta bërë atë sa më efektiv, është e domosdoshme që elementët e drejtimit t’u afrohen sa më shumë reparteve pjesmarrëse në luftim. Deri sot nuk kemi lexuar apo dëgjuar komandantin apo shefin e shtabit të GO-3 se si ishin organizuar vëndkomanda (VK) dhe vëndkomanda e përparuar (VKP) e saj. Nga Fisnik Ismaili mësojmë se VK ishte vendosur në Padesh, (3,5km larg Koshares dhe 6 km larg Batushës, vija ku GO-3 ndaloi

përfundimisht sulmin), atje dhe qendra e ndërlidhjes. Kurse për VKP nuk na thuhet gjë se ku ishte vendosur kur filloi sulmi dhe a është zhvendosur dhe sa herë gjatë dy ditëve të sulmit. Drejtimi i drejtëpërdrejtë i luftimit bëhet nga VKP, dhe atje qëndron komandanti i brigadës me shefin operativ ose ndihmësin e tij, me shefin e artilerisë dhe me ndonjë oficer tjetër drejtimi që duket e arsyeshme për situatën e krijuar. Pra, në VKP del komandanti i brigadës dhe jo shefi i shtabit, pasi ai është përgjegjësi kryesor për luftimin.

Në rastin tonë VKP duhej të ishte vendosur në drejtimin ku u dha goditja kryesore, në një vend nga ku mund të vrojtoheshin dhe drejtoheshin më mirë trupat, por nuk na thuhet asgjë. Kurse në VK merren vendimet, bashkëndohen punët ndërmjet batalioneve e llojeve të armëve e shërbimeve, dhe atje duhet të qëndroi shefi i shtabit me një pjesë të shtabit që ndjekin zhvillimin e luftimit, vlerësojnë situatën dhe furnizojnë komandantin në VKP me të dhënat dhe propozimet e përshtatshme.

Mirëpo, duke lexuar librat e Muhamet Cettës na rezulton se vendosja e komandantit Rustem Berisha, e shefit të shtabit Agim Ramadani dhe e shefave të tjerë ka qenë krejt ndryshe. Rezulton se komandanti i GO-3 ka qëndruar në VK dhe jo në VKP ku e ka për detyrë të ndjekë direkt nga afër luftimet. Këtë na e dëshmojnë oficerat që erdhën ditën e dytë të sulmit nga Helashani. Ndërsa Shefi i Shtabit, Agim Ramadani jo vetëm që nuk ka qenë në VK por ka qenë madje direkt në vijën e parë të sulmit ku dhe u vra, si me qenë ushtar i thjeshtë.

Po ashtu edhe shefi operativ, Andon Çuni. Pse është lejuar që shefi i Shtabit dhe shefi operativ i GO-3 të shkojnë në sulm, në vijë të parë?!

Kjo na thotë se nuk kemi pas drejtim efektiv të sulmit, prandaj edhe ka dështuar ai sulm. Këtu ndoshta duhet kërkuar një çelës tjetër i enigmës pse u kalua në mbrojtje të paparashikuar. Duke qenë se as komandanti, as shefi i shtabit dhe as shefi operativ nuk kanë qenë në vendet e domosdoshme të drejtimit të luftimit, ky duhet të jetë shkaku kryesor që ka sjellë pështjellimin e shtabit dhe të komandantit të GO-3 kur vritet Agim Ramadani. Ky shkak i hutim i tyre na bind sepse dihet që gjithçka ka qenë lënë në besimin e aftësive të Agim Ramadani, sikundër na e pohon me plot gojë komandant Rrustemi dhe jo në duart e tij.

Ngaqë nuk ka ekzistuar VKP, pandaj nuk na thuhet se çfarë detyrash iu dhanë artilerisë sonë në momentin kur nuk u kap vija e detyrës së afërt, Rrasa e Koshares. Pse nuk ka ekzistuar ajo, prandaj nuk na thuhet se çfarë detyre iu vu artilerisë për sigurimin e futjes në luftim të 240 forcave të komanduara nga Agim Haziri, të cilat mbritën te kazerma e Koshares në ora 10.00 të datës 10 prill. Këto forca, në kushtet që na tregojnë protagonistët e atyre luftimeve, duhej të ishin futur në luftim duke kaluar mbi rendimin e luftimit të 254 forcave (dhe jo 84 sa na thotë sot Anton Çuni) që patën shpërthyer sulmin dhe kishin arritur të merrnin kazermën e Koshares.

Ekzistenca e VKP bëhej më se e domosdoshme për faktin se mësymja zhvillohej në terren malor, ngaqë sulmi natyrisht që do të behej në vija të shkëputura se vetëm në atë mënyrë do t'i merreshin armikut krahët e për t'i dalë në shpinë, gjë që bashkveprimi midis artilerisë dhe forcave që sulmonin si dhe midis drejtimeve duhej të vrojtohej direkt nga VKP. Dhe faktikisht mësojmë se është sulmuar në 5 vija të shkëputura dhe jo në tre drejtime operative sikundër

na thotë sot gjeneral Hysen Berisha. Ato pesë vija kanë qenë: në drejtim të lartësisë ku ishte kazerma e Koshares; në drejtimin Mali i Gllavës-Rekë e Keqe; në drejtimin midis Shkozës dhe Rasës së Koshares; në drejtim Qafa e Pëllumbit-kazerma e Koshares, si dhe në drejtimin në jug të bjeshkëve të Junikut.

Këto vija sulmi na i tregojnë eprorët Agim Haziri, Ramadan Gashi, Naser Vllasi, Hysen Berisha, Halil Gashi, Gani Gjokaj, Naim Loshi, Albert Kuçi, Florim Nezir Demaj, Halit Hamëz Haxhiu, Rahim Samiu, Burim Berisha, Isa Dukaj, Yll M.Bajraktari, Fadil Hadërgjonaj etj, në intervistat që Muhamet Çetta ka zhvilluar me ta. Madje prej tyre mësojmë se forcat që kryen sulmin në orët e para të datës 9 prill i kishin kapur vijat nga ku mund të siguroheshin kushtet për t'u futur në luftim forcat e porsa mbritura nga Helshani, në mëngjezin e datës 10 prill, dhe së bashku me to të kalonin në mësymje.

Por, me sa po kuptohet, u vra Agim Ramadani, u ndalua mësymja.

Këtu fillon tragjedia e GO-3.

Atëherë, cilët duhet të jenë shkaqet kryesorë të mos vijimit të sulmit?

Së pari, armiku e ka ditur ditën dhe orën e sulmit tonë dhe i ka mashtruar deri diku forcat tona. Këtë e shohim në faktin që ai ka bërë përpjekje të shpëputte takimin me to. Dhe këtë na e thotë **Albert Kuçi**—“Cobra”, njëri ndër të parët që është futur në karaullën e Koshares, më 10 prill '99: *“Armiku dinak e kishte lënë karaullën dhe e mbronte atë nga krahu i djathtë i malit...dhe një ushtar serb më ka plagosur me gjashtë plumba. Tërë aksioni për marrjen e karaullës ka qenë i udhëhequr dhe koordinuar nga komandanti Agim Ramadani.”*¹⁴⁾

Të njëjtën gjjë e pohon edhe komandanti 327 (Hysen Berisha): *“Forcat serbe shfrytëzojnë edhe një mangësi që u shfaq te forcat policore të kufirit... Forcat policore ishin tërhequr dhe këtë zbrazëti e kishin shfrytëzuar forcat çetnike serbe, kryesisht paramilitare, të cilët kishin depërtuar disa kilometra në brendi të territorit të Shqipërisë, për të shkatërruar kështu bazën e furnizimit të logjistikës, por edhe qendrën e stërvitjes së ushtarëve në Papaj.”*¹⁵⁾

Qysh në momentin që u konstatua mashtrimi i armikut, duhej të njoftohej menjëherë komandat Rrustemi për të dërguar forca për ndjekjen e armikut. Gjë që nuk është bërë, sepse nuk kishim PDO. Madje në këtë ditë nuk ishte organizuar as sistemi i komandimit, ndërlihdja. Një strateg i madh ushtarak thotë: *“Pa ndërlihdje s’ka komandim, pa komandim s’ka fitore”*. Këtë na e vërteton kryetekniku i qëndrës së ndërlihdjes, z.Fisnik Ismaili:

“Beteja në Koshare sapo kish fillue do ditë, e kush idenë s’kish se çka ndodhke. As gazetarët nuk lejoheshin me vazhdue përtej Babinës. Rruga deri në fshatin Papaj, që ishte fillimi i zonës së luftës në brezin kufitar, ishte e lehtë deri te Dheu i Kuq me një veturë, por mbas asaj na u desht me vazhdue përpjetë duke ecë, meqë granatohej ajo pjesë brenda në territorin e Shqipërisë nga forcat serbe. Pjesën tjetër e kemi ba në kambë....Në Papaj, hala pa mbërri mirë me pushue dy minuta, na del Anton Quni përpara, për të cilin as idenë nuk e kishim kush ishte, i gjatë, me uniformë dhe pamje të një ushtaraku të shkëlqyem, por me një fytyrë që na i shtini ethet, e sy të haptë që të bante me mendue se është ndojfarë bishe i pa mëshirë, e që sot hala bajmë hajgare me këtë tregim. Ky na urdhëron me vazhdue tutje, e na as lidhjen ma të vogël s’e kishim se ku po shkojmë. Pika

e territ, në një terren plot lloç e borë, na zuni rrugës për Padesh, një fshat në rrotë të qyqes pa rrymë, ku e kuptuem se një shtëpi e vogël dykatëshe prej guri, me dyer të ulëta që më bijshin deri te gjoksi, ishte komanda e Betejës së Koshares. Kufini ishte thye veç pak ditë më herët me vetëm 150 veta, ishte kaos... Na u caktue një dhomë e vogël edhe një kohë shumë e shkurtër me i instalue pajisjet, centralet ndërlidhëse, e krejt mjetet që nuk ishin vu në përdorim.”¹⁶⁾

Të organizosh mësymjen e një brigade këmbësorie, sikundër ishte GO-3, dhe të mos kesh organizuar sistemin e ndërlidhje-komandimit?! Ky ka qenë” *Organizimi dhe strukturimi i mirëfilltë me një udhëheqje profesionale të aftësuar për të zhvilluar luftën dhe për të ndërtuar paqen në ardhmëri*”¹⁷⁾, sikundër shprehet në atë simpozium gjeneral Rrustem Berisha?

Përpjekjet e armikut për të mashtruar forcat tona, tregojnë nuk është ruajtur me fanatizëm data dhe ora e sulmit. Zakonisht koha e fillimit të sulmit (koha “0”) komandave të reparteve, si rregull, u njoftohet 1-2 orë para fillimit të tij. Gjë që nga komanda e GO-3 nuk është vepruar kështu. Këtë na e vërteton eprori Naser Vllasi:

“Në mesditë, (8 prill), Agim Ramadani më ka kërkuar me radiolidhje që të takohemi me të në Shtab. Në takimin e mbajtur në 8 prill, Agimi na dha kodet luftarake; Antoni ka spjeguar lëvizjen e njësisë në pozicione luftimi; për moral ka folur Sali Çeku. Unë e mora kodin “Fitimi”, dhe kam udhëhequr kompaninë vëzhguese diversioniste, në nivel të Brigadës 131. Kisha për detyrë që në orën 5 të mëngjesit të 9 prillit të gjendesha te piramida C/2.”¹⁸⁾

Eprori tjetër, z.Gani Gjukaj tregon: *“Planin për sulm për herë të parë e kam parë kur kam shkuar në Padesh. Ka*

qenë dikund fillimi i marsit 1999, kur këtë plan për herë të parë na e ka prezantuar Agim Ramadani.”¹⁹⁾

E dyta, sikundër thamë, nuk ka pas VKP të brigadës që komandanti i GO-3 ta bënte vetë vrojtimin dhe drejtimin e luftimit. Duke mos funksionuar ky element nuk është arritur që t’i viheshin detyra plotësuese artilerisë, duke e bashkrenduar zjarrin e saj me goditjet që duhej të jepnin forcat e skalionit të parë.

E treta, si shefi i Shtabit (Agim Ramadani), ashtu edhe Shefi Operativ (Sali Çeku) dhe komandanti i “Deltës” (Anton Çuni), që të tre këta drejtues kryesorë, në vend që të qëndronin në VK apo në VKP, duke ndjekur luftimin, ata u vunë në rolin e ushtarit, duke sulmuan si ushtarë, madje, në vijë të parë! Mos harroni, jemi në luftë frontale. Ç’ ishte nevoja që të gjithë anëtarët kryesorë të Shtabit të GO-3 të merrnin pjesë në sulm si me qenë ushtarë të thjeshtë, në vijën e parë të sulmit, kur kishin **“diku mbi 150 radiolidhje”**, **sikundër konfirmon Fisnik Ismaili?! Skandal**. Madje edhe komandantve të kompanive e batalioneve nuk u lejohet një gjë e tillë, të sulmojnë në vijë të parë, (ndërsa Hysen Berisha mburret dhe sot që sulmonte në vijë të parë), e jo më shefit të shtabit dhe shefit operativ të brigadës!

Së katërti, kur u pa që armiku nuk i qëndroi dot sulmit dhe u tërhoq në panik, sikundër na tregon ish-shefi operativ z.Anton Çuni, forcat tona, në vend që të mos e ndërprisnin sulmin dhe të bëheshin më energjike duke u përforcuar që ta ndiqnin armikun, për të mos e lënë atë të merrte frymë e të organizohej, këta ndaluan! Madje, edhe pse u erdhën përforcimet në mëngjesin e datës 10 prill, ato u *“muarrën me sigurimin e kazermës dhe me marrjen e flamurit e të dokumentav të një koloneli serb për t’ia dërguar komndantit*

Rrustem Berisha.”!²⁰) Kështu që janë këta të “epopesë së Koshares” që i kanë dhanë kohë armikut të organizohej e të kundërsulmonte, sikundër bëri ai në datën 11 prill. Me apo pa dëshirë, kjo mbetet të na e tregojnë vetë.

Së pesti, sikundër na e thotë eprori Gani Gjukaj: “*Detyrë të caktuar nuk ka pas shumica prej nesh (eporëve ushtarakë,d.g), apo urdhëresa për vendosje. Dhe kjo është mungesë e rrustem Berishës.*”²¹) Prandaj ka ndodhur që 2-3-4 oficerë kanë qenë në një drejtim (vijë) sulmi dhe kanë sulmuar si ushtarë të thjeshtë, që do të thotë se nuk janë lënë të venë dijet e tyre në interes të luftimit, janë degraduar.

Këto janë përgjegjësi të Komandantit të Brigadës. Ky nuk duhej ta lejonte kategorikisht këtë lloj disipline. Kjo tregon, në mos paaftësi nga ana e tij për drejtimin e luftimit të brigadës, atëhere duhet të kemi mungesë përgjegjësie prej tij.

A kishim forca për skalion të dytë?

Bëhet fjalë për 2 ditët e para të sulmit, 9 dhe 10 prill 1999.

Po, forcat kanë ekzistuar, pavarësisht se për këtë na jepen katër shifra: 240 forca dhe 320 forca, sipas Agim Hazirit e Ramadan Gashit²²); 300 forca sipas Rrustem Berishës, në intervistën e dt.8/4/2014; dhe 256 forca sipas Hysen Berishës, në intervistën e dt.16/4/2019; ndërsa Gani Gjukaj thotë 170-180 forca²³) Edhe kjo larmi shifrash nuk flet për mirë për përkushtimin e kryerjes së detyrave.

Nëse kemi pas 300 e më shumë forca, në ato kushte të terrenit dhe përbërjes së armikut dhe organizimit të mbrojtjes së tij, formacioni i luftimit i GO-3 mund të qe ndërtuar edhe në tre skalione, por të paktën medoemos në dy skalione,

me reserve, nëse do të ishte sulmuar në tre vija dhe jo në pesë vija. Por duke sulmuar në pesë vija, kutohet që rendimi luftimit do të ishte në një skalion, por me rezervë. Nëse do të kishim rezervë, kjo do të ishte futur para se të kishin mbritur forcat nga Helshani.

Nga ana tjetër, nëse ka ndodhur sikundër na thotë ish-shefi i Shtabit të GO-3, z. Anton Çuni, ku 84 forcat tona kanë përgjysmuar forcat serbe, nga 300 në 150 forca, të cilat “*janë tërhoqur në panik*”, vijimi i mësymjes nga ne nuk do të kërkonte aq shumë sakrifica sa u bënë. Për këtë na bind edhe mjeku veteriner Yll Muhamet Bajraktari: “*Kur ne i sulmonim serbët, ata iknin. Kjo ishte shenja e humbjes së thellë të tyre. Ata tashmë (serbët) kshin filluar t’i linin edhe kufomat e tyre në vijën e frontit. Bile ne kemi arritur edhe t’i zemë shumë serbë të gjallë dhe t’ua dërgonim organeve përkatëse të Shtabit dhe ata i përcillnin më tutje.*”²⁴⁾

Ja që këto fakte na e shtojnë edhe më shumë dyshimin se pse është kaluar në mbrojtje kur ekzistonin mundësitë e vijimit të mësymjes dhe inisiativa ishte ende në dorën tonë.

Luftë e çuditshme!

Bazuar në sa më sipër, me këto mënyra veprimi dhe ndryshim strategjie, pa raportuar dhe pa marrë miratim nga SHP, luftën e Koshares mund ta quajmë edhe një “luftë të çuditshme”. Këtë cilësim e themi edhe për faktin që na deklarojnë me të madhe: “***Armiku në betejën e Koshares ka lënë diku rreth 1600 të vvarë!***”²⁵ Kështu ka pohuar edhe gjeneral Hysen Berisha. Pra, nga 2332 forca që grumbulloi gjithsej armiku në Koshare, paskanë mbetur vetëm 732 forca të tij. Dhe 2600 apo 2300 tanët nuk i thyenin dot këto

732 forca serbe?! Edhe kjo mbetet enigmë.

Vetëm në një rast njeh historia e luftrave botërore që në një luftë disa mujore, për një muaj të vriten 1000 ushtarë armiq; ndërsa në rastin tonë, duke e luftuar kundërshtarin vetëm me zjarr, pa sulme ndeshëse me forca, për një muaj kemi vrarë 800 ushtarë armiq! Por, në raport me rastin që do të sjell, ndryshimi është jashtëzakonisht i madh, i pakrahasueshëm, kuptohet, në favorin tonë. Në rastin historik që do po tregoj, janë vrarë 1000 ushtarë armiq në një muaj, por jo duke qëndruar në mbrojtje si në rastin tonë me 2600 forca, por duke u hedhur në sulm 500 mijë forca, thënë ndryshe 25-30 divizione, të mbështetur jo vetëm me artilleri por edhe me aviacion.

Çfarë rasti paska humb Kosova! Të mos ishin laguar nga Kosova në shtatorin e vitit 1998 ata dhjetra luftëtarë dhe oficerë të Br.131,134 dhe njësitet “Delta” e “Cobra”, nuk do kishte qenë kurrë nevoja me u angazhu NATO-ja në luftën tonë. Punë fati kjo, s’ke ç’i bën.

Sikundër thamë, një realitet i tillë, 1000 të vrarë në një muaj, ka ndodhur në Vetnam, në vitin 1968. Ushtria e rregullt e Vitnamit të Veriut, bashkë me ushtrinë guerile të Vitnamit të Jugut, ku të dyja së bashku përbënin 500 mijë forca kundër 700 mijë trupave amerikane, ndërmorën të ashtuquajturën “Ofensivën Teti i Vogël”, gjatë cilës vriteshin mesatarisht 1000 amerikanë në muaj; betejë që zgjati katër muaj. Por po ua përsëris, sulmuan 500 mijë forca, (25-30 divizione të rregullta), duke sulmuar njëkohësisht kundër 30 qyteteve, dhe arritën të vrisnin për çdo muaj mesatarisht 1000 forca amerikane²⁶⁾. Kurse ne, për çdo muaj, duke mos pas prej fillimit të luftimeve ende 2600 forca, dhe vetëm duke luftuar në mbrojtje pasive (vetëm me zjarr artillerie,

pa sulme e kundërsulme), kemi vrarë 800 forca serbe në muaj, në një front prej 15 km gjerësi, me dëndësi në çdo 6 m një luftëtar, nëse kanë qenë vendosur të gjitha forcat në vijën e parë! E paimagjinueshme! E megjithatë ju zotërinj oficerë, edhe pse i patët vrarë armikut 70% të 2332 forcave të tij që kishit përballë, (sipas të dhënave që na dha z.Musa Gjakova, pavarësisht se kanë qenë më pak), si nuk arritët dot ta çanit mbrojtjen e atyre 732 forcave armike të mbetura dhe, kuptohet, me një moral shumë të ulët?! Përsëri enigmë.

Ndërsa 500 mijë forcat vietnameze, për 4 muaj rresht, duke sulmuar çdo ditë me këmbësori, artileri e aviacion, arritën t'i asgjësonin vetëm 0,006% armikut të tyre, ndërsa ne i kemi asgjësuar armikut 70% të forcave të tij! Allahile, këtë heroizëm që ka ndodhur në Koshare, duhet t'ua bëjmë të njohur gjithë akademive ushtarake të botës që ta marrin si rast unik, ku vetëm duke shkëmbyer të dy palët zjarr artilerie, artilierët tanë të një ushtrie vullnetare i kanë asgjësuar armikut 70% të forcave, ndërsa artilierët e një ushtrie klasike vetëm 4% të forcave tona. Pa le sikur të pranojmë se në Koshare ka qenë grumbulluar 30% e gjithë artilerisë së tij që kishte sjellë në Kosovë, siç na thonë këta zotërinjtë tanë, del që artileria armike ose nuk ka hapur zjarr fare, ose nuk kanë dash të na vrisnin.

A ka budallenj në Kosovë ta hanë këtë sapun për djath, këtë mburrje kaq të çmendur?! Ç'e kujtoni ju, zotërinj oficerë popullin, budalla?! Lutem, bëhuni më modestë dhe hiqni dorë nga krahinorizmi dhe mburrjet absurde e shtrembëruese të fakteve historike, se vetëm ashtu e fitoni respektin.

* * *

Që lufta e jonë në Koshare rezulton luftë e çuditshme po e shohim edhe në këndin e një aksiome të strategut të parë ushtarak të njerëzimit, Sun Xu. “*Luftëtari i zgjuar – thotë ai - ia imponon vullnetin e tij armikut, dhe nuk lejon që armiku t’i imponoi vullnetin e tij.*” Si dhe: “*Një gjeneral është i aftë në sulm atëherë kur armiku i tij nuk di se çfarë të mbrojë. Dhe ky gjeneral është i aftë në mbrojtje atëherë kur armiku i tij nuk di se çfarë të sulmojë.*”

Po t’i analizojmë këto thënie të Sun Xu-së, duke pasur parasysh atë çfarë na tha shefi i Shtabit të GO-3, z.Anton Çuni, “*Forcat serbe u tërhoqën në panik dhe u përgjysmuar.*”, del:

Së pari, oficerat tanë në Koshare nuk janë treguar luftëtarë të zgjuar. Pse e themi këtë? Sepse, edhe e patën përgjysmuar armikun, (nga 300 forca ia çuan në 150), ndërsa këta tanët duke pasur vetëm 3 vrasje nga armiku, jo vetëm që nuk ia imponuan dot armikut vullnetin e tyre, por ndërprejnë edhe sulmin, edhe pse armiku, “nuk dinte se çfarë të mbronte”. Amiku me të vërtetë që nuk dinte se çfarë të mbronte: veten apo Kosovën? Pasi nga prapa kishte luftëtarët e komanduar nga Ramush Haradinaj, ndërsa përpara sulmin tonë si “*një Vietnam në miniaturë*”. Dhe faktikisht, pas dy ditësh është armiku që ua imponoi këtyre tanëve vullnetin e tij, duke kaluar në k/sulme, dhe këta tanët kaluan në mbrojtje. A është imponim i vullnetit të tij ndaj forcav tona? A mbetet përsëri enigmë?

Së dyti, bazuar në atë çka thotë Sun Xu, është më se e vërtetë që **forcat e GO-3 u treguan shumë të afta në mbrojtje gjatë gjithë periudhës 11 prill-12 qershor’99.**

Dhe këtë aftësi e pranojnë edhe serbët, prandaj e quajnë luftën e GO-3 në mbrojtje, “*një Vietnam në miniature*” për ta. Por edhe kjo mbrojtje jonë ishte e fortë e ngjashme me skëterën “vietnameze” për serbët për atë që shpjegon Sun Xu: “*Ky gjeneral është i aftë në mbrojtje atëherë kur armiku i tij nuk di se çfarë të sulmojë.*”

Dhe faktikisht serbët nuk dinin se përse të sulmonin, ndërkohë që për detyrë kishin pengimin e depërtimit të ndihmave nga Shqipëria për në thellësi të Kosovës. Sulmet që serbët kanë bërë çdo ditë, i kanë kryer për të mos I lënë forcat tona të ndërmerrnin sulme me forca të shumta. Këtë na e pohojnë vetë protagonistët tanë: “*Atje çdo ditë, deri në përfundim të luftës, ka pasur sulme nga serbët.*”²⁷⁾ Nuk thuhet më kot në çdo doktrinë ushtarake, se mbrojtja më e mirë është sulmi. Prandaj ata kanë më se të drejtë të mburren e ta quajnë atë luftë 65 ditore, betejë fitoreje. Por zotërinjtë oficerë të Koshares nuk duan ta pranojnë këtë të vërtetë, sepse nuk duan që t’u shkatërrohen iluzionet.

Lutem më ndihmoni ta kuptoj dhe unë se çfarë përfitoi lufta e UÇK-së dhe gjithë lufta jonë çlirimtare në tërësi nga luftimi mbrojtës 65 ditor i forcave të e GO-3, me qëllim që të lëvdohemi edhe ne si ju, zotërinj ushtarakë profesionistë të Koshares. Apo ngaqë e quajnë sebët “betejë fitoreje”, duhet ta quajmë edhe ne “betejë fitoreje”? Apo, mos vallë e quani fitore ngaqë nuk i latë serbët të arrinin përsëri në kufirin ndarës midis dy shteteve?

Nuk ua bëj kot këtë pyetje, se kështu i keni thënë z.Muhamet Çetta: “*Pjestarët e GO-3 kishin një qëllim, një strategji kryesore: Mbrojtjen e kufirit në mes të Kosovës dhe të Shqipërisë.*”²⁸⁾ Ky është një fakt më shumë që të detyron të pranosh se komanda e GO-3 ka kaluar në mbrojtje me

vullnet dhe jo të imponuar nga armiku.

Kush ia dha këtë detyrë komandës dhe shtabit të GO-3 që pasi të merrnin karakollin e Koshares të kalonin në mbrojtje? Ka ndonjë dokument për këtë? Çfarë tregon kjo pavarësi e GO-3, duke mos i dhënë llogari askujt? Ç'është kjo tendencë për mënjanimin e SHP të UÇK-së, edhe pse përdorej prej tyre edhe emblema e saj? Mos vallë kemi të bëjmë me tendencën e të qenit një ushtrie mëvete?²⁹⁾ Këtë e ka shprehur edhe Milazim Maraj: *“Forcat e FARK-ut janë ato që kanë bërë luftën.”*³⁰⁾

Jo më kotë z.Ibrahim Kelmendi shprehet: *“Ushtarakët “institucionalistë”, që i komandonte Rrustem Berisha, nuk ia varnin as FARK-ut as Shtabit të Përgjithëshëm, e le më Nasimit.”*³¹⁾

Ndoshta do të vijë një ditë e do ta mësojmë të vërtetën e këtyre qëndrimeve kontraverse.

Tiranë, më 26 maj 2019

REFERENCAT

- 1)M. “Me UÇK-në në Koshare”,Instituti i Historisë, Prishtinë,2000, v.1, f.86;
- 2)M. Çetta, v.2,f.260;
- 3)M. Çetta, v.1,f.78;
- 4) M.Çetta, v.1,f.90-92;
- 5)M. Çetta,v.1,f.90-92; v.2,f.153;
- 6)M. Çetta, vëll.1, f.100;
- 7) M. Cettta, v.2,f.260;
- 8)M.Çetta,v.2,f.261;
- 9) M.Çetta,v.2,f.86,92;
- 10)M. Çetta, v.2, f.236; 11)M. Çetta,v.1,f.92;
- 12) Po aty v.2,f.228; 13)M.Çetta,v.1,f.88;
- 14)M. Çetta, v.2, f.37; 15)M.Çetta, v.2,f.155-156;
- 16)Fisnik Ismaili, fsh, 20 prill 2019;
- 17)M. Çetta, v.2, f.260; 18)M.Çetta, v.2,f.222;
- 19)M.Çetta,v.2,f.80; 20)M.Çetta, v.1,f.92;
- 21)M. Çetta, v.2,f.80); 22)M.Çetta,v.1, f.88,101;
- 23)M. Çetta, v.2,f.85); 24)M.Çetta,v.3,f.162);
- 25)M. Çetta,v.1,f.93;
- 26)Henry Kissinger “Diplomacia”,Tiranë,1999, f.674-690;
- 27)M. Cettta, v.2, f.240); 28) M. Cettta v.1,f.84;
- 29)(M.Çetta,v.1,f.96, 97,100);
- 30),(M.Çetta,v.3,f.52;
- 31)(<https://www.facebook.com/watch/?v=1129341157096690>).

KREU I TETË

DETYRA LUFTARAKE E GO-3

“Kosharja, apo hyrja në atë drejtim, kanë qenë nën urdhërin tim si ish-shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe askush tjetër nuk ka dhënë leje e as urdhër që të veprohet. Urdhërin drejtpërdrejt prej meje e ka marrë Rustem Berisha, komandanti i Brigadës 138”.

Kolonel Bislim Zyrapi

Në këtë shkrim do të sqarojmë detyrën luftarake që i qe ngarkuar Grupit të Tretë Operativ (GO-3), i cili më vonë u emërtua “Brigada 138 e UÇK-së Agim Ramadani”. Në simpoziumin e organizuar nga ish-komanda e GO-3, më 9 prill 2000, komandanti i atij formacioni të UÇK-së, z. Rustem Berisha ka theksuar si më poshtë:


*“Nga vlerësimi i përgatitjes profesionale, teknike dhe luftarake, vëzhgimit të detajuar të forcave të armikut, moralitetit të lartë ushtarak dhe motivit për luftë, Shtabi i Grupit të Tretë Operativ, nën udhëheqjen e shefit të shtabit, Agim Ramadani, që përpiloi **planin operativ për heqjen me luftë të kufirit, të cilin e miratova unë, si komandant i këtij formacioni, vendim ky, të cilit jo vetëm nuk i parapriu asnjë urdhër konkret nga cilado anë që thirrej në drejtimin e luftës, por vie nga vetë fakti që si ushtarakë të organizuar në formacione të rregullta ushtarake iu futëm luftës që në qershor të vitit '98 me veprim në rajonin e gjerë të fshatrave të Junikut, Gjocaj, Jasiq, Voksh etj.**”¹⁾ Edhe ish komandanti i Batalionit të Parë i GO-3, gjeneral Hysen Berisha, qëndron në të njëjtën valë me*

komandantin e brigadës përsa i përket detyrës luftarake për këtë njësi taktike: *“Doktrina që na ka udhëhequr ne si GO-3 ishte që lufta të filloi në një anë të kufirit dhe të përfundoi me lirinë e Kosovës. Hapja e korridorit të furnizimit nuk ka qenë objektiv i forcave që luftuan në Koshare.”*²²⁾

Mohimin e pasjes detyrë nga GO-3 për hapjen e korridorit të furnizimit e shprehin pothuajse të gjithë ish-eporët ushtarakë në përbërje të GO-3, që patën hyrë në Dukagjin në verën e vitit 1998, nën drejtimin e Tahir Zemës dhe që u larguan në fillim të shtatorit të po atij viti, me përjashtim të ish-shefit të Shtabit të GO-3, i cili zevendësoi Agim Ramadanin pas rënies së tij, z. Anton Çuni, i cili thotë:

*“Çdonjëri e ka pas idenë se duhet me u hap kufiri. Duhej të hapej kufiri për nevoja të ndryshme që të ekzistoi një hapësirë e lirë për të kaluar furnizime nga Shqipëria në Kosovë.”*²³⁾ Personi i autorizuar në emër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që i ka vënë detyrën luftarake GO-3, ka qenë z. Bislim Zyrap, në cilësinë e shefi të Shtabit të Përgjithshëm të asaj Ushtrie Çlirimtare, i cili pohon një vit pas asaj lufte dhe një muaj pas atij simpoziumi të organizuar nga vetë ish-komanda dhe shtabi i GO-3: *“Vendosëm që Kosharja të fillonte më parë, me qëllim që sa më shpejt të hapen korridore, por edhe që të mbajnë të angazhuar atje një pjesë të forcave serbe... Njësitë që kanë qenë në Koshare, në drejtim të Drinit të Bardhë, është parashikuar dhe përpunuar më herët si plan për hapjen e korridorëve për furnizimin e ushtrisë për zhvillimin e operacioneve përfundimtare të luftës... Për Kosharen është mbajtur edhe një simpozium. Por mund të them këtë: Kosharja, apo hyrja në atë drejtim, kanë qenë nën urdhërin tim si ish-shef i Shtabit të Përgjithshëm dhe askush tjetër nuk ka dhënë leje e as urdhër që të veprohet. Urdhrin drejtpërdrejt*

prej meje e ka marrë Rustem Berisha, komandanti i Brigadës 138. Tash shumë njerëz dhe politika të ndryshme thonë kinse komanda ka qenë e kësaj apo asaj politike, ish-ministrit së mbrojtjes së Bukoshit etj.”⁷⁴) Të njëjtën gjë pohon edhe eprori i GO-3, z.Agim Haziri: “Stërviteshim e përgatiteshim për luftën në Kosovë për bartjen e armatimit dhe të municionit nga Shqipëria në Kosovë.”⁷⁵) Po ashtu shprehet edhe eprori tjetër i GO-3, z. Binak Gashi: “Detyra ishte që, me u bë të gjitha përpjekjet që të bashkohen brigadat dhe njësitë e UÇK-së mes veti dhe me pjesët e tjera deri në thellësi të Kosovës, përmes pikave dhe vijave të frontit të luftimeve.”⁷⁶)



Këto fakte i mbështet edhe përfaqësuesi i Shtabit të Përgjithshëm pranë komandës së GO-3, z.Nasim Haradinaj, që ua rrëzon këto justifikime zotërinjve Rustem e Hysen

Berisha, i cili thotë: “Kemi pas marrëveshjen me fol për Kosharen vetëm ne të tre, unë, Rrustem Berisha dhe Xhafer Gashi, por Rrustemi e ka thye marrëveshjen. Shtabi i Përgjithshëm dhe Zona e Dukagjinit nuk kanë qenë të kënaqur me ritmin tonë të luftës.”⁷⁷⁾

Edhe ndihmësi i ministrit të Mbrojtjes së Qeverisë Bukoshi për çështjet e ndërlihdjes, z. Kamer Elezaj, pohon:

“ Brigada 138 ka qenë pjesë integrale e UÇK-së dhe kanë vepruar nën urdhrat Shtabit të Përgjithshëm, madje mund të themi se ka qenë brigada që ka komunikuar më së miri me Shtabinë e Përgjithshëm të UÇK-së, ngase edhe i ka pasur kushtet e mira për komunikim. Nga Shtabi i Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes së Qeverisë së Përkohshme janë dhënë urdhrat përkatës. Sot duket i çuditshëm qëndrimi i një pjese të oficerëve të kësaj brigade, sikurse janë Anton Quni dhe Hysen Berisha, të cilët nuk duan ta pranojnë se Brigada 138 ka qenë nën urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm dhe të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës dhe se Shtabi i Brigadës i ka pas ndërprerë komunikimin me Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës (qeverinë Bukoshi) – gjë për të cilën mund të dëshmoj unë personalisht, meqenëse atëherë kam shërbyer në këtë Ministri, d.m.th. në Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, si ndihmës i ministrit për çështjet e ndërlihdjes.”⁷⁸⁾

Të njëjtën gjë pohojnë edhe dy nga kuadrot më të larta politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Jakup Krasniqi:

“Kosharja objektiv ka pasur hapjen e një korridori, për të furnizuar çdo pjesë të Ushtrisë Çlirimtare me armatim, gjë që nuk ashtë bërë, por nuk ashtë bërë për shkak të grumbullimit të madh të forcave të mëdha që Serbia i kishte vendos në kufirin shqiptaro-shqiptar.”⁷⁹⁾

Xhavit Haliti: “*Beteja e Koshares ka qenë për të fut armatime dhe ka qenë përgatit edhe një kontigjent i madh armatimesh.*”¹⁰⁾

Atëherë, cili duhet të jetë qëllimi i këtij unisoni për mohimin e detyrës kryesoreluftarake, që kishte marrë GO-3 (Br.138) para se të fillonte sulmin për hapjen e korridorit të furnizimit Koshare-Drini i Bardhë?

Përgjigjia është shumë e thjeshtë: Të gjithë këta ushtarakë profesionistë, me në krye komandantin e GO-3, z.Rrustem Berisha, përmes këtij mohimi duan të justifikohen para Atdheut, për mos kryerjen e detyrës luftarake, me qëllim që të mos japin llogari para drejtësisë.

Dhe, për ta bërë bindëse se nuk kishin për detyrë hapjen e atij krridori për furnizim të formacioneve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës brenda në Kosovë si dhe të popullsisë, që ishte shpërngulur drejt zonave të mbrojtura nga UÇK-ja, këto ditë nxorrën ish-shefin e Shtabit të GO-3, z.Anton Çuni kur flet me nëntekst, në komentin që i bëhet filmit të RTS (PTC) gjatë transmetimit nga RTK3, ku deklaroi: “*Sulmi u ndërmuar vetëm me 84 forca kundër një batalioni kufitar serb. Forcat serbe u tërhoqën në panik dhe u përgjysmuan.*”¹¹⁾

Këtë sasi luftëarësh për atë fitore¹²⁾ na e konfirmon edhe eprori Naim Loshi.

Por kur sulmuan dhe sa zgjati sulmi i këtyre 84 forcave?

Këto forca sulmuan në orët e para të mëngjesit të datës 9 prill 1999, deri në ora 09.00 të datës 10 prill, kur mbritën në vijën e tyre të sulmit forcat e ardhura nga Qendrsa Stërvitore e Helshanit, sikundër tregon oficeri tjetër Agim Haziri.¹³⁾

Me këtë deklaratë, përmes gojës së z. Anton Çuni, këta zotërinj duan të na thonë, se ajo detyrë është realizuar vetëm me 84 ish-pjestarët e Brigadave 131 dhe 134 të Zonës III Operative “Dukagjini” të vitit 1998. Me të cilëm duan të na bindin, se janë këto forca që kanë çliruar Kosovën. Dhe si e kanë çliruar? Duke bërë *“heqjen me luftë të kufirit”*; duke krijuar një hapësirë të lirë me gjatësi e thellësi 15 x 6 km përmes *“Betejës afro tre ditë të Koshares me luftime të rrepta.”*¹⁴⁾, sikundër shprehet një prej atyre eprorëve të saj.

Mbi bazën e këtij “suksesi”, këtë luftim 24 orësh ata e kanë cilësuar: *“Beteja kryesore dhe fitimitare në Koshare u zhvillua më 9 prill 1999, kur edhe u rrënuua për herë të parë guri famëkeq që ndante shqiptarët dhe tokën e tyre.”*¹⁵⁾

Me këto thënie, ata duan të na bindin se kjo paska qenë detyra luftarake e GO-3!

I pyesim këta zotërinj oficerë profesionistë: Çfarë u fitua me zotërimin e kësaj sipërfaqeje 15 x 6 km, në të cilën nuk përfshihej as edhe një lloj qendre banimi?

Dhe ja se si e kanë përgatitur qysh herët përgjigjen këta zotërinj: *“Kishim një qëllim, një strategji tjetër kryesore: Mbrojtjen e kufirit në mes të Kosovës dhe të Shqipërisë, nga se aty ishin të vendosura forcat e UÇK-së të këtij Grupi Operativ.”*¹⁶⁾

Mirëpo, nuk bëhet e ditur që dikush nga instancat e larta nga jua vareshit t’ua ketë dhënë këtë detyrë për mbrojtjen e këtij kufiri, ndërkohë që Republika e Shqipërisë kishte një Division të tërë Këmborsie të komanduar nga gjeneral Kudusi Lama, me ndihmën e të cilit ju të GO-3 mundët të kapnit këtë sipërfaqe.¹⁷⁾

Dhe përsëri ata na përgjigjen: *“E kemi marrë vetë këtë detyrë.”*, shprehur kjo edhe nga vetë komandanti Rrustem

Berisha: *“Ne si ushtarë dhe e prorë të Br.131 dhe eprorë dhe luftëtarë të Brigadës 134...si dhe njësia vëzhguese diversioniste “Delta” u treguam të gatshëm që të rreshtoheshim në Grupin Operativ 3, një njësi taktike-luftarake, që formohet për kryerjen e misioneve të veçanta luftarake, çfarë është edhe Lufta e Koshares.”¹⁸⁾*

Dhe vetëlëvdimi për këtë lloj “fitoreje” arrin kulmin, kur vetë komandanti i Grupit Operativ 3 deklaroi gjithë pompozitetin në atë simpozium u e patën nderuar zotërinjtë Agim Çeku e Ramush Haradinaj: *“Kjo betejë në të ardhmen mund të shërbejë si burim doktrinor për ndërtimin e ushtrisë së Kosovës.”¹⁹⁾(?!)*

Të gjitha këto përgjigje dhe vetëmburrje nuk përkojnë aspak me realitetin; këto janë përpjekje për t’iu larguar përgjegjësisë ligjore. GO-3, i cili ka marrë më pas edhe emërtimin “Br.138 e UÇK”, nuk ka pas këtë detyrë luftarake që këta pretendojnë dhe, sikundër e pamë, nuk është aspak e vërtetë ajo që na thotë komandanti i GO-3, se gjoja *“nuk i parapriu asnjë urdhër konkret nga cilado anë që thirrej në drejtimin e luftës.”²⁰⁾*

Të nderuar profesionistë ushtarakë të GO-3, mos u mundoni të mbuloni Diellin me shoshë. Detyra luftarake ngarkuar formacionit tuaj luftarak ka qenë ajo që ka theksuar ish-shëfi i Shtabit të Përgjithshëm i UÇK-së, z.Bislim Zyrapit. Duhet të jeni të ndërgjegjshëm, se ky bojkotim i detyrës luftarake nga ana e juaj përbën vepër penale, dhe këmbëngulia e juaj për ta mohuar atë detyrë luftarake, na detyron t’i drejtohem Presidentit të Republikës së Kosovës, z.Hashim Thaçi: Për këtë lloj “heroizmi” i keni dekoruar komanduesit kryesorë formacionit luftarak GO-3, zoti President?

Radiokosovaelirë..com, 01 qershor 2019

REFERENCAT:

- 1). Muhamet Çetta “*Me UÇK-në në Koshare*”, v.2, f.261-262;
- 2)Hysen Berisha, intervistë në emisionin “debat plus”, 16.4.2019;
- 3) Anton Çuni intervistë në emisionin “debat plus”, datë 2 maj 2019;
- 4). Revista javore “Zëri”, nr.1739, 27 maj 2000,f.20-25;
- 5) M. Çetta, v.1, f.88;
- 6). M. Çetta, v.1,f.131-132;
- 7)Nasim Haradinaj, intervistë në “debat plus, 17.4.2019;
- 8) <https://ëëë.facebook.com/kamer.elezaj/posts/10210909267526988>;
- 9) Jakup Krasniqi, intervistë në “debat plus”, 3 maj 2019;
- 10) Xhavit Haliti, intervistë në “debat plus”, dt.17.4.2019;
- 11) Anton Çuni gjat komentimit të filmit të RTS (PTC);
- 12) M. Çetta, v.2,f.44;
- 13) M. Çetta, v,1, f.88;
- 14) M. Çetta, v.2,f.161;
- 15)M. Çetta,v.1,f.86;
- 16) M. Çetta, v.1,f.84;
- 17) M. Çetta, v.2,f.159;
- 18) M. Çetta, v.2,f.262-263;
- 19) M. Çetta,v.2,f.264;
- 20) M. Çetta, v.2, f.261-262

KREU I NËNTË

NUK KA AKADEMI USHTARAKE MË TË MIRË SE LUFTA

Gjatë intervistave të zhvilluara në emisionin “debat plus”, të organizuara prej RT Dukagjini, enkas për Luftën e Koshares gjatë muajve prill-maj 2019, me rasin e 20 vjetorit të asaj lufte, si dhe prej debateve përmes shtypit të shkruar dhe atij në fejsbuk, po plotësohet gradualisht përpara nesh tërë kompleksiteti i Luftës në Koshare, e cila ka marrë emërtimin “Betja e Koshares”. Debatet përmes librave, intervistave, analizave dhe komenteve, të cilat kanë ardhur gjithnjë e më shumë më të plota, tash kemi mundësi t’i ndajmë faktet nga manipulimet, duke u bërë gjithnjë e më shumë sa më i qartë realiteti i Luftës në Koshare. Sa më shumë që arrijmë ta kapim lidhjen e brendshme të ngjarjeve të atyre 65 ditëve të luftimeve të atjshme mbrojtse, aq më shumë habi kanë ngjallur shkaqet se cilat janë arsyet se pse u kalua në mbrojtje nga ato forca dhe si është e mundur që edhe pse e vetëndryshuan deryrën e ngarkuar, janë bërë e bëhen përpjekje të shpallet Grupi i Tretë Operativ si njësia luftarake taktike që çliroi Kosovën e “*që ka bërë luftën më heroike nga e tërë Ushtria Çlirimtare e Kosvës*”! Kjo propagandë hilanjoze ka arrit të krijoj në popull, sidomos në rradhët e politikës, përshtypjen se po të mos kishte ndodhur Lufta në Koshare, vështirë se do të kishte fituar lirinë Kosova dhe vështirë që të përmendej me respekt tregërmshi “UÇK”; pavarësisht se lufta në Koshare nisi 17

ditë më vonë pasi kishte filluar bashkveprimi luftarak midis Aleancës më të madhe Ushtarake Botërore, NATO-s, me tregërmshin: “UÇK”, (Ushtria Çlirimtare e Kosovës).

Edhe unë si dhe ju kolegët e Luftës në Koshare, kam dalë prej furtunës së asaj lufte me disa ide. Prej kur ajo luftë mbaroi, kam filluar të jetoj duke menduar me kokë dhe jo me zemër. Por te një pjesë e juaj, drejtues të Grupit të Tretë Operativ, po vërej se vijoni të jetoni duke menduar me zemër dhe jo me kokë. U drejtohem në emër të GO-3 pasi e shoh që kështu dhe u pëklqe, duke e konsideruar veten si një lloj ushtrie e veçantë. Kur jeton me kokë dhe jo me zemër, i peshon dhe i analizon më objektivisht pasionet dhe veprimet, si të tuat edhe të të tjerëve, me një kureshtje të ftohtë. Kur jeton me kokë, brenda vetes qenkan dy njerëz: njeri jeton, në kuptimin e vërtetë të kësaj fjale, tjetri mendon dhe e gjykon atë. Ai “tjetri” më thotë të gjykoj me qetësi gjithë atë luftë që pashë e jetova si dhe vetëlavderimet tuaja. Është ai “tjetri” që më sugjeroi të krahasoj luftën tuaj në Koshare me luftën që ka zhvilluar një brigatë tjetër e UÇK-së. Dhe për këtë qëllim ai më sugjeroi të marr për krahasim Br.121 “Iemat Jashar-Kumanova”, e cila, më falni, por, më falni që po ua them, ajo qëndron shumë më lart se Ju, pavarësisht se është lënë në hije dhe e pavlerësuar, sikundër jeni vlerësuar ju.


Cili është motivi i këtij krahasimi? Dëshira për t’i parë gjërat siç janë, dhe për të gjetur faktet e vërteta tek veprimtaria luftarake e secilës prej këtyre dy njësive luftarake, për t’i ruajtur ato për përdorim nga brezat pasardhës. Këtë krahasim, më thotë ai “tjetri”, ta bëj edhe për të demontuar propagandën tuaj të ethshme për minimizimin ose mohimin e kontributit të njësive të tjera

luftarake të UÇK-së, propagandë e nisur prej mbarimit të luftës dhe që vijon ende.

Ndonse jam fare i panjohur për ju, si dhe kam pasur fatkeqësinë të meritoj zemërimin tuaj ngaqë u jam dukur mohues i vlerave tuaja, por këtë e bëj që ju, drejtuesit kryesorë të Grupit të Tretë Operativ, (Br.138 “Agim Ramadani”), të njihni veprën e vërtetë lufrake tuajën, për të mësuar se si ka vepruar një simotër e formacionit tuaj luftarak; dhe jo të asgjësoj iluzionet tuaja të ëmbla. Këtë krahasim e bëj vetëm e vetëm që të kemi kënaqësinë e një shpirti të ri, i cili të na fali kënaqësi të pakufishme mes veti dhe jo duke mbivlerësuar secili vetveten. Këtu nuk ka ligësi, por drejtësi. Vetëm atëherë kur njeriu arrin të njohë vetveten krejtësishtë, atëherë ai mund të vlerësoi qoftë edhe drejtësinë hyjnore. Në qoftë se nuk sqarohen çështjet sot, në qoftë se nuk kërkojmë që këto gjëra të kristalizohen sot, me qëllimin e mirë që të gjithë të dinë se kush ka qenë, ç’ka qënë dhe çfarë ka bërë, atëherë populli nuk do të dijë kurrë se nga t’ia mbajë.

Nga çdo pikëpamje që ta shikosh veprimtarinë luftarake të Br.121 “Ismet Jashari-Kumanova”, (që unë po e marr për krahasim me Br.138 “Agim Ramadani”), ajo është një spektakël që vështirë se mund t’i gjendet shoqe në tërë luftën çlirimtare të Kosovës po të kemi parasysh disa veçori sikundër janë: territori ku ajo brigadë u ngarkua me detyrë të organizonte mbrojtjen pozicionale aktive të paramenduar është shumë i diskutueshëm dhe tepër i gjerë; fronti ku ajo pat organizuar mbrojtjen ishte tepër i shtrirë dhe në një terren shumë të thyer në të cilin kalonin vijat mbrojtëse të saj; masa e madhe e ushtrisë të rregullt armike të cilën përballoi për një periudhë kohore tepër të gjatë;

një lloj mbrojtje në rrethim gati 9 mujor, mbrojtje e cila zor se mund të mbështetej në ndonjë bazë organizative që kishte ekzistuar më parë gjatë gjithë periudhës shtatëmuajore masive të luftës në Kosovë të mëparshme; një luftë e gjatë pa financat e nevojshme të mëdha; një mbrojtje me luftime të përditshme e një zonë malore të populluar, e mbështetur pothuajse tërësisht në popull; mënyra e drejtimit të luftimeve të saj dhe parimet e përgjithshme taktike të zhvillimit të asaj lufte 8,5 mujore (260 ditë) me një mbrojtje të vijueshme; një mbrojtje e përhershme pozicionale aktive në një luftën guerile, rast i paprecedent për të cilin mund të themi se është një risi në artin luftarak, etj. – të gjitha këto janë një gjë krejt e re për historinë e Kosovës dhe për historianët ushtarakë shqiptarë.



Duke mbrojtur dhe ruajtur gjithë institucionet drejtuese të luftës dhe popullsinë e 37 fshatrave, kjo brigadë e mësoi atë popullsi në të njëjtën kohë me shërbimin në front, pa e vënë përpara rrezikut dhe situatave të rënda. Njëkohësishtë kjo brigadë, nën kujdesin e drejtpërdrejt të Shtabit të Përgjithshëm shfrytëzoi me mjeshtëri të rrallë armëpushimin e njëanshëm të tetorit 1998, për të siguruar rezerva materiale e ushqimore për një kohë të gjatë lufte në rrethim, të cilat, të menaxhauara me mjeshtëri nga i palodhshmi dhe i kujdesshmi Idriz Hyseni, (ekonomati i SHP), bëri që kjo bigadë ta realizoi detyrën, si dhe shpëtoi gjithë atë popullsi nga uria kur në Malet e Berishës u grumbulluan mbi 150.000 fëmijë, gra, burra e pleq në muajt mars-prill 1999.

Sigurisht Br.121 “Kumanova” nuk mund të matet me kutin e një brigade këmbësorie të një ushtrie të rregullt e me përvojë luftarake, sikundër ishin brigadat e armikut; qoftë edhe me një brigadë të një ushtrie të rregullt pa përvojë luftarake. Por ama, ia doli ta përballonte ushtrinë e rregullt serbe. Këtë e arriti duke i shpërndarë komandatët me përvojë luftarake shtatëmujore në çdo batalion, të cilët i fituan prirjet ushtarake nga domosdoshmëria historike; mori nga brigadat e tjera të asaj zone operative luftëtarë të vjetër dhe i futi në çdo skuadër, togë e kompani; ditët e luftimit vullnetarët e rinj futeshin në skuadra, toga e kompani të përbashkëta me veteranët dhe, si të thuash, inkuadroheshin brenda tyre. Pa përvojën e veteranëve të njësiteve të para të fillimvitit 1998: **“Pëllumbat”, “Lumi”, “Çeliku”, “Sokolat”,** organizimi i mbrojtjes nga Br.121”Kumanova” do të kishte kërkuar shumë më tepër kohë e sakrifica dhe ndoshta do të kishte më shumë humbje.

Regjimi që u imponohej të gjithëve në rrethim ishte një regjim sa i një discipline heroike aq edhe i një ndershmërie. Ata ishin ushtarë të luftës dhe jo të kazermës, sepse ishin përleshur aq shumë sa gati nuk u kishte dalë koha për të fjetur ata shtatë muaj më herët qoftë edhe një natë në shtëpi. Ata i kishin kaluar ata shtatë muaj më parë duke u ndëshur nga njeri skaj i zonës operative në tjetrin, larg shtëpisë, larg fëmijëve, larg festimve familjare dhe nevoja i kishte bërë njerëz të luftës. Të tërë ishin të lindur e të rriur në Kosovë, (me përjashtim të Tahir Sinanit, Indrit Carës, Bardhyl Tahirit, Aden Shehut dhe Shpëtim Golemit), dhe pothuaj të gjithë ishin të afërt nga gjaku. Lidhja e tyre e shtresës apo e gjakut i dallonte qartë dhe i bashkonte fort.

Meritat vetjake të secilit prej tyre ishin të padiskutueshme. Por të gjithë ne oficerat e karjerës nuk qemë asnjëherë të vetëdijshëm se kishim ngritur para tyre një mur të pakapërcyeshëm sa na dukej vetja të arritshëm nga kushdo prej tyre: si kur hanim ushqim si të barabartë, si gjatë natës kur shihnim gjendjen shpirtërore ku ishin zhytur ata, si gjatë kohës kur marshonim apo edhe kur ishim duke luftuar bashkë me ta, të raskapitur. Midis të gjithëve që luftonim në rrethim, popull e ushtarë, nuk ekzistonte as hieja më e vogël e keqkuptimit. Ishte e qartë se ky vëllazërim shpirtëror na bënte që të thjeshtësohej ndjenja e disfatës kur na vritej një shok pasi kishim fituar luftimin. Lavdia u përkiste të gjithëve.

Numëri tepër i vogël i të vrarëve (74 vetë) dhe i të plagosurve i kësaj brigade, (po të kemi parasysh kohëzgjatjen 8,5 mujore të luftës në rrethim), në krahasim me Br.138 “Agim Ramadani” që pati 114 të vrarë për dy muaj luftë, provon se në shumicën e luftimeve, artilerinë armiku e ka

përdorur kryesisht në distancë mjaft të mëdha në krahasim me përdorimin që ai i ka bërë artilerisë së tij në Koshare; gjë që tregon se armiku sulmet i ka ndërprerë shpejt, dhe është tërhequr dhe kjo si rrjedhojë e kundërsulmeve të menjëhershme nga togat, kompanitë dhe batalionet e Br.121 “Kumanova”.

Meritë të veçantë në këtë drejtim, duke mos e lejuar artilerinë armike t’i afrohej sa më shumë frontit në Malet e Berishës kanë edhe brigadat e tjera, por veçanërisht Batalioni Autonom i SHP nën komandën e Jetullah Qarrit-Gurri, i cili bënte mbrojtjen e përparuar të këtij brezi mbrojtjeje në rrethim, duke kapur drejtime, lartësi sunduese dhe qafa për të shmangur afrimin e artilerisë armike si dhe befasinë e sulmit të armikut, duke e penguar atë bashkë me forca të caktuara të brigadave fqinjë, si dhe duke e sulmuar artilerinë armike kryesisht natën, sipas taktikës së luftës partizane; dhe falë këtij fakti, duke e penguar armikun, brigada mernte me kohë lajme mbi sulmet e armikut dhe u kundërvijë duke i sulmuar. Mbrojtja pozicionale aktive në luftën guerile, (si në rastin e luftës sonë), përdoret vetëm në raste të veçanta, në rajone dhe pika të caktuara me rëndësi strategjike dhe përkohësisht; por edhe në këto raste të veçanta, mbrojtja pozicionale aktive kombinohet detyrimisht me mbrojtjen e manovrueshme. Ndërsa mbrojtja e kësaj brigade ishte e përhershme, dhe kombinimin e kësaj mbrojtje të përhershme me mbrojtje të manovrueshme të kësaj “kështjelle” natyrore, (malet e Berishës), SHP e realizoi përmes lëvizjeve midis pozicioneve mbrojtëse të Br.121 dhe vijave të ndarjes me zonat e pushtuara në mënyrë të vazhdueshme të nënrepartëve të Batalionit Autonom dhe të brigadave fqinje, të cilat patën karakterin e luftimeve që

nuk formonin një front të rregullt. Ky është një rast tipik unik në historinë e luftës guerile shqiptare, i huazuar prej taktikave dhe strategjia e Skënderbeut. Si rrjedhojë e kësaj strategjie malet e Berishës prej shtatoit 1998 dhe deri në fund të luftës mbetën **zonë e gjerë e banuar e lirë**; e vetmia. Kjo u arrit me luftë prej Br.121 “Kumanova”, batalionit Autonom i SHP dhe i disa nënreparte të brigadave fqinje, e ideuar kryesishtë prej ish-shefit “joprofessionist” i SHP, kolonel Bislim Zyrapit³⁴).

Po të kemi parasysh se Br.121, duke pasur një vijë kaq të gjatë mbrojtje, ku bashkëveprimi luftarak midis zonave operative çalonte së tepërmi për shkaqe objektive, gjithkush mendon se është e pamundur që ajo brigadë t’ia ketë dalë e vetme kësaj detyre.

Këtu qëndron mënjëria e “joprofessionistëve” të SHP të UÇK-së, duke përzgjedhur këtë rajon strategjik për t’u vendosur përfundimisht institucionet drejtuese të luftës. Kjo përzgjedhje është tepër e zgjuar, pasi ekzistonte mundësia për t’u tërhequr në çdo drejtim të mundshëm ngaqë nuk ka asnjë pengesë ujore në çdo drejtim strategjik nga ku mund të delet, si dhe është tepër e vështirë që armiku të përdori në këtë terren teknikën e rëndë luftarake në formacion të rregullt luftimi, gjë që mbrojtja e kishte shumë më lehtë të luftonte me atë teknikë.

Sikundër dihet, SHP ka qëndruar nën mbrojtje të Br.121 “Kumanova”, në Malet e Berishës ose rreth maleve të Berishës, duke lëvizuar herë në Kleçkë e herë në Divjakë. Vetëm prej 25 gushtit deri 25 shtator 1998 SHP

34) Është shumë interesante fakti, se menjëherë porsa u botua ky shkrim në mediat e Prishtinës e të Tiranës, qarqet anti-UÇK kanë filluar një fushatë shpifjesh nga më të ndryshmet kundër z.Bislim Zyrapit!

ka qenë bartur në Drenicë (në fshatrat: Negroc, Vuçak, Terdec, Vërboc e Krahsmiroc). Por, prej 26 shtatorit 1998 ai u rivendos përfundimisht në Malet e Berishës, në Fshatin e Ri dhe Lladroc, dhe prej janarit 1999 nuk ka lëvizur më nga Divjaka derisa u zhvendos përfundimisht në Prishtinë, më 24 qershor 1999. Ruajtjen e afërme të tij e realizoi pandërprerje një prej kompanive të batalionit autonom i SHP.

Gjithkush mund të pyesë: Pse iu dha një vijë mbrojtjeje kaq e gjatë Br.121 “Kumanova”? Edhe në këtë rast analiza ushtarake e ne “joprofesionistëve” që komandonim UÇK-në është treguar tepër e mënçur. Shfrytëzimi i veçorive të terrenit në të gjithë këtë vijë mbrojtjeje prej 33 km e gjatë, është bërë me qëllimin e zgjuar:

Së pari, malet e Berishës janë çelësi i gjithë territorit të Kosovës; kush e zotëron këtë territor me rëndësi strategjike, ka nën hyqëm gjithë Kosovën. Me humbjen e këtij territori Kosova do të ndahej në dy pjesë pa asnjë lidhje me njëra-tjetrën, dhe do t’i jepte armikut mundësinë ta shpartallonte krejt UÇK-në; kështu që rimarja e atij territori nga UÇK-ja do të ishte e pamundur.

Së dyti, forca e rezistencës e këtij pozicioni fatlum të Kosovës, nuk qëndron aq në aftësinë mbrojtëse të lartë të të gjithë drejtimeve të tij, se sa në faktin se ky terren është i atillë që pala sulmuese gati përherë është e detyruar t’i ndajë forcat e veta në shumë drejtime, ndërkohë që pala mbrojtëse ka mundësi që t’i përqëndroi focat e veta kundër çdo drejtimi prej grupeve mësymse, t’i thyejë ata me kundërsulme si në sajë të epërsisë numerike të përqëndruar për momentin dhe t’i kthehet tjetrit; ashtu edhe në sajë se armiku është i detyruar të sulmoi nga poshtë-lartë. Këto

kanë bërë që kundërshtari infektohej shpesh herë nga pavendosmëria dhe hiqte shpejt dorë nga sulmi.

Së treti, armikut, për ta pushtuar këtë terren do t'i duhej të angazhonte njëherësh shumë forca këmbësorie të mjaftueshme. Kjo do të bënte që armiku të mos angazhohej në luftime me forca të shumta kundër zonave të tjera; mirëpo këto forcat e tjera tonat do ta sulmonin në shpinë, dhe kështu ka ndodhur. Si rrjedhojë armiku nuk e ka ndjerrë kurrë veten të qetë sa herë që ka dashur të sulmonte Br.121 me forca të shumta, duke u detyruar të shpërndante vëmendjen, forcat dhe mjetet në shumë drejtime. Dhe kjo gjë është parashikuar edhe në ndarjen e zonave dhe rajoneve bazë e rezervë të përkohshme për veprime luftarake të brigadave të tjera të Zonës së Dytë Operative, ku bënte pjesë edhe Br.121, që këto njësi taktike me kapjen dhe mbajtjen e objekteve të rëndësishme të mund t'i vinin shumë shpejt në ndihmë kësaj brigade, për të lehtësuar vijimësinë e luftimeve të saj dhe pastaj në kushte të përshtatshme ktheheshin në rajonin e tyre pa u sulmuar nga armiku. Madhësia e zonës dhe e rajoneve për secilën brigadë, si dhe largësia mes tyre tyre, ka qenë varur nga detyra luftarake dhe nga karakteri i relievit dhe i veprimeve të armikut, duke bashkëvepruar me njera-tjetrën dhe me Br.121 që zhvillonte luftime në rrethim, por në këto raste sipas vendimit të Shtabit të Përgjithshëm meqenëse kjo brigadë ishte në mbrojtje të tij.

Për të plotësuar me sukses këtë detyrë shumë të rëndësishme luftarake, Br.121 u mbështet vazhdimisht jo vetëm në popullsinë e këtyre 37 qendrave të banuara por edhe në ato jashtë këtij rrethimi, duke mbajtur lidhje të ngushta me popullin për martjen e masave të gjithanshme serioze duke ruajtur konspiracionin për çdo veprim luftarak si dhe për të përballuar propagandën dhe luftën psikologjike

të armikut pushtues të kombinuar me atë të disfatistëve të brendshëm.

Të gjitha këto çfarë rendita më sipër bindin çdo ushtarak të aftë se prej muajit tetor 1998 Lufta Çlirimtare e Kosovës filloi të merrte karakter strategjik dhe fillon të tregohet një interes për pozitën strategjike të Drenicës së Poshtme dhe gjithë Llapushës.

Armiku kishte gjasa ta mposhte këtë brigadë në rast se do të bënte një mësymje të shpejtë, gati të furishme, sikundër tentoi në datën 31 mars 1999 kur e rrethoi me 15.000 forca, por atëhere ishte vonë për armikun. Atë ditë kjo brigadë qe përforcuar edhe me gati 4000 luftëtarë të tjerë, ku përfshihej gjithë Zona e Dytë Operative dhe një pjesë e Zonës së Parë Operative. Armiku pandehte se tërheqja e organizuar e gjithë forcave të Zonës Dytë Operative drejt maleve të Berishës gjatë gjysmës së dytë të 31 marsit ishte panik dhe kujtoi se do ta kishte të lehtë ta shuante Ushtarinë Çlirimtare të Kosovës. Dështimi i atij rrethimi dhe i asaj goditje të furishme të armikut donte të thoshte humbje e gjithë Operacionit “Patkoi”, parë nga pikëpamja ushtarake.

Përfundimi: Br.121 “Ismet Jashari-Kumanova” veprimi gjatë gjithë luftës me mbrojtje aktive, por me disa dallime kolosale prej GO-3(Br.138 “Agim Ramadani”), të cilat jemi përpjekur t’i pasqyrojmë në formën e një tablele krahasuese:

Br.138 “Agim Ramadani”	Br.121 “Kumanova”
<p>1) Br.138 “Agim Ramadani” luftoi në mbrojtje 65 ditë, prej 11 prill deri 19 qershor 1999. Terreni: tepër malor, i pyllëzuar kryesisht me shkurre të dendura; në kushte dimri të ashpër, duke mos pasur mundësi t’u shmangeshin vendeve të rrezikshme. Mbrojtje e organizuar në front të gjerë me krahë të zbuluar; por ngaqë edhe kundërshtari ishte në të njëjtat kushte, dobësia e këtyre krahëve nuk ishte e ndjeshme; mbrojtje e organizuar me ngutje, duke kapur pjesët sunduese të cilat u fortifikun me transe e hendeklidhje. Gjatë atyre dy muajve i gjithë efektiv i jetoj e luftoi jashtë, në terren të hapur, pa zjarr dhe rrobat u thaheshin në trup, gjë që Br.121 në këtë drejtim kishte kushte normale. Sistemin e fortifikimit e përballoi me forcat e veta dhe në kushte të këqija atmosferike. Një pjesë e forcave janë përdorur për patrullim në boshllëqet që impononte terreni, si dhe në të dy krahët, pasi nuk kishte fqinj që të përfshiheshin në rajonin e mbrojtjes së tyre, megjithatë armiku pati shumë raste që u bëri krahmarrje.</p>	<p>1) Br.121 “Ismet Jashari-Kumanova” luftoi në mbrojtje 260 ditë, prej 26 shtator 1998 deri 12 qershor 1999. Terreni: Tepër malor i pyllëzuar me drunjë të mëdhenj, të dendur si dhe shkure. Mbrojtje rrethore e parashkuar për mbajtjen me çdo kusht e një zone të gjerë me rëndësi strategjike për luftën, si dhe për ta goditur armikun në shpinë; mbrojtje e organizuar me kohë, duke ia mundësuar ekzistenca e 37 qëndrave të banuara brenda zonës së saj të mbrojtjes në rrethim, që shumë prej tyre përputheshin me vijat dhe pozicionet e brezit të saj. Gjatë tërheqjeve taktike të nënreparteve të veçanta ka ndodhur që këto ndaleshin për mbrojtje në shtëpitë e fshatrave, në bashkëveprim me banorët e tyre. Shumë prej shtëpive që ndodheshin në vijat dhe pozicionet e nënreparteve të brigadës ishin lidhur me transe e hendeklidhje me ndihmën e popullsisë, me synim që sulmi armikut të thyhej qysh në ato vija. Pyllëzimi u imponoi ndërtimin e rendimeve të luftimit të reparteve e nënreparteve në trajtë rombi, për të siguruar më mirë krahët. Forcave u ishin bërë të qarta vështirësitë dhe kërkesat e luftimit në rrethim, duke organizuar mbrojtje të pandërprerë 24 orëshe, me tri ndëresa: 30% në front, 30% e gatshme dhe 30% pushim.</p>

2) *Detyra e dhënë* nga SHP për Br.138 ishte: Hapja e korridorit të furnizimit Koshare–lumi Drini i Bardhë; ndërsa pa miratim nga SHP kjo brigadë e la atë detyrë dhe i vuri vetes detyrën e pakuptimtë:“*heqjen e kufirit shqiptar-shqiptar me luftë*” dhe kaloi në mbrojtje! Qëllimi i natyrshëm i sulmit i Br.138 ishte rrëzimi përtokë i kundërshtarit dhe jo i piramidave të kufirit. Duke i vënë vetes këtë detyrë, kjo Brigadë prej 2.600 vetësh, që qëndroi gati në sy të armikut, në veprimet e veta duhej të udhëhiqej jo nga çka ndodhte në palën armike, por nga çka po ndodhte e mund të ndodhte brenda në Kosovë. Prej momentit që ajo kaloi në mbrojtje, ajo brigadë ishte gjysëm e mundur.

2) *Detyra e dhënë* nga SHP Br.121 ishte:
Mbrojtjen e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Radio Kosova e Lirë, Agjensinë Kosovapress, Logjistikën bazë për municione dhe për ushqim të luftëtarëve dhe të popullsisë qindramijëshe të zhvendosur në Malet e Berishës; Qendrën e Bashkëveprimit Luftarak midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Aviacionit Luftarak të NATO-s; popullsinë e 37 fshatrave, si dhe Spitalin Qendror të UÇK-së (*vendosur në shtëpinë e Habib Isë Zogaj në Divjakë*) bashkë me 23 ambulanca mjekësore v ku mjekohesh popull e ushtri, nën udhëheqjen e dr. Fadil Beka; dhe tre muajt e fundit të luftës mbrojti edhe Qeverinë e Përkohëshme të Kosovës. Qëllimi i natyrshëm i mbrojtjes së Br.121 ishte thyerja e çdo sulmi të armikut, duke e detyruar kundërshtarin të hiqte dorë nga sulmi, dhe e realizoi.

<p>3) Br.138 "Agim Ramadan" në fund të luftës pati 2300-2600 luftëtarë të organizuar në 4 batalione dhe 2 njësite të veçanta si dhe rendimi luftarak i Logjistikës; duke dalë pa realizim të detyrës. Rendimin e luftimit e ndërtoi në dy skalione me rezervë njësitë "Delta" dhe "Cobrat"</p>	<p>3) Br.121 "Kumanova", në tetor '98 u kompletua me 800 luftëtarë dhe deri në fund të luftës, duke ardhur prurjet e reja si dhe ardhia në tre muajt e fundit të disa nënreparte nga Br.114 "Fehmi Lladrovci" dhe Br.113 "Mujë Krasniqi" arriti rreth 1300 luftëtarë; ndarë në 4 batalione. Pra, Br.121 ka pas efektiv 50% më pak se Br.138 dhe me detyrë shumë më të rëndësishme e më të vështirë për ta realizuar, dhe e realizoi. Rendimin e luftimit e ndërtoi në një skalion të fortifikuar me tre vija mbrojtëse të fortifikuara dhe kanale k/ tanke; në rezervë dy kompani si dhe disa grupe vullnetare nga popullsia civile.</p>
--	--

<p>4) Br.138 "Agim Ramadani" kishtë <i>artilieri</i> të fuqishme në organikë, duke filluar nga fakti që "<i>Cdo skuadër kishte mitraloz të rëndë, sanajper 12,7mm, minahedhës 75 mm etj</i>", (M.Çetta,v.2,f.236); çdo togë pati nga një top pa zbrapsie 75mm e 107 mm dhe mortajë 82 mm, kurse kompanitë dhe batalionet nga tre të tillë, përveç që pati artileri të veçantë brigade, të organizuar në toga me topa 82 mm, 107 mm, dhe me mortaja 120 mm e 160 mm, pa folur këtu për mbështetjen me artileri nga artileria e Divizionit të Kuksit, sikundër ishte grupi 122mm me 3 bateri me nga 4 topa, me PZ në Padesh dhe municioni i pallogaritshëm;(M. Çetta, v.1,f.169;v.2,f.47,97). Të gjithë ushtarët pajisur me automatikë dhe me municion mjaft të shumtë.</p>	<p>4) Br.121 "Kumanova" të gjithë luftëtarët të pajisur me armë krahu (gjysëm automatike), Kallashnikov, Uinçester Magnum 300 dhe Heckler-Koch G3); 10 mitralozë të rëndë; 4 mitralozë 12.7 mm; 10 snajperë 12.7 mm; 6 OSA; 12 RPG7; 4 mortaja 80mm; 2 mortaja 120 mm dhe 40 mina KT; <i>asnjë oficer karjere artilier</i>. Municion artilerie tre complete luftarakë për çdo grykë zjarri; municion për armët e këmborisë tre-pesë complete luftarakë.</p>
---	---

5) Br.138 “Agim Ramadani” me 2300-2600 luftëtarë mbrohej në një vijë *fronti prej 15 km gjatësi*, me dendësi mesatare 173-174 luftëtarë km/front, por në kushte shumë të vështira dimri, (borë, shi, baltë dhe ngrica), gjë që ndikonte në uljen e ritmit të lëvizjeve dhe të veprimeve. Kjo të jep të kuptosh se mbrojtja e zhvilluar nga Br.138 ka qenë mbrojtje pozicionale pasive, për të mos u shpartalluar vetë; ndërkohë që për detyrë kishte shpartallimin e armikut, pasi e kishte mundësinë sepse kishte kontigjent të mjaftueshëm luftëtarësh, por faktikisht pa përvojë lufte, por kishte burime të shumta intelektuale ushtarake si dhe kompesohej me fuqinë e jashtëzakonshme të zjarrit që ajo dispononte; duke mos haruar faktin që, ajo do të ishte betejë vetëm këmbësorie; por u kufizua vetëm me përdorimin e zjarrit, pa e shoqëruar atë me ndeshjen, (sulmin).

5) Br.121 “Kumanova” me 800-1300 luftëtarë mbrohej në një vijë *fronti me gjatësi 33 km*, me dendësi 40 luftëtarë për km/front. Kjo dendësi luftëtarësh për km/front të len të kuptosh se mbrojtja pozicionale e kësaj brigade është arritur me kundërsulme të shpejta e të shpesh-ta, ndeshje me grupe të vogla, me sulme gjatë hapësirave midis ndërtesave (shtëpive), duke i kush-tuar rëndësi mbrojtjes së ndërhapësirave dhe rrugëve që të çonin në brendësi të fshatit.

Kjo brigadë nuk kishte për objektiv shpartallimin e armikut, sikundër e kishte ajo në Koshare, por t'i shmagej vetëm shpartallimit të vet dhe të mos e lëshonte asnjëherë këtë territor. Edhe pse me shumë pak burime intelektuale ushtarake kjo Brigadë iu afrua një ushtrie të rregullt duke u shtuar me forca pas mobilizimit të përgjithshëm. Ishte organizuar bashkëveprimi me banorët kundër grupeve diversioniste që mund të futeshin brenda rajonit të mbrojtjes. Në kushtet e dimrit të egër kishin favorin se strehoheshin në bazë grupesh nëpër shtëpitë e fshatrave dhe objekte të tjera, në 81 të tilla, me masa të forta ruajtjeje dhe sigurimi.

<p>6) Në Frontin e Koshares kemi gati 5.000 ushtarë, të ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë në dy kampe armike, me raport forcash 1:1, duke qëndruar përballë njeri-tjetrit prej mbi 2 muaj, pa hyrë asnjëherë në betejë të përgjithshme, secila palë me qëllime të njëjta: të mbronte vetveten; edhe kur përparonte njera palë apo tjetra, tërhiqeshin pa asnjë rezultat të dukshëm, ndërkohë që armikut kjo statukuo i leverdiste; ndërkohë që B..138 duhej të përparonte, për të arritur objektivin për të cilin hyri në luftë, por nuk e realizoi. Në rast se armiku do t'i kthente forcat e Br.138 në vjën ku kjo filloi sulmin, nuk do të sillte asnjë ndryshim serioz të gjendjes, përveç që pala jonë do të kishte më pak humbje. Br.138 ishte e kompletuar me vullnetarë pa përvojë luftarake, por me një numër shumë të mjaftueshëm oficerash për t'i drejtuar, që vinin nga ushtria e rregullt e me akademi ushtarake.</p>	<p>6) Në frontin e Maleve të Berishës kemi gati 6.000 forca në dy kampe armikre, të ndara 4000 me 2000, në favor të armikut, (po të kemi parasysh edhe grupet vullnetare prej popullsisë civile të 37 fshatrave, pa llogaritur logjistikën bazë ku hyjnë gratë dhe burrat që punonin për frontin.) Raporti i forcave 1:2, në favor të armikut, duke qëndruar përballë njera-tjetrës mbi 8,5 muaj, por secila palë me qëllime të kundërta, në raport me palët në Koshare: në frontin e maleve Berisha pala armike kërkonte të përparonte, ndaj dhe sulmonte çdo ditë, por pa rezultate; pala jonë kërkonte të mbrohej duke mos e lënë armikun të depëronte në rajonin e saj të mbrojtjes dhe e realizoi përmes k/sulmeve rezultativë dhe nuk e la armikun të depëronte. Br.121"Kumanova" e kreu detyrën para Atdheut. Në rast se armiku fitonte, ndryshimet do të ishin të jashtëzakonshme në dëm të UÇK-së dhe Kosovës. Br.121 e kompletuar edhe kjo me vullnetarë me përvojë luftarake shtatëmujore, por me një numër të pamjaftueshëm oficerash karjere për t'i drejtuar. Komandantët e reparteve e n/reparteve të Br.121 vinin kryesishtë nga popullsia civile.</p>
--	--

<p>7) Në Frontin e Koshares ishte armiku që sulmonte çdo ditë, ndërsa Br.138 e UÇK-së mbrohej kryesisht me zjarr, pa sulme e k/ sulme. <i>Oficerat e Br.138 rezulton se nuk kanë ndërmarrë veprime energjike</i> ose manovrimë të ndërlikuara edhe pse kishin përvojë luftime 2-3 mujore gjat vitit 1998.</p>	<p>7) Në frontin Maleve të Berishës Br.121 e UÇK-së mbrohej kryesisht duke kundërsulmuar sa herë sulmonte armiku, por edhe duke sulmuar në rastet kur lindte nevoja për të përmirësuar pozitën. <i>Oficerat e Br.121 rezulton se kanë ndërmarrë përherë veprime energjike.</i></p>
<p>8) Br.138 “Agim Ramadani” me 2300-2600 luftëtarë mbrohej duke i pasur <i>shpinën dhe krahët të sigurtë.</i></p>	<p>8) Br.121 “Kumanova” me 800-1300 luftëtarë luftonte <i>në rrethim të plotë.</i> Mbrojtja në rrethim është lloji më i vështirë i luftimit.</p>
<p>9) Br.138 “Agim Ramadani” me 2300-2600 luftëtarë, mbrohej në një rajon të pabanuar, <i>duke mos pas ndihmë prej popullsisë civile,</i> por as përgjegjësi për mbrojtje të popullsisë. Pushtimi prej saj i një brezi kufitar 15 x 4-5 km ishte vetëm një fragment i planit luftarak të saj; plotësuesi, d.m.th. thyerja e armikut dhe hapja e korridorit i mungoi ngaqë e lanë rastin pas dore në ditën e tretë të sulmit.</p>	<p>8) Br.121 me 800-1300 luftëtarë mbrohej në mes të një rajoni të banuar dendësisht nga <i>37 fshatra:</i> (Arlat, Baica e Kolshit, Baja, Bellanica, Berisha, Blinaja, Bllaca, Caraleva, Divjaka, Fushtica e Epërme, Fushtica e Ulët, Javori, Karaçica, Kizhareka, Kleçka, Komorani, Kroimiri, Leletiçi, Luzhnica, Lladroci, Llapushniku, Mirena, Nekoci, Ngucati, Novosella, Pjetërshtica, Risinoci, Sankoci, Seniku, Shala, Temeçinë, Tërpeza, Zabeli i Epërm dhe Zborci, Carraleva si dhe një pjesë e madhe e kompleksit pyjor të Blianjës), e cila u bë baza kryesore, burimi dhe forca më e madhe logjistike dhe njerëzore e kësaj Brigade çlirimtare dhe e këtyre institucioneve të asaj luftime. Në këtë drejtim Br.121 “Kumanova” ishte më me fat, por me më shumë përgjegjësi se Br.138 “Agim Ramadani”, pasi duhej bërë edhe mbrojtja e popullsisë.</p>

10) Br.138 “Agim Ramadani” me 2300 - 2600 luftëtarë *furnizohej* rregullisht me ushqime, veshmbathje, armatim dhe municione duke i ardhur nga territori i lirë, nga *Nëna Shqipëri*.

Br.138 ishte një ushtri serioze që luftonte me një ushtri serioze, por me rekrutë të rinj me stërvitje të pakët, sikundër na e konfirmon gjeneral Hysen Berisha; fuqizuar pas dy ditësh me rreth 1000 - 1500 forca të stërvitura.

10) Br.121 “Kumanova” me 800-1300 luftëtarë dhe popullsia qindra-mijëshe (në mbështetje të saj por edhe nëpër këmbët e saj); *furnizimi* u desh të organizohej nga hiçi duke mos dalë asnjëherë nga gjendja foshnjore, pasi nuk kishin pas kurrë organizim ushtarak; u duhej ta siguronin çdo gjë me forcat e veta, nga *Nëna Fshatare Kosovë*. Për këtë qëllim u mbajtën në punë 9 mullinj të ujit që bluanin 24 orë rresht: (*Mulliri i Ali Durmish Rizanit në Krojmir; Mulliri i Demir Smail Gashit, në Javor; mulliri i Haradin dhe Hazir Buçaj në fshatin Lladrovç; Mulliri i Hazir Murat Gashit në Nekoc; Mulliri i Ali Gashit, në Grykë të Gashit, në Nekoc; mulliri e Isuf Banush Hoxhës në Shalë; Mulliri i Shaban Selim Kastratit, Blinajë; Mulliri i Ramadan Bahtijar Gashit, Pjetërshticë; Mulliri i Fazli Ymer Jonuzajt, Senik*); *3 rrobaqepësi në familjet Bujupi, Shamolli dhe Arifi, si dhe 35 shtëpi kuzhinë ku punonin me rradhë të gjitha gratë e 35 fshtarva, me tre turne, ato pa fëmijë në gjoks, përveç 3 kuzhinave të menaxhuara nga luftëtarët.*) Gjithë kjo “ushtri” popullore ishte fare e papërshtatshme për të luftuar me një ushtri klasike dhe në rrethim, por makina sociale në popullsinë e këtij territori të gjerë ishte e tillë që kërkoi shumë pak kohë për t’u shndërruar nga civilë në ushtarë. Ky shndërrim kaq i shpejtë u mbështet në epërsinë individuale të popullsisë malore fshatare.

<p>11) Br.138 "Agim Ramadani" furnizimin ia bënin luftëtarët, logjistika e saj bëhej <i>me kafshë</i> dhe mjete të tjera transporti.</p>	<p>11) Br.121 "Kumanova" furnizimin ia bënin pothuajse gratë dhe të moshuarit e gjithë fshatrave. Që do të thotë se logjistika e Br.121 "Kumanova" ishin nënat dhe motrat e ushtarëve. <i>Transportimi veç me krahë.</i></p>
<p>12) Br.138 "Agim Ramadani" pati 114 <i>dëshmorë</i>, që i bie mesatarisht 1 dëshmor në çdo 20-23 luftëtarë, por <i>në çdo 2 ditë 3 dëshmorë, ose 77 dëshmorë në një muaj.</i></p>	<p>12) BR.121 "Kumanova" pati 74 <i>dëshmorë</i>, që mesatarisht i bie 1 dëshmor në 19 luftëtarë, <i>në çdo 3 ditë 1 dëshmor,ose 8 dëshmorë në një muaj.</i></p>
<p>13) Në Br.138 "Agim Ramadani" të rënë janë <i>35% nga zjarri i artilerisë</i> armike, 33% nga snajperistët armiq, 10% nga aviacioni dhe vetëm 22% kanë rënë në luftime të drejtpërdrejta me forcat serbe.</p>	<p>13) Në Br.121 "Kumanova" vetëm <i>25% e</i> dëshmorëve kanë rënë <i>nga zjarri i artilerisë</i>, 75% në luftime të drejtpërdrejta gjatë kundërsulmeve e sulmeve ndeshëse kundër forcave serbe.</p>
<p>14) <i>Mjekësia</i> në Frontin e Koshares, bazuar ne ato çka na jep z.Muhamet Çetta, 12 mjekë dhe infermierë, i bie 1 mjek apo infermier për 200-215 luftetarë (persona); që do të thotë 10 herë ngarkesë më të vogël nga ç'kanë pas mjekët në Malete e Berishës, spitali jashtë rajonit të mundshëm për goditje nga armiku, si dhe për të plagosurit për ndrhyrje më të specializuar i dërgonin në Bajram Curr dhe Tiranë.</p>	<p>14) <i>Mjekësia</i> në Frontit e Maleve të Berishës kanë shërbyer gjithsej 85 mjekë dhe infermierë (prej tyre 37 mjekë), që do të thotë se i takon 1 mjek ose infermier për 2000 banorë e luftëtarë, (10 herë më shumë ngarkesë se personeli mjekësor në Koshare), po të kemi parasysh se këtu banorët e 37 fshatrave dhe më pas, në periudhën mars-prill popullsia mbriti në rreth 150 mijë. Përveçse në këtë front ka pas dhe qindra lindje fëmijësh me vetëm një vdekje. Të gjitha kategoritë e plagosjeve u përbalua nga personeli i saj mjekësor pa asnjë vdekje.</p>

Në raport me Br.138 “Agim Ramadani”, Br.121 “Ismet Jashari-Kumanova” pati edhe këto tri veçori:

A). Këtu patëm një fenomen të ri: pjesëmarrja masive e gruas dhe vajzës shqiptare në luftë, e që solli bashkimin si asnjëherë të popullsisë të këtyre qëndrave të banuar në malësinë e Berishës e Llapushë si dhe veçori për gjithë Luftën Çlirimtare në Kosovë; gratë dhe vajzat e këtyre qëndrave të banuara jo vetëm që u bënë logjistika e vërtetë e asaj lufte, por luftuan krah për krah me vëllezërit e burrat në të gjithë aspektet e luftës, duke përfshirë edhe luftën me armë.

Ta thjeshtësosh sot domethënien e ngjarjeve të atyre gati nëntë muajve në rrethim, në qoftë se aksionit të asaj mase të madhe grash e vajzash nuk i veshim qëllimin që ishte vetëm në kokën dhe zemrat e tyre e që është punë e lehtë për ata që i kthyen krahët asaj lufte, por jo për ne që gjithë ngjarjet me pasojat e tyre qëndrojnë edhe sot përpara syve tanë.

B). Brigada 121 “Kumanova” dhe popullsia e kësaj zone ku ajo veproi u bënë ballë me heroizëm gjat gjithë periudhës 8,5 mujore në rrethim të gjitha operacioneve armike për pushtimin e kësaj zone dhe asgjësimin e institucioneve drejtuese të asaj Luftë Çlirimtare të Kosovës, duke dalë ngadhënjyes mbi ushtrinë e shumtë e super të armatosur serbe dhe duke i dhënë përgatitjes së asaj mbrojtjeje një solemnitet që s’ka shembull.

C). Njëkohësisht, me organizimin dhe forcimin e Br.121 “Kumanova” dhe luftës së popullsisë së kësaj zone, në zjarrin e kësaj lufte lindën edhe elementët e parë të qeverisjes gjatë luftës, pasi në këtë rajon strategjik u praktikua mobilizimi i detyrues pas thirrjes së QPK lëshuar më 1 prill 1999.

Që edhe lexuesi i sotëm dhe ai i nesërm, për ta pasur të qartë detyrën luftarake të Br.121 “Kumanova”, më duhet që të zgjatem disi. Për këtë e quaj më se të domosdoshme të sqaroj me pak fjalë se cilët ishin këto institucione të luftës aq të rëndësishme që u angazhua një brigadë e veçantë për mbrojtjen e tyre, kahas mbrojtjes së popullsisë së 37 fshatrave dhe asaj pjese të popullsisë së zhvendosur nga zonat përreth:

❖ Së pari, ajo brigadë mbrojti institucionin kryesor ushtarak drejtues të Luftës për Çlirimin e Kosovës, Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Duhet bërë e qartë se Luftën për Çlirimin e Kosovës e udhëhoqi ky SHP i UÇK-së, të cilin kuadrot e Frontit të Koshares dhe gjithë politika në Kosovë që e mbështet këtë të pavërtetë, se gjoja “SHP i UÇK-së ishte i përbërë nga joprofesionistë”. Dhe këtë e kanë ose nga megalomania ose nga xhelozia, e cila ka gjasa që t’u buroi jo vetëm nga mosnjohja e luftës së zhvilluar nga gjithë formacionet e UÇK-së brenda në Kosovë, nga ata kanë qenë jashtë Kosove, si dhe nga kompleksi i inferioritetit për të justifikuar mosangazhimin e tyre në luftë.

❖ Kjo brigadë mbrojti Qendrën e Bashkëveprimit Luftarak midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Aviacionit të NATO-s, e cila realizoi një bashkveprim të shkëlqyer, për të cilin Komandanti i Përgjithshëm i NATO-s, Uesli Klark, në datë 12 qershor 1999 dërgoi me fax mrënjohjen, në të cilën theksohej: **“Bashkveprimi më i mirë luftarak në historinë 50 vjeçare të NATO-s.”**, të cilin e arshivoi menjëherë shkrues-evidencieri i SHP Mustafa Gashi. Uesli Klark e bëri atë vlerësim pasi ishte ai bashkveprim që realizoi çlirimin e Kosovës pa qenë nevoja që NATO të ndërhynte me forca tokësore, për të cilin diskutohej çdo ditë

në instancat e larta ndërkombëtare, sikundër del nga libri i gjeneralit Uesli Klark. Ky ka qenë dhe është vlerësimi më i madh që i është bërë e që mund t'i bëhet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke e barazuar atë me secilën ushtri të NATO-s, për mos të thënë edhe më lartë. Dhe atë bashkveprim e mbajti ai *“koloneli Dilaver Goxhaj nga që nuk la ndonjë gjurmë për t'u theksuar në luftën për çlirimin e Kosovës”*, sikundër e keni përcaktuar ju z.gjeneral Hysen Berisha dhe klani juaj. Madje ngaqë *“nuk kam lënë gjurmë”* prandaj dhe klani juaj nuk më ka renditur në evidencat e veteranëve të asaj lufte. Ai klan bashkë me *“komandantët e mëdhenj”* të asaj lufte çlirimtare e keni zhdukur qëllimisht dekoratën më të lartë që i është dhënë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga komandanti i aleancës më të madhe ushtarake në botë, me qëllim që kjo Ushtri Çlirimtare t'i jepej gjyqit ndërkombëtar të turpfit, për të marrë ajo damkën e një ushtrie terroriste. Dhe këtë eliminim të asaj mirënjohjeje-dekoratë e keni bërë ju që miratuat Gjykatën Speciale. Dhe këtë e keni bërë duke u nisur nga mendimi, se po të bëhet e njojtur kjo lloj dekorate, krahas UÇK-së mitizohej edhe koloneli nga Shqipëria. Aq smirë e urretje keni ndaj atij koloneli, që mbajti atë bashkëveprim, sa pranuar që të demitizohej edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe vetëm atij koloneli të mos i përmendet emëri. A e shihni se sa thellë ka shkuar tradhëtia juaj dhe e udhëheqjes politike të UÇK-së? *“Ta turpërosh vendin tënd është njëlloj sikur ta tradhëtosh atë”*, thotë Viktor Hygo.

❖ Kjo brigadë mbrojti Radion Kosova e Lirë, e cila u vendos në fshatin Berishë, dhe filloi nga transmetimet më 4 janar 1999, duke u bërë një armë e fuqishme për edukimin politik e ushtarak të luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës dhe të masave të gjera popullore në Kosovë. Ajo radio shërbeu si një tribunë për demaskimin e politikës pacifiste “nuk është koha për luftë të armatosur”, duke ngjallur te populli urrejtjen e pakufishme ndaj pushtuesit dhe propagandistëve kundër asaj lufte çlirimtare.

❖ Mbrojti Agjencia e Lajmeve Kosovapress e vendosur në Fshatin e Ri, duke filluar nga transmetimi i lajmeve më 4 janar 1999, duke u bërë për të gjitha mediat kombëtare e botërore prezantuesja e së vërtetës për luftën e drejtë të popullit shqiptar në Kosovë dhe për luftimet e sukseshme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; kjo Agjenci, përmes lajmeve dhe komenteve të saj politikë e ushtarakë bëri të mundur që lufta e jonë çlirimtare të pëkrahej nga e gjithë bota demokratike.

Unë kam qenë në Malet e Berishës dhe rreth maleve të Berishës në ditët e Luftës Çlirimtare. Fashistët serbë gjatë operacionit të verës së vitit 1998 i kishin kthyer fshatrat e asaj malësie pothuajse në një shkretëtirë. Kaloje një fshat, dy, tre, dhjetë dhe kudo syri s’te zinte veçse gërmadha. Ishin këto fatkeqësi që e frynë shpirtin luftarak të asaj popullsie. Por kam qenë edhe para një muaji, por....., nuk është vendi të flas për të sotmen. Në shtëpitë e këtyre fshtarave unë pashë se si ishte lufta dhe se si bëhet lufta popullore; pashë se ç’do të thotë popull-ushtar; pashë se si urrejtja e popullit u ngrit me tërë forcën e saj kërcënuese e madhështore, u ngrit, dhe pa pyetur fare se cilat qenë shijet dhe normat e një pale ndërluftuese, me një thjeshtësi interesante, duke shkuar drejt qëllimit, pa bërë dallim, u ngrit e ra mbi kokë të forcave serbe e i zdrugati mirë duke mos lënë këmbë serbi të depëronte brenda atij perimetri prej 33 km gjatësi gjatë atyre 8,5 muajve luftë në rrethim; pashë si u shporr lufta andej nga erdhi: nga Beogradi.

Qendrat e banuara të kësaj malësie gjatë muajve të fundit të luftës u shndërruan në vendgrumbullimin më të madh të popullatës në Kosovë, të cilën makineria ushtarake serbe edhe pse e goditi pandërprerje nga të gjitha anët, madje edhe nga ajri me aeroplanë bombardues, nuk arriti ta demoralizoi atë popull; nuk arriti t'i pushtojë ato qendra të banuara në ato 260 ditë; nuk arriti të depërtojë në Malet e Llapushnikut, Zatriçit e të Berishës, të Kleçkës e fshatrave të tjera të Rrafshnaltës, edhe pse kishte premtuar se sapo të pushtonte atë pjesë të Kosovës, atje do ta ndërtonte një stadium të madh të futbollit. Dhe kjo është meritë e Br.121 “Ismet Jashari-Kumanova” dhe e gjithë Zonës së Dytë Operative “Pashtriku”.

I fituar e i mburrur nuk del ai popull siç veproi pjesa pacifiste në Kosovë, që për fat të keq ishte shumicë e nxitur nga partia e drejtuar nga idhulli i juaj, Rugova, i cili braktisi atdheun kur ekzistenca e tij ishte në pikëpyetje të madhe e që nuk i përshëndeti sa qe gjallë as komandantin symbol të asaj ushtrie çlirimtare, Adem Jasharin dhe jo më çlirimtarët e tjerë që ishin faktori kryesor i çlirimit të Kosovës. I fituar e i mburrur është ajo pjesë e popullit shqiptar në Kosovë që ndihmoi ushtrinë e tij çlirimtare sipas gjithë rregullave të artit ushtarak popullor, që në çastin e sprovës nuk pyeti se ç'kanë bërë të tjerët, por sipas rregullave të artit ushtarak popullor në raste të tilla, rrëmbeu fare thjeshtë e pa mundim të parin dru që iu ndodh afër dhe goditi me të armikun, gjersa në shpirtin e tij urrejtja për poshtërimin që i kishin bërë u zvendësua me përbuzjen dhe mëshirën ndaj popullit armik.

Gjë që ju oficerat profesionistë që luftuat në Koshare, nuk e patë dhe nuk kishit si ta shihnit se si u mund armiku para

kësaj popullsie malësorësh shqiptarë, pasi, sikundër na tha gjeneral Hyseni, ju e patë ikjen e tyre shumë vonë, në datën 19 qershor, kur u erdhën tek ju forcat e KFOR-it. Ndërsa unë, 5.000 luftëtarët e Zonës së Parë e të Dytë Operative dhe gati 150.000 pleq, gra dhe fëmijë të asaj malësie dhe të shpërngulurit nga Drenica, Suhareka, Llapusha e Malisheva, grumbulluar në Malet e Berishës gjatë atyre 12 ditëve të para të opracionit “Patkoi”, në përballje me gati 15.000 të forcave të ushtrisë së rregullt serbe, e pamë në mëngjeszin e 01 prillit 1999, kur u shpërthye rrethimi dhe iu tha Operacionit famëkeq “Patkoi” të Serbisë: SHPORRUNI!

Në fundin e lartësive të Maleve të Berishës ishin hapat e fundit që operacioni “Patkoi” nuk mundi të vijonte më tej. Në vend që ai operacion të shuante luftën tonë, ishte ky popull dhe kjo UÇK që e bënë të merrte peropinë ai Opracion Fashist.

Zotërinj oficerë të Koshares, atje unë pashë se çfarë është uria masive. Njeriu mund të besonte se në ato kushte të tmerrshme e gati të papërfytyrueshme në të cilat ndodheshin luftëtarët dhe i gjithë ai popull në rrethim, në mes të shiut e borës me temperaturë nën zero, pa pasur as racionin të plotë, - sepse ushqimet nuk ishin të mjaftueshme,- gjithkush mund të besonte se ushtarë e popull do të ishin në gjendjen më të vajtueshme shpirtërore. Por, përkundrazi, ata luftëtarë dhe ai popull besoj se nuk duhet të kenë pasur kurrë, edhe në kushtet më të mira materiale, një pamje më gazmore e më të gjallë.

Unë pashë njëkohësisht se si nënat fshatare kosovare, atë ditë që i thamë armikut: Shporru nga Kosova!, bënë çmosë që fëmijëve të mos u mbetej pa u festuar në ndonjë mënyrë a gëzim tjetër ajo fitore: ato gjenin ndonjë krodhë

bukë të tepërt, që në ato ditë ishte një dhuratë fort e madhe, dhe ua jepnin fëmijëve; ndërkohë që ju që drejtuat luftën në Koshare dhe forcat që ju komandonit ndodheshit akoma në Babinë e Papaj, pasi nuk ishit angazhuar akoma në luftë. Kur ju u angazhuat në luftimet e 09 prillit 1999, kjo popullsi kishte një javë që festonte fitoren e çlirimit, pasi ishin të sigurtë se për ushtrinë serbe në Kosovë e kishte marrë ferra uratën.

Sikundër shihet: Është trimëria e këtij populli që na bëri ne trima. Heronjtë njihen vetëm kur shpëtojnë popullin e vet nga vdekja e sigurtë dhe jo pas beteje. Ndërsa Ju që komanduat Luftën në Koshare, a mund të na thoni: kë shpëtuan ju?

Është ky popull hero, që e solli lirinë dhe jo disa komandantë. Qindra mijëra njerëz u thurrin lavdi shumë komandantëve të formacioneve të ndryshme në Kosovë; kurse vetë ky popull dhe ish-luftëtarët e Br.121 “Kumanova” dhe Br.138 “Agim Ramadani” nuk e dinë se kanë kryer ndonjë akt heroik: mgaqë ata mendojnë se kanë zbatuar thjesht detyrën e ushtarit të Atdheut. Është ky heroizëm masiv që më frymëzon të shkruaj këto pak rreshta, duke e ditur se kjo s’është asgjë në raport me sakrificat që ata kanë bërë.

Dhe këtë respekt më së shumti ma ka ngulitur në zemër një dialog shumë i shkurtër i një foshnje me nënën e saj, dialog që ma kapi veshi rastësishtë në mesnatën e 31 marsit e 01 prillit 1999, në fshatin Divjakë, mes tre shtëpive të *Nezir Selim Zogaj*, ku qe vendosur selia e Shtabit të Përgjithshëm, në kohën kur po shkoja në godinën ku ishte sistemuar Drejtoria Operative, ku më prisnin shokët të diskutonim për mënyrën se si do të shpërthehej atë natë

rrethimi. Kishte aq shumë popull të grumbulluar e ulur mes borës e nën shi, të mbuluar me plastmase a batanie, ku “nuk kishte vend ku të hidhje mollën”. Dëgjoheshin veç krisma të largëta mitralozësh dhe artilerie. Duke ecur me vështirësi përmes kësaj mase gjigande njerëzish të të gjitha moshave dhe, në moment që dëgjova zërin e asaj foshnje që pyeste mëmëm a gjyshen e saj, (që ishin sistemuar nën një plastmas të madh, nën të cilin kishte shumë gra e fëmijë të tjerë), mbajta këmbët në dëgjova zërin e asaj foshnje:

- Serbët, nënë, si janë?

Dhe unë tërë kureshtja qëndrova në vend dhe bëja sikur kërkjoja diçka nëpër xhepa, për të dëgjuar se si do t’i përgjigjej mëma apo gjyshja asaj foshnje. Dhe më befaso i ajo përgjigje profetike e asaj femre që foli:

- E, si të ta thotë nëna, shpirti nënës . . . Serbët.., të keqen nëna.., vrasin e presin,.. por nga pushka e babit tënd një ditë do të vdesin!

Dhe, duke u larguar, m’u kujtua një thënie filozofike që s’di se kur e ku e pata lexuar dikur: “*Mendimi i një femre të padjallëzuar e me shpirt femëror; hera-herës është më i mënçur se mendimi i të urtëve.*” Dhe thashë me vete: “Luftën e kemi të fituar, se e kemi gjithë popullin me vete”. Dhe eca drejt godinës ku më prisnin shokët për të diskutuar vendimin që do të duhej të merrnim atë natë vendimtare, për të cilën kam kohë që punoj mbi një libër të posaçëm.

Dallimi mes luftës popullore dhe çdo lufte tjetër

Sikundër thashë pak më lartë, unë atje pashë luftën popullore. Por a e dini ju se çështë lufta popullore? Jam mëse i bindur se nuk e dini ngaqë nuk e keni jetuar. Më

del mua dhe kolegëve të mi për detyrë t'ua tregoj juve dhe gjithë asaj popullsisë një milionshe që u largua nga Kosova t'u tregoj se si e pashë unë luftën popullore. Lufta 8,5 mujore e Br.121 “Kumanova” ishte luftë për popullin dhe jo thjeshtë për UÇK-në, prandaj e quaj luftë popullore. Edhe lufta që bëri Br.121 “Kumanova” ishte ndryshe nga lufta që bënte Br.138 “Agim Ramadani”, sepse ishte në radhë të parë luftë për popullin; sepse qëllimet e asaj lufte qenë qëllimet e popullit – ishte në radhë të parë luftë për jetën e asaj popullsie dhe pastaj për jetën e luftëtarëve të Br.121; ishte luftë për një qëndrim unik i gjithë popullsisë së asaj malësie; ishte luftë për lumturinë e asaj popullsie pa e ndarë njëkohësisht edhe për lumturinë e vet atij formacioni luftarak; ishte luftë e mbështetur tërësisht në forcat e vet asaj popullsie, pa mbajtur shumë shpresa në ndihmën e formacioneve të tjera.

Kur them se në malësinë e Berishës u zhvillua luftë popullore duhet kuptuar luftë e zhvilluar nga i gjithë populli i asaj zone të banuar, me të cilën dua të tregoj se në të mori pjesë i gjithë populli i thjeshtë, morën pjesë të gjitha moshat dhe gjinitë e asaj popullsie të atij rajoni dhe jo vetëm forcat e Br.121”Kumanova” e dalë nga popullsia e atij rajoni; ishte luftë popullore pasi ishte ai popull që mposhti në fushën e luftës më të madhin, më të fuqishmin që donte ta pushtonte e ta digjte; ishte luftë popullore pasi nuk e humbi në asnjë rast epërsinë taktike që konsistonte në mbajtjen e inisiativës së përhershme atje dhe atëherë kur armiku nuk e priste, i cili është problemi më i ndërlikuar i çdo lloj lufte.

Luftën që bëri Br.121, ndryshe nga ajo e Br.138, e quajmë luftë prej popullit për popullin, pasi në qendër të saj ishte faktori human, jetët njerëzore të një pjese të

popullit në Kosovë dhe jo luftë për territore dhe pasuri materiale, e cila është rezultati përfundimtar i çdo lloj lufte tjetër, dhe as luftë që të shtrihej edhe në sferën e çlirimt shoqëror. Ndërsa lufta që bëri formacioni që ju komanduat në Koshare ishte luftë për territor dhe për ruajtjen e vetë jetës së atij formacioni luftarak, ishte pra një lloj lufte e zakonshme, por jo luftë e gërshetuar me elementë të luftës popullore. Duhet të bëjmë dallimin midis luftës popullore që u zhvillua në malet e Berishës dhe luftës frontale që u zhvilluan në Frontin e Koshares.

Me këto çfarë shpjegova nuk dua të them se koncepti i luftës popullore dhe i luftës guerile çlirimtare janë tërësisht të ndarë, por dua të veçoj dallime mes tyre. Në rastin e luftës së zhvilluar nga Br.121, ajo ishte luftë popullore, ndërsa lufta guerile çlirimtare që u zhvillua nga të gjithë formacionet e tjera të UÇK-së është një aspekt i luftës popullore, por jo tërësisht luftë popullore. Sikundër shihet, lufta popullore është goxha e koklavitur.

Por pse lufta popullore është luftë goxha e koklavitur? Sepse lufta popullore është një luftë në radhë të parë për jetën e vetë atij populli pastaj edhe për ato elementë që kërkon si lufta guerile edhe ajo frontale, të cilat janë thjeshtë një lloj i veçantë lufte që bëhet në radhë të parë për çlirimin (mbrojtjen) e pavarësisë, për independence ose integritetin e atij vendi. Si e tillë, lufta popullore është një koncept shumë më i përgjithshëm se çdo lloj lufte tjetër, është një luftë përmbledhëse, një bashkim i shumë elementëve të të gjithë llojeve të luftrave të tjera. Ndryshe nga lufta popullore, çdo lloj lufte tjetër është njëherazi luftë ushtarake, ekonomike dhe politike, është një kompleks. Si rrjedhojë, lufta popullore është luftë humane ku përzihen njëkohësisht të

gjithë elementët e luftës së shkallës taktike të thjeshtë në shkallë shumë të gjerë, një përleshje formacionesh nga më të ndryshmet.

......*

Dhe, në mbyllje të kësaj analize krahasuese midis dy brigadave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe luftës së zhvilluar prej tyre, nuk e tepëroj aspak ta ritheksoj për çdo shqiptar në Kosovë e jashtë saj, se sikur armiku gjatë operacionit “Patkoi” do të kishte mundur të pushtonte këtë hapësirë malore të Kosovës, malet e Berishës, të cilën e mbronte Br.121 “Ismmet Jashari-Kumanova”, në fund të marsit 1999 jo vetëm që UÇK-së do t’i thyhej shtylla kurizore e saj, gjë që armiku do t’i kishte krahët e lirë për ta shtyrë zonën e Dukagjinit, të Pashtrikut dhe të Nerodimës drejt Shqipërisë, por do t’i krijonte Millosheviçi edhe mundësinë për ta pastruar përfundimisht pjesën jugore të Kosovës, më e populluara, duke e vënë botën para faktit të kryer: “Nuk është e vërtetë se shqiptarët janë shumicë në Kosovë.”

E tillë është vepra e kësaj brigade heroinë, pjesë e Zonës së Dytë Operative, drejtuar nga dëshmorët Ekrem Rexha dhe më vonë nga Tahir Sinani si dhe e gjithë brigadave të tjera të UÇK-së. Kush nuk e di, le ta mësojë e të mos ulërasë nga smira e xhelozia.

Kur më pyesin çfarë ju ka mbetur në mendje më shumë nga lufta në Kosovë, unë gjithmonë u përgjigjem: Lufta në rrethim e Br.121 “Kumanova”. Lufta nëntë mujore e Br.121”Kumanova” besoj se do të jetë një shkollë e madhe për ushtrinë e Kosovës për të përvehtësuar mjeshtërinë ushtarake të trupave në rrethim.

Fakti që pas gati nëntë muaj luftime pothuajse të

pandërprera, në kushtet më të disfavorshme që mund të përfytyrohen, forcat e kësaj brigade mundën t'i qëndronin një kundërshtari shumë më të fuqishëm e më të madh në numër, është diçka që e nderon pa masë trimërinë dhe qëndresën e tyre dhe të popullsinë e atyre fshatrave. Si e tillë, kjo brigadë dhe kjo popullsi e kanë mbuluar veten me një lavdi të merituar.

➤ Me këtë rast dua t'i drejtohem, së pari, Kryeministrit Ramush Haradinaj: Janë këto nëna dhe gra fshatare që duhen shpërblyer me pensione të përjetshme me 1000 Euro në muaj, dhe jo ato gra që kanë bredhur me burrat e tyre nëpër Evropë kur këto nëna e gra luftonin dhëmbë për dhëmbë me vdekjen bashkë me fëmijët e tyre që çliruan Kosovën.

➤ Së dyti, e kam me Presidentin Thaçi, i cili me mosvlerësimin dhe mosdekorimin e kësaj brigade heroinë ka bërë vetvrasje. Ai do t'i bënte nder vetes nëse u kërkon ndjesë dhe u bie në gjunjë efektivave të Brigadës 121 "Ismet Jashari-Kumanova" dhe nënave të atyre 37 fshatrave që nuk i ka përmendur e dekoruar një për një ata dhe atë brigadë; duke i kujtuar se janë këta luftëtarë e ky popull që shpëtuan edhe jetën e vetë Thaçit.

➤ Së fundi, u bëj një kërkesë skulptorëve dhe piktorëve prej Kosove, jashtë e brenda saj, të përjetësojnë me një monument madhështor Nënën Fshatare Kosovare duke transportuar e mjekuar luftëtarë, duke furnizuar me ushqim e municione luftëtarët nëpër pozicione. Janë ato nëna që e mbajtën në këmbë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, të cilën e shpreh populli përmes këngë, në mënyrën më të bukur figurative:

"Ç'kanë hequr ato Nëna!

*Si balta kur e shkel këmba.
Por nga balta del floriri.
Hej, ç'trimëri u rriti gjiri!
Zemërhekurat me plumba,
ngarkuar si mal me borë,
lindën heronj e dëshmorë.”*

Të gjitha këto ua reshtova juve, që kërkonit të delni mbi gjithë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për t’u thënë se në Kosovë nuk do të ketë luftra të tjera përveç atyre njëri kundër tjetrit, sikundër po ndodh këta 20 vjet të pasluftës, dhe kjo është njëlloj si të vrasësh nënën tënde.

Shënim: *Një pjesë e të dhënave janë marrë prej fotoalbumit “Popull dhe ushtarë të pandarë”, me autor Naim Bujupi, ish-shef për Marrëdhënie Ushtarako-Civile në Brigadën 121 “Ismet Jashari - Kumanova”, Prishtinë, 2018*

Gazeta “Dita”, 9 dhe 10 maj 2019

KREU I DHJETË

FAKTET E DËSHTIMIT NUK PUSHOJNË SË EKZISTUARI, POR INJOROHEN

Në serinë e shkrimeve, për të ashtuquajturën “Beteja e Koshares”, midis të tjerave kam theksuar, se tre janë çështjet që zotërinjtë drejtues të njësisë taktike GO-3 u largohen si djalli nga thimjani: Detyra e dhënë për GO-3 nga SHP i UÇK-së; Vendimi luftarak i Komandantit të GO-3, dhe mënyra e zhvillimit të veprimeve luftarake sipas atij vendimi.

Përsa i përket Detyrës së dhënë nga SHP i UÇK-së e kemi sqaruar dhe dokumentuar në serinë e 6-të të këtyre shkrimeve, e cila ka qenë: **Hapja e korridorit të furnizimit në drejtimin më të shkurtër: Koshare - lumi Erenik**, për ardhjen nga Shqipëria të furnizimeve me armatim, municion, ushqime dhe materiale të tjera për luftën dhe popullsinë brenda në Kosovë.

Pasi bëmë edhe krahasimin midis Br.138 (GO-3) me Br.121 të UÇK-së, lidhur me detyrat e vëna atyre prej SHP dhe mënyrën e zbatimit të atyre detyrave po prej tyre, në këtë shkrim do trajtojmë se cili ka qenë vendimi i marrë nga komandanti i GO-3 (Br.138), z.Rrustem Berisha,

për zbatimin e detyrës së dhënë nga SHP, dhe shkaqet e dështimit.

Deri tashti, si nga intervistat e dhëna nga drejtuesit kryesorë të GO-3 (Br.138), si dhe nga shumë kuadro të kësaj njësie taktike, ashtu edhe nga reagimet e disa prej këtyre kuadrove përmes shkrimeve ose komenteve në fejsbuk, si dhe në ato çka na pasqyron gazeatri M. Çetta te libri i tij me tre vëllime “*Me UÇK-në në Koshare*”, nuk na jepet në asnjë lloj mënyre vendimi i marrë prej komandantit dhe shtabit të GO-3 (Br.138) dhe se si u zhvillua ai. Por, në intervistat e dhëna dhe në reagimet e ndryshme prej tyre, na thonë: “*Shihni dokumentat dhe hartën që pasqyrojnë vendimin*”. Dhe, në të kundërt, nuk na japin asnjë dokument dhe asnjë lloj harte ku të pasqyrohet me shkrim ose grafikisht vendimi i kësaj komande të GO-3 (Br.138”Agim Ramadani”) dhe realizimi i tij!

Po çfarë është Vendimi Luftarak?

Nëse i referohemi Artit Ushtarak të Luftës Popullore të Republikës së Shqipërisë, për të sqaruar se çfarë është Vendimi Luftarak, mësojmë: “*Organizimi i operacionit (luftimit) përbën detyrën e parë kryesore të komandave e të shtabeve dhe përfshin marrjen e vendimit dhe organizimin e zbatimit të tij. Marrja e vendimit është veprim me përgjegjësi të madhe në organizimin e operacionit (luftimit), sepse ka të bëjë me jetën e njerëzve, me suksesin e operacionit (luftimit) dhe ndikon drejtpërsëdrejt në zhvillimin e luftës në tërësi. Vendimi merret pasi vlerësohet me hollësi e me kujdes dhe peshohet mirë gjendja...Vendimi është diçka shkencërisht e përmbledhur, e koncentruar, që u kujton të gjithëve problemin që është studjuar, rëndësinë e tij, detyrat kryesore që duhen kryer si dhe kur do të zgjidhen, caqet që*

duhet të arrihen, si dhe disa nga masat më të rëndësishme që duhen marrë... Vendimi duhet të përmbajë: rajonet dhe objektet më të rëndësishme ku do të përqëndrohen forcat dhe mjetet kryesore në mbrojtje ose ku do të jepet goditja kryesore në mësymje; ndërtimin operativ; idenë e betejës vendimtare në operacion; detyrat luftarake të njërive e të reparteve dhe kohën e zbatimit të tyre; format e manovrës që duhen përdorur; mënyrën e bashkëveprimit për plotësimin e detyrës luftarake. Komanda, para se të marrë vendimin, këshillohet gjerësisht me shtabin dhe vartësit, ose me një pjesë të tyre.”¹⁾

Por mendoj të mos zgjatem shumë me doktrinën shqiptare, se mos na mërzitet Gjenerali Hysen Berisha, i cili, në reagimin e tij të datës 2 maj 2019, në përgjigje të pohimit tim, se: “Br.138 Agim Ramadani, nuk e realizoi detyrën e ngarkuar prej SHP të UÇK-së”, midis të tjerave më thotë: **“Kolonel Dilaver Goxhaj...po më kujton Gjeneralët famëkeq të shokut Tito, Aleksandër Rankoviqi, Ivan Millutinovic dhe Llolla Ribar, të cilët ju ende i mbani në listën e heronjve kombëtarë shqiptarë.”(!!!)** Me këtë shprehje, gjeneral Hyseni, keni bërë një dështim dhe jo një figurë të përkryer prej gjenerali. Unë të falënderoj për këtë “lëvdim” që na bën ne oficerave nga Shqipëria. Por nuk ta fal që nuk na e ke thënë më herët, o gjeneral?! Se po të na e kishe thënë, do të mbanim edhe ne gjatë luftës në vend të kapeles, “beretën blu”, dhe nuk do na qenë vrrarë as Indrit Cara dhe as Tahir Sinani. Mirë ne, se jemi nga Shqipëria, por si nuk gjete një “beretë blu” t’ia jepje autorit të atij plani luftarak në Koshare, që të mos e kishin shënjestruar snajperistët serbë; apo, je nis nga fakti, se edhe ai, si puna jonë, nuk kishte lindur në Gjakovë?

Në atë përgjigjen e datës 2 maj 2019, ti gjeneral Hyseni lëvdohesh se keni *“luftuar nën shembullin e Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti.”* Por, me sa shoh, ju, nuk e njihni historinë e Skënderbeut, se po ta njihnit, do të kishit vepruar edhe ju siç veproi gjenerali i Skënderbeut, Moisi Golemi. A e di ti, gjeneral Hyseni, se edhe Moisi Golemi dezertoi, si puna juaj në 1998, por pastaj u pendua dhe u kthye? Dhe luftoi siç luftojnë trimat, i cili *“edhe i vdekur, i tmerroi armiqtë me sy”*, thotë historia. Ndërsa ju, me t’u vrrarë Agim Ramadani, u strukët në transhe dhe nuk dolët prej saj derisa erdhën forcat e NATO-s, më 19 qershor 1999. Kështu sikur na the në atë intervistën e datës 16 prill 2019. Me sa kuptojmë, nuk ishit bindur akoma që forcat serbe ishin larguar nga Kosharja.

Dhe tashti, le të kthehemi tek vendimi luftarak.

Ti, Gjeneral Hyseni, në reagimin datës 2 maj 2019 sqaron se, ti dhe shokët e tu, e keni përgatitur planin e lufimit në Koshare mbështetur *“në formimin dhe përgatitjen në bazë të doktrinave moderne të NATO-s.”* Atëherë, që të mos infektoheni nga Doktrina Shqiptare, po i referohemi Doktrinës së NATO-s, për të sqaruar se ç’është vendimi luftarak, mbase nuk ngjason me doktrinën shqiptare, që të mos mërziteni.

Dhe ja konkretisht si e formulon doktrina e NATO-s: *“Themelore në procesin e vendimmarrjes është vlerësimi që i është bërë situatës, misionit (detyrës) dhe gjithë informacionit në dispozicion.... Vendimi për përcaktimin e përpjekjes kryesore do të varet nga misioni (detyra) e dhënë, nga liria e veprimit që i jepet komandantit, fuqia luftarake përkatëse dhe informacioni në dispozicion... Vendimi i komandantit duhet të mishëroi vullnetin e tij për*

të siguruar udhëheqjen e operacionit... Planet dhe urdhërat operacionalë janë shprehje e vendimit dhe konceptit të komandantit. Ato duhet të jenë të thjeshtë, të qartë dhe sa më konçizë. Planet për operacionet zakonisht përgatiten me shkrim. Edhe urdhërat kur është e nevojshme përgatiten me shkrim.”²⁾

Sikundër shihet, edhe nga komandantët e NATO-s vendimi luftarak “varet nga detyra e dhënë dhe duhet të mishëroi vullnetin e komandantit” dhe, si vendimi edhe urdhërat luftarakë “është e nevojshme të përgatiten me shkrim”, njësoj siç thotë doktrina shqiptare. Besoj se nuk do mërzhiteni për këtë. Dhe ju na thatë se kishit kohë në dispozicion, kishit 40 ditë që e vëzhgonit armikun. Atëhere, ku i keni, zotërinj oficerë profesionistë të GO-3(Br.138), këto dokumeta luftarake që duhet të përgatiten me shkrim? A na i keni rekomanduar shpesh herë që t’i shohim? Pse nuk na i paraqesni?

Përgjigjia e këtyre pyetjeve është e qartë: Këto dokumenta nuk do të tregohen kurrë nga ju, pasi hartuesi i atij plani nuk besoj se do të ketë shkruar, se gjoja detyra e dhënë njësisë GO-3 nga SHP i UÇK-së, do të ketë qenë “*heqja me luftë e kufirit*”, (sikundër na u tha në atë simpoziumin e datës 9 prill 2000, në Gjakovë), por hapja e korridorit të furnizimit.

Në atë simpozium na është bërë me dije edhe se kush e ka hartuar planin e mësymjes për njësinë GO-3. Atëhere na lejoni ta sqarojmë, se kush e merr vendimin luftarak: komandanti apo shtabi njësisë?

Ja se çfarë na thotë Doktrina e NATO-s: “*Me të marrë dhe analizuar detyrën, komandanti duhet të bëjë një vlerësim të plotë të saj... Pasi komandanti prononcohet për qëllimin*

(idenë) e tij dhe shpalos konceptin e tij të operacionit (luftimit) në formën e një vendimi, shtabi i tij fillon menjëherë punën për përpilimin e një versioni përfundimtar të planit me detajet e nevojshme. Nga ky plan përpilohet gjithashtu edhe urdhëri i operacionit (luftimit)...”³⁾ “Nëse themi që marrja e vendimit është funksion I komandantit, do të thotë se përgjegjësia dhe kompetencat për të ushtruar këtë funksion janë vetëm të komandantit”⁴⁾.

Në rastin e njësisë taktike GO-3, e cila do të sulmonte në një territor të kontrolluar nga armiku, pa asnjë lidhje direkte me një forcë tjetër, vendimi duhej patjetër që të përcaktohej nga Komandanti.⁵⁾

Pra, e sqaruar, vendimi është detyrë parësore e komandantit të njësisë.

Po, vendimin luftarak, për kalimin në mësymje të njësisë taktike GO-3 (Br.138), kush e ka përpiluar e shpalosur? Përgjigjen na jep vetë komandanti i kësaj njësisje, z. Rrustem Berisha: “Shtabi i Grupit të Tretë Operativ, nën udhëheqjen e shefit të shtabit, Agim Ramadani, përpiloi planin operativ për heqjen me luftë të kufirit, të cilin e miratova unë, si komandant i këtij formacioni.”⁶⁾

Po të njëjtin pohim, z. Rrustem Berisha e ka theksuar edhe pas 14 vitesh, në intervistën e dhënë në datë 8.4.2014, te TVDukagjini: “Vendimin e miratova unë vet si komandant i atij operacioni. Ky plan, ishte një plan i përgatitur mirë, ku i kishte objektivat e qartë si në fazën afat shkurtër e afat gjatë. Planin e kanë përgatit njerëz profesionalë.”

E shoh të arsyeshme të theksoj, se Brigadës së Këmbisorisë (BrK) nuk i jepen detyra “afat shkurtër e afat gjatë”, pasi BrK kryen detyrë të shkallës taktike e jo operacion; detyra “afat shkurtër e afat gjatë” jepen në

operacione të shkallës operative, operatovo-strategjike dhe strategjike, e që janë masa të Komandës së Përgjithshme. BrK, sipas mundësive që ka, i caktohet brez mësymjeje me gjerësi 4-6 km, me detyrë të afërt rreth 5 km dhe detyrë e largët 10-15 km thellësi, në mënyrë që të realizohet në një kohë sa më të shkurtër, mundësishtë brenda ditës; (bazuar në normat e BrK së ushtrisë shqiptare; ndërsa BrK e ushtrisë jugosllave, gjerësinë e brezit mësymës e ka 8-10km, detyrën e afërt 6-8 km, të largtën 15-20 km).

Por, duke qenë se, njësia taktike GO-3(Br.138) vepronte në një territor të kontrolluar nga armiku dhe pa asnjë lidhje direkte me një forcë tjetër të UÇK-së, patjetër që këto detyra do të ishin më të kufizuara, si në madhësi e hapësirë edhe në kohë. Këtë duhet të ketë pas parasysh hartuesi i këtij plani, Agim Ramadani, prandaj dhe pat deklaruar se mbritja në Malishevë do të mund të arrihej për 10 ditë, të cilën na e konfirmon komandanti i një kompanie i Br.138, z.**Rahim Samiu-Zogu**, në intervistën e dhënë gazetarit Muhamet Çetta:

“E di se komandant Agim Ramadani ka punuar dy muaj rresht për këtë projekt aq të rëndësishëm për thyerjen e kufirit, sepse kjo ishte e vetmia shpresë, e vetmia rrugë që të nisej puna nga e mbara. Projekti i komandant Agim Ramadani ishte, pra, thyerja e kufirit shqiptaro-shqiptar dhe shkuarja në Rrafshuin e Dukagjinit dhe në pjesët e tjera të Kosovës. Ai bile na thoshte: Për 10 ditë do të futemi në Malishevë.”⁷⁾

Si është e mundur atëhere, që këta oficerë profesionitë “*të formuar dhe përgatitur në bazë të doktrinave moderne të NATO-s*”, mendojnë se marrja e vendimit luftarak nuk i përket aspak komandantit, por shefit të shtabit të njësisë?!

Shtabi i brigatës, i përbërë nga oficerë elitë të brigatës, nën drejtimin e shefit të shtabit, (i cili në rast nevoje ka të drejtë të japë urdhëra në emër të komandantit), ndihmojnë komandantin me këshillat e tyre. Ata duhet të jenë të pavarur dhe të vendosur në këshillat e tyre, duke i siguruar komandantit informacione dhe duke gjykuar faktet për përgatitjen e vendimit, dhe mbajnë përgjegjësi për këshillën që i japin komandantit. Megjithatë, vetëm komandanti ka të drejtë të marrë vendimin, i mbështetur në këto këshilla dhe propozime të shefave të armëve e të shërbimeve. Pastaj shefat e armëve e shërbimeve merren me kalimin e vendimit në urdhëra e në masa dhe kontrollojnë zbatimin e tyre. Me t'u marrë vendimi, oficerat e shtabit zbatojnë urdhërat e tij. Kurse shefi i shtabit, pas shpalljes së vendimit, thërret veç e veç ose së bashku të gjithë oficerat e shtabit, për të diskutuar probleme të veçanta, me qëllim që të kenë një bagazh unik mendimesh, për zbatimin e vendimit.

Kjo që ka ndodhur në njësinë taktike GO-3 është e pafalshme. Madje këtu duhet kërkuar shkakun e dështimit nga kjo njësi luftarake. Pse është e pafalshme? Përgjigjen e kësaj pyetjeje na e jep gjenerali anglez i Luftës II Botërore, Bernard Montgomeri, komandanti i betejës së El-Alamfit, në Afrikë, (23 tetor-4 nëntor 1942), dhe i fushatës në Sicili, (10 korrik-17 gusht 1943):

“Plani operacionit duhet të përgatitet gjithmonë nga komandanti dhe jo të ndikohet shumë e të veprojë me forcë sipas të dhënave të shefit të tij... Ai, njëkohësisht duhet të dijë e të llogarisë mirë, se çfarë është strategjikisht e përshtatshme për të, çfarë është taktikisht e mundshme për forcat që ka në dispozicion. Kështu, ai, patjetër që do të fitojë.”⁸⁾

Dhe më tej ai thekson:

“Një komandant duhet të jetë shumë i përpiktë në përgatitjen e planit të tij taktik, duhet të jetë shumë i vendosur në plotësimin dhe përmbushjen me sukses të detyrës që ka marrë përsipër për ta kryer.”⁹⁾

Si është vepruar prej komandës së GO-3 për përmbushjen e atij vendimi?

Duke mos vepruar sikundër e thekson gjeneral Montgomeri, prandaj komandat Rustemi gjithçka e pat lënë në duart e shefit të shtabit, Agim Ramadani; prandaj, me vrasjen e Agimit pas 48 orësh si ka filluar sulmin njësia GO-3, mësymja jonë ndaloi. Në këtë moment komandant Rustemit dhe gjithë shtabit të tij, u ka ikur nga duart inisiativa (nisma). Këtu fillon mosvijimi më tej i sulmit. Shkaku? Mos njohja me hollësi e planin të luftimit.

Duke mos e përpiluar vetë planin, nuk e njihnin atë, dhe nuk kish sesi të dallonin rastin për të kapur situatën. Përgjegjësia e komandantit është ta zgjidhi ndërlikimin dhe jo ta komplikoi atë. Komandantët që nuk janë në gjendje të zgjidhin ndërmjet alternativave, kujdesi kthehet në një alibi për mosveprim. Kjo ka bërë që të mos ishin në gjendje të ndryshonin vendimin kur e vërejtën se armiku e kishte parashikuar atë; duke mos e ditur se cilat objekte duhej të kapeshin në ato momente e të anashkalohej rezistenca e armikut, tanët kaluan në mbrojtje, duke e zgjeruar frontin e duke i shpërndarë forcat. Si rrjedhojë, e filluan mirë sulmin por nuk e vijuan atë, gjë që ka qenë për mangësi të komandantit dhe shtabit, e jo të luftëtarëve.

Këto janë arsytet pse komandantit dhe shtabit të Br.138 u ka ikur nisma nga duart; këto janë shkaqet pse armiku ka mundur t'u impononte vullnetin e vet, duke e përballuar më pas sulmin tonë. Ishte ky hutim i komandantit dhe shtabit që armikut iu dha mundësia të përballoi hovin e parë të sulmit tonë; prandaj tanët e patën të vështirë t'ia impononin vullnetin e tyre armikut; prandaj këta tanët e patën të vështirë më pas ta mposhtnin mbrojtjen e tij. Këtë gjë thotë edhe B. Montgomeri:

“Udhëheqja, e cila është paraqitur si jo e mirë dhe e papërshtatshme, gjithmonë mban me vete forcën e humbjes dhe të dështimit.”¹⁰⁾

Dhe kjo është mangësi e komandantit dhe shtabit të Br.138 dhe jo e luftëtarëve të saj. Kyçi i suksesit, si në nivel operativ dhe në nivel taktik, pavarësisht nga teatri i luftimeve apo lloj i konfliktit, është kapja e hershme e nismës dhe mbajtja e saj. Këto janë arsytet kryesore pse u kalua në mbrojtje pa u konsultuar dhe pa marrë miratim nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së; gjë që nuk qëndron ajo çka thotë komandanti i GO-3 në simpoziumin e Gjakovës, se “Si komandë e përbashkët e njësive konstituive të formacionit GO-3, dhe më vonë të brigadës 138 “Agim Ramadani”, patëm një mirëkuptim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm edhe me të gjitha instancat drejtuese të luftës.”¹¹⁾

Përgjegjësinë e dështimit të asaj mësymjeje në Koshare, duhet ta pranojë me ndershmëri ushtaraku, komandanti i Br.138, të cilën e thekson edhe shefi i Logjistikës së saj, z.Gani Gjukuraj, kur thotë: *“detyrë të caktuar nuk kanë pasur shumica prej nesh, apo urdhëresa për vendosje. Dhe, kjo është mungesë e Rrustem Berishës.”¹²⁾* Gjë të cilën e përforcon parimisht edhe B.Montgomeri, kur thotë: *“Çdo*

komandant, në çdo moment, sado pak të vështirë, duhet t'ia kaloi të gjitha informatat e tij oficerave dhe ushtarëve të njësisë.”¹³⁾

Dhe ngaqë komandanti dhe shtabi i njësisë taktike GO-3 dështuan në realizimin e detyrës së vënë nga SHP i UÇK-së, prandaj z.Rrustem Berisha, për t'iu larguar kësaj përgjegjësie të madhe, në simpoziumin shkencor të organizuar prej tij, në 9 prill 2000, justifikohet duke na lënë të kuptojmë, se gjoja sulmin në Koshare e kanë ndërmarrë në kokë të tyre, si formacion ushtarak i pavarur, gjë të cilën na e thekson gjeneral Hysen Berisha në intervistën dhe gazetës “Bota sot”, datë 4 maj 2019, kur thotë : *“Sali Çeku shtylla kurrizore e Ushtrisë së Kosovës dhe personaliteti rreth të cilit koordinohet çdo çështje që kishte të bëjë me institucionet relevante rreth organizimit ushtarak.”*

Dhe, si rrjedhojë, nuk ka pse t'i japin kujt llogari, ngaqë gjoja nuk kanë pas vartësi nga asnjë lloj komande, të cilën e thekson edhe gjeneral Rrustem Berisha:

“por vie nga vetë fakti që si ushtarakë të organizuar në formacione të rregullta ushtarake iu futëm luftës që në qershor të vitit '98...Edhe pse u nënshkrua, kjo marrëveshje edhe sot e kësaj dite dëshmon përmbajtjen imponuese të asaj, që, jo tërësisht, ishte në objektivat e UÇK-së”¹⁴⁾

Kjo është arsyeja pse ky komandant e mohon vartësinë nga SHP i UÇK-së dhe Zona III Operative, duke e pohuar pa ndrojtje: *“Vendimit (të tyre D.G), nuk i parapriu asnjë urdhër konkret nga cilado anë që thirrej në drejtimin e luftës.”¹⁵⁾*

Me këtë shprehje shpërfillen jo vetëm luftëtarët e Br.138, por edhe UÇK-ja. Dhe unë ankoem për faktin, i cili nuk duhet të më bënte njohës të këtij luftimi.

Vetëm kemi një lutje: Amani, mos urdhëroni ndonjë tip tjetër, si ai tek “Bota sot”, i datës 6 qershor 2019, se na ka mbyllur gojën me ato arsye që nuk kanë arsye.

12 qershor 2019

REFERENCAT:

- 1) Arti Ushtarak i Luftës Popullore, Tiranë, 1985, f.83-84;
- 2) Doktrina Taktike e Forcave Tokësore të NATO-s, ATP-35(B), Sh.B.Ushtarake, Tiranë, 1999, f.45,46,48,49;
- 3) Po aty, f.45, f.125; 4) Po aty, f.39;
- 5) Po aty, f.264;
- 6) Muhamet Çetta “Me UÇK-në në Koshare”, Prishtinë, 2002, v.2, f.261;
- 7) M. Çetta, v.2, f.221; 8) Bernard Montgomeri “Fushë beteja”, Sh.B.Ushtarake, Tiranë, 1994, f.71;
- 9) Po aty, f.73; 10) Po aty, f. 76;
- 11) M. Çetta, v.2, f.264;
- 12) M. Çetta, v.2, f. 80;
- 13) Bernard Montgomeri, f.73;
- 14) M. Çetta, v.2, f.162;
- 15) M. Çetta, v.2, f.261-262.

KREU I NJËMBËDHJETË

PËRFUNDIME

1. Lufta dymujore në Koshare dhe në mal të Pashtrikut thithi gjithë vullnetarët shqiptarë e të huaj të cilët ishin të gatshëm të falnin edhe gjënë më të shtrenjtë për lirinë e Kosovës, jetën e tyre. Kjo gjë vërtetoi se Lufta Çlirimtare e Kosovës ishte një luftë e drejtë dhe, si e tillë, prandaj edhe angazhoi Paktin Ushtarak më të fuqishëm botëror, Aleancën Veri Atlantike – NATO-n, prandaj dhe Serbia pësoi disfatë në këtë luftë.

2. Plani i organizimit të futjes në luftë e të gjithë vullnetarëve të ardhur nga tërë diaspora shqiptare dhe të grumbulluar në Shqipëri pasi ishte angazhuar NATO-ja në luftën tonë çlirimtare, duke sulmuar nga territori i Republikës së Shqipërisë për në thellësi të Kosovës dhe bashkimi i tyre me luftë me formacionet e tjera të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishte e vetmia mënyrë në ato momente që ato forca të mund të angazhoheshin në atë luftë çlirimtare.

3. Riangazhimi i kuadrove ushtarakë shqiptarë të shkolluar në akademitë ushtarake të ish-Jugosllavisë, që ishin larguar nga lufta në verën e vitit 1998, duke e justifikuar atë largim me nonsensin, se po të zhvillonin luftime brenda në Kosovë “*populli do të binte pre e luftimeve ofensive të ushtrisë serbe, por edhe terreni i papërshtatshëm dhe i minuar nga ushtria serbe*”, duket si një shlyerje faji para atdheut të tyre dhe vrasje ndërgjegjeje. Por, nuk është ashtu. Strategjia e tyre për çlirimin e Kosovës, duke sulmuar me emigrantët nga jashtë Kosove, nuk është thjeshtë ide vetëm e këtij grupi oficerësh, por ka qenë ide shumë më e hershme e Ministrisë së Mbrojtjes së Qeverisë Bukoshi. Për këtë flet qartë ish-shëfi Operativ e më pas shëf i Shtabit të GO-3, z. Anton Çuni, në intervistën e datës 02 Maj 2019, dhënë TV Dukagjinit, të cilin e cituam më herët³⁵⁾.

4. Strategjia e këtyre kuadrove ushtarakë, për çlirimin e Kosovës “*me një luftë nga kufiri e deri në çlirim*”, u vërtetua se është një strategji sa e gabuar aq edhe disfatiste. Kjo strategji len të kuptohet, se në çdo rast që Kosova mund të pushtohet, e vetmia mënyrë për ta çliruar atë është dalja jashtë Kosove e pjesës më aktive të popullsisë, organizimi i saj jashtë territorit të Kosovës dhe ta çlirojnë atë “*me një luftë nga kufiri*”. Kjo “strategji” u vërtetua se është sa utopike aq edhe aventurë tepër e rrezikshme, e cila nxit mosreagimin e popullit ndaj çdo pushtuesi, me justifikimin se “*populli bie pre e luftimeve ofensive të ushtrisë pushtuese, por edhe terreni do të jetë i papërshtatshëm dhe i minuar nga pushtuesi*”.

35) *Shih shitesën nr.16.*

Pak a shumë, pré e këtij disfatizmi ra edhe udhëheqja politike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në verën e vitit 1998³⁶⁾).

5. Nuk qëndron dhe nuk duhet pranuar ideja e hedhur nga ish-komandanti i forcave që sulmuan në Koshare (GO-3) se Lufta në Koshare “*do të mbetet ngritja, organizimi dhe strukturimi i mirëfilltë me një udhëheqje profesionale të aftësuar për të zhvilluar luftën dhe për të ndërtuar paqen në ardhmëri.*”³⁷⁾) Po të pranohet kjo lloj strategjie në doktrinën ushtarake të Kosovës do të thotë që të pranohet, se e vetmia rrugë çlirimtare të jetë: **Në rast se Kosova pushtohet, moshat e afta për luftë të dalin jashtë territorit të saj dhe të sulmojnë nga jashtë-brenda(!)**, sikundër u veprua nga GO-. Por kjo lloj “strategjie” e propozuar dhe e praktikuar nga kuadri drejtues i GO-3, nuk e justifikoi veten, edhe pse nuk u munguan rezervat njerëzore e materiale për të siguruar vijimësinë e atij operacioni në Koshare si dhe në mal të Pashtrikut.

6. Sikundër tregoi rrjedha e luftimeve dymujore në Koshare, komanda e GO-3 i mbivlerësoi aftësitë luftarake të veta dhe të efektivave që komandoi, pavarësisht se luftëtarëve të GO-3 nuk u mungoi vendosmëria dhe shpirti sulmues. E dimë tashmë se mësymja e forcave tona u ndal plotësisht nga forcat kufitare serbe pas një luftimi 60-64 orësh, si rrjedhojë e paaftësisë së kuadrit komandues të GO-3.

Si rrjedhojë, komanda dhe shtabi i kësaj njësie taktike të ushtrisë sonë, ra në krizë të rëndë profesionale, të cilës

36) *Shih J.Krasniqi “Kthesa e madhe”, Prishtinë, 2006, f.81-82*

37) M. Çetta “Me UÇK-në në Koshare”, v.2, f.262-264

nuk i shpëtoi gjatë gjithë periudhës tjetër, deri në fund të luftës. Kjo vërtetoi tezën, se kur ke bërë një herë një gabim në strategji, rrallëherë mund t'u shpëtosh pasojave të tij. Pikërisht Lufta në Koshare tregoi se kuadrot ushtarake, që dezertuan nga lufta në verën e vitit 1998, nuk i shpëtuan dot pasojave të atij gabimi të rëndë, prandaj dhe pësuan disfatë. Kështu, GO-3, nga një njësi taktike luftarake që mori nismën duke kaluar e para në sulm, u detyrua të kalonte në mbrojtje, duke njohur humbjen.

Ishte mungesa e shpirtit të mësymjes te komandantët e këtij formacioni, duke e përqendruar vëmendjen në kërkimin e sigurisë nga sulmi i forcave serbe, prandaj nuk mundën të zbatonin detyrën për hapjen e korridorit ë furnizimit.

7. Veçoria kryesore e luftimeve në Koshare ishte se ato u zhvilluan me baraspeshim forcash në shkallë taktike, si në këmbësori ashtu dhe në artileri. Kalimet e shpeshta të forcave serbe në sulm e kundërsulme, edhe pse me raport forcash të barabarta në shkallë taktike, u realizuan për faktin se komanda e GO-3 u tregua e ngathët dhe e paaftë të shfrytëzonte situatat që u krijuan dy ditët e para të sulmit. Në vend që të avanconin përpara në ndjekje të shpejtë të armikut, ato arsyetonin qëndresën e mbrojtjes serbe. Kjo është një nga arsyet që forcat serbe mundën të merrnin në dorë iniciativën.

8. Bazuar në shpjegimet e dhëna prej kuadrit komandues të GO-3, dhënë gjatë intervistave, një nga arsyet e tjera pse sulmi ynë u ndërpre, qysh ditën e dytë të tij, ishte se nuk kishin parashikuar krahëmarrje dhe shpinëmarrje të

armikut që të mund ta rrethonin e ta asgjësonin atë qysh në ditën e parë të sulmit.

9. Është e vërtetë që forcat e GO-3 praktikuan gjerësisht futjen e grupeve të vegjël të zbulimit në prapavijë të armikut, por vetëm për vëzhgim, pa i sulmuar forcat serbe nga shpina e që këto sulme të shndërroheshin në metodë të përgjithshme luftimi, prandaj dhe lufta në Koshare morri karakter pozicional nga të dy palët.

10. Lufta në Koshare tregoi se, për të zhvilluar suksesin taktik në atë operativ, dhe që faktikisht ideja ishte për të arritur suksesin operativ, (hapja e korridorit të furnizimit), ishte e nevojshme të angazhoheshin qysh në momentin e parë të sulmit jo më pak se 1000 forca, të cilat ekzistonin faktikisht në Helshan (Krumë).

11. Një e metë tjetër që vërehet në Luftën e Koshares, është se rendimet e luftimit të forcave që sulmuan ditën e parë të asaj lufte ishin të paskalionuara dhe bashkëveprimi midis artilerisë dhe forcave sulmuese ka qenë i dobët.

12. Përvoja e luftërave na mëson: kur kundërshtari e organizon mbrojtjen në një terren të vrojtuar mirë, ku i mungojnë mbulimet natyrore nga zjarri i sulmuesit, sikundër ishte mbrojtja serbe në Koshare, atëherë një mbrojtje e tillë është lehtë të thyhet me zjarrin e artilerisë dhe të mortajave dhe mësymja do të kryhet patjetër. Por, bazuar në literaturën e botuar deri sot për Luftën në Koshare, na rezulton se artileria e shumtë e GO-3 është përdorur e shpërqendruar, duke i dhënë rëndësi përdorimit të saj me toga, e në raste të

veçanta edhe vetëm me një grykë zjarri. Por dihet se vetëm zjarri i përqendruar i artilerisë mund ta shpërtheu mbrojtjen e fortë të kundërshtarit. Kjo sidomos duhej të qe përdorur në etapën e parë të sulmit, kur mbrojtja serbe nuk kishte qëndrueshmërinë që pati më pas.

13. Sigurimi materialo-teknik për GO-3 nuk ka pasur vështirësi të mëdha edhe pse terreni ishte i vështirë malor, me mungesë rrugësh për mjete të motorizuara, dimri i ashpër, me borë, me ngrica, me tufan etj.

14. Morali, besimi në fitore dhe këmbëngulja e luftëtarëve tanë, për të vijuar me çdo kusht mësymjen, rezultoi se kanë qëndruar shumë më lartë se ai i kuadrit të tyre udhëheqës.

15. Ishte rendimi i gabuar luftarak dhe mungesa e iniciativës nga kuadri komandues i njësisë GO-3, që solli humbje të ndjeshme njerëzore.

16. Midis të tjerave, zëdhënësi i atij kuadrit komandues të Luftës në Koshare, Gjeneral Hysen Berisha, kohët e fundit ka bërë të njohur publikisht skenarin e mirëlllogaritur të klanit të kuadrove “patriotë” kundër personit tim, ndoshta nga nervoza, duke thënë: *“Koloneli nga Shqipëria Dilaver Goxhaj nuk la ndonjë gjurmë për t’u theksuar në luftën për çlirimin e Kosovës edhe pse ishte në Shabin e Përgjithshëm*

të saj.”³⁸⁾)

Nuk do të më takonte mua t’i përgjigjesha kësaj paturpësie dhe mosmirënjohjeje, duke përfituar prej modestisë sime. Jo më kot filozofi Frederik Niçe ka thënë:

*“Cila gjë paguhet më rëndë? Modestia jote, mos vënia veshit nevojave të tua, e cila është mungesë respekti kundrejt vetes dhe që shpërblehet me humbjen e shëndetit dhe të miqve, me humbjen e mirëqenies, krenarisë, guximin dhe kthjelltësisë.”*³⁹⁾)

Nisur nga kjo, ndoshta nuk gaboj që, me këtë rast ta lë mënjanë edhe unë modestinë e tepruar. Por, para se t’i tregoj disa “gjurme” të mijat këtij gjeneralit të Koshares, më lejoni t’i kujtoj këtij dhe gjithë klanit të tyre “patriotë” e dy krahëve të asaj lufte, një postulat të shërbimeve të fshehta izraelite: *“Dështimet e operacioneve gjithnjë bëhen të njohura e i marrin vesh të gjithë, ndërsa për operacionet e suksesshëm nuk flitet kurrë, nuk i merr vesh askush dhe asnjëherë.”*

Kështu ka ndodhur, zoti gjeneral Berisha, edhe me klanin tuaj. Dështimin tuaj në Koshare e morën vesh të gjithë, i madh e i vogël, në Kosovë e jashtë saj, sepse, ashtu sikundër bëjnë dhe serbët, edhe ju e glorifikuat dështimin tuaj. Me këtë dua të them, se është e vërtetë që keni prodhuar histori, por nuk keni konsumuar asgjë prej saj. Përsa u përket sukseseve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

38) Gazeta “Bota Sot”, datë 4 maj 2019, intervistë e z.Hysen Berisha

39) https://en.wikipedia.org/wiki/Friedrich_Nietzsche

dhe të Shtabit të Përgjithshëm të saj, ku ka pjesën e vet jo të vogël edhe koloneli Dilaver Goxhaj nga Shqipëria, të cilat ju të klanit “patriotik” keni bërë të pamundurën që t’i fshini nga memoria e popullit, gjë që tregon cinizëm e pandershmëri të plotë. Kjo sjellje e juaj po më detyron së fundi të dal pak nga vetja, për t’u përmendur vetëm pak prej atyre “gjurmëve” që anë ndikuar në rrjedhën e mëtejshme të luftës, duke e lënë përkohësisht mënjanë modestinë e oficerit shqiptar:

- Ardhja vullnetarë në luftën për çlirimin e Kosovës, si e kolonelit Dilaver Goxhaj, që sipas jush “nuk ka lënë asnjë gjurmë”, ashtu edhe e kolegëve të tij prej Shqipërie, është bërë menjëherë pasi ju ishit larguar prej asaj lufte patriotike, por ndryshe nga ju, ne nuk e shkuam kurrë ndërmend dezertimin. Vetëm kjo do të mjaftonte për t’ua mbyllur gojën ti dhe gjithë kategorisë tuaj. Unë erdha tek ju, ashtu siç erdhi dikur në çetën partizane të Kurveleshit tim, Xheladin Beqiri nga Karadaku juaj.

- Është mirë ta dini, z.Gjeneral, se cili është roli i atij “kolonelit nga Shqipëria, që nuk ka lënë gjurmë”, për marrjen e vendimit të jashtëzakonshëm prej SHP, në 20 mars 1999, për kalimin e UÇK-së nga strategjia e pritjes dhe e thyerjes së sulmeve serbe, në strategjinë e tërthortë: luftë manovruese, me sulme, mbrojtje e kundërsulme, duke e koordinuar atë strategji me strategjinë e luftës së rregullt.

-Ishte ai koloneli që “nuk ka lënë gjurmë”, që mbajti bashkëveprimin midis UÇK-së dhe aviacionit të NATO-s, bashkëveprim për të cilin Komandanti i saj, gjenerali Uesli

Klark, në ditën e fundi të asaj lufte u shpreh: *“Bashkëveprimi më i mirë luftarak në historinë 50 vjeçare të NATO-s.”*⁴⁰⁾

- Bllokimi i Flotës Luftarake Detare Ruse në Dardanele, për të mos mundur të vinte në detin Adriatik për të penguar bombardimet e Flotës Detare Amerikane, mësoje se u realizua duke bashkëvepruar SHP i UÇK-së me Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Turke, duke komunikuar ai “koloneli që nuk ka lënë gjurmë” me atasheun ushtarak të Shqipërisë në Turqi, kolonelin Hajro Limaj;

- Interesohuni se cili ka qenë ndikimi i atij kolonelit në shpërthimin rrethimit të madh 12 ditor i SHP, i dy zonave operative dhe i 150 mijë qytetarëve, në natën e 31 marsit 1999; ndërkohë që shumë prej jush besonit se do të asgjësoheshim.

- Është ai koloneli që “nuk ka lënë gjurmë”, bashkë me Komandant Drinin, që ju e vratë pas lufte, të cilët hartuan planin e Operacionit “Shigjeta”, por që ju dhe shokë tuaj nuk ditët ta vinit në jetë ashtu siç duhej.

- Është ai kolonel që mbajti bashkëveprimin me Misionin Ushtarak Amerikan, bashkë me djalin e tij, i përzgjedhur nga SHP, mision, të cilin drejtuesit kryesorë të UÇK-së nuk e lejuan të ishte prezent në Shtabin tonë të Përgjithshëm, me justifikimin se aty kishim Misionin Ushtarak Francës!

- Bashkëveprimin me Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë së Shqipërisë për tërheqjen e të plagosurve tanë

40) Telegrami Falënderues i z.Uesli Klark, datë 12 qershor 1999

me helikopterë ushtarakë dhe çuarjen e tyre në Spitalin Ushtarak në Tiranë, e realizoi disa herë ai koloneli, që për ju nuk ka lënë gjurmë.

- z.Gjeneral Berisha, për të mos u lodhur më tej lidhur me “gjurmët “ e mia në SHP, të cilat po mundoheni nga dita në ditë për t’i fshirë ju, klani i përbashkët “patriotik” i të dy krahëve, (i cili u shfaq qartë në kohën e “demarkacionit” me Malin e Zi), mendoj ta mbyll me gjurmën e vendosjes prej meje të komunikimit të drejtpërdrejtë midis SHP të UÇK-së dhe Komandantit Suprem të NAO-s, Gjeneralin Uesli Klark, gjë që Ministria e juaj e Mbrojtjes nuk e ka ende këtë nivel të drejtpërdrejt komunikimi.

Fatmirësisht, ai dokumentacion ekziston në arkiv timin familjar, ngaqë e kërkoi Misioni Ushtarak Amerikan dhe u detyrova t’ia faksoja tim biri. Kjo është edhe arsyeja që këtë dokumentacion nuk keni mundur ta zhdukni, sikundër keni bërë me telegramin e falënderimit të Gjeneralit Klark.

Me këtë rast, po më detyroni ta bëj për herë të parë publike, se ai komunikim vijoi vetëm një javë, dhe u ndërpre me urdhër të z. Kadri Veseli dhe Agim Çeku, të cilët këto ditë u kanë propozuar juve për deputet të PDK në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të këtij viti. Pse-në e ndërprerjes së atij komunikimi të drejtpërdrejtë e kuptova pas disa ditësh, kur mbërriti në SHP grupi i oficerëve të shërbimeve të fshehta franceze me të cilët po këta autoritete më ndaluan të komunikoj; dhe, çuditërisht, grupi i oficerëve amerikanë nuk u lejua po nga këto autoritete të vinte në SHP!

gjurmë të kthjelloheshit për këto të vërteta, prandaj dhe nuk e kam parë të nevojshme të deklarojem për to.


Mirëpo koha tregoi se kjo modesti e imja është marrë prej jush si paaftësi e dobësi. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me institucionet shtetërore të Kosovës për luftën si dhe ato shoqërore të dala nga lufta, ta fshijnë gjithë veprimtarinë time në SHP si dhe atë të pasluftës, duke shkuar deri atje, sa të mos figuroj as edhe si veteran i thjeshtë i UÇK-së në listat e publikuara prej tyre! Dhe e gjithë kjo ligësi e juaj shpirtërore “patriotike” kam bindjen se rrjedh nga mungesa e aftësive tuaja njerëzore, profesionale si dhe ato intelektuale, të cilat tregojnë se jeni të ngarkuar me reminishencat e së kaluarës të bashkim-vëllazërimit jugosllav.

Besoj, z. gjeneral Berisha, se përmendja e këtyre pak gjurmëve të fshira prej jush, shpresoj se do ta ngacmojnë disi ndërgjegjen e klanit tuaj “patriotik”, për t’u çliruar sadopak nga barra e rëndë e mosmirënjohjes që keni aktualisht. *“Mosmirënjohja, - shkruan Sami Frashëri,- është ligësia më e madhe në botë. Shërbyesit e njerëzimit, kundrejt veprave të tyre të mira që kanë bërë, shpresojnë që të paktën të dëgjojnë një falënderim, të shohin pak nderim, por kundrejt tyre mbahet një qëndrim mospërfillës e haresë dhe shumë herë bëhen objekt mërie, armiqësie e përbuzjeje. Kjo gjendje i bën ata të pendohen pse janë njerëz.”⁴¹⁾*

Mjafton ta shohësh me vëmendje deklaratën tuaj: *“Koloneli nga Shqipëria Dilaver Goxhaj nuk la ndonjë gjurmë”*, për të kuptuar se ju e matni veprimtarinë e njerëzve me kutin tuaj. Vetëm me këtë shprehje kuptohet se ju nuk jeni angazhuar në Luftën për Çlirimin e Kosovës si obligim ndaj atdheut, por thjesht si rast veç për të bërë emër, “për të

41) Sami Frashëri, vepra, v.3, f.67, Prishtinë, “Rilindia”, 1978

lënë gjurmë”, prandaj dhe keni bërë sikur keni luftuar si në Dukagjin edhe në Koshare.



Me këtë rast, po ua rikujtoj edhe një herë juve dhe klanit tuaj “patriotik”, se unë u angazhova në Luftën për Çlirimin e Kosovës për disa arsye kryesore: së pari, dashuria ndaj kombit, të cilën ma kultivuan në shpirt ato shkollat ushtarake në Republikën e Shqipërisë, të cilat zotëria juaj i ka anatemuara në shkrimet e botuara. Janë ato shkolla që na kanë bindur ne

ushtarakëve shqiptarë se Kosova ka qenë është e do të jetë Shqipëri. Së dyti, erdha në UÇK për t'i kthyer borxhin birit të Kosovës, Xheladin Beqirit-Karadakut, i cili është Heroi i parë i Popullit Shqiptar shpallur nga Kuvendi Shqipërisë, në vitin 1946, dhe jo pa qëllim ua përmenda më lart. Së treti, erdha tek ju në Kosovë për të vënë në jetë gjithë njohuritë ushtarake që m'i mundësoi populli im gjatë gjithë karrierës sime ushtarake 35 vjeçare. Dhe, së katërti, erdha në atë luftë çlirimtare pasi më obligonte edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në Nenin 8 të saj thekson: “Republika e Shqipërisë mbron të drejtat kombëtare të popullit shqiptar jashtë kufijve të saj.”

Kështu që, s'më mbetet gjë tjetër, zoti gjeneral, veçse t'i them gjithë kategorisë suaj: Fali o Zot, se nuk dinë çfarë bëjnë!

17. Strategjia e propozuar nga ish-Komandanti i GO-3, bazuar në përvojën e Luftës në Koshare, për çlirimin e Kosovës me sulm nga jashtë me anë të emigrantëve, në rast ripushtimi, është një strategji e dështuar e provuar dy herë.

Rasti i parë ka ndodhur në vitin 1961 në Kubë.

Fidel Kastro kishte pak kohë që kishte mposhtur regjimin e urryer të Batistës përmes kryengritjes popullore. Mërgimtarët kubanë në SHBA ishin kundër Kastros dhe, me mbështetjen e ish-qeverisë dhe të presidentit të Kubës në ekzil, formuan një “ushtri çlirimtare” – nën drejtimin e CIA-s – në disa baza të fshehta në Guatemalë. Patën edhe 16 avionë të vjetër B-26, të gatshëm të ngriheshin nga Nikaragua për të desantuar nga ajri 1400 emigrantë kubanë në ishull. Plani i operacionit i projektuar nga CIA ishte përgatitur me detaje dhe presidenti SHBA, Kennedy, i inkurajoi, nuk i ndërpreu. Plani bazohej i gjithi në sulmin e rreth 20 mijë mërgimtarëve kubanë, të cilët shpësonin se do të ndihmoheshin nga një

ushtri e rregullt prej 20 mijë vetësh brenda në Kubë. Në 14 prill 1961 emigrantët kubanë u nisën fshehtas me anije dhe në 17 prill zbarkuan në Gjirin e Derrave duke zënë kryeurë në një zonë të papopulluar, (ngjashëm si GO-3 ynë). Mërgimtarët që zbarkuan nuk qenë ushtarë ekspertë. Ushtria e Kastros pa humbur kohë i kundërsulmoi menjëherë dhe pas 64 orësh sulmuesit u dorëzuan dhe u burgosën në Havanë. Misioni i çlirimit nga jashtë Kube dështoi. Kastro forcoi pushtetin e tij, duke u bërë që atëherë lider absolut.

Rasti i dytë. Me sa duket, z.Rrustem Berisha dhe kolegët e tij e kanë studiuar hollësisht këtë lloj strategjie të emigrantëve kubanë dhe kanë dashë ta eksperimentojnë, ndoshta për të justifikuar dështimin dhe dezertimin që patën në verën e vitit 1998 brenda Kosovës, duke e ditur që kishin një favor krejt të ndryshëm nga ai në Kubë: në Kosovë po zhvillohej luftë çlirimtare nga një ushtri guerile 20 mijëshe, e mbështetur edhe nga aviacioni i NATO-s. E kemi këtë bindje pasi ngjashmëria midis sulmit në Gjirin e Derrave dhe sulmit në Koshare është shumë e përafërt:

i- Edhe ushtria zbarkuese kubane, edhe ushtria sulmuese GO-3 e jona, nuk u penguin, por u ndihmuan nga presidentët dhe qeveritë e tyre në ekzil;

ii- Stërviçja e mërgimtarëve kubanë u bë në disa baza jashtë Kubës, në Guatemalë; edhe ushtria e GO-3 tonë u bë jashtë Kosove, në disa baza, në Shqipëri;

iii- Plani i operacionit nga mërgimtarët kubanë ishte përgatit në detaje, po ashtu edhe plani i GO-3, por tanët me forcat e veta;

iv- Plani i sulmuesve kubanë bazohej në sulmin e 20 mijë emigrantëve; plani i GO-3 u bazua në sulmin e 2.000 emigrantve;

v- Mërgimtarët kubanë i mbështeti SHBA; edhe tanët gjatë luftës u përkrahën dhe u mbështetën nga SHBA;

vi- Sulmuesit mërgimtarë kubanë i kishin shpresat te ushtria 20 mijëshe që do të ngrihej menjëherë porsa këta të zbarkonin, pavarësisht se Fidel Kastro i kishte paraprirë mosngritjes së saj; edhe GO-3 ynë i kishte shpresat te ekzistenca e UÇK-së 20 mijëshe, e cila kishte gati dy vjet që po luftonte e organizuar kundër pushtuesve serbë; por “çlirimtarët” tanë nga jashtë-brenda nuk mundën të çanin as mbrojtjen e një batalioni kufitar serb, e jo më të çlironin Kosovën, sikundër pretendonin; dhe kjo për shkaqet që shpjegohen në faqet e këtij libri;

vii- Në 17 prill 1961 sulmuesit kubanë në befasi relative, duke “*thyer kufirin bregdetar*” të Kubës arritën të kapnin kryeurë me përmasa 15 x 6 km, por brenda një luftime 64 orëshe të rrethuar, u kapën rob nga forcat e Fidel Kastros, ngaqë nuk kishin ku të tërhiqeshin; edhe forcat tona të GO-3 sulmuan në 9 prill 1999, në befasi relative, duke “*thyer kufirin shqiptaro-shqiptar*” dhe pas 60-64 orësh luftë sulmuese dështuan në qëllimin e tyre dhe, duke mos pasur në shpinë det por Shqipërinë mëmë, nuk u rrethuan e nuk u kapën rob nga forcat serbe, prandaj dhe u organizuan në mbrojtje, duke kapur një brez kufitar (“kryeurë”) të papopulluar, duke luftuar në mbrojtje kryesisht pasive 65 ditë rresht;

viii- Sulmuesit emigrantë kubanë nuk ishin ushtarë ekspertë, po ashtu edhe sulmuesit tanë të GO 3-it;

ix- Fidel Kastro, përmes asaj fitoreje forcoi pushtetin e vet jetëgjatë deri edhe sot që po e citojmë atë luftë; edhe Serbia përmes asaj pengese që i bënë furnizimit të UÇK-së nga Shqipëria, e konsideron Luftën në Koshare fitoren më

të madhe të luftës së saj më UÇK-në dhe, duke e shfrytëzuar këtë fitore justifikoi para popullit të vet shkëputjen e Kosovës. Si rrjedhojë, presidenti serb Vuçiç prandaj atë fitore e quan “Beteja e Dytë e Kosovës” dhe “Termopilet serbe”;

x- Në të dy rastet, si në Gjirin e Derrave edhe në Koshare, rezultoi se një luftë e tillë nuk e siguron kurrë befasinë e plotë të sulmit, sado konspirative të jetë përgatitja e kësaj lloji “strategjie çlirimtare” të vendit nga jashtë-brenda, veçanërisht sot në kohën e internetit.

Tipari kryesor dallues mes dy praktikave të kësaj “strategjie”, për çlirimin e vendit nga mërgimtarët apo prej atyre që i ka nxjerrë pushtuesi jashtë atdheut, të eksperimentuara në Kubë dhe Kosovë, qëndron në faktin se:

Sulmuesit mërgimtarë kubanë nuk patën mundësi të bënin simpozium shkencor dhe ta trajtonin këtë lloji “strategjie” si një risi në teorinë e artit ushtarak kuban dhe botëror, ngaqë u kapën rob dhe u burgosën;

Ndërsa “profesionistët tanë institucionalistë” jo vetëm që e festuan atë kapje të brezit kufitar, duke u dekoruar nga të dy Presidentët e Kosovës, (Rugova dekoroi komandantin e tyre Tahir Zemën, Thaçi gjithë bashkëmendimtarët dhe vartësit e tij), duke e trajtuar atë si një zbulim të ri, i fituar nga përvoja e tyre luftarake. Dhe për këtë “zbulim” të madh teorik në artin e luftës, organizuan menjëherë pas lufte një simpozium shkencor, duke e paraqitur këtë “zbulim” si një lloji pasurie të vërtetë që i bëhet ligjesisë së luftërave çlirimtare si në artin ushtarak shqiptar edhe në atë botëror, duke arritur deri atje, sa ta propozojnë si mënyrën më me pak kosto dhe më të sigurtë për çlirimin e vendit në rast pushtimi, prandaj dhe propozojnë që, *“në të ardhmen mund*

*të shërbejë si burim doktrinor për ndërtimin e ushtrisë së Kosovës*⁴²⁾. Nuk thuhet më kot që historia përsëritet, por në një stad edhe më të lartë.

Të dy këto beteja, nëse do t'i quajmë të tilla, plotësuan njëra-tjetrën, duke sulmuar njëra palë nga deti, ndërsa tjetra nga mali, duke na dhënë të njëjtin rezultat: **dështimin**. Ky dështim e hedh poshtë përfundimisht këtë lloj strategjie, duke na thënë së është e pamundur të çlirohet atdheu në këtë mënyrë. Si rrjedhojë, kjo lloj strategjie nuk ka gjasa të hyjë si një risi as në artin ushtarak shqiptar dhe as në atë botëror.

“Luftërat që dëshirohen, propozohen dhe përgatiten prej një grupi të veçantë njerëzish apo qarqe pushtetarë ndërmerren për t’u sjellë atyre përfitime financiare ose pushtet, respekt e autoritet, si në rastin e gjeneralëve dhe kapitenëve pa punë.”, thekson nobelisti gjerman Hermann Hesse.

FUND

42) M. Çetta, “Me UÇK-në në Koshare”, Prishtinë, 2002, v.2, f.264

PJESA E DYTË

“Gjykimet (mendimet) e një njeriu e mira është t’i shikosh në vepër sesa në fjalë. Sepse shumica veprojnë keq dhe flasin shkëlqyeshëm.”

*Senatori romak
Marcus Claudius Marcellush
(268-208 para e.r.)*

S H T E S A T

SHTESË (APPENDIX) 1:
MILAZIM MARAJ :
Vlerësim i turpshëm i një Oficeri

“Bota Sot”, 11 Tetor 2018 NË ORA: 14:20

Anëtari i Shtabi i Përgjithshëm edhe pas 20 vitesh kundër luftës së Koshares.

Një anëtar i ish Shtabit të Përgjithshëm të UÇK deklarohet edhe një herë kundër Luftës së Koshares.

Dilaver Goxhaj tha së Operacioni “Shigjeta” është operacioni më i madh i UÇK-së. Pastaj së për organizimin e tij kishte pasur shumë debate si do të organizohej. Sipas tij, Goxhaj, Bislim Zyrapi dhe Drini ishin kundër ndërhyrjes në Gorozhup, sepse përball këtij vendi në Zym Serbia kishte artileri të rëndë. Pastaj vlerësimi i këtij grupi, sipas Dilaver Goxhaj ishte së Gorozhupi ishte cak i lehtë për të u goditur nga Zymi. Kurse Goxhaj dhe të përmendurit ishin për atë, të hyjnë nga Pashtriku. Pastaj ishte Agim Çeku që u kishte mbyllur gojën këtyre kur u kishte thënë:” Së është i porositur nga Amerikanet që të ndërhyhet nga Gorozhupi”. Goxhaj pastaj tregon së nuk ka pranuar ta komandoj operacionin “Shigjeta” dhe se paska sugjeruar që operacioni duhet të udhëhiqet nga një djalë vendas. Kjo deklaratë e tij nxjerr në pah shumë gjera:

1. Agim Çeku paska qenë fajtori për dështimin e këtij operacioni.

2. Anëtari i shtabit Dilaver Goxhaj ka refuzuar urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK për të udhëhequr operacioni. Çka është kjo në Luftë?

3. Ky plan i hartuar pas shumë debatesh nuk ka pasur strategji si të mbahet territori i çliruar pas sulmit. Ky qenka profesionalizmi i këtij eksperti.

4. Operacioni “Shigjeta” ka pasur efekt jehone thotë anëtar i Shtabit , që në këtë rast del më shumë si një këshilltar i keq. së si anëtar i shtabit.

5. Pse nuk e tregon së kundërsulmi serb ka arritur të futët në Shqipëri, pastaj më forca të përbashkëta të artillerisë shqiptare dhe forcave të NATO-s janë larguar, por ka pësuar edhe popullata civile shqiptare afër kufirit?.

6. Vlerësimi i zotit Goxhaj së Klintoni nga Amerika paska thënë se ”UÇK është bërë e papërmbajtshme” por nuk është sqaruar nëse e kishte fjalën për operacionin “Shigjeta”. Për këtë operacion rrufe ku mbetën gjithë ata ushtarë të rënë dhe terreni përsëri u mbulua më ushtrinë serbe pikërisht nga gabimet e planifikimit sipas kësaj deklarate. Goxhaj thotë së operacioni “Shigjeta” ishte më i lavdishëm së sa Kosharja. Çka të duhet ky krahasim zotëri? Kujt po i hynë punë tani apo keni nj porosi tjetër?

Ky tip ekspertit më këto vlerësime kaq paushallë dhe jo profesionale më plot të pavërteta që lexohen edhe nga njerëz laik që fare nuk kanë të bëjnë me luftën dhe organizimin e operacioneve të luftës, tregon çartë qëllimin e tij për t’u angazhuar në këtë shtab. Por me këtë deklaratë nuk e ka treguar vetëm qëllimin e ti material. Kundërshtimi i tij që ta komandoj operacionin dhe sulmi që i bënë luftës së lavdishme të Koshares tregon mision të caktuar, për të cilin ende nuk ka tregime të plota. Pastaj vrasja e komandant Drinit më një herë pas luftës????!!!. Pse dezinformon ky njëri? Brigada e Koshares nuk e paska thye kufirin. Si nuk ka turp më gënjeje kështu haptas?. Më datën 09.04.1999 është çliruar territori i Rrasës së Koshares.

Ku i bije Rrasa e Koshares zotëri ekspert, në Shqipëri apo në Kosovë? Më 10.04.1999 është çliruar Karakolli i

Koshares po a e dini ju ku ka qenë i ndertuar, në Kosovë apo Shqipëri. Kosharja dhe Rrasa e Zogut, Gomaret e Botushës janë në Kosovë apo Shqipëri. Po Gjocajt, Jasiqi dhe Juniku ku janë? Deklarimi juaj së në Koshare luftuan vetëm 63 ditë, jo vetëm që është i pa vërtetë, por tregon qëllimin tuaj te keq ose që fare nuk ke informata për këtë luftë dhe që ndoshta mundë të jesh njeri nga ata që ka penguar këtë luftë për aq sa ke pas mundësi.

A quhet fitore në literaturën që ju e keni mësuar (lexuar) si ushtarak territori i çliruar dhe mbajtja e tij apo sulmi dhe vrojtimi i tij nga Shqipëria sikur keni bërë ju? Ose një sulm me plot viktima dhe humbje të djemve më të mirë të Kosovës të motivuar dhe përcaktuar për liri dhe pavarësi e Kosovës. Po të ishte çdo gjë në rregull ju zotëri do të duhej të përgjigjeshit pa gjyqit ushtarak për kundërshtimin e urdhrat dhe për planin e gabuar që ka sjell humbje. Vlerësimi i juaj:” Ju në Kosovë jeni të infektuar nga Serbia që festoni humbjet”është tagji komik. Më vjen shumë keq që një shqiptar që pretendon të jetë oficer i lartë të dal më këto ofendime të pavërteta për popullin e vet, para botes!. Unë njoh shumë oficer shqiptarë që kanë qenë në Luftë edhe në Koshare, por asnjë nuk e njoh që ka refuzuar urdhrat apo shmangur nga aksionet.

Ky vlerësim shumë ofendues e i pa bazë për ne në Kosovë tregon përcaktimin tuja kombëtar, nivelin tuaj njerëzor dhe patriotik kur futesh në shtab për të marr pagë dhe pastaj refuzon të futesh në aksion. Ne jemi shqiptarë kemi luftuar të jemi të lirë dhe luftojmë të mos jemi (ju dhe na) por janë shpirtrat e humbur dhe të shitur që na shohin si (ju dhe na). Janë ata; që nuk janë të gatshëm të sakrifikojnë për popull dhe atdhe, por të përfitojnë në çdo formë dhe

mënyrë pa meritë dhe djers. Janë ata që nuk kanë turp të i shohin shqiptaret në ju dhe na!

SHTESË (APPENDIX) 2: NTERESANTE!

Hysen Berisha

Kosharja Forumi Lirisë, 12.10.2018

Kjo tendencë e re super manipulimi...e fosileve rusokomunist të sigurimit shtetëror, të gatshëm për veprime destruktive ndaj të vërtetës historike. Kjo traditë e manipulimit të historisë siç bënë për 100 vite regjimi komunist rus në Tiranë, duke e modifikuar e shkruar historinë (botimet e Institutit shtetror të Historisë “Historia e popullit shqiptarë” në dy vëllime) të modifikuar në kryeqendrat e bllokut të “Varshaves”, që të lexoheshin më pastaj në Tiranë por edhe në Prishtinë, përkundër rrezikut për të mare 20 vite burgim për libra “të ndaluar”, nuk mund të ndodhë më për faktin se jemi vet ata që e bëmë historinë, jemi të gjallë dhe kryesore ishim me tituj akademik e luftën e kemi bërë në kohën e internetit. Nuk është më Kosova e viteve 1960/70, kur duheshin ti sillëshin libra, abetare e mësues nga Shqipëria për të ndërtuar sistem arsimor. Po flasim për një Kosovë dhe qytetar që kanë emra në shkencën botërore.

Mirëpo, ky manipulim e merr përgjigjen nga libri i Kreg Jurisheviqit - “Duart e përgjakura” dhe Idioma popullore, “Dielli nuk mbulohet me shoshë”! Edhe pse të dhënat historike mbi Kosharen flasin vetë. Andaj mjerë kush fabrikon të vërteten historike për çfarëdo çmimi. Disa kemi ditur që krahas pushkës e komandim - drejtimit të luftës, ta trajtojmë edhe lapsin e diplomacinë!

Kosharja Forumi Liris.

<https://www.google.com/amp/s/telegrafi.com/goxhaj-shigjeta-operacioni-suksesshem-ne-koshare-detyra-nuk-u-krye-video/amp/>

SHTESË (APPENDIX) 3: Dilaver Goxhaj

Përgjigje z.Hysen Berisha dhe kategorisë së tij
Pashtrku.org, 15.10.2018

Lexova komentin e një farë “historiani” ushtarak, i quajtur Hysen Berisha, në portalin “Kosharja Forumi Liris”, i cili komenton intervistën time dhënë TV Dukagjinit, e transmetuar në 10 tetor 2018. Ky zotëri më akuzon për manipulues të historisë, pse unë them se: “Forcat e UÇK në Kosharë luftuan, nuk u turpëruan, por, edhe pse luftuan 63 ditë resht, duke mos u munguar asgjë, si në armatime e municione, ashtu edhe në furnizimet e tjera të nevojshme për të luftuar në mënyrë meritore, duke i pasur edhe krahët edhe shpinën të sigurta, nuk e realizuan dot detyrën luftarake që u ishte dhënë, e cila ishte hapja e krridorit për furnizimin me municione e logjistikë për formacionet e UÇK-së që luftonin brenda në Kosovë”.

I them këtij bicim historiani, se puna matet me rezultate dhe jo me llafe. Le të na e tregoi ky zotëri se cili qe rezultati asaj lufte 63 ditore i forcave të UÇK-së që sulmuan në Koshare për në thellësi të territorit të Kosovës, se mbase unë nuk e di mirë.

Por ky zotëri, ngaqë nuk ka se cfarë rezultatesh të na tregoi në interes së detyrës së vënë nga SHP i UÇK-së, prandaj kalon në fyerje e të tjera fjalë pakuptim, duke

na cuar 70 vite prapa, me propagandën tipike titiste kundër Shqipërisë.

Me sa po duket, ky “historian” duhet të jetë pinjoll i ndonjë shqiptari të vetquajtur jugosllav, se po të qe safi shqiptar i pastër do t’u ishte bashkuar 19.800 pjestarëve të tjerë të UÇK-së që luftuan brenda në Kosovë, (bashkë me ata edhe unë me 155 të tjerë nga Shqipëria), andaj dhe shtjellon fraza pa kuptim, gjë që tregon se çfarë niveli politik dhe se sa e ndjen përgjegjësinë e detyrës në luftë.

Ky zotëri kujton se mjafton të qëllosh në ajër me armë dhe detyra u realizua. Se për atëpaskishim keq ne! Për këta tipa s’ka rëndësi se e theve apo nuk e theve vijën mbrojtëse që të bën armiku.

Le të na thotë ky zotëri se kush e fitoi atë betejë: forcat tona që nuk e hapën dot korridorin e funizimit, apo forcat serbe që nuk i lanë forcat tona që të hapnin atë korridor? Cila palë e realizoi synimin e vet?

A e din ky zotëri se janë vrarë 114 djem nënash dhe janë plagosur mbi 350 të tjerë gjatë atyre 63 ditë luftimesh dhe detyra që iu ngarkua komandës së atyre mbi 2000 forcave tona nuk arritën ta kryenin atë detyrë? Si do të justifikohemi para familjeve të atyre djemve që dhanë jetën për të hapur atë korridor të domosdoshëm? Dhe nuk u hap. Apo duke thënë: “jemi trima”. Duhet të kemi kurajon të pranojmë mosarritjet tona dhe jo t’i quajmë mosarritjet herroizëm. Nëse do të ishte hapur ai korridor aq I nevojshëm qysh javën e parë të atyre luftimeve, ndryshe do të ishin zhvilluar luftimet dhe lufta kish gjasa të mbarohej shumë më shpejt; si rrjedhojë do të kishim disa qindra dëshmorë më pak. Po të ket pak logjikë realiste, besoj se ky zotëri, dhe ata që e mbështesin atë, do të kenë guximin të pranojnë atë

që është fakt i kryer, se forcat tona nuk e realizuan detyrën e ngarkuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, edhe pse Ministria e Mbrojtjes e QPK ua plotësoi të gjitha nevojat.

Atëherë, ku qëndron manipulimi që unë i paskam bërë asaj “beteje madhështore” sipas tij, apo se po them atë që ndodhi? C’janë këta “historianë” e “atdhetarë” të mëdhenj që i tremben kaq shumë të vërtetës?! Dhe përgjigjia është: Hem qerosa, hem fodullë.

Si rrjedhë, ky “historian”, duke mos e pasur atë guxim që patën ata 19.800 luftëtarët e formacioneve brenda në Kosovë nuk ka sesi të pranoi mosrealizimin e asaj detyrë pse nuk u hap fronti në Koshate, prandaj ka gjasa të fillojë nga fyerjet e të na krahasoi me armiqtë e cështes shqiptare, pasi këtë gjë e ka fare të lehtë e të trashëguar.

Tiranë, 14.10.2018

SHTESË (APPENDIX) 4:

Goxhaj: “Shigjeta” operacioni më i suksesshëm, në Koshare detyra nuk u krye (Video)

Telegrafi 10.10.2018 • 20:47

Dilaver Goxhaj, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, ka rrëfyer të pathënat e operacionit “Shigjeta”.

Ai në “Debat Plus” me Ermal Pandurin në RTV Dukagjini tha se “Shigjeta” është operacioni më i madh i UÇK-së, por deri te realizimi i tij kishte shumë debate se si do të organizohej.

“Unë, Bislim Zyrapi dhe Drini ishim kundër ndërhyrjes nga Gorozhupi, sepse përballë këtij vendi në Zym, Serbia kishte artileri të rëndë. Nga Zymi, Gorozhupi

do të ishte cak i lehtë për t'u goditur, ndërsa ne ishim për atë që të hynim nga Pashtriku”.

“Çeku, për të na mbyllur gojën, na tha se ishte porositur nga amerikanët të ndërhyhet nga Gorozhupi”, tha ai, përcjell Telegrafi.

Goxhaj thotë se i është propozuar atij për të marrë komandën e këtij operacioni, por ai e kundërshtuar.

“Unë u thashë se është nder për mua, por operacioni duhet të udhëhiqet nga një djalë vendas, sepse u thashë se ky do të ishte një operacion shumë i madh dhe historik”.

Sipas anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, jehona e operacionit “Shigjeta” ishte e madhe në Serbi edhe në botë.

“Clintoni deklaroi nga SHBA, se UÇK-ja është bërë e papërmbylqshme. Të nesërmen u mbledh Parlamenti i Serbisë dhe ishin në mëdyshje të vazhdojnë luftën apo jo. Propaganda ishte fitorja më e madhe me operacionin ‘Shigjeta’”.

Goxhaj ka thënë se “Shigjeta” ishte operacion më i lavdishëm sesa ai në Koshare.

“Në Koshare luftuan 63 ditë dhe kishin furnizim të mirë me armë, por kufirin nuk e thyen. Ata luftuan, nuk u turpëruan, por detyrën nuk e kryen. Ne s’kemi pse të lëvdojmë një betejë që nuk e fituam. Ju në Kosovë jeni ‘infektuar’ nga Serbia, që festoni humbjet”, tha ai./**Telegrafi**/

SHTESË (APPENDIX) 5: DILAVER GOXHAJ

Reagim ndaj emisionit te TV-Dikagjini, të datës 10 tetor 2018

Pashtriku.org, 12.10.2018

Duke ndjekur emisionin e TV Dukagjinit, me titull: “Të pathënat për UÇK-në”, të përgatitur prej gazetarit të atij TV, Ermal Panduri, transmetuar në datën 10 tetor 2018, e cila është intervista ku kanë folur zotërinjtë: bashkluftëtari i Zahir Pajazitit Fadil Begu, kryetari i Organizatës së Veteranëve të UÇK-së për Shqipëinë Sokol Poga, Komandanti i Qendrës Stërvitore të UÇK-së në Helashan kolonel Maliq Doci, një prej furnitorëve kryesorë për formacionet e UÇK-së prej Hasi në brendësi të Kosovës Qamil Cahani, dhe autori i këtij reagimi, Dilaver Goxhaj, reagojmë. Në fund të asaj interviste, gazetari Panduri i ka bashkangjitur edhe një intervistë të ish-oficerit nga Shqipëria, i njohur me emërin Spiro B., i vetgraduar kolonel. Mirë ka bërë, e drejt e tij si gazetar. Por, sikundër do ta shpjegojmë më pas, kjo shtesë e tij është qëllimkeqe.

Themi për Spiron “i vetgraduar”, për faktin se nuk e ka gëzuar kurrë atë gradë ushtarake sa ka qenë oficer efektiv në Ushtrinë e Shqipërisë. Kjo për arsyen e thjeshtë se, kur Spirua është liruar nga Ushtria e Shqipërisë, (në gjysmën e dytë të viteve ’70-të të shekullit XX), jo vetëm që Ushtria Shqiptare nuk kishte grada, por që të gëzoje atë gradë duhej të ishte minimalisht komandant Brigade (Regjimenti), ndërkohë që ai zotëri ka qenë shef stërvitjeje a shef operativ Brigade që, po të ishin gradat në atë kohë, do t’i takonte maksimalisht grada major, por kurrë kolonel. Ky zotëri, me sa po duket, e ka qejf vetgradimin, pasi edhe

kur krijoi Armatën Kombëtare Shqiptare (AKSH) në vitin 2003, për të cilën u fut edhe në listën e zezë të Presidentit të SHBA Xhorxh Bush (i vjetri), edhe atëherë u vetgradua Gjeneral-Kolonel, (për t'u barazuar me Enver Hoxhën kur iu dha kjo gradë në Kongresin e Përmetit, 24 maj 1944, kur UNÇSH vendosi gradat), dhe zgjodhi për pseudonim një emër e mbiemër madhështor për t'u paraqit si i lindur nga Zoti për beteja të mëdha ushtarake, Vigan Gradica. Edhe mbiemrin Gradica e ka zgjedhur për të na thënë se është Mehmet Gradica i kohës sonë! Kjo tregon se djallëzia e tij është e pa arritshme. Nëse nuk e ka nga djallëzia, atëherë ai është i sëmurë prej delirit të gjigando-manisë.

Por që të mos largohemi nga tema: z. Ermal Panduri përveç që i ka censuruar thëniet tona për “viganin” Spiro, por e mbyll qëllimisht atë intervistë me theniet e tij. Dhe kuptohet se cili është qëllimi ideologjik i këtij gazetari: që t'i paraqesë të pavlera e të paqena gjithçka folëm e treguam në parafolësit, protagonistët e vërtetë të atyre ngjarjeve, që u trajtuan e u folën për operacionin “Shigjta”, si dhe për çështjen e të qenit të atij Spiros dëshmitar prefencial i Prokurorit Elez Blaka. Ç'është gjithë kjo dashuri dhe përkrahje e prokurorëve dhe e gazetarëve partiakë në Kosovë ndaj një magazinieri të UÇK-së që vepronte gjat luftës në qytetin e Kuksit dhe kurrë në Kosovë, madje i përkrahur pa rezerva edhe nga z. Azem Sylja, e i mbështetur pas lufte edhe nga shumica e ish-anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?! Ku vallë flen lepuri?

Dhe ajo që është interesante në intervistën e atij Spiros, në këtë emision, është shprehja e tij: “Unë, po të kisha 3000 ushtarë do ta çliroja vetëm Prizërenin”. Ç'paska humbur Kosova një fat kaq të madh!

Kjo deklaratë pompoze e “viganit” Spiro tregon se, ky zotëri ose nuk ka pirë ilaçet kur ka dhënë intervistën, ose nuk e kanë çuar për ta vizituar te mjeku psikiatër. E themi këtë për vet faktin se ai bie ndesh me ato çka ka thënë në shumë shkrime të tij. Në ato shkrime, ai është deklaruar se na paska qenë emëruar nga Azem Syla zëvendës Komandant i Operacionit “Shigjeta”. Madje ka deklaruar edhe tjetrën: e ka komanduar atë luftim, (le ta quajmë operacion), nga një largësi 20-30 kilometra larg, pasi, sikundër tregojnë të gjithë pjemarrësit në të quajturin Operacioni “Shigjeta”, ai ka qenë në një zyrë në ish-Uzinën Mekanikë të Kuksit!

Dhe kjo duhet të jetë një risi në artin ushtarak botëror dhe jo vetëm shqiptar, që ta drejtosh luftimin nga një zyrë pa dritare dhe në një largësi të tillë, duke mos qenë nevoja ta shohësh fare as frontin e jo më vijën e parë të luftimeve.

Mirëpo, dimë që në mal të Pashtrikut dhe në Koshare u grumbulluan e u angazhuan në luftim gati 5000 ushtarë.

Nëse do të pranojmë se ky zotëri ka qenë zëvendës komandant i atij opracioni të planifikuar nga Shtabi i Përgjithshëm (dhe jo nga ministri Azem Syla, sikundër na e paraqet ky, në disa dokumenta me nënshkrimet e Azem Sylës), si është e mundur që nuk e çliroi Prizrenin? Dhe kjo do të ketë ndodhur për faktin se kanë qenë më shumë ushtarë se sa i duheshin këtij lloj Spiro; ishin 5000 dhe jo 3000, prandaj nuk e ka marrë mundimin ky “trim vigan” që ta çlironte Prizrenin! Sa të humbur paskemi qenë!

Ngaqë kanë qenë 5000 dhe jo 3000 luftëtarë, prandaj ky “zëvendës komandant operacioni” nuk mundi të çlironte edhe ato 300-1000 metra në thellësi të territorit të Republikës së Shqipërisë që ishin pushtuar e fortifikuar nga forcat serbe, prej Qafës së Prushit e deri Gorozhup. E

paskemi vrarë mendjen kot se pse nuk u realizua detyra për hapjen e korridorit të furnizimit si në Koshare edhe në Pashtrik, ngaqë kanë qenë më shumë se sa i nevoiteshin “viganit” Spiro. Pse nuk na e ka thënë më parë ky “vigan”, që mos të ishim lodhur kaq shumë.

Dhe me këtë deklaratë mburavece të këtij “trim vigani”, gazetari i njëanshëm Ermal Panduri na embyll intervistën e “të pathënave për UÇK-në”! Turp, e faqe e zezë, kur këta gazetarë të pushteteve duan të na i paraqesin si të vërteta këto brockulla mburavece të një ish-oficeri të përjashtuar nga tre ushtri, dy shqiptare e një ndërkombëtare, si i padenjë për të qenë oficer ushtrie: nga Ushtria e Republikës së Shqipërisë, Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe nga KFOR-i .

Tiranë, 11.10.2018

SHTESË (APPENDIX) 6: HYSEN BERISHA

Sipas intervistës te TV Dukagjini, më16.4.2019,

Përgatitja për vendimmarrje të betejës në Koshare ka ndodhur 5-6 muaj përpara. Vendimmarrjes i ka parapri një proces i gjatë i përgatitjes së kësaj lufte, duke filluar me rekrutime e trajnime. (...) Në fund strukturimi i brigadës 131, si brigadë kryesor, të cilës ju bashkangjit disa muaj përpara një bërthamë e brigadës 134 dhe njësia pranë-shtabore e Ministrisë së Mbrojtjes për vëzhgime, që e udhëhiqte Anton Quni, i cili më vonë shkrihet në G3, batalioni “Delta”, njësi kjo për operacione speciale. Janë këto tre brigada që janë formuar diku në maj 98, nga ministri i mbrojtjes Ahmet Krasniqi, me vendimin e tij. Në qershor 98 janë hy në Kosovë, ku kanë zhvillua luftime në Zonën e Dukagjinit. (...)

Ahmet Krasniqi vizitën e fundit e ka bërë në qendrën stërvitore në Papaj. Pat lënë një porosi: ‘Për bashkim le të përbihen edhe bjeshkët e Strelcit.’

Ideja e luftës në Koshare: lufta të fillonte në një anë të kufirit dhe të përfundonte me lirinë e anës tjetër të Kosovës. Kjo doktrinë na ka udhëheq për luftë.

Na e dimë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës u organizua në një moment, nga dy drejtime ose vija mobilizuese, që ishin Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm, ose në zhargonin popullor: Lëvizja. Dhe prej dy drejtimeve erdhën ushtarë.(...)

Oficerët është e natyrshme me e respektua vijën institucionale, që ishin Ministria e Mbrojtjes, Qeveria, Presidenti, Kushtetuta e Kaçanikut, e të tjerë. Krahu tjetër ishte Lëvizja, që e ka karakterizuar irredentizmi nacional(...)

Orarin për sulm e kemi marrë vesh me 8 prill, në mbramje, në terr, nga Shefi i Shtabit Agim Ramadani. (...) Nga batalioni ‘Atlantiku’ kanë 7 veta. 5 prej tyre u nisen në drejtim të Malit të Zi, - ata e dinë ku kanë shkua, - dy u ndalen në Koshare. (...)

Ditën e parë në sulm ishin 256 pjesëmarrës. Në përfundim të luftës, kur në kemi zbritur nga Kosharja me 19 qershor, ishim 1.800 pjesëtarë(...)

Qëllimi i luftës në Koshare ka qenë që lufta të zhvillohej mbi doktrinën: Të fillohej lufta në këtë anë të kufirit dhe të përfundonte me liri në anën tjetër, me lirinë e Kosovës. Nuk ka qenë vec hapja e korridorit. Objektivi I Koshares nuk ishtevec hapja e korridorit të furnizimit.

Luftës në Koshare i ka pas paraprirë një kohë përgatitore shumë e gjatë(...)

Një ushtri thyhet nëse i merret kazerma(!)

Gjatë vëzhgimit kemi parë se ushtria serbe nuk ka qenë e aftë dhe jemi bindur se mund të luftohet me ta.

Ne i kemi dërguar furnizime Ramushit.

Në një moment të caktuar armiku ka dalë në shpinën tonë

Fronti Koshares mbetet emblem e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës.

Hapja e korridorit nuk ka qenë objektivi ynë,. Objektivi I Koshares nuk ishte hapja e korridorit të furnizimit. *(Po, atëherë përse luftuat, si do hynit në Kosovë nëse nuk do hapnit korridorin? D.G.)*

Beteja e Koshares ishte e pabarabartë. Ata vetëm 300, por kemi luftuar heroikisht.

(Serbët flasin për heroizëm por jopër fitore-tha një gazetar. Pore dhe këta mund të flasin për heroizëm, por kurrësesi për fitore.D.G)

Serbët kanë kujtuar se do të ishim si në vitin 1998. Kanë kujtuar se do të kishim armë si të rezervistëve të Shqipërisë.

Ne i kemi vrarë 1200 serbë(!!!) me luftë frontale. Ne kemi dit çdo detaj të armikut.

Kazërmën e morrëm ditën e dytë dhe e gjetëm bosh.

Ne ishim 1800-2200 vetë(...)

Kishim të gjitha llojet e mortajave. Artilierët tanë ishin shumë të përgatitur(...)

Pas kapjes së pozicioneve ne prisnim k/sulm nga armiku

Morali i ushtarëve tanë ishte shumë i lartë, ndërsa i serbëve shumë i ulët, se ishin në vend të huaj. Kur shikoj një ushtar që i duket qyta e pushkës kuptoj se ose ishte rekrut ose rezervist dhe kjo na ka bind se luftën e kishim të lehtë. dhe këtë bindje e krijuam pas një gamë të tërë vlerësimesh,

gjatë vëzhgimeve 40 ditore. Trupat serbe qëndruan deri në 19 qershor.

Serbët nuk kanë besuar se ne do të kishim djem të trajnuar aq mirë.

Shtabi i Përgjithshëm e dinte dy-tri javë përpara se kur do të sulmonim ne.

Qendruam në Koshare deri 19 qershor.

Sulmin e kemi kryer me grupe të vogla, ku secili grup kishte rolin e vet duke sulmuar.

I morrëm pozicionet deri të Shkoza dhe qëndruam deri në fund.

Pranon se sulmuan me 250 forca?

(Pranon se kur sulmon raporti i forcave duhet të jetë 3:1 në favor të atij që sulmon.D.G)

SNTESË (APPENDIX) 7:

Hysen Berisha i përgjigjet Dilaver Goxhajt

E vërteta e Betejës së Koshares

“Bota sot”, 02 Maj 2019

I nderuar Kombi im Shqiptar!

Për hir tuajin dhe në emrin tuaj po i përgjigjem, pas dy sulmeve ish-Kolonelit të Ushtrisë Popullore të RPSSH – Kolonel Dilaver Goxhaj:

Beteja e Koshares ç’është e vërteta plotësisht u hartua si plan lufte, u stërviten ushtarët , i armatosen dhe u prinë burrat oficer të Kosovës të cilët artin ushtarak e kishin mësuar në Zagreb, e kudo tjetër në ish-Jugosllavi.

Vite para kësaj Beteje, këta burra që ju po i etiketoni u rreshtuan kundër ushtrisë serb edhe në luftërat tjera në ish

Jugosllavi.

Në Tiranë u organizuam nën komandën e Kolonel Ahmet Krasniqit, nën shembullin e Gjergj Kastriotit e nën flamurin kombëtarë, u vendosëm në një repart të ish ushtrisë shqiptare të braktisur, tashmë të shndërruar në një stallë bagëtish.

Në kushte të tilla formuam GO3 (Grupin Operativ 3), stërvitem ushtarët për mision, oficerët komandues u harmonizuam ndër veti, planifikuam sulmin në imtësi, hartuam strategjinë, rrokëm armët dhe u vendosem në krye te atij rreshti ushtarësh për të çliruar Kosovën.

Ja arritëm zoti Kolonel! Sepse sekreti i atij sukseesi ishte uniteti i forte midis ushtareve e ushtarakëve në Betejën e Koshares. Dy dekada pas këtij sukseesi, Presidenti i Republikës së Kosovës Zotëri Hashim Thaqi, nderoi Betejën e Koshares, Brigadën 138 – “Agim Ramadani” si njësi ushtarake e UÇK, e cila e zhvilloi operacionin, si dhe të gjithë ushtarët, oficerët komandues dhe dëshmorët e kësaj Beteje.

Kolonel, përpara sulmit tonë ishte Korpusi i tretë i Gjeneral Lazarevicit, icili pas studimit të hollësishëm të operacioneve luftarake gjatë ditëve të luftës në Koshare, vije në përfundim dhe e quan “Bitkana Koshare”, në gjuhen shqipe për Ju z. Kolonel Beteja e Koshares!

Debati i personazheve në këtë Betejë, i cili po zhvillohet në distancë por mbështetur mbi argumentet shkencore ndërmjet Ne oficerëve që drejtuam operacionin për çlirimin e Kosovës dhe gjeneralëve serb të cilët kishin për detyrë ta ndalnin këtë çlirim me ushtritë e tyre, ka sjellë deri të përfundimi shkencorë se operacioni i luftimit i zhvilluar me dt.09 Prill, 1999, të njihet sidita e parë

e Betejës së UÇK në Koshare. Mbështetur në analizën moderne që bëjnë ushtritë dhe oficerët profesionistë, armata që e braktisë arenën luftës është ushtria humbëse.

Ky është epilogu të cilin nuk mundësh me e ndryshua me shkrimet tuaja, ka për tendencë përçarjen e kombit shqiptarë dhe destabilizimin e Republikës së Kosovës.

Nuk do t'ia arrini, prandaj ik nga kjo temë dhe shijo pa kompleks e xhelozsi sukseset e ish-Komandantit të Betejës së Koshares, tashmë Ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, z. Rustem Berisha dhe stafit të tij, në formimin dhe përgatitjen në bazë të doktrinave moderne të NATO, të armatës së re të Republikës së Kosovës.

Ish oficerët e Akademive jugosllave që ju z. Kolonel i përçmoni e fituan luftën dhe nën shembullin e Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti po e mbrojnë lirinë dhe token e bekuar të Kosovës.

Desha me iu thurë lavdi Heronjve të kombit shqiptarë por po më kujtohen Gjeneralët famekeq te shokut Tito, Aleksander Rankoviqi, Ivan Millutinovic dhe Llolla Ribar të cilët ju ende i mbani në listën e heronjve kombëtarë shqiptarë prandaj po hezitoj, mirëpo, po dua të thur lavdi nderim dhe respekt për të gjithë burrat e gratë që u rreshtuan pas Flamurit Kombëtarë dhe trimërisht i mundën ushtritë okupatore serbo-ruse në Kosovë.

Kolonel Goxhaj, në Betejën e Koshares, poezia dhe kënga kanë qenë muza jonë dhe dy elemente që kanë plotësuar njërat jetrën, kanë frymëzuar ushtarët në vijat e luftës prandaj këtij reagimi dua që pikërisht përmes poezisë së autorit Hamit Alia, poetit shqiptarë të lindur në fshatin Kasaj të Tropojës, aty ku unë zhvillova Betejën e Koshares (si dhe luftimet për zmbropsjen e invadimit serb

në territorin e Republikës së Shqipërisë, detyre të cilën ju nuk e realizuar), prandaj lexojeni këtë poezi që unë po e vendosi si përkrenaren e reagimit tim: Hamit Aliaj.

(Dhe e përfundon reagimin e tij duke na e dhënë të plotë poezinë e Hamit Aliaj.)

02 Maj 2019

SHTESË (APPENDIX) 8: HYSEN BERISHA

Intervistë ekskluzive. Rrëfen Komandanti

Beteja e Koshares ishte meritë e Sali Çekajt dhe organizimit institucional

“Bota sot”, më 4 maj 2019 në ora: 17:07

Komandanti i Betejës së Koshares, Hisen Berisha, në një intervistë ekskluzive për gazetën “Bota sot”, sjell rrëfimin e tij në 20 vjetorin e kësaj beteje, e njohur si njëra nga betejat më të përgjakshme dhe më heroike të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ai ka deklaruar se kjo betejë e lavdishme ishte meritë e Sali Çekajt me bashkëluftëtarë e patriotë të devotshëm që iu përgjigjën vullnetarisht thirrjes për çlirim me luftë të Republikës së Kosovës.

Berisha në këtë intervistë ka thënë se roli i Ministrisë së Mbrojtjes në këtë betejë ishte furnizimi me mjete dhe me ushtarë, rol të cilin sipas tij e përmbushi pjesërisht.

Hisen Berisha që ishte njëri ndër protagonistët e kësaj beteje, ka thënë se tendenca e Serbisë çdoherë ishte për të fshehur numrin e saktë të ushtarëve të humbur në atë luftë, si një tendencë që të mos e njohin Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si ushtri rivale. Ndërsa, komandanti Berisha

në këtë intervistë ka folur edhe për deklaratat e kolonelit shqiptar Dilaver Goxhaj, për të cilin ka thënë se është zëri i vetmuar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, që ju dha mundësia të bënte diçka për Kosovën.

“Bota sot”: Tashmë janë bërë plotë 20 vjet nga beteja më e lavdishme – Beteja e Koshares. Mund të na flisni z. Berisha, cilat janë emocionet tuaja dy dekada pasluftës?

Hisen Berisha: Njëzet vite pas lufte, ne po e argumentojmë mbështetur në formula ushtarake, suksesin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në këtë luftë. Krenaria u shtua pas dekoratës së presidentit të Republikës së Kosovës dhënë kësaj brigade. Sikur u ngjallën heronjtë nga varri.

“Bota sot”: Serbia asnjëherë nuk është ndalur duke propaganduar në forma të ndryshme lidhur me këtë betejë. Si i keni parë ju gjithë këto?

Hisen Berisha: Tendencë për të fshehur numrin e saktë të ushtarëve të humbur në atë luftë, tendencë që të mos e njohin Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si ushtri rivale.

“Bota sot”: Kur jemi te propaganda serbe, mendoni se ju ka dëmtuar në luftën që është bërë?

Hisen Berisha: Propaganda Serbe ka qenë e pabesueshme për shqiptarët kudo në botë, mirëpo tash këtë propagandë nuk e beson askush as faktori ushtarak ndërkombëtarë. Prandaj, Serbia ka për aleatë e partnerë vetëm Rusinë e Kinën.

“Bota sot”: Beteja e Koshares, mendoni se ishte fatale për Serbinë?

Hisen Berisha: Po!

“Bota sot”: Z. Berisha është folur shumë në vitet e fundit rreth rolit të Ministrisë së Mbrojtjes në këtë betejë. Sipas jush, cili ishte roli i kësaj ministrie?

Hisen Berisha: Ministria e Mbrojtjes në këtë betejë kishte rolin e furnizimit me mjete dhe me ushtarë, rol të cilin e përmbushi pjesërisht.

“Bota sot”: Pasi jemi te bashkëpunimi, në anën tjetër, cili ka qenë bashkëpunimi me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së

Hisen Berisha: I njëjtë me rolin e Ministrisë së Mbrojtjes, plotësonin njëra-tjetrën edhe duke u koordinuar.

“Bota sot”: Si e kujtoni rënien e Agim Ramadanit dhe Sali Çekajt, dhe si jeni ndjerë ju në ato moment më të marrë lajmin?

Hisen Berisha: Dhembja ka qenë paralizuese. Vetëdija se rënia e Agimit dhe Salihut në vijat e frontit kishte lëshuar hapësirë të madhe komandimit. Na ktheu në realitet me nevojën urgjente për zëvendësimin, për aq sa mund të zëvendësoheshin këta kolos të mendimit dhe drejtimit ushtarak për luftë në fushëbetejë.

“Bota sot”: Në këtë kohë, si udhëheqës i gjithë kësaj beteje, si kanë qenë raportet e juaja me Rugovën dhe Bukoshin?

Hisen Berisha: Si njësi të formuara me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, Ahmet Krasniqi, kemi mbajtur bashkëpunim institucional. Por, për detajet e këtij bashkëpunimi mund të flasë më shumë Komandanti i Brigadës apo thënë më qartë ishte Sali Çeku shtylla kurrizore e Ushtrisë së Kosovës dhe personaliteti rreth të cilit koordinoheshin çdo çështje që kishte të bëjë me institucionet relevante rreth organizimit ushtarak.

“Bota sot”: Z. Berisha, meritë e kujt ishte Beteja e Koshares?

Hisen Berisha: Sali Çekaj me bashkëlufëtare e patriotë të devotshëm që iu përgjigjën vullnetarisht thirrjes

për çlirim me luftë të Republikës së Kosovës.

“Bota sot”: **Si e vlerësoni Kosovën dy dekada pas luftës, a po shkon në vend amaneti i të rënëve?**

Hisen Berisha: Vendosuni në atmosferën e luftës: Serbia nuk kishte nënshkruar Rambujen, urdhëroi dëbimin masiv të shqiptarëve, ishte autori masakrave, Izbicës, Mejës, Reçakut, Krushës etj. A mund të rrinim duke parë ka qielli?

“Bota sot”: **Në kontekst të kësaj çka ishte objektiv i kësaj lufte dhe sa u përmbush ai? Një oficer i Shqipërisë ka vënë dilema për këtë?**

Hisen Berisha: Misioni i kësaj lufte ishte çlirimi i Kosovës, e thash më sipër se dekorata presidenciale në 20 vjetorin e saj tregon edhe suksesin e saj. Zëri që e citoni është zëri i vetmuar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Megjithatë, z. Goxhaj, ju dha mundësia të bënte diçka për Kosovën. Ai është një teoricien i mirë që ka nevojë t’iu bëjë përditësim (update) njohurive të tij që i ka demantuar koha teknologjike dhe doktrinarë, për të qenë i harmonizuar me standardet e ushtrive të kohës. Por, Koloneli Goxhaj nuk la ndonjë gjurmë për tu theksuar në luftën për çlirimin e Kosovës. Po të flasim me gjuhën tekniko-ushtarake lidhur me objektivat e një lufte, atëherë dua të sqaroj se çdo luftë ka tre nivele objektivash e që janë: ai strategjik; Operativë dhe taktike. Në nivelin strategjik objektiv yni dhe i çdo lufte të karakterit çlirimtarë është dhe ishte çlirimi i Kosovës. Në aspektin operativ ishte zhvillimi i kapaciteteve tona luftarake dhe shtrirja e luftës me kapacitetet tona në përmasa vendore deri në armatën e Kosovës. Kurse në nivelin taktik, ne kishim detyra konkrete që na u dhanë me urdhrin për sulm që nga kapja e objektivave të afërm në

fazën e parë të sulmit që u realizuan në ditën e parë, me eliminimin e të gjitha pozicioneve siguruese të Kazermës ushtarake si dhe pozicioneve përgjatë vijës kufitare nga “2 Korriku” mbi Qafëmorinë deri te Rrasa e zogut mbi Rrasen Koshare. Kapja e këtyre objektivave na mundësoi që kazerma të mërej ditën e dytë të luftimeve dhe brenda ditës së 11 prillit të arrijmë të riorganizojmë sistemin e zjarrit, plotësimin e kapaciteteve dhe zhvillimin e njërive për kapjen e objektivave të ardhshme dhe përmbushjen e objektivit final të Betejës përkatësisht luftës.

I tërë operacioni ishte organizuar në tre drejtime operative: DO 333, që mbulonte zonën nga “Gusha e Batushës” deri në “Shkallën e Radanit”, në Qafë Morinë; DO 555, që përfshinte “Gushen e Batushës” deri në “Oplaz” të Junikut, dhe DO 777 që përfshinte “Rrasën e Koshares”, deri në “Rrasen e Zogut”.

Zhvillimet e luftimeve dhe hapja në krah të luftimeve nga forcat serbe, me dislokimin në zonën e luftimit të Korpusit të Prishtinës apo Rajonit të tretë ushtarak prej afro 15 mijë trupa, me urdhrin e Komandantit të Operacionit u zhvilluan edhe DO 999, që mbulonte zonën e luftimit nga Rrasa e Zogut deri në tre kufi.

Tre drejtimet e para operative u komanduan që më Urdhrin për Sulm të Shtabit të GO3. Ndërsa, DO 999, u komandua me urdhrat plotësues që lëshoi Shtabi i GO3, përkatësisht Brigada 138 Agim Ramadani, gjegjësisht Komandanti i operacionit, Rrustem Berisha.

“Bota sot”: Si e vlerësoni Kosovën dy dekada pas luftës, a po shkon në vend amaneti i të rënëve?

Hisen Berisha: Krijimi i ushtrisë së Kosovës plotëson pjesërisht amanetin e dëshmorëve, anëtarësimi i kësaj

ushtrie në NATO plotëson amanetin e tyre. Ne po punojmë intensivisht që djemtë e Kosovës të jenë sa më parë përkrah ushtrive aleate të UÇK në NATO.

SHTESË (APPENDIX) 9: Sqarim modest

Ermal Panduri <ermalpanduri@gmail.com>

To:laver goxhai

Oct 12, 2018 at 4:17 PM

RTV Dukagjini deshiron te sqaroi se në asnjë formë nuk mund të merr anë për të definuar pozicionet e njerezve qe në një menyre ose në nje tjeter kanë kontribuar per të cliruar Kosoven. Nderkohe në asnje moment askush nuk mund te definoj se cfare duhet te publikojme e cka nuk duhet te publikojme, por i gjithë opinioni duhet ta dije se nuk publikohet në asnje moment dicka qe mund te jete fyese dhe denigruese per persona të ndryshem.

“RTV Dukagjini nuk pranon ti nenshtrohet presioneve nga askush, dhe nuk pranon ne asnje menyre qe te shantazhohet dhe te merr direksione per menyren e te berit gazetari. Materiali eshte shkurtuar per te permbledhur pjeset me te rendesishme, por jo edhe per ti sherbyer qërimave te hesapeve mes individeve te ndryshem ne Shqipëri”, ka thene autori i emisionit Debat Plus, njeherit drejtori ekzekutiv i RTV Dukagjini, Ermal Panduri.

Ermal Panduri

RTV Dukagjini

Drejtor Ekzekutiv

+386 49 756 500

SHTESA (APPENDIX) 10: Reagim i D.Goxhaj

On Oct 12, 2018, at 17:15, laver goxhai <lavergoxhai@yahoo.com> wrote:

z.Ermal, ne nuk kemi perdorur aspak fyerje per X a per Y person në intervisten dhene juve në Durres, keshtu qe nuk qendron ajo c'ka me shkruani.

Se dyti, Në rast se ju do t'i qendronit besnik kesaj qe po me shkruani mua, se nuk lejoni fyerje, atehere, pse lejuat trasmetimin e fyerjeve që beri Spiro Butka ndaj Gjon Lleshit dhe Rajmonda Maleckes në kete interviste e në kete emison te dates 10.10.2018?!

Ja pra, që “dretesia” e juaj eshte me dy standarte: në rast se fyejnë dashamirët tuaj, ju i lejoni; në rast se përdorin fyerje jo dashamiret tuaj, ju nuk i lejoni!

Dhe po detyrohem t'ua perseris: nga ne të katert që u inervistuum në Durres nuk pati as edhe një fyerje ndaj askujt. Nëse ju do te quani fyerje ate te vertete qe une thashe për Spiron: Me kombesi jo shqiptare, ajo nuk eshte fyerje, por nje e vertete që juve, nuk e kuptoj se pse nuk u pelqen te tregohet!

Edhe ajo qe tha z.Sokol Poga se Spiron e ka shkarkuar Kryesia Qendrore e OVLUÇK në Prishtine, nuk eshte fyerje, por nje fakt kokfortë, gjë qe ju mund ta kishit verifikuar shume lehtë, se 100 metra larg selisë së asaj organizate ndodheni.

Edhe ajo thenia tjetere e Sokolit se Spiro nuk eshte më kryetar shoqate, edhe kete mund ta verifikonit po në ate seli.

Dhe keto fakte na japin në të drejten te mendojme se Spiro eshte i preferuari juja, dhe per kete arsye ju na jepni te drejten te themi se ju e keni drejtesine me dy standarte.

Ne qe kerkojme pse ju na keni censuruar, nuk eshte detyrim, sikunder po me shpreheni, por nje e drejte legjitime e jona. Besoj se do të më mirekuptoni.

Ne rast se do të na bjere rasti te takohemi, sikunder qe rasti në Durres, do te flasim edhe më hollesisht, dhe jam i sigurte se do ta keni guximin intelektual te pranoni se keni gabuar në këtë rast.

Dilaver Goxhaj
12.10.2018

SHTESA (APPENDIX) 11: Përgjigje

Ermal Panduri <ermalpanduri@gmail.com>

To:laver goxhai

Oct 12, 2018 at 5:42 PM

z.Goxhaj, të ju them sinqerisht as qe kisha planifikuar të ju kishim fare në xhirime, por duke ndjerë dhembshuri per shkak të moshës edhe ju pranuan, sepse ne erdhem vetem për Pogën. Por nëse jeni mesuar t'i kontrolloni mediat tjera, ne nuk na kontrolloni kurrë.

Me nderime
Ermal Panduri
RTV Dukagjini
Drejtore Ekzekutiv
+386 49 756 500

**SHTESA (APPENDIX) 12: Reagim i D.Goxhaj,
ndaj emisionit te TV Dikagjini.docx**

On Oct 12, 2018, at 15:13, laver goxhai <lavergoxhai@yahoo.com> wrote:

Meqenese nuk e keni marre nga portalet e tjera, lutem merrni reagimin tim per emisionin tuaj te dates 10.10.2018, në të cilin keni censuruar theniet tona per veprimtarine e deshmitarit tuaj besnik kunder UÇK.

Mesojeni: Kur unë nuk iu tremba tankeve dhe bombave te Serbise, si kujtoni ju,se do t'u trembem reagimeve tuaja dhe të miqve tuaj anti UÇK? Mos u genjeje mendja.

Besoj se do te keni miresine te më dergonit edhe adresen e portalit tuaj qe une te mund te lexoj reagimet tuaja dhe te atyre që u shkruajne juve.

Por kujdes, nese do te kete fyrrje në ato shkrime, bashke do ballafaqohemi në gjykatë.

Preshendetje

Dilaver Goxhaj

lavergoxhai@yahoo.com

cel:+355 68 220 1446 Tirane

SHTESË (APPENDIX) 13: RRUSTEM BERISHA

Fjala e mbajtur në simpoziumin shkencor, më 9 prill 2000, Gjakovë

Të nderuar familjarë të dëshmorëve, të nderuar bashkëluftëtarë, i nderuar zotëri komandant i TMK-së, i nderuar ish-Komandant i Zonës Operative të Dukagjinit të UÇK-së, të nderuar mysafirë, ju falënderoj që me pjesmarrjen tuaj keni madhëruar këtë solemnitet. Jemi sot këtu për të festuar një nga ditët më të shënuara të luftës sonë.

Sot janë mbushur dy vjet (*faktikisht ky simpozium është mbajtur pas 9 muajve, D.G*) prej ngjarjes së lavdishme-

heqjes me luftë të kufirit në mes Kosovës dhe Shqipërisë, që ishte ideal i shumë brezave më parë dhe brezit tonë që luftuan e dhanë jetën e tyre për këtë qëllim. Lufta e Koshares ishte epike e madhe e UÇK-së, kjo luftë i mbledhi shqiptarët nga e gjithë bota, shqiptarët e të gjitha besimeve fetare, të të gjitha mendimeve politike. Kanë kaluar dy vite (9 muaj, D.G) nga kjo ditë. Janë bërë shumë orvatje që kjo luftë të sqarohet në një mënyrë apo tjetër. Shpeshherë, këtë e kanë bërë edhe persona të cilët nuk kanë pasur të bëjnë me këtë luftë. Është tentuar shpesh që kësaj lufte dhe atyre që e bënë atë, t'u jepet kahje dhe të përvehtësohen për interesa të politikës ditore.

Duke pasur parasysh se të gjithë ata, të cilët luftuan në këtë vijë të frontit nuk kishin asnjë ideal tjetër përveç asaj të luftës së shenjtë për atdhe dhe me qëllim të ruajtjes së këtij ideali, ne jemi munduar deri tani dhe do të mundohemi edhe më tutje që kjo vepër t'u jetë e kushtuar vetëm dëshmorëve, atdheut dhe kombit.

Parimi i luftës sonë ishte shembulli personal në udhëheqje dhe komandim.

Qëllimi ishte gjithnjë dhe do të mbetet, ngritja, organizimi dhe strukturimi i mirëfilltë me një udhëheqje profesionale të aftësuar për të zhvilluar luftën dhe për të ndërtuar paqen në ardhmëri.

Ngritja e moralit luftarak mbi bazën e motivit për luftë ishte e vënia politikë e kësaj brigade. Në këtë kontekst, lajtmotivi që kushtezoi sukseset e punës së të gjithë neve të rreshtuar në këtë brigadë ishte se politika jonë e vetme ishte lufta, e që vie si rrjedhojë e vetëdijes që karakterizon kuadrin profesional që bëri dhe që e drejtoi këtë brigadë dhe luftën në të gjitha rrafshet. Këta eprorë ishin ata të cilët

arritën profesionalizmin dhe vetëdijësimin e ushtarakëve, të cilët këtë brigadë e shndërruan në promotor të bashkimit për ata që dinë të dalin nga vetvetja duke lënë anash bindjet, idetë dhe ideologjitë e tyre për t'i bashkuar pushkët për një qëllim të vetëm-lirinë e atdheut. Sepse, “Kur pushkët bashkohen, edhe krismën e kanë më të mirë”, thoshte strategu i lartë ushtarak, heroi Agim Ramadani.

Ishte periudha e Konferencës së Rambujesë, koha e amullisë dhe e dëshpërimit të përgjithshëm, kur mëse një milionë njerëz ishin dëbuar nga trojet e veta, koha kur ende ishte i mundshëm qëndrimi i ushtrisë dhe policisë serbe në kufijtë e Kosovës, koha kur forcat e armikut i kishin marrë të gjitha masat për përballimin e sulmit të mundshëm nga forcat e NATO-s.

Nga vlerësimi i përgatitjes profesionale, teknike dhe luftarake, vëzhgimit të detajuar të forcave të armikut, moralit të lartë ushtarak dhe motivit për luftë, Shtabi i Grupit të Tretë Operativ, nën udheheqjen e shefit të shtabit, Agim Ramadani, përpiloi planin operativ për heqjen me luftë të kufirit, të cilin e miratova unë, si komandant i këtij formacioni, vendim ky, të cilit jo vetëm nuk i parapriu asnjë urdhër konkret nga cilado anë që thirrej në drejtimin e luftës, por vie nga vetë fakti që si ushtarakë të organizuar në formacione të rregullta ushtarake iu futëm luftës që në qershor të vitit '98 me veprim në rajonin e gjerë të fshatrave të Junikut, Gjocaj, Jasiq, Voksh etj. Atëbotë, situatë taktike luftarake, edhe pse të shkëputur nga tërësia e brigadës, e cila u dislokua në Lugun e Baranit, imponoi nevojën e veprimit si ushtarakë në rrethana lufte, me ç'rast bëmë organizimin e banorëve vendës për luftë, siç ishte njësi “Cobra”, njësi vëzhguese-diversioniste, e themeluar dhe përgatitur nën

kudesin profesional të Agim Ramadanit. Kjo njësi sukseset luftarake i kurorëzoi në Betejën e Koshares. Gjithashtu u bë organizimi i mbrojtjes civile nga pjesa e popullsisë jo e aftë që të sistemohet në njësi operative. Ky organizim mundësoi mbijetesën dhe në situatën e pashpresë, kur popullsia e kësaj ane mund të ishte tashmë jo vetëm pre e luftimeve intensive të ushtrisë serbe, por edhe e terrenit të paparshatshëm dhe të minuar në rajonin e gjerë të Bjeshkëve të Nëmura, si kalim i vetëm i mundshëm për evakuim. Këto ishin rrethanat që edhe më shumë e lidhën motivin dhe idenë tonë për një luftë nga kufiri e deri në çlirim, tek luftëtarët, konkretisht tek ne si ushtarakë që drejtonim këtë brigadë.

Ishte kjo një periudhë kur kuadri politik, që përfaqësonte kauzën shqiptare në qendrat e vendosjes ndërkombëtare, mendohej të krijonte vakumin kohor, që nënshkrimi i tyre të mos bartte pasoja politike, të cilat në rrafshin taktik dhe të luftës në terren shënuan përkeqësim. Edhe pse u nënshkrua, kjo marrëveshje edhe sot e kësaj dite dëshmon përmbajtjen imponuese të saj, që jo tërësisht, ishte në objektivat e UÇK-së.

Në rrethana të tilla ne si ushtarakë dhe eprorë të Brigadës 131, edhe eprorë dhe luftëtarë të Brigadës 134, që në sajë të gatishmërisë për të luftuar për çështjen e shenjtë në Kosovë, dhe të përmbajtur nga veprimi i ulët i disa bashkëluftëtarëve dhe drejtuesve të tyre, për kategorinë e të cilëve lufta nuk nënkuptonte sakrificën sublime, dhe gatishmërinë për të tejkaluar çdo pengesë, së cilës çdo natyrë, qoftë ajo teknike, taktike, strategjike, apo edhe politike, si dhe njësia vëzhguese-diversioniste “DELTA” u treguam të gatshëm që të rrestohemi në Grupin Operativ 3, njësi taktike-luftarake, që formohen për kryerjen e misioneve

të veçanta luftarake, çfarë është edhe Lufta e Kosohares, rezultatet e së cilës erdhën edhe nga bashkëpunimi ekspeditiv ushtarak me njësitë luftarake që vepronin në Rrafshin e Dukagjinit nën komandën e komandantit Ramush Haradinaj, bashkëpunim dhe bashkëveprim ky që shtrihet si në planin taktik të strategjisë globale të luftës në Dukagjin, dhe objektivit koherent të luftës si force që reanimoi rrjedhën e efektit të luftës dhe politikës në procesin e çlirimit dhe pavarësimit të Kosovës. Rezultat, pra, i funksionimit si sistem, si në planin global edhe atë intern organizativ në si brigadë dhe njësi operative-batalioneve, shërbimeve, si ai i logjistikës, ndërlihdjes e në veçanti shërbimi shëndetësor, sistem ky, që në të ardhmen mund të shërbej si burimi doktrinor për ndërtimin e ushtrisë së Kosovës.

Si komandë e përbashkët e njësi konstituive të formacionit GO-3, dhe më vonë të brigadës 138 “Agim Ramadani”, patëm një mirëkuptim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm edhe me të gjitha instancat drejtuese të luftës, të cilat nuk hezituan që edhe të na vizitojnë dhe të shprehin mbështetjen e tyre morale dhe mirëkuptimin për qëllimet tona si njësi, si dhe mbështetjen e natyrës teknike, materiale dhe në njerëz, për çka në respekt të ndërsjellë, paraprakisht ua bëmë me dije vendimin tonë për luftë nga kufiri deri në çlirim, në Zonën e Dukagjinit, për ç’gjë gjetëm mbështetjen dhe përkrahjen materiale, morale dhe premtimin për strategjinë operacionale, të cilat në ditët në vazhdim morën rrjedhën e vet për t’u karakterizuar me rezultate të larta ushtarake në terren, deri në çlirimin përfundimtar.

Vepra dhe dëshmorët të cilët sot po i kujtojmë me devotshmëri, në zemrat tona dhe të çdo familjeje kanë lënë

një hapësirë që nuk plotësohet me asgjë, por në historinë tonë kanë plotësuar një boshllëk të domosdoshëm. Ky plotësim ka nxjerrë kurorën e rezultateve, pa të cilat nuk ishim komb e as Kosova shtet. Prandaj, ju thërras: Lavdi dëshmorëve! Ju faleminderit!

Marrë i plotë prej librit : Muhamet Çetta “Me UÇK-në në Koshare”, Prishtinë, 2002, v.2, f.260-264

SHTESË (APPENDIX) 14 : RRUSTEN BERISHA *Sipas intervistës në TV Dukagjini, më 8.4.2014*

Për ta bërë një betejë të madhe duhej me bë përgatitje të mëdhaja. Ishim përgatit ushtarakisht të njësitë me armë të rënda, vëzhgime përgjatë brezit kufitar e në thellësi. Vendimin e miratova unë vet si komandant i atij operacioni. Ky plan, ishte një plan i përgatitur mirë ku i kishte objektivat e qartë sin ë fazën afat shkurtër e afat gjat. Ishte planifikuar operacion me forca. Planin e kanë përgatit njerëz profesionalë(...)

Realisht Br.138 e ka zanafillën e vet dhe në përbërjen e saj ishin tri njësi. Të tri këto njësi ishin miratuar nga Ahmet Krasniqi(...)

Ishte paraparë një operacion mashtues në drejtim të kazermës “7 Korriku”.

Armiku kishte ndërmarrë masa preventive për moslejimin e njërive të UÇK-së në brendësi duke organizuar prita të ndryshme me mina(...) (*pra, jo mbrojtje të organizuar, D.G*)

Arsyeja e një operacioni të tillë: Ne ishim të pabarabartë me serbët në armatim dhe vendosëm të ndërmerim një operacion me përmasa më të gjera. Qëllimi tjetër: të hiqej ai kufi i padrejtë.

Kosharja nuk ka qenë pjesë e operacionit “Shigjeta” Kosharja është operacion jashtë operacionit “Shigjeta”(...)

Ne kemi pas një bashkupim të mirë me Rramush Haradinaj. Bshkëpunimet janë të shumta. Ramushi nuk i ka lënë të qetë njësitë serbe të afroheshin(...)

Ne e kemi pas problem të futeshim në thellësi se na ka pengu NATO. Gjat 12 ditëve jena sulmu 4 herë nga NATO.

Ka pas djem në Koshare që as në dasëm nuk kanë shtirë me armë(...)

Kishim armë kundërkëmbserie, kundërtanke dhe artileri(...)

Fillimisht patëm 300 forca, por në vijën e parë patëm 150 forca kryesishtë. E zëmë armikun në befasi të plotë (min.29)(...)

Serbët e theksojnë Betejë të madhe për me arsyetu humbjet, prandaj dhe e krahasojnë me Betejë e Dytë e Kosovës...

Ne e kemi parapa futjen tonë në kohën kur ata kishin(...)

Në 9 prill forcat tona patën suksese shumë të madh. Kurse të nesërmen kazerma u fut në rrethim të plotë dhe u muar kazerma dhe shumë armatim e municion(...)

Pastaj filloi faza e dytë e mësymjes. (*d.m.th., kalimi në mbrojtje këta zotërinj e quajnë faza e dytë e mësymjes?! DG*)

Ne kishim staf profesional.

SHTESË (APPENDIX 15: NASIM HARADINAJ

Sipas intervistës në TV Dukagjini, 18 prill 2019

Në angazhimin e zellshëm të tv-Dukagjinit, emisioni i radhës i “debat plus”, dedikuar “Betejës së Kosharës (93-minutësh), 18.04.2019, paneli i gazetarëve kishte mysafirë Nasim Haradinajn dhe Milaim Zekën

Moderatori Ermal Panduri: “Kemi të ftuar Nasim Haradinaj dhe Milaim Zekaj, njerëz që kanë çka të rrëfejnë për betejën e Kosharës, betejë të cilën, njerëz të ndryshëm, e quaj betejë më të lavdishme, që e ka udhëheq Ushtria Çlirimtare e Kosovës, disa të tjerë thonë, është organizuar nga FARK-u. Por cila është e vërteta sipas këtyre dy njerëzve, pjesë e kësaj beteje, disa të tjerë thonë që nuk kanë qenë pjesë e kësaj beteje. (...) Bashkë me Nasim Haradinajn dhe Milaim Zekën janë edhe Fidan Rama dhe Imer Mushkolaj.”

Milaim Zeka (4’30’): “Për betejën e Kosharës ka lloj-lloj teorish. (...) Por vet fakti që ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në krye me Agim Ramadanin, kanë hangër dhe kanë pi në kazermën e ushtrisë jugosllave, e cila ka qenë kazerma nga ma t’ fortat, vetë fakti që luftëtarët e Kosharës, n’ krye me Agim Ramadanin, e kanë marrë dhe për atë flet, - edhe Beogradi po ta dëgjosh, aty është ba një luftë shumë e madhe dhe shumë heroike.” Nasim Haradinaj (7’30’): “... S’pari, UÇK-ja nuk i ka mbërri objektivat, sepse objektiva të UÇK-së kanë qenë me e çlirua Preshevën, territoret e Maqedonisë (...), ka qenë objektiv edhe Çamëria, në betim të ushtarëve të UÇK-së, prandaj as në betejë të Kosharës nuk është mbërri objektiv. Pse nuk janë mrrë këto objektiva, nuk duhet me u ndie i fyem.” – përgjigjet Nasimi në pyetjen e moderatorit, nëse “beteja e Kosharës” ka realizuar objektivin, hapjen e korridorit për furnizim të UÇK-së në Kosovë.

Milaim Zeka (10'45"): "Nasim Haradinaj ka qenë i dërguar nga Shtabi i Përgjithshëm në betejën e Kosharës, dhe njerëzit më kompetent me fol për betej të Kosharës janë Rrustem Berisha, Nasim Haradinaj, Kudusi Lame dhe Xhafer Gashi..."

Nasim Haradinaj ndërhyrë: "Xhafer Gashi për betejë të Kosharës, kurse Kudusi Lame për përgjithësi."

Nasim Haradinaj: (11'25"): "Kemi pas marrëveshjen me fol për Kosharën vetëm na tre, unë, Rrustem Berisha dhe Xhafer Gashi, por Rrustemi e ka thye marrëveshjen. (...) Sa më shumë të vonohet Rrustem Berisha, me u ul me mua, pavarësisht nëse është ministër dhe unë i dukem i vogël, jam kanë mbi ministër për ta, e dinë ai mirë, dhe e dinë ai se katër herë e kam shty urdhnin për shkarkim të tij si komandant ... udhën nga Shtabi i Përgjithshëm. (...) Kjo Brigadë ka qenë nën komandën e Ramush Haradinajt. (...) Brigada e Kosharës janë rreshtuar para Azem Sylës, Jakup Krasniqit, Plakut dhe meje (...) edhe Anton Quni, edhe Rrustem Berisha. (...) Kosharja ashtë vendos pse kemi mrrri marrveshje unë, Rrustemi, Agimi dhe Xhafer Gashi dhe e ka aprovua Sali Çeki. Për këtë unë jam sulmuar pastaj, nga Zona e Dukagjinit, si FARKist, ndërsa Rrustemi, Agimi, Sali Çeki janë sulmuar nga të tjerët si Lëvizje, pse u bam bashkë. Unë kam garantuar në Shtab të Përgjithshëm, konkretisht para Xhavit Halitit dhe Jashar Salihit, se këta djem, Rrustem Berisha, Agim Ramadani, Xhafer Gashi, Sali Qeki, nuk na mashtrajnë. Me Anton Qunin nuk kam ba marrëveshje..."

Nasim haradinaj (25'10"): "Momenti për datë, për ditë dhe për minutë (të sulmit në Koshare, konkretizim nga unë) është raportuar edhe në Shtab të Përgjithshëm..."

është eskivazh anashkalues i përgjigjes konkrete në pyetjen: “kush e ka marrë vendimin për betejë të Kosharës”.

Milaim Zeka: Duhet me dit se ushtarët qajshin pse nuk i lejojshin të përparonin këta komandantët që sot e glorifikojnë Betejën e Koshares.

Nasim Haradinaj (36’30”): “Marrëveshjen (për sulm në Koshar), e kam bërë me njerëz të revoltuar të FARK-ut...”

Milaim Zeka (37’50”): “Është fakt që në Dukagjin ka pas hy një brigadë e FARK-ut, e komanduar nga Tahir Zemaj e Nazif Ramabaja. Por është fakt, gjithashtu, që edhe në atë brigadë kanë qenë dy njerëz të njohur të Lëvizjes, Lum Haxhia (Hajdin Abazi, konkretizim sqarues nga unë) dhe Kamer Elezaj, i cili ka qenë shok i ngushtë i Fehmi Lladrovci...”

Nasim Haradinaj (42’30”): “Ne, që kemi vendos me u bashkua, e kemi ba Rrustem Berishën komandant, sepse ka qenë më i pranueshme për të gjithë(...)”

Nasim Haradinaj (67’50”): “I vetmi që u ka dhënë leje gazetarëve, me raportua për betejë të Kosharës, ka qenë Jakup Krasniqi, nuk ka dhënë FARK-u(...)”

Nasim Haradinaj (79’50”): “Kosharja ka pas me u thye më 1 prill. Por është shty për një javë. Për këtë shtymje ka pas edhe udhën-arrest, pse ka ndodh shtymja. Shtabi i Përgjithshëm kishte arsye të lëshonte urdhën-arrest, sepse e kishim informuar që sulmi do të ndodhte me 1 prill(...)”

Shtesë (appendix) 16: ANTON ÇUNI

Sipas intervistës dhënë TV Dukagjini, më 02 maj 2019.

“Kur jam paraqit për herë të parë në një objekt të

Ministrisë së Mbrojtjes, në dhomën operative, ka qenë në mur një hartë, - kjo ka ndodh në fillim i korrikut 1998, - e cila ishte mbuluar me një stof. E shpalosa. Aty pashë se dikush kishte parapa një ndërhyrje strategjike që të kishte hapje të kufijve, në Qafë të Prushit, Qafë të Morinës. Nuk ishte evidentuar Kosharja(...)

E kemi paraparë për një ndërhyrje(...)

Në atë kohë nuk kishte ndonjë ide për hapjen në Koshare(...)

Hapjen e kufirit duhet ta kenë paraparë edhe ata të SHP dhe komandat e zonave (...)

Ne, në një moment në qendrën stërvitore në Papaj janë gjend eprorët dhe ushtarët e brigadave 131, 134 dhe të batalionit diversanto-vëzhgues dhe ishte paraparë që të hapej kufiri. Derisa që gjallë Ahmet Krasniqi nuk e ka pas këtë ide. Çdonjëri e kanë pas idenë se duhet me u hap kufiri.

Duhej të hapej kufiri për nevoja të ndryshme që të ekzistoi një hapësirë e lirë për të kaluar furnizime nga Shqipëria në Kosovë. Këtë ide duhet ta kenë pas edhe këta të SHP, komandantët e zonave(...)

Jo të gjitha kalimet kanë qenë të sigurta(...)

Kur flasim për ushtarakë, janë në pyetje Rrustem Berisha, Agim Ramadani, Sali Çekaj, që të gjithë vartës të drejtpërdrejtë të kolonelit Ahmet Krasniqi. Edhe unë, si komandant i batalionit diversanto-vëzhgues, isha nën komandën e Ahmet Krasniqit. Deri sa Ahmet Krasniqi ka qenë gjallë, ne nuk e kemi materializuar këtë ide. Kolonel Ahmet Krasniqi nuk e ka pas idenë të ndërmerret një operacion në regjionin e Kosharës. (...)

U zgjodh Kosharja për të krijuar epërsi dhe aty do të mund të minimizonim të gjitha avantazhet që kishin

forcat serbe. Plani i Koshares është bërë nga ushtarakët e komanduar nga Kolonel Ahmet Krasniqi(...)

Kishim informacion se kishte forca ushtarake brenda por që nuk kishin municion e armë për të vepruar(...)

Kemi kërkuar që të kemi mbështetje edhe nga SHP edhe nga Ministria e Mbrojtjes

Ne, siç kemi punue me kolonelin Ahmet Krasniqi, kemi punue edhe me Kolonelin Halil Bicaj. (...)

Meqë jemi përcaktuar të kishim bashkëpunim edhe me Shtabin e Përgjithshëm, njeriu më i afërt, i pranishëm aty, ka qenë Nasim Haradinaj. (...) Pas një kohe Nasim Haradinaj ka organizuar një takim në qendrën stërvitore në Papaj mes Rrustem Berishës, Agim Ramadanit, Sali Çekaj, meje, me Jakup Krasinqin, si përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm. (...) Gjatë bisede nga ne nuk është kërkuar të heqim dorë nga përgjegjësia që kishim ndaj ministrisë së mbrotjes, që të kalonim vetëm nën komandën e Shtabit të Përgjithshëm. (...)

Rrustem Berisha me ka treguar që Koloneli Halil Bicaj i ka dërguar tre përfaqësues, të cilët kanë kërkuar që ata ta udhëheqin operacionin. Kjo është fakt. Kolonel Rrustem Berisha ju ka thanë se mund të angazhohen në detyra specifike, ‘por ky operacion tashmë ka filluar dhe ne do të vazhdojmë me realizimin e operacionit’.

Në rastin tonë nuk ka ekzistuar asnjë komandim i veçantë, as me gojë as me shkrim. Thjeshtë, ishte marrëveshje mes komandantëve të brigadës 131, 134 dhe batalionit diversanto-vëzhgues. Udhëheqësit e këtyre njërive kanë qenë Rrustem Berisha, Agim Ramdani, Sali Çeku dhe unë. Do të thotë është marrëveshje e mbrendshme. Në kohën kur ne kemi arrit një marrëveshje të mbrendshme,

që mund ta hapim një korridor për furnizim të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ne nuk kishim fare kontakt me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së. Ne ishim të lidhun drejtëpërsdrejtë me Minsistrinë e Mbrojtjes. Ndërkohë janë realizuar kontaktet, por nuk kanë qenë kontakte që ne të hyjmë nën komandë të Shtabit të Përgjithshëm, por kanë qenë kontakte për bashkëpunim e koordinim sa më të mirë. Për këtë bashkëpunim kemi pas mirëkuptim edhe nga Ministria e Mbrojtjes (...) Edhe Shtabi i Përgjithshëm ka pas mirëkuptim që ne ishim pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes...”

Duhej me e hap kufirin për nevoja të ndryshme, që të ekzistonte një hapësirë e lirshme për të kaluar nga Shqipëria në Kosovë(...)

Kemi bërë 23 kalime kufitare për të përcaktuar vendin ku dhe si të kalonim(...)

U zgjodh Kosharja për të krijuar epërsi dominuese për të minimizuar të gjitha avantazhet që kishin forcat serbe (...)

Plani ynë ka qenë shumë më herët. Plani i Koshares është bërë nga ushtarakët e komanduar nga kolonel Ahmet Krasniqi. Kemi kërku që të kemi mbështetje edhe nga SHP edhe nga Ministria e Mbrojtjes. Nuk është kërkuar që të hiqnim dorë nga Ministria e Mbrojtjes, por një disponim të dyanshëm.

Kanë qenë dy grupime UÇK(...)

Në një emision tjetër, rrokum-tv, më 24.03.2017, me rastin e përvjetorit të fillimit të bombardimeve nga NATO, z.ANTON ÇUNI ka rrëfyer: “Në ditën e sulmimit ishim 160 forca, ditën e fundit të luftimeve ishim 2.600. Në përbërje të 2.600 luftëtarëve.”

Edhe KTV-ja nuk është përmbajtur pa dhënë kontribut

të saj në (dez)informim zhurmues për “betejë të Kosharës”. Në emisionin “interaktiv”, 11.04.2018, është ftuar Anton Çuni, ndërkohë si më sharmanti për këto sqarime.

Anton Çuni (1’15”): “Brenda nisive apo brigadave 131, 134, dhe batalionit diversanto-vëzhgues, u arrit ni marrëveshje, gjithni duke u konsultuar, këshilluar dhe duke kërkuar ndihmë nga ministria e mbrojtjes e Republikës së Kosovës, nën udhëheqjen e kolonelit Halil Bici, dhe në raport me Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u dakordua që në një hapësirë gjeografike në mes të Shqipërisë dhe Kosovës duhet të hapet një korridor...”

Ndërsa në bisedën me gazetarin Muhamet Çetta gjatë muajit maj 1999, (vell.2, f.129), Antoni thotë: Në 23 shkurt 1999 ka zbrit në Durrës dhe pas disa ditësh shkon në Babinë, ku tregon: “ Në Babinë takuam edhe oficerë në mesin e të cilëve edhe Rustem Berishën, i cili ishte komandant i brigadës.

Derisa po stërviteshim në Kalimash, edhe pse i provuam, pothuajse të gjitha llojet e armëve, duke përfshirë edhe topat 120mm, nuk ishim ndonjë project luftime se nga do t’ia mësynim për t’u futur në Kosovë. Projektin e gjetëm në Babinë, i hartuar nga ushtarakët: Agim Ramadani, Rustem Berisha dhe Sali Çeku (për këtë unë kisha mësuar se ata ishin hartues të projektit për thyerjen e kufirit në Koshare), porë dhe oficerë të tjerë që drejtonin njësitet ushtarake në mënyrë profesionale. Në Babinë kam takuar po ashtu edhe officer Skënder Ahmetxhekajn, i cili në Koshare ishte edhe komandant imi.... Pas shkuarjes sonë në Padesh... kishte mospajtime të atyketushme lidhur me datën e saktë kur do të ndërmerrej sulmi ndaj forcave serbe (....)

Ne i kemi filluar luftimt në 8 prill, pasdite, dhe

gjatë orëve të mbrëmies. Unë isha i vendosur në Rasë të Koshares... Atë ditë nuk ia kemi dalë që tëa thyejmë kufirin, por kemi marrë 5 deri 6 kilometra pozicione, në të cilat deri atë ditë ishin të pozicionuara serbët.... Dhe të nesërmen, pra, në 9 prill u muar kazerma e Koshares.... Brigada “Cobrat”, pas vrasjes së Agim Ramadanit udhëhiqej nga Naser Vllasi., ndërsa njësitet e mëparshme dhe njësitë që ishte nga drejtuar Skënder Ahmetxhekaj (në të cilin isha dhe unë)u shkrinë nëpër batalione dhe njësite të tjera.”

SHTESË (APPENDIX) 17: Shkruan oficeri MUSA GJAKOVA

30 prill 2019

Më habiti analiza për betejën e Koshares së z.Dilaver Goxhaj, më shumë më ngjason si një elaborim i nivelit të një kadeti të akademisë ushtarake dhe vlerësimi i një gjenerali që bie ndesh me situatën e kohës së prillit 1999. Reagimi juaj z. Goxhaj, pas dy dekadave është qesharak dhe paradoksal me qendrimet tuaja personale të ndikuara nga keqëdashësit e vlerave të luftës së Koshares.

Shifet qartë që juve gjeneral ju mungojnë shumë të dhëna edhe ato që i posedoni i interpretoni me injorancë duke u fokusuar vetëm me “327”- ën...Aq i zbehët është përshkrimi sa që mua më lë përshtypje një plasim gazetaresk nga një i dehur...

Po që se nuk mjaftojn dhe të mungojnë fazat e zhvillimit të betejës që ka zgjatur 67 ditë, deri me 14 qershor 1999, atëher studioni hartat luftarake të forcave serbe të

angazhuara në këtë betejë. Nëse skeni aftësi t'i zbërtheni drejt ato do të ju ofroj ndihmën time profesionale.

Të dhënat mbi forcat e armikut të angazhuara në Koshare që vetë i paraqesin ata janë: batalioni kufitar 53 i Brigadës 125 të Ushtrisë jugosllave, e përkrahur nga policia serbe, batalioni i II i Brigadës 125 të motorizuar, pjesë i Brigadës së parashutistëve, pjesë e Brigadës 72 të njësiteve speciale, njësitet e policisë së Korpusit të Prishtinës, njësitët e policisë së korpusit të 2 beogradase të përforcuara me policë nga ish vendet jugosllave, detashment të huaj me forca vullnetare e mercinarë, detashmenti “Kozak” i ardhur nga Rusia, pjesëmarës nga lufta në Qeçenj, mbeshtetja nga eskadrila e aviacionit sulmuese-bombarduese të armatës jugosllave. Gjeneral, ju nuk keni aftësi si shifet që të studioni betejën edhe pse i shmangesh realitetit dhe plason broqkulla qe se di kujt i shërbejn...

Beteja e Kosharës mbetet shembull se me një plan luftarak të hartuar nga GOP-3 në krye me Shefin e Shtabit Agim Ramadanin, e miratuar nga KOM Rustem Berisha, u realizua në tërsi dhe me sukses më veprime taktike të subordinuara dhe të koordinuara me sistem komandues unik të një force në numer të vogël, të kryen sulmin duke e shpartalluar në panik tërë atë makineri të shumëfishtë ushtarake serbe.

Juve po të ishit më afër betejës e pse jo edhe pjesëmarës do ta kuptonit “ferrin e betejës” për forcat serbe që ata vete e pranojnë. E theksoi se beteja e Koshares mbetet betejë e lavdishme e UÇK-së që përfaqëson simbolin e unitetit, bashkimit dhe të krenarisë.

Kjo betejë mbetet njera ndër hallkat më të fuqishme në zinxhirin e pakëputshëm të luftës së Kosovës.

Autori është ish epror i Brigadës 138 “Agim Ramadani” të UÇK-së, i plagosur në betejën e Koshares.

SHTESË (APPENDIX) 18: **Gjenerali serb VLADIMIR LAZAREVIÇ**

Nga Kosova ika duke qarë, Kosharja ishte një Vietnam. Kosharja ishte Betejë e Dytë e Kosovës...

Gazeta Express E shtune, 11 Nentor 2017 12:10

Gjenerali i pensionuar serb, Vladimir Lazareviç, I cili ishte komandant I Korpusit të Prishtinës të Ushtrisë Jugosllave gajtë luftës në Kosovë, zbulon dëshmitë e tij nga koha e luftës dhe tmerrin e Betejës së Koshares

“Sulmi ishte i tmerrshëm, dhe armiku ishte shumë, i armatosur mirë, me mbështetje të mirë ajrore dhe instruktorët më të mirë të NATO-s ... Ishte një Vietnam në miniaturë. Nuk ishte beteja vetëm e Karakollit të Koshares, ishte një front prej 15 kilometrash”, transmeton Telegrafi.

“Ishin këputur të gjitha lidhjet me vijën e parë të frontit. Unë merrja raport nga ura ime komanduese. Përveç përshkrimit të hollësishëm të këtij kaosi, ai tha: ‘Ne do ta mbrojmë kufirin me çdo kusht!’, me shkronja të theksuara. U rrëqetha kur i lexova këto fjalë dhe u përgjigja: ‘Mbajeni, mbrojeni Serbinë. Ne po vijmë’, dhe këtë do ta kujtoj derisa të jem gjallë. Ne shkuam në vijën e parë të luftimeve. Në atë kohë, gjeneral Pavkoviç ishte gjithashtu pranë meje, i cili përshëndeti fjalët e mia dhe urdhëroi të ashtuquajturin homologun tonë nga ana jonë”. transmeton Telegrafi.

Sqarim: Gjenerali i pensionuar serb, Vladimir

Lazareviq, ishte dënuar nga Tribunali i Hagës me 14 vjet burg, për përgjegjësi komanduese për krime të luftës në Kosovë.

Ai në Hagë është dorëzuar më 3 shkurt 2005. Është dënuar sipas përgjegjësisë komanduese, pasi që në luftën e vitit 1998-99 në Kosovë ka qenë komandant i Korpusit të Tretë të Prishtinës, e më pas edhe komandant i Armatës së Tretë të Ushtrisë së Jugosllavisë.

Së fundmi Serbia e ka emëruar gjeneralin e dënuar për krime lufte në krye të Akademisë Ushtarake, gjë që ka nxitur reagime të fuqishme edhe të faktori ndërkombëtar.

SHTESA (APPENDIX) 19: Ish ushtaraku serb DRAGAN KAMENOV

**Unë personalisht hodhi rreth 45 mijë mina
(predha) në Koshare**

Gazeta Express, 2 Maj 2019, 12:53

Një ushtarak serb që ka marrë pjesë në Betejën e Koshares, ka thënë se gjatë kohës sa zgjatën luftimet në këtë zonë, vetëm ai personalisht ka hedhur afër 45 mijë mina (predha) në drejtim të ushtarëve të UÇK-së.

“Mesatarisht në ditë i kam hedhur nga 1 mijë e 200 deri në 1 mijë e 300 ose 1 mijë e 400 mina” (predha), *përcjell klankosova.tv*, deklaratat e Dragan Kamenov, ish komandanti i togut minahedhës të brigadës së 2-të të motorizuar të Ushtrisë Jugosllave, të dhëna për dokumentarin “Rrëfime lufte nga Kosharja”, të punuar rishtazi nga televizioni shtetëror serb RTS dhe Zastava Film nga Beogradi.

“Për aq sa më kujtohet, besoj që personalisht i kam hedhur nga 40 mijë deri në 45 mijë mina (predha)”.

“Gjithmonë ndodhte diçka, kështu që mua më duhej të veproj dhe t’u ndihmojë 24 orë pandërprerë”, ka shtuar ai, *transmeton klankosova.tv*.

Në këtë dokumentar, ushtarakët serbë pranojnë se patën humbje të shumta nga UÇK-ja, ndërsa tregojnë se edhe dëmet që ata ua shkaktuan pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishin kryesisht falë shfrytëzimit të minahedhësve.

SHTESA (APPENDIX) 20: AGRON JUSUFI

(Pjesmarrës në Luftën e Koshares)

Si e nisëm betejën e Koshares me hiç më shumë se 300 ushtarë

Gazeta Express, E martë, 11 Prill 2017 07:01

“Numrat nuk kanë qenë të rëndësishëm, por forca dhe vullneti me të cilin është udhëhequr ajo betejë. Megjithatë nuk ka pasur më shumë se 300 ushtarë në fillim të aksionit”, ka deklaruar Jusufi, i cili më pas tregoi se si atyre u ishin bashkuar ushtarë e ushtarë për ta vazhduar betejnë që kishte zgjatur me muaj.

“Beteja e Koshares ka zgjatur me muaj. Ka pasur luftime të ashpra dhe në distanca shumë të vogla. Ka pasur përleshje të afërta me njësitë paramilitare serbe”.

“104 të vrarë mbi 250 të plagosur kanë qenë serbë, sipas të dhënave të serbëve”.

“Nuk mund të flitet për luftën e UÇK-së e mos të përmendet beteja e Koshares. Kjo betejë është e njohur edhe nga NATO si një betejë vendimtare në luftën për çlirimin e atdheut”.

“Ishte betejë që e rrëzoi edhe mitin e ushtrisë serbe, por edhe pretendimin e tyre për Kosovën”.

SHTESË (APPENDIX) 21: FISNIK ISMAILI 20 prill 2019 (fsb)

Tash, për detyrat e mia gjatë Betejës së Koshares:

Gani Begun, komandantin tim, e kam takue rastësisht në fshatin Babinë afër Bajram Currit, në fillim të prillit 1999. Edhe ai kish ardhë prej Londre edhe njiheshim prej atje. S’ishim pa nja 6 muej, edhe s’e kishim pasë idenë për njani tjetrin që ishim nisë për luftë.

Ishte dita ime e dytë aty, në një shkollë të improvizueme, të shndërrueme në mini kazermë, në të cilën ushtarët stërviteshin 2 javë, para se me shkue në front. Atë ditë i kisha shkrepë 3 ose 4 plumbat e mi të parë në jetë, duke i gjue do kanaçe me pushkë 10-she, si pjesë e njësitit të artillerisë së lehtë me minahedhës 80 mm.

U gëzova kur e pash Ganën, e ai u gëzue edhe më shumë, sepse komandanti i kazermës, Musë Dragaj, i kishte thanë me gjetë ushtarë për me e krijue repartin e ndërlidhjes, e aty s’ish se kishte ushtarë që merrshin fort vesh në këtë punë. I thasë që as unë lidhje me radiolidhje s’kam, por ai

insistonte se di më shumë për teknologji se krejt tjerët aty bashkë, edhe se e mësoj shpejt.

Me urdhër të Musës, u krijue reparti i ndërlidhjes me mue dhe Ganiu, ky ndërlidhës me shkollë nga akademia ushtarake në Sarajevë dhe shumë vjet shërbimi në aeroportin e Sllatinës, të cilëve na urdhëruen me u nisë për front menjherë të nesërmen, meqë beteja në Koshare sapo kish fillue do ditë, e kush idenë s'kish se çka ndodhke. As gazetarët nuk lejoheshin me vazhdue përtej Babinës.

Rruga deri në fshatin Papaj, që ishte fillimi i zonës së luftës në brezin kufitar, ishte e lehtë deri te Dheu i Kuq me një veturë, por mbas asaj na u desht me vazhdue përpjetë duke ecë, meqë granatohej ajo pjesë brenda në territorin e Shqipërisë nga forcat serbe. Pjesën tjetër e kemi ba në kambë, që për një esnaf si unë, me 140 kg trup edhe cantë 40 kg në krah, e një çantë me skener edhe aparat dixhital Kodak (i posadalun në treg, 700 funta e kisha ble) në dorë, një rrugë si ajo malit përpjetë ka qenë tmërri vetë.

Në Papaj, hala pa mbërri mirë me pushue dy minuta, na del Anton Quni përpara, për të cilin as idenë nuk e kishim kush ishte, i gjatë, me uniformë dhe pamje të një ushtaraku të shkëlqyem, por me një fytyrë që na i shtini ethet, e sy të haptë që të bante me mendue se është ndojfarë bishe i pa mëshirë, e që sot hala bajmë hajgare me këtë tregim. Ky na urdhëron me vazhdue tutje, e na as lidhjen ma të vogël s'e kishim se ku po shkojmë.

Pika e territ, në një terren plot lloç e borë, na zuni rrugës për Padesh, një fshat në rrotë të qyqes pa rrymë, ku e kuptuem se një shtëpi e vogël dykatëshe prej guri, me dyer të ulëta që më bijshin deri te gjoksi, ishte komanda e Betejës së Koshares.

Atë natë u takuem për herë të parë me komandantët e brigadës në një dhomë të vogël, te ndriçueme me qirinj edhe flakën e kaminit, e dritare të mbulueme me batanije, mos me na pa armiku. Më kujtohen Rustem Berisha dhe Sali Çekaj. Ishte dita kur ish vra Agim Ramadani, e unë e Ganiu s'e kishim idenë. S'e kishin idenë as ushtarët tjerë, nga të cilët e mbanin lajmin fshehtë, që mos me ua ulë moralin. Kufini ishte thye veç pak ditë më herët me vetëm 150 veta, ishte kaos, ishte kohë shumë e ndjeshme edhe rrezik shumë i madh me dështue gjithë ai mund e përkushtim.

Na u caktue një dhomë e vogël edhe një kohë shumë e shkurtër me i instalue pajisjet, centralet ndërlihdhëse, e krejt mjetet që nuk ishin vu në përdorim. Komunikimi ishte kaotik, me radiolidhje të vogla e vijë fronti që zgjerohej, deri sa u rrit distanca aq shumë, sa që nuk dëgjoheshin me njani tjetrin shpesh, se nuk mbërrinin valët.

As vetë nuk e di se qysh, as saktë çka kemi ba. Me një agregat të vogël që përdorej për mbushje të disa baterive, për 5 ditë e shndërruem dhomën tonë në një ambient hi-tech përplot pajisje. Komunikohesh pa problem në distanca të mëdha. E tanë beteja, çdo aksion e çdo veprim, dëgjohej në dhomën tonë. E mbaj mend kur u pat futë Rusta mbaa 5 ditësh në dhomë, na pat kqyrë me habi e pat thanë “Çka qenkeni ju kështu, o hej?”

Deri në fund të luftës u patën bë diku mbi 150 radiolidhje e diku 1500 ushtarë. Të verdhat Grundig, që ishin diku rreth 20, e që nuk përgjoheshin se i kishim të kodueme, përdroeshin nga komandantët kryesorë, dhe aty flitej më lirshëm për veprimet. Tjerat, të zezat, përdroeshin nga komandues togjesh e ushtarë kyçë, për komunikim që nuk e kompromitonte betejën. Detyra jonë ishte me dëgjue

me kujdes, me u sigurue që, nëse dy veta nuk dëgjoheshin, me shërbye si urë komunikimi, dhe me u sigurue që asnjë prej 150 radiolidhjeve nuk mbetet pa bateri, në një mal të madh pa rrymë.

E kishim një Motorola të vogël të një komandanti të vrrarë serb (të cilën e mbaj suvenir), e cila shërbente me i përgjue pak se çka po flasin, meqë sinjali nuk mbërrinte larg. Nxirrim tek tuk informata, deri na erdhi Burim Berisha një ushtar entuziast, student shumë i kfilltë i elektros, i cili u ofrue me na ndihmue me riparue radiolidhje të prishuna, edhe na tregoi për centralin e komunikimit serb në karauillën e Koshares, të cilën e kishin hudhë në podrum edhe dojshin me e kallë. Të nesërmen me një gomar të ngarkuem, na e pruni centralin dhe u bë pjesë e ekipit tonë.

SHTESË (APPENDIX) 22: oficeri NASER VLLASI

Në emisionin e TV Dukagjini “debat plus”, më 23.04.2019

Naser Vllasi, pjesëmarrës në luftimet në Koshare, si komandant i Njësisë “Cobra”. Paneli i gazetarëve: Ermal Panduri moderues i emisionit, dhe Ilir Mirena, Astrit Gashi e Fidan Rama.

Naser Vllasi (minuta 3, skundi 10 / 3’10”): “Njësinë kobra aty (në Koshare – konkretizimi sqarues nga unë) është llogaritë si njësi elitare, sepse është ngarkuar me detyra shumë speciale. Ketë njësi gjatë vitit 1998 e ka themeluar vet Agim Ramadani, i cili e ka udhëheq deri sa më ka caktuar mua komandant të kësaj njësie. (...)

Kam marrë pjesë në Luftën e Kroacisë. Kam shërbyer në kuadërtë brigadës 134, togu diversant trupa antiterroriste. (...) Marrëdhënia ime me Ahmet Krasniqin ka qenë besueshmëria, sepse unë jam n' mes e 16 eprorëve e shërbimit informativ ushtarak të ministrisë së mbrojtjes, ku në stafin e tyre, deri sa ishte ministri në jetë, jam unë njani prej tyre. (...) Në momentin pas vrasjes së ministrit tonë të parë të mbrojtjes është caktuar ai tjetri, ashtë ai Halil Bicaj. (...) Marrëdhëniet e mia kanë qenë të mira me ministrin, Ahmetin, sidomos me zv-ministrin Agim Mehmetin, i cili ka qenë një prej shtyllave e organizimit të strukturave të ministrisë së mbrojtjes.”

Naser Vllasi (6'20”):” Në shërbimin informativ ushtarak në kuadërt të FARK-ut të ministrisë së mbrojtjes kam qenë unë pjesëtar, por ka qenë edhe një pjesëtarë i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, i cili tani ka funksione të larta politike, emrin e të cilit nuk është nevoja ta përmend akoma. Në të gjithë e dimë si janë formuar celulatat e para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e sidomos ne ushtarakët që kemi shërbyer në Kroaci, Slloveni, Bosnjë. Gjatë vitit 1990-91 ka qenë një bërthamë, e cila është iniciativë e ushtarakëve, ku ka qenë Tomë Berisha. (...) FARK-u i parë formohet në vitin 1998. (...) Në Kroaci kam qëndruar deri në vitin 91, 92, 93, kohë pas kohe jam kthye e shkua (...)”

Naser Vllasi (11'5”): “Në korrik të vitit 1998, si epror i shërbimit informativ ushtarak, e kam takuar Xhavit Halitin në Tiranë, por jo me detyrë të caktueme. Jemi takuar spontanisht. Se në atë kohë vinin ushtarë nga t' gjitha anët që të futen brenda në Kosovë. N' atë takim, atë mbramje, në atë lokal, Xhavit Haliti mua më ka lënë përshtypje pozitive. (...) Aty vet Xhavitit e ka konfirmua se ushtarët që nuk janë

t'përgatitun, duhet t'shkojnë n'baza t'ministrisë mbrotjes. Ata janë ushtarakët t'cilët i kanë disa baza n'territorin shqiptar, përgatisin njësitë dhe ato njësi futen brenda n'Kosovë. (...)"

Naser Vllasi (14'10"): "Ahmet Krasniqi, kur është emnue ministër, ma s'pari e ka tagur Sali Çekun, pastaj ka vazhdue i ka takuar edhe t'Shtabit t'Përgjithshëm UÇK-së. Fatkeqësisht bashkimi nuk ndodhi, edhe pse e dëshironte ushtari dhe komandanti që ishin në vijën e parë. Janë disa qarqe të caktuam, që po i shohim edhe tani, të cilët nuk duan t'i pranojnë disa realitete. Lufta është nis me shtabe lokale, me nisitë. Na që kemi pas informata, fakt ashtë që agjunkturat serbe janë fut mrena nisiteve, brenda ministrisë dhe kanë arrit me na përça. (...) Unë jam kanë epror i zbulimit, Besnik Osmani ka qenë i kundërzbulimit i shërbimit informativ ushtarak t'ministrisë së mbrotjes. Kemi pas shefin, analitiken, t'gjitha i kemi pas. (...) Unë ia kam përcjell informatat shefit tim, Ali Hazirit, ushtarak nga Drenica. Besoj është gjall, jeton me familje në Bosnjë. Kontaktet me Shtetin shqiptar i kanë mbajt ushtarakët tjerë, si Skender Hasimi, Hilmi Nebiu, t'shërbimit informativ, ata janë takuar, Agim Mehmeti, ministri sa ka qenë n'jetë. Ne sipas hiarkisë kemi vepruar."

Naser Vllasi (19'50"): "N'momentin kur ashtë vra Ahmet Krasniqi unë jam gjet në shtabin nr. 1 në Tiranë, afër vilës së Azem Hajdarit. Kanë qenë orët e vona të 21 shtatorit. Mrena shtabeve ishim të veshun n'uniformë. Hin Mhedî Maloku i Llapit dhe thotë: 'e vranë bacën'. Na e morëm si lajm tronditës (...) Dyshonim se një pjesë e shtetit shqiptar ishte inkriminuar, se këto vrasje nuk arrihen pa ndihmën e shtetit. (...)"

Naser Vllasi (24'10"): "Hartimi i planit për thyerjen e kufirit nuk ashtë ba n'kohën deri sa ka qenë Ahmet Krasniqi ministër, kjo bahet pasi vjen Halil Bica. Në fakt në bazën stërvitore, - QSU i thoshin qendrës stërvitore ushtarake, - n'Papapaj, aty janë fillua përgatitjet e stërvitjet me muaj më herët, ku janë stërvit ni numër i vogël i ushtarëve, ku ne kohë pas kohe ju kemi krye revista, inspektive, asaj baze, si njerëz t'shërbimit informativ. Por n'atë kohë s'e kanë dit rrolin tim. E kanë dit që jam në G2, por nuk e kanë dit që jam për zbulim. Vetëm Sali Çeku ka pas informacion, - prej kujt nuk e di, - dhe Nasim Haradinaj e kanë dit se jam G2. (...) Kur u takuam me Nasimin me pyeti a je njer i shërbimit informativ t'ministrisë. I thash: po. Nasimi tha: 'jemi bashkë'. I thash ajo ashtë e ditun. Vet dëshira e ministrit tonë të parë ka qenë që të jemi bashkë."

Naser Vllasi (27'20"): "Agim ramadani ka qenë shef i grupit operativ tre (3). Hera e parë kur e takoj Agim Ramadanin ashtë data 29 nator 98. Për Agimin m'ka fol vllau im, Nehru Vllasi, i cili ka qenë i angazhur në fillim në themelim të ministrisë mbrojtjes, me shokë. Edhe ai ka qenë pjesë e ministrisë mbrojtjes, prej fillimit deri n'fun. Ai me thotë nëse do me vazhdua luftën dhe me pas suksese, janë këta n'Papaj. Agim Ramadanin nuk e kam njoft deri atëherë. Në Papaj i kam takuar Agimin, Rustem Berishën. Në këtë dokument shihen shënimet për brigadë 131, prej kujt merren pajisjet. Rustem Berisha komandant, shifra 3.11, GD Naser Vllasi. Ua marrë atyne 9 radiolidhje. Nuk kem pas nevojë t'i pyesim. Nënshkrimet poshtë të komandantit Rustem Berisha, nënshkrimi im dhe i shefit të shtabit qendror të Forcave të Armatosura të Republikës Kosovës, se duhet me i dallue."

Naser Vllasi (31'10"): "FARKu ka ekzistuar në Tiranë, edhe ministria e mbrojtjes së Republikës Kosovës ka ekzistuar në Tiranë. Në Kosovë ka qenë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. (...) Në Koshare luftuam si UÇK, e cila është dashtë të jetë pjesë e FARK-ut, edhe pse ka disa që tani nuk po i pranojnë marrëveshjet.(...) Diku në fillim të muajit mars (1999) ka qenë një vizitë e Jakup Krasniqit, Azem Sylës, Gjeladin Gashit "plakit", - ai mue m'ka dashtë shumë, - edhe nga ajo vizitë e mbrapa, - sipas vlerësimit tim, - meqë kam qenë për disa informime e vlerësime, - më 7 mars shkoj në Tiranë dhe thom gjithçka, struktura e GO-3 ashtë formuar pa naj emrim apo plan t'Ministrisë Mbrojtjes. Në GO-3 ka pas komandantë dhe ushtarë të tri nisive, të brigadës 134, 131 edhe batalionin diversanto-vëzhgues që e ka udhëheq Anton Quni.(...) Kobra e ka marrë emnin nga Agim Ramadani, në vitin 1998, me themelimin e saj me djemë ma t'imrë t'fshatit Gjocaj, Jasiq, Junik, atyne pjesëve. Vetëm Agimi e ka ditë në nantor 98 se unë jam i ministrisë. (...) Gjatë vitit 1998 kam vepruar, edhe në nisitit hekuri, n'Mrasor, të Komuna e Klinës. Edhe n'zonën ku ka qenë komandant Binak Gashi, edhe komandant i imi. Aty ka qenë edhe Fadil Gashi, i cili e ka njoft vetëm strukturën e ministrisë mbrojtjes. Binaku me dyjat. Une me dyjat. (...) Unë kam fjet me 31 gusht e 1 shtator 1998 në Drenoc t'Zatriqit me ni odë me Hashim Thaçin, Bislim Zyrapin, Rexhep Selimin dhe vozitsin e tyne. Ka pas edhe tjerë aty. Jam kanë nën komandë të Shtabit të Përgjithshëm në territor të Kosovës, në Shqipëri kam pas raporte të mira me t'gjithë. (...) Përmuan nukka pas kurrfarë pengese, pse ka qenë edhe ministria tjetër e themelueme. Se unë e kam dit që Nasim Haradinaj

i jep llogari asaj ministrie. Qëllimi ka qenë i përbashkët, Nuk kemi pas probleme në terren, n'aspektin operativ. (...) Agim Mehmeti, zv-ministri, ashtë ai që na ka informuar për marrëveshjen, prandaj i kam besuar. Unë kam qenë njeri ma i besueshëm i Agim Mehmetit. (...) Si GO-3 kemi funksionuar deri me 11 maj (1999, në Koshare – konkretizim sqarues nga unë). Aty e tutje jemi caktuar si brigada 138 pre komandantit t'përgjithshëm, Agim Çeku. (...) Agim Ramadani dhe gjithë ushtarakët aty kanë qenë të sistemuar në FARK, por jo në hiarkinë e lartë, kanë qenë në nivel të brigadave. Dihet, brigatat 131, 134, në vitin 1998, me Agim Ramadanin, Rustem Berishën, Tahir Zemën.”

Naser Vllasi (44'10"): “Agim Ramadani, me Sali Çekun, me Rustem Berishën, me shokë, kanë dashtë me arsyetua atë ushqim e ato stërviqe edhe përgatitje, edhe nuk ju kanë përgjegj vendit t'vet ni mënyrë që t'presin t'na çliroi dikush tjetër, po kanë dashtë edhe vet ta bajnë luftën, edhe ta rrimi lirinë edhe me gjak. Urdhni për sulm me 1 prill mua nuk me ka ardh(...)”

SHTESË (APPENDIX) 23: PREN MARASHI

Intervistë te TV Dukagjini, më 6 prill 2019

“Në UÇK jam kyç më 4 prill 1998”, fillon përgjigjen Preni, në pyetjen e gazetares, “kur je kyç për herë të parë në UÇK?”, dhe vazhdon: “Deri në prill 1999 kam qenë ushtar i thjesht, kam marrë pjesë në disa zona të veprimeve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në prill 1999 u caktova komandant togu, ndërsa më 4 maj u caktova komandant i batalionit 4 të Brigadës 138 “Agim Ramadani”. Krumë. Aty kam qëndruar deri më 4 prill 1999. Kemi kaluar në

Papaj, ku kemi takuar gjithë eprorët e Ushtrisë çlirimtare të Kosovës, që ishin aty, si Rustem Berisha, Sali Çeku, Agim Ramadani, Xhafer Gashi, Anton Quni, Nasim Haradinaj, Esat Krasniqi. Takuam një epror të Shqipërisë, tashmë i ndieri, Adem Dahri. Këta i kemi takuar në Papaj, para se të nis sulmi.(...)

Në Papaj grupi sulmit nuk ka qenë më shumë se 115 veta. Tani thuhet se ata ishin pjesë e Grupit Operativ-3(...)

Pyetje: Përse është quajtur grup, kur bëhet fjalë për rreth 115 veta, që kanë bërë stërvitje ushtarake në Papaj. Kush e ka definuar atë si GO-3 dhe përse; kush i ka komanduar ato stërvitje aty dhe nga kush është financuar?

Përgjigje: Ditën e parë sulmuam me 170 vetë. Në fund u bëmë 2600 vetë. Batalioni I tij me 276 vetë, 70% nga diaspora. Nuk kanë pas ushtarët përgatitje të gjatë.

Nuk kemi pas mungesë armatimi(...)

Kemi zhvilluar 67-68 ditë luftime.(...)

Gjerësia e frontit 5 km(..)

Beteja përfundoi në 14 qershor, madje pati luftime të ashpra(...)

SHTESË (APPENDIX) 24:

Presidenti Serbisë VUÇIÇ

Beteja e koshares - Termopilet serbe

Gazeta Express, E mërkurë, 14 Qershor 2017, 23:27

Sot në Serbi është përkujtuar 18 vjetori i Betejës së Koshares, në të cilën pjesëtarët e UÇK-së morën përfundimisht kontrollin në kufirin shqiptaro – shqiptar dhe karakollin ku qëndronte Ushtria pushtuese e Serbisë.

Në këtë Betejë, siç e pranojnë zyrtarë serbë, kanë rënë 108 ushtarë të Serbisë.

Duke përkujtuar këtë betejë, e cila është zhvilluar gjatë muajit prill 1999, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, e ka quajtur atë Beteja e Dytë e Kosovës dhe Termopilet serbe, njofton “Politika” e Beogradit.

Presidenti serb, i cili sot ka zbuluar një shtatore të ushtarit të vrarë, hungarez ka thënë ai, por i lindur në Beograd, ka premtuar se për ushtarët e vrarë në Koshare do të ngrihet një përmendore e madhe në Serbi.

SHTESË (APPENDIX) 25: ALI RAMAJ (fsb)

“Beteja e Kosharës”, pavarësisht se si u organizua, nuk ishte vendimtare për lirinë e Kosovës, sado që LDK-istët përpiqen t’ia japin atë ngjyrë, dhe përpiqen të thonë, se ishte “arkitekturë” e LDK-së, edhe pse “komandanti suprem i Forcave të Armatosura të Kosovës-FARK” bërtiste në kupë të qiellit: “NATO t’i ndërpriste sulmet mbi caqet serbe.”

Nuk ishte punë e vogël që, pasi të përmyllej lufta, e gjithë ajo strukturë e vetëquajtur shtetërore, me Qeveri e Ministri Nomade gjithandej nëpër botë, e në fund të luftës të mund të shpallej (të akuzohej) bashkëpunëtore e Serbisë. Prandaj, punuan dhe punojnë me të madhe që të konvertoheshin pas lufte në çlirimtarë të vërtetë. Pikërisht për këtë qëllim, shkuan aq larg sa e bindën edhe Ibrahim Rugovën të fliste mirë për Betejën e Kosharës, duke e gënjyer se Agim Ramadani ishte ithtar i tij. Deri sot asnjë gjysëmnrjeriu nuk ofroi asnjë gjysëmargumenti që Agim Ramadani të kishte qenë anëtar apo ithtar i LDK-së.

Por, edhe po të ishte, çfarë do të thoshte kjo? Gjithë kjo propagandë zhurmëmadhe ka vetëm një qëllim: Përmes gjakut të tij të rehabilitohej gjithë ajo strukturë destructive, e cila s' bëri gjë tjetër, veçse mblodhi djersën e mërgimtarëve të shkretë dhe e shkërdheu nëpër kanale të fshehta, që veç ata e dinë se ku mbetën. Me këtë propagandë, ata përpiqen që përmes gjakut të një Agim Ramadani, të shterret lumi i gjakut që rrodhi para tij, vetëm e vetëm që të rehabilitohej një qyqar i korruptuar deri në fyt e që kishte dëshirë të quhej President i Kosovës, çfarëdo Kosove të ishte ajo. Ai qyqar kishte ngjallur simpati në Perëndim për dy arsye: Shtirej se ishte anti-islamist, e që këta i besonin, duke mos ditur se ishte asgjë dhe, së dyti: Ai kishte strukturë kërmilli, që pajtohej edhe me një marrëveshje arsimit, vetëm që në fund të një dokumenti të figuronte nënshkrimi i tij pranë nënshkrimit të një Presidenti, qoftë ai edhe Millosheviçi. Për Perëndimin, Ibrahim Rugova ishte garantues i paqes, por ja që kishte struktura edhe para-rugoviste që nuk u pajtuan me vasalitetin, servilizmin dhe sterilitetin e tij politik. Gjatë luftës kam thënë që FARK-u i Bukoshit ishte formuar për njëqind e një arsye, por kryesorja është ajo, që në përfundim të luftës do të hyjnë në Kosovë duke shtënë në ajër si çlirimtare, të cilën u munduan ta bënin përmes Brigadës së Tahir Zrmës *Mërgimi*, por nuk “iu dhezi” as përmes Kosharës...

Pas lufte, pse Ramushi, Hashimi, X-ksi e Y-psiloni i këndojnë LAVDI e ilahi atij “presidentit historik”, janë çështje xhepi, ani pse s' do të duhej të ndodhte. <https://ëëë.facebook.com/850797711938882/>

SHTESË (APPENDIX) 26: ENVER EMINI (fsb)

Serbija e ka urdhnu Qeverinë që me i largu nga fronti oficerat që i kem shkollu ne. Kështu dezerton Tahir Zemaj. Nga ajo kohë oficerat e Akademisë Jugosllave qëndrojnë në Laprakë dhe në disa ushtrimore si në Tropojë e gjetkë. Kjo vazhdoi deri te intervenimi i NATO-s kur shifet që Serbia do të kapitullonte. Dhe kështu bahet kjo marrëveshje që shumica e oficerave të hyjnë nën urdhërat e Shtabit të Pergjithshëm të UCK-së. <https://ëëë.facebook.com/1129341157096690>

SHTESË (APPENDIX) 27: SA NJERËZ JANE VRARË NË LUFTEN E KOSOVËS?

Gazeta Express, E diel, 16 Tetor 2018

Të dhëna konkrete për njerëzit e vrarë gjatë luftës në Kosovë: **Gjithsej 13.518**

[**8 Maj 2018, të prezantuara nga Radio “Europa e Lirë”** (që financohet nga Kongresi amerikan)]

Nga këta: shqiptarë: **12.452**

prej të cilëve:

- ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: **2.132.**

- civilë shqiptarë: **8.662, (prej të cilëve fëmijë shqiptarë të moshës 0 – 5 vjeçare: 239)**

- persona të zhdukur (deri në prill 2018): **1.658** (mund të ketë edhe serbë në këtë shumë)

Të tjerë: - serbë: **645 (civilë, ushtarë dhe policë)**

- të etnive tjera: **421 (civilë, police, ushtarë)**

SHTESË (APPENDIX) 28: The Battle of Košare – twenty years later

“The Srpska Times”, 09.04.2019

On this day twenty years ago, the Battle of Kosare began. The battle on the Yugoslav-Albanian border, which lasted for 67 days, a battle that took 108 lives. One of the heaviest fighting in the recent history of the Serbian army, which has become a symbol of the defense of the homeland.

The Battle of Košare was fought during the Kosovo War between the Army of #Yugoslavia and the Albanian terrorists (so-called “Kosovo Liberation Army”), who were supported by the NATO and Albanian Army and the French Foreign Legion. The battle was fought over the border crossing Raša Košares on the border between FR Yugoslavia and Albania from 9 April until 10 June during the NATO aggression on Yugoslavia. The aim of the Albanian side was a land invasion of Kosovo and the cutting off of the communications of the Yugoslav Army between the forces in Prizren and Đakovica. Another aim of the Albanians was the taking of the entire region of Metohija. After heavy fighting, Yugoslav army managed to defeat the attackers and prevent their entry to Kosovo. It is estimated that in the Battle of Košare there was around 15,000 Albanian terrorists, supported by NATO, the regular Albanian army and the French Foreign Legion.

Around 12,000 NATO troops were on the Albanian side, while only about 2,000 Serbian soldiers defended the the Serbian border, mostly members of the 125th and 549th Motor Brigade, parts of the 63rd Parachute Battalion and 72nd Special Brigade, and Russian volunteers. Battle of Košare took many lives on both sides.

Lufta e Koshares

Përbërja, efektiviteti dhe armatimi i brigadës së tankeve

Përbërja	Efektiviteti	A r m a t i m i						
		Granatshikësish	Motocikletat 82 mm	Topa vëllorë 100 ose 107 mm	Topa V. K. 75 mm	PRDKT "Sagger"	Tanqe T-54, T-55, T-72, M-84	Transportues të blinduar
Komanda dhe shtabi	66							
Tre batalione tankesh, gjithsej	846						2	
Një batalion këmbësorë dhe motorizuar	300	18	8				93	
Një grup artilerie vetëvizuese	245			18				30
Një bateri artilerie vetëvizuese KA	80				6			
Një bateri e PRDKT "Sagger"	75					6		
Kompani zbulimi	66							
Kompani xhenierë	61							
Kompani nderlidhëse	52							
Kompani e shëndetësisë	32							
Nënrepartet e shërbimit	70							
Gjithsej në brigadë	1893	18	8	18	6	6	95	30

Përbërja, efektiviteti dhe armatimi i brigadës së këmbësorisë

Përbërja	Efektiviteti	A r m a t i m i												
		Granatshikësish lehtë	Topa KT pa zbrapje 120 mm	Topa KT pa zbrapje 120 mm	Flakshikës të lulligatë	PRDKT "Sagger"	Mitrçez KA 12.7 mm	Mitrçez KA 7.62 mm	Mitrçez 12 mm	Obus 120 mm ose 102 mm	Tanqe T-54 ose T-55			
Komanda dhe shtabi	66													
Pesë batalione këmbësorë, gjithsej	1440	225	10	45	30		15	60	45					
Një grup artilerie 150 ose 122 mm	845												18	
Një batalion tankesh	282						6							31
Një bateri PRD KT	75													
Një bateri e artilerisë KA	78							6						
Kompani e zbulimit	66													
Batalion xhenier	148													

Lojal

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
Kompani e nderlidhjes	52												
Kompani e shëndetësisë	32												
Toga e mbrojtjes KK	13												
Toga e sigurimit	25												
Nënrepartet e shërbimeve	61												
Gjithsej në brigadë	4583	225	10	45	30		6	15	6	60	45	18	31

**SHTESË (APPENDIX) 30: SASIA E FORCAVE
SERBE NE KOSOVE**

60 mijë trupa ushtarake,
12 mijë trupat policore,
6 mijë trupat paramilitare e kriminale,
63 mijë civilë serb të armatosur.
SHUMA: 141 000

-

F u n d -
Tiranë, Prill – Korrik 2019

PRURJE E RE NË HISTORINË USHTARAKE TË KOSOVËS

Reçencë

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Libri i Dilaver Goxhaj (Shpëtim Golemi) të titulluar “Lufta e Koshares”, që përmban analiza, ballafaqime, krahasime dhe replika, është një prurje e re në literaturën e historisë ushtarake të Kosovës në veçanti, por dhe të historisë ushtarake shqiptare në përgjithësi.

Autori nëpërmjet një analize të shkoqitur dhe të plotë është munduar dhe ja ka arritur që të argumentojë se lufta është një ngjarje politiko-shoqërore që qëndron në ballafaqimin e armatosur dhe të dhunshëm mes popujve, shteteve ose konflikteve të brendshme apo të jashtme mes dy ose shumëpalësh kundërshtare. Lufta mund të përkufizohet edhe si një konflikt i dhunshëm ushtarak mes dy ose më shumë grupesh që përbëhen nga një numër i madh njerëzish. Lufta është shoqëruar gjithmonë me vdekjen e një numri të madh njerëzish dhe me vuajtje të mëdha. Kështu në Betejën e Koshares kemi humbjen e 114 luftëtarëve si dhe plagosjen e mbi 350 luftëtarë, pra është një nga ngjarjet më të veçanta të historisë së luftës çlirimtare në Kosovë, 1997-1999.

Dihet nga ushtarakët se në forcat ushtarake gjen zbatim ajo që quhet në tërësi forcë kundërshtuese. Në betejë apo në luftim kemi dy pjesë vepruese, në veprim (mësymje, sulm, goditje...) dhe kundërveprim (mbrojtje, kundërsulm, kundërveprim dhe forca ushtarake...) e domosdo një anë e forcave të betejës quhet mbrojtje dhe tjetra mësymje, ose në të kundërt. Forca e çdo formacioni luftëtarësh krijohet me forcën e mijëra njerzëve të bashkuar në kuadratin e atij formacioni. Por forca njerëzore bashkohet dhe me forcën e masës së mjeteve dhe të teknikës luftarake. Dhe në përplasjen në fushën e luftimit nuk ndodh gjë tjetër veçse shkarkimi i forcës. Kur këto forca, tashmë me qëllime ushtër grumbullohen dhe nisen për në front, askush nuk pyet për burimet e lëvizjes, për prejardhjen, por duam të marrim rezultatin e asaj force. E thënë më shkoqur, kur na pushton marrëzia e luftës, ne nuk pyesim për harxhimet, për pasojat dhe aq më pak për shpjegimet teorike të ngjarjes ushtarake. Kështu punët e ushtrisë mund dhe duhet të quajmë sistem sepse veprimet e betejës duhet jo vetëm të përgatiten nën një dorë, pra nën një mendim, por edhe duhet kuptuar se repartet apo njësitë, me veprimin, lëvizjen e tyre, ata mbeten në gjendje të pa shkëputur lidhjesh reciproke. Dhe njëra palë fiton apo e mund palën tjetër, sigurisht duke i konsumuar kundërshtarit forcat, por në të vërtetë njëra palë ka arritur të asgjësojë forcën e lëvizjes së kundërshtarit. Në Betejën e Koshares, bazuar më analizën e prezantuar në këtë libër, nuk u arrit zbatimi i urdhërit për hapjen e korridorit të funizimit në drejtimin Padesh -Drini i Bardhë.

Forcat që morën pjesë në Betejnë e Koshares e ndërpresin mësymjen, në kundërshtim me urdhrin e dhënë nga Shtabi i Përgjithshëm, dhe kalojnë në mbrojtje.

Dihet se në vendimin për betejën llogariten forcat si dhe kërkohen rrugë më të shkurtëra për të arritur qëllimin. Pra njëra anë të fitojë epërsi mbi tjetrën, por gjithnjë pa e ndalur lëvizjen. Sepse mund të ndodhë që pjesë të frontit apo reparte të veçanta të mos jenë aktive në atë betejë. Kjo mund të ndodhë për arsye të shumta, sidoqoftë ato mund të quhen “forca të vdekura”. Mund të pranohet se çdo repart, sidomos në veprimin mësymës, nuk bën gjë tjetër, veçse ai kalon pengesat që i bëjnë rezistencë, rezitencë që sa më shumë i afrohem rajonit ku janë përqëndruar forcat kryesore të armikut, aq më shumë rritet. Drejtuesi ushtarak me mend, forcat di t’i ndajë, skalionojë dhe ti përdorë në ato pika rezistence të kundërshtarit, të cilat atij i japin tempin e duhur për të ecur përpara. Nga çdo komandant i përgatitur e di mirë se shpejtësia e kalimit të pengesave, pra nxjerrja jashtë luftimit e çdo vije mbrojtëse, rrit forcën, fiton kohën, krijon pështjellim tek kundërshtari, ngre lart moralin dhe shpejton fitoren. Dhe kjo ndodh sepse shpejtësia në veprim rrit forcën nga një në dy herë më shumë. Pra reparte të ndryshme, në luftim shfaqin tjetër guxim, veprojnë më shpejtë, duke dhënë më shumë forcë luftarake. Sespe forca e gjallë e çdo batalioni, psh, është lëvizje, dhe kur humb një pjesë numerike e këtij reparti, kuptohet ka humbur forca e lëvizjes. Kështu ata ushtarakë që nuk kanë njohje të mjaftueshme për detyrat në fushën e mbrojtjes, ata që nuk kanë mundur të ndërtojnë vetë një vendim beteje, nuk mund të kuptojnë përmbajtjen e vërtetë dhe të domosdoshme të Artit Ushtarak. Këtu mund të përfshihen ata që vinë nga fusha të tjera por edhe kuadrot ushtarake me njohje mesatare. Prandaj të gjitha këto njohuri për Artin Ushtarak, kërkojnë aftësi vënies në jetë, dituri dhe respekt, gjë që na rezulton se

nuk u zbaruan gjatë zhvillimit të Betejës së Koshares.

Nga literatura ushtarake dimë që betejë quhet ndeshja e dy bashkimeve ushtarake kur këto përbëjnë forcat kryesore të ushtrisë së të dy palëve, ose, të paktën, veprojnë në mënyrë të pavarur në një teatër të veçantë të luftës. Dhe ky teatër i luftës ishte rajoni i Koshares (Padesh-Batushë-Junik), rajon i përzgjedhur nga vetë drejtuesit e GO-3 për të sulmuar. Nisma e Grupit të Tretë Operativ (GO-3) (Br. 138 “Agim Ramadani”) u mirëprit nga Shtabi i Përgjithshëm, pasi UÇK-ja kishte shumë nevojë për armë, municione dhe materiale të tjera për luftën, si dhe për popullin që i ishte bashkangjitur formacioneve të luftëtarëve.

Në libër gjatë gjithë analizës argumentohet se lufta është një tërësi e padukshme, pjesët e të cilës nuk kanë më vlerë më vete, veçse në raport me të tërën. Veprimi sulmues dhe ai mbrojtës kanë lidhje midis tyre, janë pra një metodë luftimi e domosdoshme. Sulmi kërkon edhe një kohë, çast pushimi, dhe gjatë këtyre pushimeve, kur forca e sulmit është ndalur, imponohet veprimi mbrojtës. E po ashtu, hapësira të cilën ne, të themi, e kemi lënë prapa sepse e pushtuam, duhet siguruar, pra duhet mbrojtur. Dhe mbrojtja kërkon vendosje forcash apo ruajtje, kundërveprim apo zjarr artilerie mbi të, ndryshe do të ecet dhe do të vuajmë nga metoda “korr e mos lidh”. Komanda dhe shtabi i asaj beteje kishin krijuar bindjen se armiku ishte i kërcënuar dhe se do të tërhiqej shpejt. Oficerët e këtij formacioni na rezulton se nuk u konsultuan me Shtabin e përgjithshëm të UÇK-së për mënyrën e kryerjes së detyrës.

Për ta kuptuar mirë tërë zhvillimin e betejës, kërkohet të njihet dhe roli i shtabit ushtarak në luftë. Mbetet e përhershme ajo që detyra e çdo shtabi ushtarak është

të mbajë në dorë fjetet e pafund të lëmshit të ngatërruar të gjendjes së frontit. Ai grumbullon elementë dhe pas studimit, krahasimit dhe përlllogaritjes, qartëson vendimin e mundshëm. Mbi çdo të dhënë, përfundimi apo vendimi paraprak, duhet një gjykim i lirë, i lirë dhe në dorë të specialistit. Prijësi ushtarak që do të vendosë mbi luftimin e ardhshëm, duhet të nuhasë situatën e frontit, ngjarjet duhen zotëruar, përballuar dhe të mbetemi mbi to, me kurajë ushtari të vërtetë. Por në këtë betejë nuk mund të flitet për sukses taktik, e jo më operativ e strategjik, ku nuk u depërtua me tepër se 2-4 km në thellësi të mbrojtjes kufitare serbe dhe duke kaluar edhe vetë në mbrojtje.

Shtabi ushtarak mendon vetëm për kapacitetet, taktikat dhe kombinacionet që duhet zbatuar për të përballuar luftën. Teoria ushtarake na ndihmon ta zgjidhim këtë lëmsh. Sytë i mbajmë tek prijësi ushtarak, i cili është e duhet të jetë një kapacitet i besueshëm dhe i provuar në betejë, kjo përbën bazën e drejtimit të lirë të luftës. Sistemi i ideve të Artit Ushtarak, në rritjen e tij, ka shkelur rrugë të shumta. E ato shkelje janë shpjeguar me fjalë duke radhitur paragrafë dhe më pas mendimin ushtarak që kemi sot, gjithnjë në raportin: mekanizëm, praktikë dhe teori. Kjo njësi taktike, (GO-3), kishte për mision të hapte korridorin e furnizimit, për të mundësuar kalimin në mësymje të përgjithshme të gjithë UÇK-së. Komandanti dhe shtabi kishin për detyrë: hapja e atij korridori dhe jo kapjen e Rrasës së Zogut dhe të Koshares.

Duke i përzier kërkesat e Artit Ushtarak me ndodhitë e shumta në luftë dhe mbi to ca përlllogaritje mbi forca, mjete dhe sasi armatimi, të pleksura dhe me letërsi, arrijmë në tentativë për të zbuluar përmbajtjen e vet Artit Ushtarak,

betejën dhe mënyra e zhvillimit të saj, mundësitë luftarake me sasi forcash, armësh, sasinë e zjarrit vrasës, etj,etj.

Shkenca Ushtarake përpunon Artin Ushtarak duke u bazuar në ligjet themelore që prodhojnë luftën e armatosur si fenomen shoqëror. Nga studimi i ligjeve përcaktohen parimet e organizimit dhe të zhvillimit të luftës së armatosur. Pastaj vijnë parimet dhe tezat teorike nga studimi i të cilave e sidomos zbërthimi, dalin rregullat dhe normat e veprimeve luftarake në shkallët taktike dhe operative, sepse shkalla strategjike kap dhe zbërthen kërkesat themelore të drejtimit të luftës, pra ligjet dhe ligjësinë. Të tëra këto janë elementët përbërës të Artit Ushtarak. Këto rregulla dhe norma formulohen në rregulloret ushtarake të luftimit dhe zbatohen në praktikat e pafund gjatë zhvillimit të luftës. Vetëm duke njohur dhe zbatuar me korrektesë ligjet dhe normat dhe doemos me metodë shkencore, mund të përpunohet Arti Ushtarak.

E tërë rruga, pra lëvizja në të cilën kanë ecur luftërat e pambarimta njerëzore, mund të kuptohen atëhere kur të njohim vetëm një pjesë të shkëputur të asaj përplasjeje vrastare. Por kjo shkëputje duhet të dihet se mbetet gjithnjë pjesë e së madhes, të përgjithshmes, sepse nuk ka e nuk mund të ketë ngjarje më vete, secila rrjedh nga një ngjarje tjetër, e kështu pa ndërprerje. Pra duke menduar se veprimtaria e një personaliteti, duke shkëputur nga vullnetet e lira të gjithë njerëzve është gabim. Pra, çdo ndryshim, çdo hap drejt luftës me apo pa Napoleonin, apo i të gjithë prijësve ushtarakë, me apo pa famë, i sollli shumica e vullneteve njerëzore dhe vetëm shumica e këtyre vullneteve i duroi një kohë e i asgjësoi pastaj.

Mbrojtja e forcave në Koshare ishte një fitore për serbët, sepse fusha e betejës mbeti në duart e serbëve. Forcat e GO-3 gjatë dy muajve na rezulton se nuk bënë as edhe një orvatje të vetme për sulm vendimtar, për betejë, por zgjodhën rrugën e mesme: duel artilerie. Libri me argumente dhe me një ballafaqim pas kaq vitesh thekson se nuk ishte siç duan ta quajnë “beteja më e madhe, nderi më i madh është Beteja e Koshares”. Luftëra janë zhvilluar kudo në botë, secila nga ato ka dhe pikën kulmore, por jo të thuhet në këtë formë si nderi më i madhe, apo beteja më e madhe.

Për të ngritur dhe ndërtuar Betejën e Koshares historianët ushtarakë me materialet që paraqiten në të ardhmen do të dinë të përcaktojnë qartë: terrenin, forcat (armiku dhe ne), ndërtimi operativ, urdhërat, planet, shtabe, përvojat, drejtuesit ushtarakë, dinamikën e zhvillimit të luftimeve, rënien e luftëtarëve, deri në nxjerrjen e përfundimeve ushtarake për këtë betejë. Libri i Dilaver Goxhaj (Shpëtim Golemi) do të jetë një ndihmesë shumë e madhe për të kuptura dhe qartësuar të gjithë dinamikën e luftimeve të zhvilluara në Koshare.

Tiranë, 5 korrik 2019

BIBLIOGRAFIA

1. SUN XU “ARTI I LUFTËS”, Tiranë, 1994
2. Arti Ushtarak i Luftës Popullore, Tiranë, 1985
3. Doktrina e përbashkët e FA të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2009
4. Jakup Krasniqi. “Kthesa e madhe”, Prishtinë, 2006
5. Doktrina Taktike e NATO-s, (ATP-35(B), Tiranë, 1999
6. Karl Fon Klauzeviç, “Mbi luftën”, Tiranë, 1996, Libri 6
7. Karl Fon Klauzeviç, “Mbi luftën”, Tiranë, 1996, Libri 7
8. Mehmet Shehu, “Mbi Luftën Popullore”, Tiranë, 1973
9. Strategjia Moderne (Autorë të ndryshëm), Tiranë, 1997
10. Kolonel Kristian Millotat, “Oficeri i Shtabit të Përgjithshëm”, Tiranë, 1993
11. Bernard Montgomeri ,“Fushë beteja (Kujtime), Tiranë, 1994
12. Henry Kissinger, “Diplomacia”, Tiranë,1999
13. Robert Greene “The 33 Strategies of Ęar”, London, 2006
14. Charls Henderson, “Silent Warrior”,New York, 2000
15. Naim Bujupi, “Popull dhe ushtarë të pandarë”, Prishtinë, 2018
16. Muhamet Çeta, “Me UCK□në në Koshare”, Instituti I Historisë I Kosovës, Prishtinë, 2000, Vëll. 1,2,3.
17. Simpoziumi shkencor I GO□3 (Br.138 “Agim Ramadani”, Gjakovë, 9.4.2000
18. Fjala e Rustem Berishës në Simpoziumin Shkencor Gjakovë, 9.4.2000
19. Human Rights Watsh:“Nën Pushtetin e Urdhrave”, Tiranë, “Korbi”, 2002 301

20. Informues për Ushtritë e Huaj, Akademia e SHP e R. Shqipërisë, Tiranë, 1989
21. Arkivi i Radio Kosova e Lire, vëll. 2, 3, Prishtinë, 2009
22. Radiokosovaelirë..com, 01 qershor 2019;
24. Radikosovaelire.com, 12 qershor 2019
25. Portali: Pashtriku.org, 2 Dhjetor 2018; 15.10.2018; 27 prill 2019; 29 prill 2019; 5 maj 2019; 12 maj 2019; 28 maj 2019
26. Arkivi i Agjencisë Kosova Press, Vëll. 3,4, Prishtinë, 2016
27. Gazeta “Dita”, Tiranë, 9 dhe 10 maj 2019
28. Gazeta “Bota sot”, 22 maj 1999; dt.11.10.2018; dt.2.5.2019; dt. 4.5.2019; dt.6.6.2019.
29. Gazeta “Telegraf”, dt. 10.10.2018
30. Gazeta Express, e hënë, 31 Mars 2014; E martë, 11 Prill 2017; E mërkurë, 14 Qershor 2017; E shtune, 11 Nentor 2017; 16 tetor 2018; 2 Maj 2019,
31. “Politika”, 9 prill 2017
32. Gazeta “The Srpska Times”, datë 09.04.2019
33. Reagim i Musa Gjakovës, 30 prill 2019
34. Radio”Europa e Lirë”, datë 8 Maj 2018,
35. Portali “Kosharja Forumi Lirisë”, 12.10.2018
- 34.Dragan Kamenov, prej komandantit të një toge mortajash serbe, raport në TV-Klan Kosova: “Rrëfime lufte nga Kosharja”, datë 2 maj 2019
36. TV Dukagjini: Intervista në Emisionin “debat plus”: dt. 09.4. 20114; 10.10.2018; 02.4.2019; 06.4.2019; 08.4.2019; 16.4.2019; 18.4.2019; 23.4.2019;26.4.2019; 02.5.2019; 06.5.201936.Reagime të Hysen Berishës, Tetor 2018, 2 dhe 4 maj 2019.

Përmbajtja e lëndës

Ideja e hapjes së koridorit në Kosharë!	3
Po cilët janë organizatorët dhe drejtuesit e “Betejës së Koshares”?	12
Pjesa e parë.....	39
Kreu i parë	41
Injoranca nuk është argument	41
Përgjigje z.Milazim Maraj.....	41
Dy Milazimët.....	43
Vështirë të falet një e keqe e paralajmëruar	46
Intriga është krijimtari	47
Strategjia Milazim-iane “e mbajtjes së territoreve”	51
Milazimi zbulon se me kapjen e fshatit Batushë u çlirua Kosova!.....	55
Intriga nuk di të fshihet, ajo të fajëson e të gjykon pa dëshmi.....	57
Ne, dhe ju trimat pas beteje.....	61
Kreu i dytë	64
Kreu i tretë.....	77
Gjeneral, ka dava Kosharja, gjeneral!	77
Po, çfarë duhet të kuptojmë me njësi taktike gjitharmëshe?	78
Pse e emërtuam “Operacioni Shigjeta”?	82
Fronti i Koshares	84
Kreu i katërt	87
Kur historia nuk është e saktë,	87
Populli e ka të vështirë.....	87

Të gjykoi edhe të tashmen	87
Po pse po zgjatemi për këtë lloj “beteje”?	89
Pse e themi këtë?	93
Qëllimi tjetër i gjithë kësaj propagande është që Ushtria Çlirimtare e Kosovës të ngelet një çështje e hapur	94
Kreu i pestë	97
Çdo gjë që kemi dëgjuar gjer më sot për “epopenë” e koshares dhe për br.128 Thënë prej një “gjenerali” të vetgraduar - janë opinione dhe jo fakte!.....	97
Kreu i gjashtë	104
Kalimi në mbrojtje	104
Imponim apo i vullnetshëm	104
Kreu i shtatë.....	121
Mbetet enigmë	121
Pse ndërpritet sulmi.....	121
Dhe pse kalohet në mbrojtje?!.....	121
Mbetet enigmë, pse GO-3 ndërpreu mësymjen?.....	127
A kishim forca për skalion të dytë?	141
Luftë e çuditshme!.....	142
Kreu i tetë	149
Detyra luftarake e GO-3	149
Kreu i nëntë	157
Nuk ka akademi ushtarake më të mirë se lufta.....	157
Dallimi mes luftës popullore dhe çdo lufte tjetër	183
Kreu i dhjetë	189
Faktet e dështimit nuk pushojnë së ekzistuari, por injorohen	189

Si është vepruar prej komandës së GO-3 për përmbushjen e atij vendimi?	197
Kreu i njëmbëdhjetë	201
Përfundime.....	201
Pjesa e dytë.....	219
Shtesat.....	219
Prurje e re në historinë ushtarake të kosovës	282
Reçencë	282
Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj	282
Bibliografia	289

